

*Vrasje në emër të Allahut*

# VRASJE NË EMËR TË ALLAHUT

MIRZA TAHIR AHMAD

## HYRJE

Ishte fundi i vitit 1950 kur u ndërmor puna origjinale në gjuhën urdu mbi të cilën është bazuar ky libër i tanishëm. Përkthimi i këtij libri në gjuhën shqipe u ofrohet lexuesve shqiptarë për dobinë e tyre. Libri origjinal është botuar me titull *Mez-heb Ke Nam Per Khun* (gjakderdhje në emër të religjionit). Që nga atëherë janë bërë disa botime dhe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, arabe, bengale, ruse, spanjole dhe indoneziane.

Burimi kryesor i *Mez-heb Ke Nam Per Khunit* ishin trazirat e shkallës së gjerë dhe tepër të përdhunshme anti-ahmadiane të vitit 1953 në Pakistan. Trazirat kishin mbaruar më herët se kur u shkrua libri - kur gati ishin shëruar plagët duke lënë pas disa vrragë që veniteshin ngadalë. Por rrjedhat e këtyre trazirave vazhduan të ekzistonin pa u zvogëluar dhe pa u dobësuar. A është Islami religjioni i luftës ose i paqes? A e përkrah Islami dhunën, gjakderdhjen, shkatërrimin dhe çrregullimin? A i mbyll sytë nga persekutimi i çfarëdo forme? A lejon plaçkitjen, zjarrvënien dhe vrasjen në bazë të preteksteve të diferencave doktrimore brenda Islamit apo në mes të feve të tjera? Andaj, libri nuk është shkruar me qëllim që të ndriçohen ngjarjet kryesore ose të ringjallen ndodhitë e vdekura e të varrosura të vitit 1953, por që të

përshkruhen çështje të rëndësishme të lartëpërmendura në formë pyetjesh. Vërtet, vuajtjet, mjerimet dhe turbullirat e vitit 1953 janë të lidhura me të kaluarën, mirëpo çështjet e ngritura në atë kohë vazhdojnë të jenë relevante dhe të rëndësishme edhe sot. Ato nuk kanë të bëjnë vetëm me Pakistanin ose me Islamin. Ato ngrisin pyetje të amshueshme universale që kanë të bëjnë me çdo religjion: çështjet e paqes dhe të luftës, të rregullit dhe të kaosit, të mbrojtjes dhe të shtypjes së të drejtave fundamentale njerëzore.

Disa vite me radhë Sejed Barakat Ahmadi kërkonte me ngulmim lejen për të përkthyer këtë libër timin në gjuhën angleze. Sejed Barakat Ahmadi kishte mbrojtur titullin e doktoraturës në lëmin e historisë arabe (në Universitetin Amerikan të Bejrutit) dhe të letërsisë (në Univesitetin e Teheranit). Ai ishte në shërbim të diplomacisë indiane dhe u pensionua si Komisionar i Lartë i Uest Indisë. Ai gjithashtu ishte edhe këshilltar i Delegacionit Indian në Kombet e Bashkuara, anëtar i Këshillit për Hulumtime Historike dhe student i mësimdhënies së arabishtës në Universitetet e AI-Ez-herit (Egjipt) dhe të Aligerit (Indi).

Para katër viteve, kur Sejed Barakat Ahmadi ndërmori këtë punë, ai vuante nga një kancer i shkallës së lartë në fshikëz. Mjekët i kishin dhënë një afat prej 6 muajsh për të jetuar. Ai vazhdimisht më shkruante duke kërkuar që t'i lutem Allahut për shëndetin e tij dhe duke shprehur dëshirën që Allahu i Plotëfuqishëm t'i japë mundësi që të përfundojë jo vetëm këtë punë, por edhe shumë projekte të tjera që i kishte ndërmarrë në të njejtën kohë.

Pa dyshim, është pikëllim i madh për ne se përkthyesi nuk gjendet më në mesin tonë - vdiq në fillim të vitit 1988. Por, në të njejtën kohë çdokush ndien një satisfakcion kur mëson se atij ju dha një zgjatje e jetës dhe ai nuk vdiq para se të mbaronte shumë punë të rëndësishme që kishte ndërmarrë. Gjatë disa viteve të fundit njera nga punët e tij të rëndësishme, që u prit me brohoritje të mëdha, ishte libri i tij *Hyrje në Skriptin Kuranik*.

Vetëm disa muaj para vdekjes së vet, ai ishte në gjendje të shkruajë një artikull të lartë akademik *Muhammedi dhe jehuditë* që u çmua si një model i hulumtimit historik.

Gjatë ditëve të fundit të jetës së vet, ai vuante nga dhembjet e mëdha dhe nga shqetësimi i tepërt, por ai ishte njeri jashtëzakonisht trim e i durueshëm dhe vazhdoi të punojë deri në çastin e fundit të jetës. Allahu i dhëntë paqe të amshueshme shpirtit të tij!

Kur përkthimi iu dorëzua botuesve, ata më dhanë opinionin e njerit nga komentuesit, i cili kërkonte që dorëshkrimin duhet t'i shtohet një kapitull rreth dënimit me vdekje për apostacinë (për ndërrimin e fesë). Ata më sugjeruan që tekstin ta begatoj me shkrime mbi tendencat e rritura të terrorizmit dhe të militantizmit në disa shtete islamike. Veçanërisht, çka është kuptuar në përfundim nga khomeinizmi dhe gadafizmi, popullit i jepet një impresion shumë negativ rreth mësimave paqësore të Islamit. Në lidhje me këtë do të çmohej lart nëse këtij libri i shtohen një apo dy kapituj me qëllim që të diskutohet tema që është lidhur ngushtë me ngjarjet

shumë të njohura të kohës. Prandaj librit ju shtuan dy kapituj të rinj që nuk ekzistojnë në tekstin origjinal.

Më në fund, dëshiroj t'i falënderoj disa persona, të cilët më ndihmuan në përgatitjen e këtij versioni të tanishëm: Mansur Ahmad Shahun për transkriptimin dhe diktimin e shënimeve të mia; Malik Sejfur Rahmanin, Abdul Momin Tahirin dhe Munir Ahmad Xhavedin, të cilët më ndihmuan bashkërisht në gjetjen e shënimeve të Hadithit [të thënave të Profetit Muhamedit s.a.v.s.; B. A. Rafikun për bashkëpunim me botuesin, dhe botuesin për përmirësimin e gabimeve tipografike.

Mirza Tahir Ahmad

## KAPITULLI I

### RELIGJIONI PIKON GJAK

A fillon historia jonë me mallkimin e vëllavrasjes? Ky është një tregim i përgjakshëm i vrasjes, i mbytjes dhe i torturave në çdo ngjarje. Është derdhur aq gjak gjatë tërë historisë sa që e tërë bota mund të ngjyrosej në të kuqe - bile shumica e gjakut do të tepronte. Kur do të pushojë njeriu së vrari njeriun? A do të shuhet ndonjëherë etja e tij për gjak?

Abili ishte njeriu i parë që pa asnjë arsye u vra nga vëllai i tij. Tregimi i kësaj vrasjeje është ruajtur nga Kurani e nga Bibla, si një mësim për ne të gjithë dhe do të mbetet si shembull gjer në fund të kohës. Po të studiosh historinë del i qartë fakti: se njeriu është një krijesë agresive. Agresiviteti i tij ka mbetur i pazbutur nga rritja e civilizimit. Njeriu edhe sot është aq mizor sa ka qenë para mijëra vitesh. Tregimi i pamëshirshmërisë, i tiranisë dhe i agresivitetit të tij është shumë i gjatë dhe mjaft i dhimbshëm. Zjarri i agresivitetit njerëzor nuk është shuar edhe pas egërsisë mijëravjeçare.

Vrasja e individëve dhe zhdukja e grupeve të tëra të popujve është një temë që përsëritet në histori. Shtetet kanë sulmuar shtetet; shtetet kanë luftuar kundër fqinjëve të tyre dhe kundër popujve që jetojnë shumë larg kufirit të tyre. Hordhitë që jetonin në stepe e në shkretëtira kanë mundur popujt me kulturë të lashtë; është derdhur gjak nga Cezari e nga Aleksandri; Bagdadi

qe shkatërruar nga Halaku e nga Çengezi: toka e kurukshetrave u bë e kuqe me gjakun e kauravasëve dhe të pandavasëve.

Nganjëherë gjaku, për shkak të supozimeve të gabuara, qe derdhur në emër të nderit e nganjëherë në emër të hakmarrjes. Nganjëherë hordhitë e uritura vërshuan tokat paqësore, duke kërkuar ushqim, dhe nganjëherë duke kërkuar epërsinë e sundim botëror. Mirëpo, më së shumti gjaku i njeriut - i krijuar sipas imagjinatës së Allahut - është derdhur në emër të Krijuesit të vet. Religjioni është përdorur si arsye për vrasje masive. Duke vërejtur këtë aspekt të natyrës së njeriut, dikush habitet dhe mendon se njeriu është gjinia më e ulët dhe më e pamëshirshme në rruzullin tokësor. Dikush pret se religjioni duhet të mësojë njeriun se si mund të jetë ai i civilizuar, por në vend të kësaj ai sheh se religjioni pikon gjak. Ky fakt të përkuqton atë incident që ngjau në kohën e krijimit të Ademit, të përshkruar nga Kurani dhe nga Bibla. Kurani thotë:

*Dhe kujtoje kohën, o njeri, kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po shkoj të caktoj një zëvendës në tokë. Ata thanë: A do të krijosh (njerëz të atillë) që do të krijojnë çrregullime dhe do të bëjnë gjakderdhje në të, kurse ne Të madhërojmë Ty dhe Të lavdrojmë Ty dhe Të konsiderojmë Ty të Shenjtë! Allahu tha: Unë e di atë që ju nuk e dini. (2:31)*

Ky dialog në mes të engjëjve dhe të Zotit është hutues, sepse çdo libër mbi historinë religjioze dëshmon se engjëjt kanë pasur mendim të drejtë. Nëse është ashtu, atëherë përse Zoti refuzoi të pranojë *këshillën* e tyre ose

të miratojë kundërshtimin e tyre për planin e Tij? Kjo, me të vërtetë, ishte në kundërshtim me vet profecinë dhe në fund të fundit edhe në kundërshtim me vetë pejgamberllëkun e Vulës së profetëve, Muhammedit s.a.v.s.

Historia e religjionit në çdo anë të botës dhe në çdo kohë është një histori e torturave, e shtypjes, e ekzekutimit dhe e kryqëzimit. Me të vërtetë, është një fakt tepër shqetësues kur njeriu atë religjion, që pritej të jetë strehim i fundit i paqes e i qetësisë, në një botë të luftërave dhe të konflikteve, e gjen se është bërë shkak i shkatërrimit dhe i gjakderdhjes. Megjithëse, në të vërtetë religjioni në vete nuk është shkak i vrasjeve masive, dhe është gabim po të mendohet kështu. Njeriut nuk i është dhënë religjioni që ai të inkurajohet për vrasje. Kur ndokush me ndenja të përziera të satisfaksionit dhe të habisë zbulon, se Zoti nuk e krijoi religjionin për këtë qëllim, fiton një fije shprese. Zëvendësi i Zotit - krijimin e të cilit e kundërshtuan engjëjt, ishte me të vërtetë një reformator i madh. Religjioni, të cilin predikonte ai, quhet Islam - religjioni i paqes. Pyetja mbetet këtu: Përse, në shikim të parë, historia krijon përshtypje se religjioni sanksionon gjakderdhjen dhe vrasjen në emër të paqes? Kurani e nënvizon qartazi se përse një vështrim i përciptë, i hedhur mbi historinë, mund të çojë njeriun deri te një përfundim i tillë. Ai e përmend të kaluarën për të treguar se ata që vazhdojnë të përdorin brutalitetin në emër të religjionit janë anti-religjioz ose janë ndjekësit e një religjioni të korrumpuar. Ka edhe disa liderë religjiozë që s'kanë dashamirësi, dhembshuri, mëshirë dhe devocion. Të them të vërtetën se ata janë



hipokritë me epshe për pushtet, dhe mizoria është pasioni i tyre mbizotërues. Do të jetë një gabim fatal të lidhësh religjionin me veprat e këqija të njerëzve të tillë. E vërteta qëndron në faktin se Zoti - burimi kryesor i mëshirës - nuk i lejon ndjekësit e një religjioni që t'i shtypin njerëzit e Tij.

Kurani përmend shumë ilustrime historike për të vërtetuar këtë pikë. Faza e parë e jetës së profetëve është paraqitur nga Kurani si një standard për reformën religjioze dhe për predikimin. Është fare e qartë se përdorimi i forcës është ndaluar në mënyrë të prerë. Ata ndjekës që erdhën shumë më vonë pas profetëve dhe predikojnë me forcë, trashëgojnë një religjion të korrupsuar nga koha ose ata vetë janë të korrupsuar. Ata përdorin forcën në emër të religjionit, edhe pse vetë religjioni i tyre e kundërshton forcën.

Historia religjioze e Kuranit është e mbushur plot me shembuj të forcës dhe të dhunës së përdorur në emër të religjionit nga ata që s'kishin ndonjë religjion. Njerëzit janë torturuar në emër të Allahut nga ata persona që s'kishin bile as njohuri më të vogël ndaj Zotit. Hazret Nuh a.s., i cili e ftoi popullin e vet në drejtim të pastërtisë morale dhe në drejtim të devocionit, nuk ishte njeri shtypës, por, përkundrazi, ata që dëshironin ta mposhtnin zërin e tij ishin në gabim. Duke dëgjuar predikimin e Nuhit a.s., ata thanë:

*Nëse nuk do të heqësh dorë ti, o Nuhë, do të gurëzohesh me siguri. (26:117)*

Historia e persekutimit religjioz, siç është përmendur në Kuran, tregon qartazi se ndjekësit e religjionit të vërtetë janë viktimat e dhunës. Kurani e paraqet shembullin e Ibrahimit a.s. që i thirri njerëzit në drejtim të Zotit, duke përdorur dashurinë, simpatinë dhe përgjithësinë. Ai s'kishte ndonjë shpatë e as ndonjë armë. Mirëpo, paria e popullit të tij bëri tamam atë që bënin kundërshtarët antireligjioz të Nuhit a.s. Ati i Ibrahimit, Azeri, tha: *Nëse ti nuk do të heqësh dorë nga predikimi yt, unë do të të gurëzoj ty.*

Fjalët që përdori Azeri, janë identike me ato që thanë armiqtë e Nuhit a.s. Të dy - Nuhi a.s. dhe Ibrahimit a.s. - u nënçmuan dhe u diskredituan; të dy u rrahën dhe u torturuan, por ata të dy i pranuan këto tortura me durim e me qëndrueshmëri. Duke ndezur zjarrin e shtypjes e të mizorisë, torturuesit e Ibrahimit a.s. u orvatën ta djegin atë për së gjalli.

Ata që e kundërshtuan Lutin a.s. nuk dinin gjë rreth religjionit. Prapëseprapë ata u bënë armiqtë e tij dhe e kundërshtuan atë dhe ithtarët e tij në emër të religjionit. Ata iu kërcënuan me dhunë dhe e alarmuan se ai dhe ithtarët e tij do të dëbohen. Ata u munduan të bëjnë gjithçka për ta ndaluar atë të predikojë religjionin e vet.

Persekutuesit e Shuejbit a.s. bënë në të njëjtën mënyrë dhe thanë: *Ne me siguri do të të dëbojmë ty nga vendi ynë, o Shuejb, dhe ndjekësit e tu, ose ju duhet të ktheheni në religjionin tonë. (7:89)*

Duke cituar këta shembuj, Kurani vërteton se ka një model të konvercionit (ndërrimi i fesë) në drejtim të

religjionit të vërtetë edhe model të përdorimit të forcës nga armiqtë e vërtetësisë kundër një konvercioni të tillë. Përgjigja e Shuejbit a.s. ndaj kërcënimeve e tipizon sjelljen e të gjithë profetëve të Zotit. Ai tha: *A edhe pse ne nuk dëshirojmë?*

A është e mundur që zemrat të ndërrohen me forcë, a mund të rikthehet njeriu në atë religjion të cilin ai e kishte lëshuar, pasi ka marrë vesh se është fals? Dhe a mund të rikthehet ai, pasi të ketë zbuluar vërtetësinë e religjionit të ri? Asnjë diktator s'ka qenë kurrë në gjendje t'i largohet kësaj logjike. Ky është një fakt historik se shpata kurrë nuk i ka sunduar zemrat e njerëzve e as nuk do t'i sundojë kurrë. Nëse trupi i njeriut mund të nënshtrohet me anë të forcës, atëherë shpirti kurrë. Besimi ka lidhje me zemër. Kjo është natyra e njeriut që kurrë nuk ndërrohet. Njerëzit e pafajshëm që janë dënuar me vdekje në emër të religjionit nga ata që nuk e kuptojnë religjionin, do ta ngrenë vazhdimisht zërin e tyre kundër kësaj padrejtësie. Ata do të shtrojnë përgjithmonë pyetjen: A kërkoni prej nesh që të qëndrojmë ndaj atij besimi, të cilin inteligenca jonë e ka refuzuar? Kurdoherë që është bërë kjo pyetje, armiqtë e religjionit në tërë botën i kanë akuzuar profetët për apostacinë (heqja dorë nga religjioni i mëparshëm) dhe i kanë dënuar me vdekje. Janë zbuluar tortura dhe dënime jo njerëzore. Tregimi i dhunës është një tregim që nuk përfundon kurrë. Hazret Musai a.s. dhe ithtarët e tij përjetuan të njetin fat nga duart e të ashtuquajturve liderë religjioz të asaj kohe, Faraoni, Hamani dhe Karuni, të cilët thanë: *Mbytni djemtë e atyre që i besuan atij, ndërsa gratë e tyre i lini të gjalla.*

Konvercioni nga një religjion në tjetrin nuk dënohej nga profetët, por, përkundrazi, ata dhe ithtarët e tyre dënoheshin për shkak të së ashtuquajturës apostaci. Pas Hazret Musait a.s., Hazret Isai a.s. përjetoi tortura dhe dhunë të ngjashme që arriti kulmin me tentativën për ta mbytur atë në Kryq. Gjakderdhja dhe dhuna kanë vazhduar gjithmonë në emër të religjionit - viktimat e të cilave gjatë tërë kohës kanë qenë ata që fajësoheshin për apostacinë. Megjithëse, asnjë libër i diktuar (hyjnor) nuk sanksionon dënim ndaj atyre që ndërrojnë fenë e tyre. Nëse disa njerëz të pandershëm bëjnë ndryshime në mësimet e paraqitura të librave të diktuar, vështirë se dikush mund t'i akuzojë vetë librat. Për nga natyra, Librat që iu diktuan profetëve të Zotit, nuk predikojnë dhunën.

Duke bërë fjalë rreth referencës së historisë religjioze, Kurani vërteton se profetët dhe ithtarët e tyre kanë qenë viktimat e dhunës; viktimat që e pranuan dhunën me durim. Është përtej imagjinatës së dikujt se populli që ndërron fenë mund të torturohet në emër të religjionit, dhe po ashtu edhe profetët e Zotit, të cilët dërgohen prej Zotit për të na bindur, nuk mund ta pranojnë këtë. Kjo bën të pakuptimtë edhe vetë misionin e tyre. Po ashtu, Kurani na tregon se si dënoheshin ithtarët e një profeti për shkak të konvercionit, jo vetëm në jetën e atij profeti, por edhe gjatë qindra viteve pas vdekjes së tij. Një shtypje e tillë nuk është sanksionuar nga Zoti. Mandej, në Kuran është përmendur edhe tregimi i popullit të Shpellës (të krishterët e parë). Këta të krishterë janë persekutuar 300 vjet me radhë, dhe unë i kam parë ato

vende ku këta njerëz të pambrojtur janë torturuar - amfiteatrot të ndërtuara për luftë të gladiatorëve me buaj dhe me luanë. Këto ishin ato vende ku u hidheshin të krishterët lakuriq bishave të uritura. Bishat duke ulëritur të krishterët e pambrojtur i shqyenin dhe i bënë një kafshatë goje. Nganjëherë, këta *renegatë* u hidheshin atyre demave, të cilat nuk ushqeheshin disa ditë me radhë. Bishat e uritura sulmonin duke ulëritur dhe duke lëshuar britma e fërshëllime. Të krishterët shpoheshin me brirë ose shkeleshin për vdekje. Dhe pas këtij festivali të përgjakshëm, romakët ktheheshin në shtëpitë e tyre, të kënaqur dhe të gëzuar. *Renegatët* merrnin dënim të përshtatshëm! Mirëpo, gjersa këmbët e të krishterëve dridheshin, zemrat e tyre tregonin një qëndrim të paluhatshëm ndaj besimit në Zot.

Persekutimi i tyre në mënyrë të herëpashershme vazhdoi tre shekuj. Dhe kur nuk gjetën vend për t'u fshehur, ata shpëtuan veten duke u strehuar në katakombet e nëndheshme. Këto labirinte të gjera ekzistojnë edhe sot e kësaj dite dhe na kujtojnë e na bindin se të krishterët mund të jetonin me insekte, me akrepa e me gjarpërinj, por jo me liderët religjioz të veshur bukur. Po ashtu, si *Es-habe Kahf* (njerëzit e shpellës) që u strehuan nën dhe, Kurani përmend edhe të krishterë të tjerë që besonin Zotin Një dhe që u dogjën për së gjalli. Zoti thotë: *E paraqes për dëshmi qiellin me plot yje. Dhe Ditën e Premtuar. Dhe dëshmitarin (e premtuar) dhe atë që dëshmohet. Shkatërrofshin ata të zotët e hendeqve! Ndezësit e zjarrit me lëndë djegëse! Kur ulen rreth tij. Dhe zemra e tyre dëshmon rreth asaj që bënë me besimtarët. Dhe mosbesimtarët nuk i urrenin besimtarët*

*por vetëm se e besojnë Allahun - Zoti i Plotëfuqishëm dhe i Lavdëruar - Të cilit i takon mbretëria e qiejve dhe e tokës, dhe Allahu është dëshmitar i çdo sendi.(85:2-10)*

Shkalla e lartë e këtyre akteve të shëmtuara u bë edhe më e zezë për shkak të të ashtuquajturve *mbrojtës religjioz*, të cilët në realitet e ndalojnë adhurimin e Zotit; viktimat e tyre ndjejnë një dhembje më të madhe, kur u ndalohet adhurimi i Allahut, se sa të përjetojnë tortura fizike në emër të Allahut. Kurani thotë: *Kush mund të jetë më mizor se ai që pengon të përmendet emri i Allahut në Xhamitë e Allahut dhe që përpiqet për shkatërrimin e tyre? Nuk ishte e udhës për ata që të hyjnë në xhami, por vetërn duke u frikësuar prej Allahut. Ata do të kenë poshtërim në këtë jetë dhe në botën tjetër do të kenë ndëshkim të rëndë. (2:115 )*

Pra, Kurani kategorikisht e hedh poshtë përdorimin e forcës për të shtypur lirinë fetare. Ai deklaron se besimtarët e vërtetë kurrë nuk e përdorin forcën për të predikuar emrin e Allahut, sadoqë ata ballafaqohen me dhunë.

Gjer më tani rrëfyem tregimin e persekutimeve ndaj profetëve që erdhën para asaj kohe kur drita e Zotit erdhi për të ndriçuar botën. Por, fundi i fundit dielli i vërtetësisë së amshueshme agoi në qiejt e ujdhesës arabe dhe bota së shpejti u ngroh nga drita e mesazhit të Muhammedit s.a.v.s.

Për mijëra vite me radhë bota ka pritur profetin më të madh. Një qind e njëzetekatër mijë profetë kanë jetuar

dhe kanë vdekur me shpresë për të pritur Vulën e profetëve (Hazret Muhammadi s.a.v.s.). Dhe më në fund ai profet, për hir të të cilit u krijua e tërë kjo botë, u paraqit duke reflektuar tërë madhështinë dhe shkëlqimin e Krijuesit të vet. Ai është më i madhi prej të gjithë profetëve dhe religjioni i tij është i përsosur dhe i përkryer. Mirëpo, edhe ai vetë u bë pre e persekutimeve dhe e torturave të pashoqe. Mësuesi dhe Prijësi ynë, Profeti Hazret Muhammedi s.a.v.s. i bëri ballë çdo forme të përfytyrueshme të dënimit, të torturave e të mundimeve shpirtërore që përjetuan profetët e mëparshëm dhe ihtarët e tyre.

Myslimanët e parë detyroheshin të shtriheshin për tokë nën diellin përzhitës. Gurë të zjarrtë viheshin mbi krahorët e tyre; ata tërhiqeshin zvarrë nëpër rrugët e Mekës si shtazët e ngordhura, mbeteshin të uritur e të etur, futeshin nëpër qeli të errëta, plaçkiteshin pasuritë e tyre dhe kështu shkatërroheshin familjet e tyre. Gratë shtatëzëna rrëzoheshin prej deveve dhe vdekja e tyre e pashmangshme u ofronte gëzim e argëtim mizorëve. Kufomat e tyre copëtoheshin - edhe mëlqia e axhës së Profetit të shenjtë s.a.v.s. është përtypur. Ata u copëtuan me shpata dhe u shpuan me shigjeta. Po ashtu, edhe Profeti i shenjtë s.a.v.s. u qëllua me gurë nga vagabondët dhe nga rrugaçët, dhe u përzu e u godit nga djemtë e djallëzuar, derisa kalldrëmet e Taifës u skuqen me gjakun e tij. Pos kësaj, ai edhe në fushëbetejen e Ohodit u lëndua rëndë.

Kjo gjakderdhje u bë në emër të religjionit, sepse myslimanët thoshin *Rabbonallah* - Zoti ynë është

Allahu. Ky persekutim dhe kjo torturë u bë në emër të religjionit, sepse, sipas politeistëve, Profeti i shenjtë s.a.v.s. dhe myslimanët ishin renegatë. Politeistët e quajtën Profetin s.a.v.s. dhe ithtarët e tij *sabi* - njerëz që e prishin dhe e ndërrojnë religjionin e të parëve të tyre dhe që adaptojnë ndonjë religjion të ri. Me qëllim që të mënjanohet kjo *e keqe*, banorët e Mekkës adoptuan metodat e torturës dhe të shtypjes që ishin përdorur edhe nga paraardhësit e tyre. Hazret Muhammedi s.a.v.s. dhe ithtarët e tij këto vuajtje dhe mundime i përjetuan për një kohë të gjatë, me durim e me qëndresë, për të vërtetuar se dhuna dhe mundimi shkaktohen dhe shfaqen nga njerëzit antireligjiozë e jo nga ndjekësit e së vërtetës.

Profeti i shenjtë s.a.v.s., i ngritur nga Allahu në një pozitë të pashoqe, u tregoi persekutuesve dashurinë e tij të papërshkrueshme, mëshirën dhe faljen në përgjigje të akteve të tyre të tiranisë e të mizorisë. Kur në fund arriti fitorja dhe politeistët e Mekkës iu nënshtuan profetit s.a.v.s., ai shpalli amnestinë e përgjithshme. Nuk u bë masakër e as nuk u caktua ndonjë dënim për persekutuesit e tij. Nuk u bë asnjë burgosje e as ndonjë ekzekutim. Por, përkundrazi, në vend të hakmarrjes jehonte proklamimi i Kuranit: *Sot nuk ka qortim kundër jush. Allahu ju faltë! Ai është më i Mëshirshërn prej të gjithë atyre që bëjnë mëshirë.*

Atë ditë u falën më mizorët. Iu falën gabimet atyre, të cilët robërit e pambrojtur i torturuan mbi rërën përvëluese të Mekkës. Iu falën edhe krimet atyre, të cilët i tërhiqnin zvarrë myslimanët nëpër rrugë si shtazët e ngordhura. U falën edhe ata që e shkatërruan paqen, dhe



ata që i gurëzuan myslimanët e pambrojtur - bile u fal edhe ajo grua që e pat përtypur mëlqinë e axhës së Profetit të shenjtë s.a.v.s.

Nëse historia e botës prej Ademit a.s. e gjer më tani shlyhet bashkë me të gjitha shënimet dhe evidencat e çdo persekutimi dhe të kartës së të drejtave njerëzore, një vështrim i hedhur mbi jetën e Profetit të shenjtë s.a.v.s. vërteton më së miri se religjioni i vërtetë nuk shkakton urrejtje, persekutim, shtypje ose ndalim të mendimit.

Mirëpo, Profeti i shenjtë s.a.v.s. nuk i përkufizoi mësimet e tij deri te thirrja e tolerancës religjioze. Por meqë profeti i Islamit u bë *mëshirë për tërë universin* (21:108), një deklaratë e përgjithshme është bërë nga Kurani:

*S'ka dhunë në çështjet e fesë. (2:257)*

Dhuna është e panevojshme, sepse rruga e drejtë dhe ajo jo e drejtë u dallua qartazi dhe s'ka mundësi që të ngatërrohen këto të dyja. Kjo deklaratë, në dukje, është e pazakonshme dhe jashtë rregullit. Nga njëra anë ky ishte një autorizim arbitrar që dënonte ashpër, me të gjitha mjetet që kishin në dispozicion, një grup të vogël njerëzish për shkak se ata u fajësuan për *apostacinë*. Dhe kur ky grup i vogël i *renegatëve* arriti fuqinë, atëherë çka ngjau na e tregon Kurani:

*Nuk ka dhunë në çështjen e fesë, sepse e vërteta është dalluar nga e pavërteta.*

*Kush i mohon djajt (që e pengojnë nga rruga e drejtë) dhe e beson Allallun, ai e kap fuqimisht lidhjen e fortë që s'këputet kurrë. Dhe Allahu është i Gjithëdëgjueshëm dhe i Gjithëdijshtëm. (2:257)*

Por, duhet përmendur se kjo proklamata është bërë në Sure *Al-Bakara* të Kuranit që ishte diktuar gjatë dy ose tri viteve të para, pas arritjes së Profetit të shenjtë s.a.v.s. në Medinë - vendi ku myslimanët jo vetëm që ishin të lirë nga persekutimi i mekasëve, por edhe kishin fuqi. A mund të ekzistojë ndonjë proklamata më humane dhe më bujare dhe e paqes nga një profet, i cili vetëm një ose dy vjet më parë ishte persekutuar për hir të ndërrimit të religjionit të vet.

Njerëzit që bëjnë persekutime në emër të religjionit janë tërësisht të paditur ndaj esencës së religjionit. Religjioni është metaforë e zemrave. Religjioni s'është politikë dhe pasuesit e tij nuk përzihen me parti politike. As religjioni nuk është nacionalitet me besnikëri të kufizuara, as ndonjë shtet me kufij gjeografikë. Ky është vetëm transformimi i zemrave - transformim në dobi të shpirtit. Vendi i religjionit është në thellësinë e zemrës. Është larg vringëllimës së shpatës. Malet nuk lëvizin nga shpata, as zemrat nuk ndryshohen me forcë. Derisa persekutimi në emër të religjionit është temë përsëritëse në historinë e agresivitetit njerëzor, liria e vetëdijes është temë përsëritëse në Kuran.

Profeti s.a.v.s. u urdhërua herë pas here që të proklamojë: *Dhe thuaj: Kjo është e vërteta prej Zotit tuaj, pra le të besojë ai që dëshiron, dhe le të mohojë ai që dëshiron.*(18:30)

Vërtetësia qartazi është një çështje e zemrës dhe ajo s'ka të bëjë me forcën. Kur një herë zbulohet e vërteta, s'mund të shlyhet me asnjë forcë. Kështu, pohimi i Kuranit se kur një herë zbulohet dhe njihet vërtetësia,

është zgjedhja jonë ta pranojmë ose ta hedhim poshtë. Po ashtu, në një vend tjetër Kurani thotë:

*Vërtet, Ky (Kuran) është një këshillë. Pra, kush dëshiron, le ta marrë për vete atë rrugë që e shpie te Zoti i tij.(76:30)*

Asnjë kartë e të drejtave njerëzore s'mund ta tejkalojë qartësinë e frazës kuranike *Faman sha'a* - kush dëshiron. Fjala *kush* është inkluzive. Është e çuditshme që dikush, përkundër kësaj deklarate aq të qartë, të mendojë se Islami i jep përkrahje përdorimit të forcës! Përsëri në Suren 39 të Kuranit Profeti i shenjtë s.a.v.s. urdhërohet t'u tregojë mosbesimtarëve:

*Thuaj: Vetëm Allahun e adlluroj unë duke ia kushtuar vetëm Atij bindjen time. E për sa ju përket juve, adhurojeni kë të doni pos Allahut. (39:15-16)*

Derisa liria e vetëdijes - liria e të besuarit dhe të predikuarit - është bërë gurë i themelit në religjion, dhe shtypja e herezisë religjioze është qëllim i forcave anti-religjioze, Kurani vë theksin e fortë mbi lirinë e konvercionit. Rreshti i fundit i Sures 109 të Kuranit vë në pah principin fundamental të një religjioni të vërtetë: *Ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time.* Edhe më parë Zoti e përmend të njëjtin princip, duke bërë një pyetje retorike. Duke iu drejtuar Profetit të shenjtë s.a.v.s., Ai thotë:

*Dhe sikur të kishite zbatuar Zoti yt dëshirën e Tij, vërtetë të gjithë njerëzit që ekzistojnë nëpër tokë do ta kishin pranuar besimin. Atëherë, pra, a ti do t'i detyrosh me dhunë të bëhen besimtarë? (10:100)*

Në planin e krijimit, njeriu duhet patjetër të ketë liri të plotë për të besuar ose, përndryshe, nuk ka dhunë; një njeri patjetër duhet të përdorë arsyen dhe logjikën e tij. Mbi të gjitha, besimi është një dhuratë nga Zoti, që u dhurohet atyre për të cilët Ai mendon se e meritojnë.

Një qind e njëzetekatër mijë profetë janë dërguar nga Zoti të cilët me predikimet dhe me shembujt e tyre praktikë kanë treguar se bartësit e mesazhit Hyjnor janë bërë pre e shtypjes dhe e dhunës e jo që ata ishin shtypës dhe tiranë. Profetët fituan zemrat e njerëzve me anë të forcës shpirtërore e morale e jo me anë të forcës fizike. Është një tragjedi e madhe se priftërinj të dekretuar dhe hoxhallarë me çallma të mëdha, bashkë me petkat e tyre të *dëllirësisë*, janë bërë torturuesit e njerëzve të pafajshëm në emër të profetëve të shtypur. Ata e kanë monopolizuar religjionin, edhe pse nuk e dinë gjë për atë. Ata deklarojnë se janë duke e mbrojtur nderin e profetëve të tyre - duke u sjellë vdekje të tjerëve, duke përhapur gënjeshtër të ndyra dhe mbi të gjitha duke bërë krime të tmerrshme, që e turprojnë njerëzinë. Ata këtë e kanë bërë para lindjes së Profetit të Islamit s.a.v.s. dhe ende janë duke e bërë.

Në Evropën mesjetare, të ashtuquajturit ithtarët e Krishtit, papat, prelatët, kardinalët, klerikët dhe paria e Kishës kanë shkruar një kaptinë të terrorit në librat e historisë. Augustini i Shenjtë këtë e quajti *persekutimi i justifikueshëm* që Kisha e Krishtit e bëri ndaj jobesimtarëve. Historianët e sotëm krishterë pranojnë se ky, *persekutim i justifikueshëm* bërë në emër të Krishtit, është një turp për Kishën. Muzeu i figurave të dyllta,

*Madam Tysao*, në Londër ka një ekspozitë mjaft prekëse, të çuditshme dhe të tmerrshme të këtij persekutimi. Muzeu originalisht u themelua në Paris më 1770, më vonë u vendos në Angli në vitin 1802. Në këtë Muze janë vënë statuja, të punuara nga dylli, të njerëzve të famshëm dhe jo të famshëm. Dhoma e Tmerreve është një lloj burgu nëntokësor. Aty figurat janë punuar në mënyrë aq misterioze sa që të duken sikur marrin frymë. Shumë vizitorë ndalen pranë një rojtari për të pyetur për drejtimin, por aty e gjejnë vetëm dordolicën me të cilën ishin duke biseduar. Aty gjenden edhe maskat e vdekjes së kokave të prera në gijotinë të Luisit XVI dhe të Marie Antonitës, të mbledhura personalisht nga Madam Tysao. Aty gjendet edhe një trekëmbësh autentik bashkë me instrumentet e tjera për tortura: shtyllë ndëshkimi, trungje, kamxhikë, dukatë, grazhda, stol, kryqi, karmanjolla, kapistra si dhe shumë mjete të tjera të këtij lloji. Disa ekspozita janë aq rrënqethëse sa që mbahen të mbuluara me perde që mos i shohin fëmijët dhe njerëz me zemër të dobët.

Kjo është një botë e çuditshme ku në një anë njeriu mund të arrijë edhe lartësinë më të madhe, d.m.th. gradën e profetit dhe mund të bisedojë me Krijuesin e vet, por në anën tjetër kur rrëzohet ai, rrëzohet në formë të një prifti me *petka religjioze*, duke u bërë mallkim për njerëzimin. Ai, bile, mund të rrëzohet edhe më poshtë dhe bëhet një inkuizitor! Instrumentet e torturave të ekspozuara në Madam Tysao rrëfejnë ngjarjet tragjike të inkuizicionit spanjoll dhe francez. Janë torturuar njerëz të pafajshëm në emër të të ashtuquajturit ndërrim të fesë (apostaci); ata detyroheshin të pohojnë dhe të deklarojnë

se kanë hequr dorë nga parimet e religjionit të vërtetë. Por, kur ata refuzonin të vepronin kështu, hidheshin në grazhda, rriheshin, torturoheshin, linçoheshin, përshkoheshin në hunj dhe digjeshin për së gjalli. Viktimat ose pranonin kërkesën e tyre ose shijonin vdekjen e tmerrshme. Paria e Kishës me të gjitha veshjet e tyre të bukura, të cilët kanë bërë torturime kundër të krishterëve të pafajshëm, na përkujtojnë Krishtin me kurorë gjembash e duke derdhur gjak mbi Kryq dhe që qante me dënësë dhe luste Zotin me zë të ulët: *Eli, Eli lema sabaktani* (o Zoti im, përse më lëshon (Mateu 27:46). Të tillë ishin këta që simbolikisht e përdornin mishin dhe gjakun e Krishtit në shërbimet e Kungatës, dhe nuk e përkujtonin se Farisi e luti Pontios Pilaten ta kryqëzojë Krishtin, sepse ai ishte renegat dhe e mohoi fenë e të parëve të vet. Mirëpo, kryqëzimi i Krishtit humb rëndësinë dhe zbehet kur krahasohet me inkuizicionin e të krishterëve të mesjetës. Është kënaqësi dhe, pa dyshim, krenari që Islami me këtë deklaratë *S'ka dhunë në çështjen e besimit* më në fund e mbylli derën e masakrimeve të tilla në emër të religjionit. Por, fatkeqësisht, kjo kënaqësi dhe krenari pati një jetë të shkurtër. Çdo mysliman e ul kokën e tij nga turpi kur ai i sheh hoxhallarët (ulematë) e sotëm duke u orvatur për të krijuar rrugë të reja të shtypjes së lirisë së të menduarit e të vetëdijes, ashtu siç bënin priftërinjtë katolikë të Evropës mesjetare. Dhe, megjithëkëtë, këta janë ata hoxhallarë (ulema) që pohojnë se e mbrojnë nderin e Profetit të Shenjtë s.a.v.s., të cilin Kurani e përshkruan si *mëshirë për tërë universin*.

Këta hoxhallarë deklarojnë se janë personifikim i vërtetë i mëshirës, por zemrat e tyre janë të zbrazëta nga mëshira. Përkundrazi, ata janë plot zemërim. Përdorimi i forcës në emër të religjionit tani është bërë pjesë e besimit të tyre. Në emër të ujit të shenjtë të Zotit - zbritur për t'i sjellë freski temperamentit tonë - ata ndezin zjarrin e urrejtjes e të zemërimit në zemrat e njerëzve të pafajshëm. Ihtarët e Princit të paqes (Muhammedi s.a.v.s.), gjaku i të cilëve e pastroi Arabinë barbare, tani tentojnë të vrasin njerëz të pambrojtur. Në emër të mbrojtësit të shtëpive të pambrojtura, të njerëzve të varfër, ndjekësit e tij inkurajojnë plaçkitjen e shtëpive të atyre që nuk janë në gjendje të mbrojnë veten. Në emër të Profetit s.a.v.s., i cili mbrojti edhe nderin e grave të rrugaçëve, shkatërrohen martesat të lumtura e të dashura të grave myslimane dhe shndërrohen në marrëdhënie kurvërie. Në emër të ndërtuesit të xhamisë së parë në Medinë, të cilin ai ua ofroi të krishterëve të Nagjranit, për shërbime të së Dielës; në emër të Profetit s.a.v.s. që i mësoi ihtarët e vet të respektojnë tempujt e besimtarëve të tjerë, ulematë (hoxhallarët) e sotëm nxisin masën që t'i rrënojnë xhamitë e një grupi të vogël, jeta e të cilëve është dedikuar për përhapjen e shahdetit. Aksionet e padrejta dhe veprat e shëmtuara, të cilat i pat hedhur poshtë dhe i pat ndaluar përgjithmonë Profeti i Shenjtë s.a.v.s., tani po përsëriten tamam në emër të atij Profeti. Si do të mendonte Profeti s.a.v.s. sikur t'i shikonte hoxhallarët e umetit të vet, duke i akuzuar në mënyrë false udhëheqësit e grupeve dhe të sekteve të tjera myslimane, duke bërë vepra të ndyra dhe duke i sharë gratë dhe amviset? Si do të reagojë një agnosticist për këtë demonstrim të *zellit religjioz*? A mund të mendojë një

musliman, bile edhe për një çast, se Profeti ynë s.a.v.s. t'i ketë këshilluar hoxhallarët e umetit të vet që të mbajnë fjalime provokative dhe përçarëse, ose ai të ketë urdhëruar që ata të mbajnë fjalime të zjarrta, që t'i flakërojnë fshatra të tëra të njerëzve të varfër e të pambrojtur? I pakënaqur me tërë këtë, a i pat treguar Princi i paqes s.a.v.s. liderëve religjiozë që t'i konsiderojnë renegatë të gjithë ata muslimanë që Islamin e interpretojnë dhe e kuptojnë ndryshe nga interpretimi i tyre? A ka lejuar ai vrasjen e atyre *renegatëve* dhe të grave të tyre dhe rrënimin e xhamive të tyre - se gjoja kjo është rrugë e vetme hyjnore për të zhdukur apostacinë?

Këto janë ato pyetje për të cilat ne të gjithë duhet të mendojmë seriozisht. Myslimanët duhet t'i marrin në konsideratë sjelljet dhe qëndrimet e këtyre hoxhallarëve. Sepse, shtypja, torturat, ekzekutimi, zjarrvënja dhe rrafshimi i xhamive nuk janë traditat e Profetit të Islamit s.a.v.s. Çdo gurë e rrugëve të Mekkes, ku u tërhoqën zvarr të ashtuquajturit *renegatët*, e dëshmon këtë. Po ashtu, këtë e dëshmon edhe çdo kokërr e rërës përvëluese e Arabisë ku u torturuan njerëzit e pambrojtur vetëm se e përqaftuan Islamin. Kalldrëmi i Taifës ku u derdh gjaku i Profetit s.a.v.s., dëshmon faktin se Mësuesi ynë i madh s.a.v.s., në mënyrë të mëshirshme, nuk mësoi se besimi religjioz është i domosdoshëm e as nuk dha urdhër që të digjen shtëpitë e adhurimit në emër të adhurimit, ose të çnderohen gratë në emër të nderit. Kokat e muslimanëve ulen poshtë nga turpi dhe shpirtërat e tyre derdhen lot për liderët religjiozë të sotëm, të cilët predikojnë dhunën në emër të Profetit të Shenjtë s.a.v.s.



## KAPITULLI II

### PREDIKIMI I ISLAMIT: DY PIKËPAMJE KONTRADIKTORE

1. *Kur çdo metodë e bindjes (gjatë predikimit 13 vjeçar) dështoi, Profeti s.a.v.s. kapi shpatën ... kjo shpatë e largoi të keqen dhe i shleu veprat e këqija, papastërtinë e zemrës dhe ndytësinë e shpirtit. Jo vetëm kaq, por shpata bëri diçka më tepër. Kjo ua largoi verbërinë dhe kështu ata filluan ta shihnin dritën e vërtetësisë - dhe kjo (shpatë) gjithashtu e shëroi sëmundjen e tyre të arrogancës - arrogancë e cila pengon njerëzit për të pranuar vërtetësinë ... qafat e palakueshme dhe kokat krenare u përrulën me modesti.*

(Molana Abul Ala Modudi)

*Muhammedi predikoi Islamin duke e mbajtur shpatën në një dorë kurse Kuranin në dorën tjetër.*

(Prof. Wilfred Cantwell Smith)

2. *Kritikët janë të verbër. Ata s'mund të shohin se të vetmen shpatë, të cilën e përdori Muhammedi, ishte shpata e mëshirës, e dhembshurisë, e miqësisë dhe e faljes - shpata që i mposhti armiqtë dhe i pastroi zemrat. Shpata e tij ishte më e mprehtë se shpata e çeliktë.*

(Gyanandra Dev Sharma Shastri)

Këto janë dy pikëpamje kontradiktore mbi mënyrën se si është përcjellë mesazhi i Islamit në botë. Kritikët, veçanërisht orientalistët, pohojnë se luftërat e Profetit të Islamit kanë pasur karakter ofensiv dhe njerëzit u futën me dhunë në Islam. Sipas historianëve objektivë, kjo pikëpamje nuk përputhet me realitetin. Profeti s.a.v.s. nuk përdori as forcën e as dhunën për të predikuar Islamin dhe të gjitha luftërat që bëri ai kanë pasur vetëm karakter mbrojtës. Ekspansioni (zgjerimi) i Islamit ishte vetëm rezultat i forcës morale e shpirtërore të Profetit s.a.v.s.

Prapëseprapë, pikëpamja se Islami u përhap me forcë, fatkeqësisht, mbrohet edhe nga vetë disa liderë myslimanë. Ata, si orientalistët, jetën e Profetit të Islamit s.a.v.s. e ndajnë në dy faza: në fazën e Mekkes dhe në atë të Medinës. Ata janë të mendimit se ai në Mekke ishte i dobët dhe i pafuqishëm, andaj tregoi sjellje të bindjes dhe kompromise të bashkekzistencës paqësore. Pastaj, në Medinë kur arriti fuqinë, iu drejtua shpatës. Sipas këtyre mendimtarëve, po të mos vepronte në këtë mënyrë, nuk do të kishte revolucion shpirtëror në Arabi dhe as nuk do të përhapej Islami. I ndjeri Molana Abul Ala Modudiu ishte një udhëheqës paraushtrues i kësaj pikëpamjeje. Në librin e vet *Al-xhihad Fil Islam* ai shkruan:

*I deleguari i Allahut për 13 vjet me radhë i ftoi arabët që të pranojnë Islamin. Për këtë qëllim ai shfrytëzoi çdo mjet të mundshëm të bindjes, u paraqiti argumente dhe prova të pakundërshtueshme, u tregoi mrekullitë dhe vuri para tyre jetën e vet si një shembull të devotshmërisë dhe të moralit. Shkurt, ai përdori çdo mjet të mundshëm komunikimi, por populli i tij refuzoi ta pranojë Islamin.*

Më pikëllohet zemra ime kur do të citoj pjesën e mbetur të këtij paragrafi të lartëshënuar, mirëpo është e nevojshme ta citoj: *Kur çdo metodë e bindjes dështoi, Profeti kapi shpatën. Ajo shpatë ua largoi të keqen dhe i shleu veprat e këqija, papastërtinë e zemrës dhe ndytësinë e shpirtit. Jo vetëm kaq, por shpata bëri diç më tepër. Kjo u largoi verbërinë dhe kështu ata filluan të shihnin dritën e vërtetësisë - dhe ajo (shpatë) gjithashtu shëroi sëmundjen e tyre të arrogancës - arrogancë e cila i pengon njerëzit të pranojnë vërtetësinë ... qafat e palakueshme dhe kokat krenare u përulën me modesti. Si në Arabi ashtu edhe në vende të tjera, zgjerimi e përhapja e Islamit ishte aq e shpejtë sa që brenda një shekulli një e katërta e botës e kishte përqafuar atë. Ky konvercion u bë për shkak se shpata e Islamit i shqeu perdet që kishin mbuluar zemrat e njerëzve.*

Deklarata e lartëpërmendur është dhënë nga një dijetar mysliman, i cili vetën e konsideron *mizaxh shams resul* - njeri që e gjen veten në harmoni të plotë me mendjen e me zemrën e Profetit të Islamit *s.a.v.s.* në një shkallë aq të lartë sa që ai ka drejtë të jetë i autorizuar për interpretimin e domethëniesve të vërteta të të thënave dhe të veprave të Profetit *s.a.v.s.* - një pohim që nëse pranohet, do t'i japë pohuesit aq ose më shumë të drejtë se sa gëzonte vetë Profeti i Islamit për të reprezentuar të kuptuarit e Fjalëve të Zotit. Kjo do të thotë se të kuptuarit e Molanës i përket tragjedisë së papërshkrueshme - sepse është bërë nga një lider mysliman dhe e përsërit pohimin e pabazë të armiqve të Islamit. Ata që e akuzojnë Profetin *s.a.v.s.* se gjoja i futi

njerëzit me dhunë në fe janë orientalistët me paragjykime. Frazheologjia e Molanës duket se e lavdëron Islamin, por, në realitet, ajo vërteton akuzën e kritikëve evropianë të Islamit. R.Dozi thotë:

*Gjeneralët e Muhammedit predikuan Islamin, duke mbajtur shpatën në njerën dorë dhe Kuranin në dorën tjetër.*

Smithi thekson se *nuk ishin gjeneralët por ishte vetë Profeti, i cili predikoi duke mbajtur shpatën në njerën dorë kurse Kuranin në dorën tjetër.*

Gjeorgje Sale shkruan: *Kur ndjekësit e Profetit u shtuan për nga numri, atëherë ai deklaroi se Zoti e ka lejuar atë që të sulmojë mosbesimtarët me qëllim që të zhduket idhujtaria dhe të stabilizohet religjioni i vërtetë.*

Dr. C. G. Fanderi që gjatë pjesës së fundit të shek.XIX ishte i angazhuar aktivisht në punë misionare, në mesin e myslimanëve Indian, nxiti turbullira të mëdha duke shkruar trakte të diskutueshme, siç ishte trakti *Profeti fals i Islamit*. Në një ndër traktatet e tilla ai shkruan:

1. *Gjatë 13 viteve, Muhammedi përhap dhe predikoi fenë e tij të re në bazë të kushteve të pajtueshmërisë dhe me durim të madh.*
2. *Tani (në Medinë) ai u bë Al-Nabio Bis sejf (profeti i shpatës).*
3. *Nëse ne studiojmë sjelljet e ihtarëve të Muhammedit, do të shohim se ata ishin të mendimit se nuk është e domosdoshme për ta që të ndjekin ndonjë kod religjioz dhe moral. Zoti nga ata kërkoi vetëm një gjë: se ata*

*duhet të luftojnë për hir të Zotit me shpata, shigjeta dhe kama për të vazhduar vrasjen.*

Dhe pas këtij njoftimi, Dr. Fanderi përfundon: *Ju duhet të zgjidhni njërin prej këtyre - Krishtin, Fjala e Zotit, ose Muhammedin- birin e Abdullahut. Njëri prej tyre është ai që e sakrifikoi jetën e tij për hir të veprave të devotshmërisë, kurse tjetri jetën e vet ia dedikoi shpatës.*

Aloj Sprangleri, Henri Kope dhe shumë kritikë të tjerë të Islamit e ndoqën vijën e njëjtë të sulmit kundër Islamit e kundër Profetit të Islamit s.a.v.s. Vashington Irvingu shkoi një hap më tutje. Në kopertinën e njërit ndër librat e tij është botuar një pikturë imagjinare e Profetit të Islamit me një shpatë në njërën dorë dhe Kuranin në dorën tjetër.

Nëse dikush e krahason tërë këtë që u përmend më lartë me citimin hyrës të *Al-xihad Fil Islamit* të Molana Modudiut, ai do të bindet se këto janë ato kritika që më parë patën shkruar kritikët e Profetit.

Si Molana edhe orientalistët janë të mendimit se Islami ka një natyrë dhune. Por, përkundër këtij besimi, Molana e beson Islamin, kurse të tjerët e refuzojnë. Pavarësisht nga fjalët, nuk ka dallim në mes të paragrafëve 1,2 dhe 3 të citimeve të lartëpërmendura të Molana Modudiut dhe të citimeve të lartëshkuara të Dr. Fanderit. Mirëpo, njëri tregon respektin e një myslimani, kurse të tjerët sarkazmën e një kritike të idhët.

Komentime të gënjeshtërtë të orientalistëve, të bëra kundër Profetit të Islamit s.a.v.s., s'janë aq të çuditshme, sa janë të prekshme. Ato, nganjëherë, bëhen për shkak të

mosdijes, por në të shumtën e rasteve për shkak të smirës. Armiqësia ndaj Islamit e përleu bile edhe objektivitetin e historianëve të balancuar. Por, më të prekshme janë komentet e atyre myslimanëve, të cilët pohojnë se e ndjekin në mënyrë të devotshme profetin e pafajshëm, mirëpo prapë e prezantojnë atë - ose me anë të injorancës ose të arrogancës - si një barbar që përdori shpatën për t'i futur njerëzit në fenë e vet dhe për të pushtuar tokat!

Molana Modudiu nuk ishte aspak i bindur ndaj bukurisë natyrore të Islamit, ose ai nuk ishte i bindur se Islami mund t'i pushtonte zemrat vetëm me anë të forcës së vet shpirtërore, as në të kaluarën e as bile sot. Ai shkruan: *Marrëdhëniet dhe asociacionet njerëzore janë aq të integruara sa që asnjë shtet s'mund të ketë liri të plotë të aksioneve në kuadër të principeve të veta, derisa principe të tilla të mos jenë në fuqi në ndonjë shtet fqinj. Prandaj, grupet myslimane nuk do të jenë të kënaqura me stabilizimin e një shteti islamik vetëm në një rajon. Duke u varur nga burimet e veta, ata duhet të përpiqen të shpërndahen në të gjitha drejtimet. Kështu ata, në një anë, do ta përhapin ideologjinë e tyre, ndërsa në anën tjetër ata do t'i thërrasin njerëzit e të gjitha kombeve që ta pranojnë doktrinën e tyre - ku qëndron shpëtimi i tyre i vërtetë. Nëse shteti i tyre islamik do të ketë fuqi dhe mjete e burime, ai do të luftojë kundër shteteve jo islamike dhe do t'i shkatërrojë ato, dhe në vend të atyre do t'i stabilizojë shtetet islamike.*

Molana Modudiu i përkrah pikëpamjet e përdredhura të Sër Villiam Murit rreth Profetit dhe Islamit. Në

biografinë e tij mbi Profetin, të cilin ai e shkroi për ta ekspozuar *Profetin fals të Islamit*, sipas kërkesës së Dr. Fanderit, Sër Villiam Muri thotë: *Shpata e Muhammedit dhe Kurani janë armiqtë më fatal të civilizimit, të lirisë dhe të së vërtetës, që bota deri më tash ka njohur.*

Lideri i madh hindu, Gandixhi, në ditët e hershme të jetës së tij ishte i influencuar nga piktura e shtrembëruar e Islamit, siç vërtetohet nga ky shkrimi i tij: *Islami ka lindur në një atmosferë dhune. Në atë kohë kur forca e tij vendimtare ishte shpata, dhe bile është edhe sot.*

Mirëpo, Gandixhi ishte njeri mjaft mendjehollë, andaj ai e korrigjoi veten dhe në gazetën e tij *Young India* shkroi: *Sa më shumë po studioj aq më shumë po zbuloj se forca e Islamit nuk qëndron në shpatë.*

Hindusët e tjerë, bile edhe Arja Samaxhistë, të cilët kanë bërë një studim objektiv të Islamit, e ndjekin *zbulimin* e Gandixhiut. Pandit Gianandra Dev Sharma Shastri thotë: *Kritikët e Islamit me paragjykime dhe veçanërisht ata që dëshirojnë të provokojnë përleshje në mes të hindusëve dhe të myslimanëve në Vend, thonë se Hazret Muhammedi pas arritjes së fuqisë në Medinë nuk mundi ta mbajë më fasadën e mëshirës dhe të butësisë së vet. Ku ai për të fituar me çdo mjet fuqinë e përjetshme, statusin dhe pasurinë, përdori forcën dhe dhunën dhe u bë profet vrasës dhe gjakpirës. Ai ra poshtë nga niveli i idealit të durimit, të përmbajtjes dhe të qëndrimit të tij. Por, kjo është pikëpamja e atyre vëzhguesëve që janë paragjykonjës dhe partizanë, dhe të cilët janë mendjeshkurtër dhe sytë e të cilëve janë të mbuluar me perden e injorancës. Ata kërkojnë zjarrin në vend të*

*dritës, shëmtimin në vend të bukurisë dhe të keqen në vend të së mirës. Ata e shtrembërojnë çdo kualitet të mirë dhe e prezantojnë atë si një ves të madh. Kjo reflekton papastërtinë e tyre shpirtërore dhe zemërore ...kritikët janë të verbër. Ata nuk mund të shohin se e vetmja shpatë që e përdori Muhammedi ishte shpata e mëshirës, e dhembshurisë, e miqësisë dhe e faljes - shpata që i mposhti armiqtë dhe pastroi zemrat e tyre. Shpata e tij ishte më e mprehtë se ajo e çelikutë.*

S'ka koment! Ah, sikur të sillej edhe Molana Modudiu me drejtësi ndaj profetit Muhammed s.a.v.s., ashtu siç u soll një ithtar i Krishnës (Hindu). Jomyslmanët që e kanë studiuar historinë e Islamit, u bindën para këtij fakti se Profeti i Islamit s.a.v.s. nuk ishte vetëm bujar e i njerëzishëm, por edhe model i virtyteve të larta njerëzore. Një hindu tjetër, kryeredaktor i Sat Updaishës, shkruan: *Disa njerëz thonë se Islami u përhap me anë të forcës së shpatës, por ne nuk mund të pajtohemi me këtë mendim. Sepse, ajo që përhapet me dhunë, shpejtë refuzohet. Nëse Islami ishte i përhapur me forcë e me dhunë, sot, me siguri, s'do të ekzistonte Islami. Përse? Sepse, Profeti i Islamit ka pasur fuqi shpirtërore, ai e respektoi dhe e dashuroi njerëzimin dhe se ai ishte i udhëhequr nga ideali i lartë i së mirës.*

Qëndrimi antimyslman i Lëvizjes së Arja Samaxhit njihet mirë. Themeluesi i kësaj Lëvizjeje, Svami Dajanandi, ishte kritiku i ashpër i Islamit dhe i Profetit të tij. Deklarata e poshtëshënuar është bërë nga një hindu në një mbledhje të organizuar nga Arja Samaxhi në



Lahor (Pakistan). Redaktori i *Vedik Magazinës* dhe ish-profesor i Gurukulit, Kangri Ram Devi, thotë:

*Ulur në Medinë Muhammedi i magjepsi arabët; i përforcoi me forcën shpirtërore; forca që i bën njerëzit devta (perëndi) . . . nuk është e drejtë që të thuhet se Islami u përhap me forcën e shpatës. Është fakt se për propagandën e Islamit kurrë nuk është përdorur shpata. Nëse religjioni mund të përhapet me forcë, atëherë le të orvatet dikush sot.*

Fjalja e fundit e paragrafit të lartëshkruar është një sfidë e fortë së cilës askush s'mund t'i përgjigjet, bile as edhe Molana Modudiu vetë. S'ka shpatë që mund të ndërrojë një zemër dhe ta kthejë besimin në mosbesim. Ishte vargu i gjatë i profetëve para Profetit të Islamit s.a.v.s. dhe kjo është një e vërtetë historike se çdo profet u kundërshtua me forcë. Çdo herë që ndonjë profet predikoi religjionin e vërtetë, ai u kundërshtua me shpatë dhe me gjithëkëtë religjioni i vërtetë u përhap, kurse shpata dështoi ta pengojë atë. Nëse të gjithë profetët e së kaluarës dhe ithtarët e tyre mund të qëndronin kundër fuqisë së shpatës, atëherë si është e mundur që Muhammedi s.a.v.s. të ketë adoptuar një rrugë të ndryshme dhe të ketë marrë shpatën - vegël e dhunës dhe jo e vërtetësisë? S'ka padrejtësi më të madhe sesa kjo që ai të akuzohet për përdorimin e forcës për t'i ndërruar besimet e njerëzve.

Një dijetar jomysliman, Dr.D.W.Laitzi, duke hedhur poshtë këtë akuzë false, jep një argument të fortë, të bazuar mbi Kuranin. Ai thotë:

*Të gjitha këto argumente të parashtruara për të vërtetuar se qëllimi i xhahadit ishte që Islami të përhapej me dhunë, janë në kundërshtim me Kuranin. Sepse, Kurani thotë se qëllimi i xhihadit është të mbrohen xhamitë, kishat, sinagogat dhe manastiret.*

Pas një mbrojtjeje të qartë ndaj Profetit s.a.v.s., tani të ashtuquajturit myslimanë, të cilët e akuzojnë atë për përdorimin e shpatës, le t'i përgjigjen kësaj pyetjeje të Kuranit:

*A nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin apo zemrat e tyre janë të mbyllura me drunat? (47:25)*

Molana Modudiu, autor i komentimit vëllimoz të Kuranit *Tefhimul Kuran*, me siguri e ka lexuar disa herë këtë ajet. A nuk i ra ndërmend se interpretimi i Kuranit për qëllime politike mund ta çojë komentatorin në rrugë të gabuar? Mandej, Molana thotë:

*Ky ishte ai plan që ishte adoptuar nga Profeti s.a.v.s. dhe nga kalifat e tij të udhëzuar mirë. Arabia, ku për herë të parë u themellua partia myslimane, ishte vendi i parë që u pushtua. Pas kësaj, Profeti s.a.v.s. u dërgoi thirrje të gjitha shteteve fqinje, por nuk priti se a pranohet kjo thirrje ose jo, dhe fill pas arritjes së fuqisë ai filloi konfliktin me Perandorinë Romake. Pas vdekjes së Profetit s.a.v.s., Abu Bakri u bë lider i Partisë dhe sulmoi Perandorinë Romake e Persiane, kurse Omeri më në fund fitoi betejën.*

Kjo është, në realitet, një deklaratë e luftës kundër të gjitha shteteve fqinje jomyslimane - ata janë të sigurtë vetëm derisa është i dobët shteti islamik. Po qe se

paragrafi i lartëshënuar ishte shkruar nga ndonjë historian marksist i Partisë Komuniste, askush nuk do t'i jepte ndonjë rëndësi. Mirëpo, ky është opinioni, i konsideruar, i një lideri mysliman të pozitës së Molana Modudiu. Dhe si i tillë është shumë më fyes ndaj Profetit s.a.v.s. se sa kanë shkruar Muri, Fanderi, Smiti dhe kritikë të tjerë të Islamit. Paragrafi i lartëcituar është përkthyer nga origjinali i Molana Modudiu që është në gjuhën urdu. Fjalët *Partia Myslimane* janë përdorur qëllimisht nga Modudiu. Ai e ka degraduar umetin mysliman duke ia dhënë statusin e një partie politike. Ai shumë mirë e dinte dallimin në mes të këtyre dy fjalëve, dhe prapë në një libër tjetër ai shkruan: Fjala tjetër që ka përdorur Kurani për *parti* është *umeti*.

Duke i emërtuar myslimanët një parti politike, Molana ose me pavetëdije ose, siç duket, qëllimisht ia jep Profetit s.a.v.s. pozitën e barabartë të një lideri të një partie politike, duke i dhënë moralet e një politikani. Si mund ta shpjegojë dikush paragrafin e poshtëshënuar të shkruar nga Molan Modudiu?

*Pas kësaj, Profeti u dërgoi thirrje të gjitha shteteve fqinje, dhe ai s'priti se a pranohen këto thirrje ose jo, dhe fill pas arritjes së fuqisë së tij ai filloi konfliktin me Perandorinë Romake.*

Është çudi se si një mysliman të ketë guxim aq të madh sa që e bën Profetin fajtor të invadimit të stilit të Hitlerit (naudho billah)! Profeti s.a.v.s. ishte princ i paqes e jo pushtues. Molana Modudiu dëshironte të kishte fuqi politike dhe, fatkeqësisht, kjo i jep bazë të rrejshme interpretimit të tij të historisë islamike. Kurse, Islamit

nuk i nevojitet mbështetje politike. Në Bengal, tani Bangladesh, myslimanët në mes të shek. XVIII, kur Britania e Madhe mori përsipër administrimin e këtij vendi nga mongolët, ishin pakicë e vogël. Me kalimin e kohës më 1947 Bengali fitoi pavërsinë dhe atëherë shumica e popullsisë ishte myslimane. Myslimanët gjatë sundimit britanik s'kishin kontroll politik në atë vend, e as nuk pati ndonjë migracion të myslimanëve nga India veriore. Ky zgjerim i popullsisë myslimane të Bengalit u bë për shkak të ndërrimit paqësor religjioz, që ishte rezultat i predikimeve të sufive shëtites, të misionarëve myslimanë dhe të hoxhallarëve të xhamive të fshatrave.

Vështrimi i Thomas Arnoldit mbi këtë temë është me mjaft rëndësi. Ai thotë: *Islami ka fituar triumfet e veta misionare më madhështore dhe të përhershme tamam në atë kohë e në ato vende ku fuqia e tij politike ishte më e dobët.* Molana Modudiu, si duket, kurrë s'ka lexuar historinë islame të Bengalit, të Malaizisë ose të Indonezisë. Ai ishte aq i magjepsuar nga fitoret turko-afgane dhe mongole saqë ai kurrë s'pati kohë të vërejë se shteti më i madh i myslimanëve në botë, Indonezia, kurrë s'ka pasur ndonjë pushtues mysliman - e aty as s'ka pasur ndonjë luftë e as dhunë. I njëjti rast shihet në Malajzi.

Profeti s.a.v.s., me të vërtetë, ishte i pafajshëm. Ai e mori shpatën vetëm për vetëmbrojtje dhe tamam në atë kohë kur shtypja u bë e padurueshme. Për këtë temë një Sikh (anëtar i Sikhizmit) objektiv thotë: *Në fillim armiqtë e Profetit ia bënë të vështirë e të rëndë jetën atij dhe ihtarëve të tij aq sa Profeti i këshilloi ihtarët e vet ta braktisin atdheun e tyre dhe të emigrojnë në Medinë. Ai*

*më shumë preferoi emigrimin se sa të luftonte kundër popullit të vet, por kur shtypja e tejkaloi çdo kufi të tolerencës, ai mori shpatën e tij për vetëmbrojtje. Ata që mendojnë se religjioni mund të përhapet me forcë, janë të marrë dhe nuk i njohin rrugët e religjionit e as ato të botës. Ata krenohen për këtë ideologji dhe besim të tyre, sepse janë shumë larg nga rruga e vërtetësisë.*

*Kush e di më mire - një gazetar sikh ose një mizaxh shenas nubuvat?*

## KAPITULLI III

### RRËZIMI I FILOZOFISË MODUDIANE

Në fillim të vitit 1920, Lëvizjet e ringjalljes hinduse, pas dështimit të Lëvizjes së përbashkët të Hindu-Myslim kilafetit, ndërmorën një hap agresiv. Muhasbah hindus, të themeluar në Hardvar në vitin 1914 nga Pandit Madan Mohen Malavija (1861-1946), iu bashkua Aria Samaxhit me fushatën e vet të quajtur Shudi (rikthimi i myslimanëve në hinduizëm dhe pastrimi i tyre, duke filluar në Penxhab, në Krahinat e Bashkuara (tani Uter Perdesh), në Dekken dhe në pjesët e tjera të Indisë. Duke i detyruar myslimanët me forcë që të heqin *fëlliqësinë* e tyre me zhytje totale në ndonjë lumë ose në rezervuarin e ujit, çetat hinduse provokuan trazira komunale. Gjatë viteve 1922-1926 u shënuan më shumë se 200 përlëshje të zhvilluara në mes të hindusëve e të myslimanëve. U zgjeruan sulmet verbale dhe me shkrime kundër Profetit s.a.v.s. dhe kundër Islamit. Në zellin e tyre religjioz, shkrimtarët e literaturës Shudi kanë bërë sulme të pahijeshme kundër Profetit të Islamit s.a.v.s. Një predikues i Aria Samaxhit, Pandit Kaliçaren Sharma shkroi mbi imoralitetin e Profetit s.a.v.s., dhe në librin e vet *Vichitra Jiven* (Viçitra Xhiven-Jeta e çuditshme), ai e akuzon Profetin se gjoja ka përdorur shpatën për përhapjen e fesë islame. Të gjithë myslimanët, sipas Pandit Sharmës, janë të prirë për plaçkitje, për zjarrvënie dhe për dhunim. Në maj të vitit 1924 në Lahor një shitës i librave, Raxhpali, botoi një traktat në gjuhën urdu, të shkruar nga një autor anonim, duke kritikuar ashpër Profetin e

Shenjtë s.a.v.s., Traktati *Rangila Rasul* (Profeti bandill), sugjeron se të gjithë liderët e religjioneve të mëdha lidhen ngushtë me disa ide e simbole. P.sh. themeluesi i Aria Samaxhit, Svami Dejanand, e lavdëroi beqarinë, dhe reformat e tij ngushtësisht identifikohen me ato të Vedës. Po ashtu, sipas tij, jeta dhe besimi i Profetit të Islamit janë të lidhura ngushtë me marrëdhëniet e grave. Më vonë, Raxhpali u vra nga dy të rinj mysliman. Kjo vrasje shkaktoi përlëshje në mes të myslimanëve dhe të hindusëve. Një hindu tjetër shkroi një artikull *Udhëtimi për në xhehenem* në Risala-i-Vartman, duke e paraqitur Profetin në xhehenem dhe duke shkruar vuajtjet e *mëkateve* të tij.

Ahmaditë (anëtarët e Xhematit Mysliman Ahmadia) e Indisë së pandarë u tubuan menjëherë dhe e rrënuan lëvizjen e rikthimit nga themelet e saj. Imami i Xhematit Ahmadia i asaj kohe, Mirza Bashirudin Mahmud Ahmadi, gjithashtu ndërmori një hap pozitiv. Ai dha një propozim që të mbahet një konferencë ndërreligjioze ku liderët e feve të ndryshme duhet të takohen dhe të sqarojnë besimet e tyre me qëllim që të rrëzohen muret e injorancës dhe të paragjykimeve. Ai vetëm për këtë qëllim organizoi një konferencë vjetore. Kjo u quajt *Jome Peshvajane Mezahib* (Dita e Themeluesve Religjiozë). Atë ditë një mysliman duhet të flasë mbi madhërinë e Krishnës ose të Budës, kurse një hindu të flasë rreth Profetit të Shenjtë të Islamit s.a.v.s., duke hedhur poshtë ato keqkuptime që ishin përhapur rreth tij nga propagandistët. Qëndrimi i ahmedianëve, gjatë kësaj kohe fatkeqe të shpifjes e të urrejtjes, ishte se jomyslimanët duhet të edukohen dhe duhet t'u jepet

mesazhi i dashurisë e i paqes që Profeti i Islamit s.a.v.s. i pat dhënë botës. Akuzat dhe kritikrat e idhëta sektare nuk e ndihmojnë një misionar në predikimin e fesë së tij. Ai në vend të akuzave e të shpifjeve duhet t'i vërë theksin pikave të mira të fesë së vet. Gjithashtu, Imami i Xhematit Ahmadija e bindi qeverinë e Indisë, në atë kohë qeverinë e Britanisë së Madhe, të përforcojë ligjin për ta mbrojtur nderin e liderëve religjiozë. Guvernatori i Penxhabit, William Hailey, të cilin e shpjegoi Mirza Bashirudin Mahmud Ahmadi, rekomandoi që qeveria e Indisë duhet ta ndërrojë ligjin, duke ndaluar çdo material që turpërisht është ofensiv ndaj ndjenjave religjioze. Qeveria e pranoi këtë rekomandim dhe u formua një projektligj që iu bashkëngjiti Kodit Penal 295A të Indisë, sipas të cilit do të jetë krim të ofendosh e të fyesh, ose të tentosh të ofendosh besimet fetare të ndonjë klase njerëzore. Ky projektligj u aprovua më 1927 nga Kuvendi Legjislativ.

Mirëpo, myslimanët indianë në atë kohë ishin shumë të shqetësuar e të zemëruar. Një kaligraf mysliman, Abdul Rashid, u zemërua aq shumë nga sulmet fyese kundër jetës së Profetit të Islamit s.a.v.s., sa që e vrau Svami Shradhanadin - një lider i Shudit. Rashidi u gjykua dhe u dënua me vdekje. Mijëra myslimanë të Delhit marshuan në drejtim të burgut komunal të Delhit për të marrë kufomën e tij dhe të cilën e varrosën si një dëshmor. Ky glorifikim i vrasjes i zemëroi dhe i inatosi hindusët, që Islamin e quajtën religjion të dhunës e të forcës dhe që mbështetet mbi xhihad e jo mbi arsyetim dhe mbi virtyte. Një gazetar i ri, Abul Ala Modudi, iu përgjigj këtyre akuzave në një seri artikujsh në *Al-Xhamiat* - gazeta e



Xhemat Ulema-e-Hind. Këta artikuj, më vonë, u botuan në librin *AI-xhihad Fil Islam* (xhahadi në Islam).

Në pjesën e parë të këtij libri Molana Modudiu në mënyrë bindëse vërtetoi se luftërat që zhvilloi Profeti i Islamit s.a.v.s. kanë pasur karakter mbrojtës. Ai luftoi për të stabilizuar lirinë e vetëdijes dhe i kundërshtoi të gjitha përpjekjet që e shtypnin punën paqësore të predikimit të Islamit. Duke e bindur lexuesin se Islami, me të vërtetë, e stabilizon lirinë e vetëdijes, Molana Modudiu, siç duket, vetë paraqet dyshimin mbi argumentin e tij, duke i bashkëngjitur këtë shënim: *Ajo liri e vetëdijes është e kufizuar vetëm me besim e me religjion. Kjo nuk do të thotë se njerëzit kanë liri të bëjnë mëkat. Islami nuk lejon që të përdoret forcë e dhunë për konvercion, por forca mund të përdoret - faktikisht duhet të përdoret - për t'i ndaluar njerëzit të bëjnë vepra të këqija. Shtetet dhe kulturat joislamike nuk mund të lejohen të praktikojnë imoralitetin, dhe forca që është përdorur për t'i mbajtur këto shtete larg veseve të këqija, mund të dallohet qart nga ajo që është përdorur për t'i futur njerëzit në Islam.*

Kështu, Molana për të vërtetuar mendimin e tij zhvillon një metodë të përdredhur të interpretimit të Kuranit e të thënave të Profetit s.a.v.s.

Molana Modudiu shkon pak më thellë në diskutimin e përdorimit të forcës dhe shpjegon qëllimin e ajetit 29 të Sures 9 të Kuranit. Duke e cituar atë, ai, jashtë kontekstit, thotë:

Fjalët *derisa të mos japin xhizjen* shpjegojnë qartazi qëllimin e luftës (ndalimi i veseve të këqija). Po të ishin këto fjalë *derisa të mos e pranojnë Islamin* atëherë, pa

dyschim, dikush mund të thoshte se Islami lejon përdorimin e forcës për përhapjen e fesë. Mirëpo, fjalët *derisa të mos japin xhizjen* janë të qarta. Pranimi i të paguarit të xhizjes i jep fund luftës. Pas kësaj, jeta dhe pasuria e jomyslimanëve janë të pacenueshme, pa marrë parasysh a e pranojnë Islamin ose jo.

Molana Modudiu filloi të shkruajë këtë libër me qëllim që të vërtetojë se Islami jep liri të plotë të vetëdijes dhe se Profeti i Shenjtë *s.a.v.s.* u aktivizua në luftë për shkak se kundërshtarët e tij e shtypnin atë liri. Kjo ishte një përgjigje lidhur me pohimet e jomyslimanëve se Islami është bazuar mbi dy principe themelore: Të detyrohen njerëzit me forcë të bëjnë vepra të mira dhe të ndalohen nga ato të këqijat. Mbasi, t'i detyrosh njerëzit me forcë të bëjnë vepra të mira është kundër lirisë së vetëdijes, Islami e përmban veten nga kjo. Por, Molana ka harruar pak, sepse pasi i përmendi fjalët e Kuranit, të cilat thonë se lufta duhet të ndalet, pasi jomyslimanët pajtohen të paguajnë xhizjen. Si mund të fitohet ajo luftë që filloi për t'i fshirë veprat e këqija, nëse armiku paguan xhizjen, pa bërë premtim se i fshin veprat e këqija? Qëllimi i Molanës është të imponojë taksën e të votuarit, që kur arrihet marrëveshje për pagesën e saj, principi i dytë i Islamit - eliminimi (shfarosja) i veprave të këqija - është harruar në mënyrë të volitshme.

Pjesa finale e logjikës së Molana Modudiu, sidoqoftë, e zhvleftëson dhe e asgjëson atë qëllim për të cilin ai shkroi këtë libër. Ai thotë:

*Kur të gjitha metodat e bindjes dështuan, Profeti s.a.v.s. kapi shpatën. Kjo shpatë i eliminoi djallëzitë,*

*papastërtitë dëmprurëse dhe ndytësinë e shpirtit. Shpata bëri edhe pak më tepër - ajo eliminoi (mënjanoi) verbërinë e tyre sa që mundën të shohin dritën e vërtetësisë - dhe ajo, gjithashtu, e shëroi arrogancën e tyre - arrogancë që i pengon njerëzit të pranojnë të vërtetën, qafat e ngurta dhe kokat krenare u përulen me modesti. Si në Arabi, ashtu edhe në vendet e tjera, zgjerimi dhe përhapja e Islamit ishte aq e shpejtë sa që brenda një shekulli një e katërta e botës e kishte pranuar Islamin. Ky konvercion u bë për shkak se shpata e Islamit i shqeu ato perde që i kishin mbuluar zemrat e njerëzve.*

Kjo gjithashtu është e neveritshme për shpirtin e Islamit. Një gabim çon te tjetri. Më në fund, pas 137 faqeve të argumenteve të gënjeshtërta, Molana pohon:

*Kur është e padrejtë të thuhet se Islami i futi njerëzit në Islam me shpatë, ashtu është e padrejtë të thuhet se shpata nuk luajti asnjë rol në përhapjen e Islamit.*

Molana filloi të shkruajë librin e vet me qëllim që të vërtetojë se luftërat që zhvilloi Profeti i Shenjtë s.a.v.s. kanë pasur karakter mbrojtës. Ai luftoi që të stabilizojë lirinë e vetëdijes, por librin e përfundon duke ja zgjatur duart armiqve të Islamit. Duke vepruar në këtë mënyrë, Molana ja hapi dyert një orientalisti sulmues të ashpër. Prestigji që gëzon ai në mesin e një pakice të vogël, që përbëjnë një klasë, dijetarësh myslimanë të Perëndimit, i ndihmon orientalistët që argumentet e tyre të antixhihadit t'i mbështesin me shpatën vringëlluese të Molanës, *për të luajtur një rol në përhapjen e Islamit.*

Më pak se dy vjet pas Hixhrës (emigrimi i Profetit s.a.v.s. nga Mekka në Medinë), es-habët e tij u konfrontuan me mijëra mekkasë të vendosur për ta fshirë e për ta zhdukur Islamin, Profetin e tij dhe ithtarët e tij. Ishte agimi i së premtës, më 17 Mars të vitit 623 (17 Ramazan të vitit 2 pas Hixhrës) kur mekkasit me 700 deve dhe me një kalorësi prej 100 kuajsh filluan të zbresin nga lugina e Badrit nga shpati i Alkankalit - 20 mila në jug të Medinës. E nga ana tjetër, ishin vetëm 313 myslimanë në mbrojtje të Islamit. Ata kishin vetëm dy kuaj dhe ishin aq të paarmatosur sa që kur gjatë luftës iu thye shpata e Ukkashahut, Profeti s.a.v.s. mundi vetëm ta zëvendësojë atë me një dajak, të cilin ai e përdori në vend të shpatës. Situata e tyre ishte bërë aq e vështirë dhe dëshpëruese sa që Profeti s.a.v.s. duke derdhur lot e luti Zotin: O Allah, nëse ky grup i vogël myslimanësh do të zhduket dhe do të asgjësohet sot, askush nuk do të mbetet për adhurimin Tënd!

Siç shkruan Montgomeri Vat (Montgomery Watt): *Ebu Xhehli e merrte me mend dhe shpresonte se do të lirohej njëherë e përgjithmonë nga Muhammedi.*

Vill Duranti pajtohet me Vattin: *Sikur Muhammedi të pësonte disfatën, karriera e tij mund të përfundonte njëherë e përgjithmonë.*

Mirëpo, shpresat e Ebu Xhehlit nuk u plotësuan dhe myslimanët me sukses e mbrojtën vetën kundër forcave shumë më të armatosura dhe më të mira të Mekkës.

Historia islamike i ka ruajtur mirë emrat e atyre 313 es-habëve që e mbrojtën Islamin në Luginën e Badrit.

Njeriu çuditet se çfarë roli luajti shpata në ndërrimin e besimit të këtyre 300 myslimanëve të pazakonshëm. Në mesin e tyre ishte edhe Ebu Bakri, Omeri, Osmani dhe Aliu, të cilët u bënë kalifë të Profetit *s.a.v.s.*. A ishte shpata kjo që e largoi dhe e eliminoi *fundërrinën* e zemrave të tyre? Aty ishin edhe Auf bin Harith, Omer bin Salimah, Muavidh dhe shumë të tjerë që ranë atë ditë. Hollësitë e sakta të ndërrimit të besimit të tyre janë të panjohura. A mund të thotë dikush se ndyrësitat e shpirtërave të tyre dhe fundërrina e zemrave të tyre ishin pastruar me tehun e shpatës?

Tre es-habë të mëdhenj, të cilët më vonë trimërisht luftuan për të mbrojtur fenë, ishin Sad bin Abi Vakkasi, Ebu Ubejdah bin al-Xherah dhe Khalid bin Validi. Asnjëri prej tyre nuk e përqafoi fenë Islame me forcë. Qindra emigrantë (muhaxhirë) dhe mijëra ndihmtarë (Ansar) e pranuan fenë islame dhe i dhanë strehim Profetit *s.a.v.s.* të persekutuar. Asnjë shpatë nuk ka luajtur ndonjë rol për t'i futur ata në Islam. Këto konvercione ishin frytet e Islamit, krenaria e njerëzimit dhe tabela shënimi në rrugën e vërtetësisë së fundit. Çfarë diskreditimi mund të jetë më i madh ndaj tyre se sa të thuhet se zemrat e tyre u pastruan nga forca e shpatës, ose të sugjerohet se është gabim dhe padrejtësi të thuhet se shpata nuk luajti ndonjë rol në ndërrimin religjioz të tyre?

Ç'kanë qenë këta njerëz para ardhjes së Islamit? Para ardhjes së Muhammedit *s.a.v.s.*, Arabia ekzistonte vetëm si një njësi politike, ashtu e përmend Vill Duranti. Ai shkruan: Në nomenklaturën e pakujdesshme të grekëve, të cilët tërë popullsinë e gadishullit e quajtën Sarakenoi

(saracens) që në mënyrë të dukshme ka dalë nga arabishtja sherkiun, i.e lindjes. Më parë ata quheshin Scenite Arabs - arabët që jetojnë në çadra (dalë nga fjala greke skene - çadër e tend). Ata jetonin në një tokë shterpe dhe problemet e komunikacionit qëndronin mbi vetëmjaftueshmërinë fisnore. Gjatë periudhës së dytë mijëvjeçare para erës krishtere, arabët e zbutën devenë dhe e bënë kafshë shtëpiake, kafshë që në mënyrë të përsosur është e përshtatshme për kushtet e shkretëtirës. Kjo kafshë u jepte qumësht për ushqim, kurse urina e saj përdorej si medicinë. Mishi i saj ishte i butë dhe i njomë, ndërsa lëkura dhe qimet e saj prodhonin tendat dhe rrobat. Bile, edhe bajgat e saj përdorreshin si lëndë djegëse. Deveja mund të qëndrojë gjatë dimrit edhe 25 ditë pa ujë, kurse verës 5 ditë. Grupet e vogla të nomadëve shkonin pas deveve, sepse ato ishin burimi i tyre më i rëndësishëm. Aloï Spengeri e përmbloodhi tërë historinë preislamike të Sarakenoit, duke i përshkruar arabët si *parazitë të deveve*.

Arabi nuk tregonte besnikëri ndaj asnjë grupi më të madh se fisi i vet, por intensiteti i devotshmërisë së tij ndryshon anasjelltas nga shtrirja e tij; për fisin e vet ai me vetëdije bënte gjithçka që njerëz të civilizuar bëjnë vetëm për vendin, religjionin dhe racën e tyre d.m.th. gënjejnë, vjedhin, vrasin dhe vdesin. Ai nuk ishte i kufizuar nga ndonjë ligj i shkruar dhe as bile nuk ekzistonte ndonjë shtet që e zbatonte këtë ligj.

Arabët vajtonin për lindjen e vajzave dhe i fshihnin fytyrat e tyre nga turpi. Në disa raste vajzat vriteshin fill pas lindjes. Por, nëse ato shpëtonin, hijeshia e tyre

natyrore ndoshta mund t'u ofronte disa vjet të dashurisë nga burrat dhe nga dashnorët e tyre që duhet të shkonin në skajet e botës për të mbrojtur nderin e tyre. Ato nuk ishin më shumë se pjesët e pronës. Ato ishin pjesë e pasurisë së patundshme të etërve, të burrave ose të bijëve të tyre dhe ato trashëgoheshin bashkë me plaçkat e tjera. Ato, gjithashtu, ishin skllave dhe rrallë ishin shoqe të etërve, të burrave dhe të vëllezërve të tyre.

Arabi i jepte mendim vështrues jetës së pasvdekjes. Ai ofronte sakrificën njerëzore; ai adhuronte gurët e *shenjtë*. Qendra e adhurimit të gurit ishte Mekka. Në ditët preislamike, brenda Kabes, ishin të vendosur disa idhuj që supuzohej se i përfaqësojnë zotat. Zoti më i madh i Mekkës ishte Elubali - një idhull i bërë nga një lloj druri. Por, në Hixhaz, tri perëndeshat - Lata, Manata dhe Uza - kishin krenari për pozitën e tyre të lartë si bijat e Zotit.

Arabi me trup të zhvilluar e të fortë mund të jetonte vetëm me disa hurma dhe me pak qumësht të deves. Nga palma e hurmës ai bënte një lloj vere që e ngjiste lart, drejt fluturimeve poetike e romantike. Jeta e tij rrotullohej në mes të dashurisë dhe të luftës dhe hakmerrej shpejt për fyerje dhe lëndim, jo vetëm për hir të vetes, por ashtu edhe për hir të fisit të vet.

Syri për sy dhe dhëmbi për dhëmb ishte ligji. Turpi i papërfundueshëm e priste gjithmonë hakmarrësin, nëse ai nuk e vriste mundimtarin. Një pjesë të madhe e jetës së vet ai e kalonte në hakmarrje fisnore (në arabisht tha'r). Në historinë preislamike arabe *Ajamul-Arab* (Ditët e arabëve) ishte emri që aplikohesh për ato beteja që i

zhvillonin arabët në mes të tyre. Ato ditë të veçanta quheshin p.sh. Dita e Buathit ose Ditët e AI-Fixharit. Këto armiqësi ndërfishnore zakonisht shpërtheheshin nga grindjet për bagëtinë, tokën ose për betejën që u zhvillua në mes të Benu Bakrit dhe farefiseve të tyre Benu Taglibit, për një deve femër që i takonte një plake të fisit Bakr, që quhej Basus.

Një krytar i Taglibit e kishte lënduar atë deve dhe si rezultat i kësaj filloi ajo luftë që zgjati 40 vjet! Kjo luftë mori fund vetëm atëherë kur të dy fiset e asgjësuan njëri-tjetrin. Një luftë tjetër e njohur ishte Dita e Dahisës dhe Al-Gabrës që plasi për shkak të sjelljes jo të drejtë të dy kryetarëve në një garë të mbajtur në mes të një kali (i quajtur Dahis) dhe të pelës (e quajtur AI-Gabra). Lufta shpërtheu fill pas mbarimit të konfliktit të Basusit dhe vazhdoi për një afat disa dekadash.

Ky ishte sfondi social ku u rrit Muhammedi s.a.v.s. dhe të tillë ishin këta njerëz, të cilëve Zoti u dha rastin e parë të përqafojnë fenë e një Profeti të perskutuar.

Të mendosh se këta njerëz të ashpër dhe luftëdashës, të cilët për një gjë të vogël bëheshin gati për gjakderdhje, janë bërë besimtarë me dhunë ose me forcë, do të thotë se ti kontradikton vetë historinë. Përveç kësaj, kjo zhvlehtëson besimin e atyre pionerëve që vunë në rrezik jetën e tyre për ta mbrojtur Islamin në Betejën e Badrit. Usejd bin Hudejr, Sad b. Khethamah, Asd b. Zuraha, Abdullah b. Ravaha, Sad b. Ubedah, Munzir b. Amir, Bara b. Marur, Ubedah b. as-Sami, Rafi b. Malik dhe shumë ndihmtarë (Ansar) të tjerë udhëtuan gjatë tërë rrugës nga Medina për në Mekke për të përqaftuar



Islamin. Të mendosh se shpata ka luajtur një rol në ndërrimin e besimit të tyre, do të thotë ta mohosh, gjithashtu, faktin historik.

Gjersa në historinë krishtere është religjioni që i shndërroi shpatat në thikat e plugut, interpretimi i historisë islame i Molana Modudiut na bind që të besojmë se është shpata që e lavron tokën e shpirtit për të pranuar farën e religjionit. A ishte kjo shpatë e Profetit të Shenjtë apo disa ajete të Kuranit që e ndërruan tërësisht jetën e Omer bin Khatabit, një armik i përbetuar i Islamit, dhe e bëri shërbëtor të devotshëm të Islamit?

Në ditët e hershme të persekutimit të Profetit s.a.v.s., Omeri, një i ri kokfortë 26 vjeçar, vendosi ta vrasë Profetin s.a.v.s., kështu dëshironte të çfaroste shkaku kryesor të ndasisë në mes të Kurejshve. Në rrugën e shtëpisë së Profetit s.a.v.s., ai u takua me Noejm bin Abdullahun dhe ja zbuloi atij qëllimet e këqija. Noejm bin Abdullah i tha: O Omer, shko tek anëtarët e shtëpisë sate. Motra jote, Fatima, dhe dhëndëri yt, Saidi, e kanë përqaftuar fenë e Muhammedit! Dhe, pa thënë asnjë fjalë, Omeri shkoi drejt te shtëpia e motrës, ku një sahabi (kolegu i Muhammedit), Khabbabi, ishte duke recituar ajetet e para të Sures Ta-Ha. Sapo Omeri hyri brenda në shtëpi, Khabbabi u fsheh në një skaj, kurse Fatima i fshehu faqet e Kuranit në teshat e veta. Mirëpo Omeri e kishte dëgjuar recitimin e Khabbabit, dhe i sulmoi Saidin dhe Fatimën. Kur Fatima u zhyt në gjak, ai u zbut dhe shprehu dëshirë t'i shohë ato ajete. Ai i lexoi dhe thirri çuditërisht: Ah, sa fjalë të bukura dhe fisnike qenkanë këto! Mandej, ai shkoi drejt te shtëpia e Arkamit ku Profeti s.a.v.s. ishte duke u ulur me es-habët të vet. Ai filloi

të qajë dhe tha: O profet i Allahut! Unë kam ardhur te ju që të deklaroj besimin tim në Allah, në Profetin e Tij dhe në atë që ti solle prej Allahut.

Përse, pra, Molana Modudiu është aq i vendosur të paraqesë një pikturë të dhunës të Islamit? Përse ka kontradikta në teorinë e tij të xhihadit? Një shikim i hedhur mbi sfondin e Molana Modudiu dhe mbi kushtet nën të cilat ai shkroi librin e tij, *AI-Xhihad Fil Islam*, mund t'na ndihmojë në përgjigjen e këtyre pyetjeve.

Sejed Abul Ala Modudiu fëmijërinë dhe rininë e tij të hershme e kaloi në Hejdrabad (Dekken), ku ende sundonte Nizami në stilin madhështor mongolian dhe ku kryeministri i tij hindu i këndonte lëvdatat Profetit të Shenjtë s.a.v.s. Në udhëkryqet, nga veriu për në jug dhe nga lindja për në perëndim, ekzistonte fortifikata e fundit e kulturës mongoliane - predominuese myslimane - në Indi. Në një shtet ku popullsia dërmuese ishte hindu (më shumë se 80%), sunduesi sadoqë ishte pa forcë efektive, e përkujtonte ende madhësinë e të së kaluarës të sundimit mongolian. Ajo ishte një botë jo reale. Oborri me gjithë aristokracinë, oborrtarët, shërbëtorët, shervanitë (kostum indian) mëndafshi, çallmat ceremoniale, tokzat dhe stolitë madhështore, ishte një përkujtim i Oborrit të Delhit, para shkatërrimit të tij nga Nadir Shahu (1739). Aty ishin mercenarët arabë, me kamat e lara me flori dhe me pushkët e gjata, dhe me ushtrinë e rregulltë bashkë me të gjitha pajisjet e luftës moderne. Raxhat (princër indianë) dhe maharaxhat - disa prej tyre mbretëronin mbi rajonet më të mëdha se shtetet hinduse të Indisë Britanike - zinin pozitat më të larta

nderi në qeverinë e Nizamit dhe ishin pjesë e një pikturë surreale të tolerancës myslimane dhe të besnikërisë hinduse.

Ndonëse kultura Hejdrabadiane njihej si bazë indiane, por për nga forma ishte më tepër myslimane. Organizata shoqërore ende ishte feudale, por në asnjë kuptim primitive. Ajo ishte madhërisht e kultivuar me sjellje të bukura, dhe, mbi të gjitha, toleranca dhe respekti reciprok për të cilat mund të flitet në vëllime për gjeneratën tonë, nëse dëshirojmë të dëgjojmë.

Ky ishte ai Hejdrabad ku u formua personaliteti i Modudiut të ri. Shumë i ndjeshëm dhe impresionues, ai filloi karrierën e tij të gazetarisë në vitin 1918, duke iu bashkuar personelit të redaksisë të Medinës (Bixhnor). Pasi që punoi si redaktor i gazetës Taxh (Xhabalpur), dhe mori përsipër redaksinë e Al-Xhamiat-it (Delhi) në vitin 1925. Atë kohë Lëvizja Shudi ishte në lartësi të vet dhe tamam në atë kohë, siç u përmend më parë, redaktori i ri i Al-Xhamiatit filloi të shkruajë artikujt e tij. Ata qartazi ishin të shkruar nën presionin e punës së tij të përditshme dhe ata të gjithë u kompletuan brenda gjashtë muajve. Modudiu filloi të shkruajë këta artikujt më shumë si një nacionalist se sa një fanatik religjioz, por duke studiuar më shumë literaturën islamike - aq sa kishte mundësi të lexonte brenda gjashtë muajve dhe pa ndjekur ndonjë shkollë islamike - ai u bë ringjallës religjioz. Të dy artikujt e tij në *Al-Xhihad Fil Islam* dhe evolucioni i përgjithshëm i mendimit të tij ishin bërë pjesë-pjesë. Ai filloi të shkruajë librin e tij si një nacionalist indian dhe, si i tillë, qëllimi i tij ishte t'u

tregojë hindusëve indianë, veçanërisht Gandixhiut, se Islami nuk është ndonjë religjion i dhunës. Lideri i madh mysliman indian, Molana Muhammed Ali Xhohri, duke mbajtur një fjalim në xhaminë kryesore të Delhit, tha: Unë dëshiroj që një mysliman të shkruajë një libër ku duhet të shkruhet me argumente se Islami s'ka kurrfarë lidhjeje me dhunën. Modudiu i ri ishte ndër të pranishmit dhe vendosi që këtë detyrë të marrë përsipër. Pra, në pjesët e para të artikujve të vet, ai u bëri të ditur hindusve se Islami nuk ishte një religjion i shpatës. Por, autori ynë ishte i lindur dhe i rritur në një mbretëri myslimane, ku hindusët si një shumicë ishin nën një lider mysliman.

Shkrimtari i dy librave të historisë së Hejdrabadit ishte i kredhur në fuqinë e autoritetit politik. Ai së shpejti ra në kontradiktë me argumentet e veta kundër xhihadit të shpatës. Ky mysliman hejdrabadi me ton të theksuar deklaroi: *Eshtë gabim të thuhet se shpata nuk ka luajtur ndonjë rol në konvercion.* Ky gazetar i ri nuk qe as historian e as dijetar i fesë. Ai s'mundi të kuptojë se sadoqë dinastitë myslimane e sunduan Dekkenin më shumë se 600 vjet, pjesa dërmuese e atij vendi mbeti hindu. Fuqia politike në duart e myslimanëve nuk ka ndihmuar kurrë për të futur njerëzit në Islam. Autori i librit *Al-Xhihad Fil Islam* ishte vetëm 24 vjeçar. Kurse Molana, bile edhe në moshën 65 vjeçare, mbeti *i përciptë*. Siç ka observuar Prof. Fazlur Rehmani: *Modudiu, ndonëse nuk ishte ndonjë alim (dijetar), prapëseprapë ishte njeri autodidakt me intelegjencë të konsiderueshme dhe me dituri të mjaftueshme.... Ai në asnjë mënyrë nuk ishte ndonjë dijetar i përpikët ose i*

*thellë, por padyshim ishte si një erë e freskët në atmosferën e zymtë islamike të krijuar nga medresat tradicionale.... Mirëpo, Modudiu askund nuk ekspozon pamjen më të gjerë dhe më të thellë të rolit të Islamit në botë. Duke qenë më shumë një gazetar se sa një dijetar serioz, ai shkroi me një shpejtësi të madhe dhe me përfundime sipërfaqësore me qëllim që t'i ushqejë lexuesit e vet të rinj të zjarrtë - dhe ai shkroi pa pushuar.... Asnjë prej ithtarëve të Modudiu nuk u bë kurrë një student serioz i Islamit, si rezultat i kësaj, për besimtarët, pohimi i Modudiu përfaqësonte fjalën e fundit rreth Islamit, pa marrë parasysh sa dhe si ai në mënyrë të potershme dhe kohë pas kohe veten e futi në kontradiktë lidhur me tema të rëndësishme, siç janë politika ekonomike dhe teoria politike.*

*I ndjeri Mufti Kifajtullah nga Delhi mbante të njëtin opinion. Ai thotë: *Unë e njoh mirë Molana Abul Ala Modudiu. Ai as nuk është mësuar e as nuk është disiplinuar nga ndonjë dijetar i famshëm. Ai ka lexuar shumë, por të kuptuarit e tij ndaj religjionit është shumë i dobët.**

*I ndjeri Molana Husejn Ahmad Madani e kishte paraparë qartazi rrezikun dhe tha:*

*Pamfletet dhe librat e tij përmbajnë ato opinione, të cilat janë antireligjioze dhe heretike, sadoqë janë të shkruara me zbulurime teologjike. Lexuesit shekullarë (joprofesionistë) s'mund të kuptojnë përmes këtyre zbulurirneve. Si rezultat i kësaj ata e gjejnë Islamit, të sjellë nga Profeti i shenjtë, të urryer; ai Islam që është përcjellë nga ummeti i Muhammedit që prej 1350 vitesh.*

Molana Muhamed Tajebi në njerën nga letrat e veta shkruan:

*Duke i lexuar shkrimet e Modudiu kam ardhur deri në këtë përfundim se ai nuk përvetëson disiplinën e filozofisë legale dhe të misticizmit islamik. Andaj, ai s'mund të shkruajë me autorizim mbi këto tema.*

I ndjeri Molana Ahmad Ali Lahuri gjithashtu ka shkruar në të njëjtën mënyrë:

*Molana Modudiu dëshiron që myslimanëve t'i paraqesë një Islam të ri. Dhe myslimanët nuk do të pranojnë ndonjë Islam të ri, derisa Islami i vjetër, të cilin ata e ndjekin prej 1350 vitesh, të mos jetë tërësisht i shkatërruar dhe të mos vërtetohet se Islarni është bërë i pazbatueshëm dhe i papraktikueshëm.*

Molana Modudi, siç e pamë, nuk ishte as ndonjë historian, e as ndonjë dijetar religjioz. Ai esencialisht ishte një gazetar dhe ai kishte të dy cilësitë themelore të një gazetari: zotëronte mirë gjuhën urdu dhe kishte aftësinë e të shkruarit shpejtë. Në atë kohë *AI-Xhamiat* dilte dy herë në një javë dhe ai duhej të shkruante brenda dy a tri ditëve rubrikën e tij mbi xhihadin, pos redaktimit të gazetës së vet. Duke mos pasur asnjë përvojë në fushën e hulumtimit dhe duke mos pasur as kohë për këtë, ai, pra, gabimisht e konsideroi betejën e Hunenit (30 janar të vitit 630) që u bë fill pas nënshtrimit të Mekës (11 janar të vitit 630) si kthesë e historisë islamike. Kur armiqtë e Islamit u mposhtën në mënyrë vendimtare në betejën e Hunenit, Molana konkludon se kjo ishte ajo fitore dhe ajo fuqi politike, fituar nga kjo

betejë, që ndihmoi kthimin e tërë Arabisë në Islam. Molana Modudiu nuk është i vetëm në vizatimin e këtij përfundimi. Orientalistët, të cilët nuk shohin asnjë forcë morale e shpirtërore në mësimet e Islamit dhe të cilët janë të paaftë t'i kuptojnë mrekullitë e mëdha të treguara nga Profeti ynë i Shenjtë s.a.v.s., përhapjen dhe zgjerimin e Islamit e lidhin gjithnjë me forcën. Orientalistët e ndajnë jetën e Profetit në dy pjesë: pjesa e parë është periudha e persekutimit në Mekke dhe e dyta është periudha e ngadhënjimit pas emigrimit të tij në Medinë. Gazetari ynë i ri, Abul Ala Modudi, me këtë njohje të përciptë të historisë islamike, e ka pranuar këtë ndarje të qartë e të thjeshtë, por, në realitet, shumë dinake të jetës së Profetit të Shenjtë s.a.v.s.

Konfliktet e armatosura, luftërat dhe kërcënimet e luftës në mënyrë të vazhdueshme e trazonin Profetin s.a.v.s. Pas emigrimit të tij në Medinë, paganët e Mekkes dhe jehuditë e Medinës, të inkurajuar nga hipokritët, vazhdimisht bënin komplete kundër Islamit. Ata ishin të frymëzuar me urrejtje ndaj myslimanëve dhe kishin ethe armiqësie kundër Profetit të Islamit. Të gjitha aksionet mbrojtëse që i ndërmoren myslimanët e detyruar, e pengonin misionin bazë të Profetit s.a.v.s. Myslmanëve u nevojitej paqe por, siç do të tregojë më poshtë shqyrtimi ynë, paqja prishej qëllimisht që të pengohen ata e të turbullohen nga përhapja e fesë së re.

1. Armiqtë e Islamit kanë përdorur çdo mjet komunikimi kundër Islamit. Poetët, për arabët, ishin historianë, gjenealogjistë, satiristë, moralistë dhe burime të diturisë. Poeti ishte *ndezës i betejës* dhe *gazetar i kohës*. Ansarët (myslimanët e Medinës) akuzoheshin për çnderimin e

vet, duke iu nënshtruar një të huaji. Asma binte Mervan e Umejs bin Zejdit krijoi disa vargje ku talleshin dhe fyeshin myslimanët e Medinës. Ajo thotë:  
O ju frikacakë të fisit Malik dhe Nabit  
Dhe ju o frikacakë të Aufve e Khezrexhve  
E dëgjoni një të huaj që s'ka lidhje me ju  
Ai s'është prej Muradve e as prej Medhixhve  
Kur prijësi juaj është vrarë  
A do të keni shpresë në të  
Si njerëzit e pangopur,  
duke shikuar vorbën me sup gjeli;  
A s'ka njeri të ndershëm në mesin tuaj,  
Që përfiton momentin e pambrojtur  
Dhe i këput shpresat e mendjelehtëve.

Poeti i shekullit, i klasës së Khezrexhve, Ebu Afak, i fyente myslimanët e Medinës me këto vargje:  
Kam jetuar për një kohë të gjatë,  
Por unë nuk kam parë kurrë  
As ndonjë shtëpi e tubim të njerëzve  
Më besnikë e fisnikë ndaj Aleatëve,  
kur i thërrasin ata fëmijët e Kajlës në tërësi  
Malet do të copëtohen para se ata të nënshtrohen.  
Megjithatë këtu është një kalorës  
Që vjen në Mesin e tyre që i ndan  
(Ai thotë) Kjo është e lejuar,  
ndërsa kjo është e ndaluar  
Për të gjitha llojet e gjërave  
Por nëse ju keni besuar në fuqi  
Dhe në forcë, përse pra  
Nuk e ndiqni Tubën?



Tubat ishin mbretër të famshëm të Arabisë jugore. Ebu Afaku në realitet i pyeti Ansarët: një herë kur i bëtë rezistencë Tubës, tani çka ngjau që i keni pranuar deklaratat e një refugjati të Mekkes? Gjersa Asma dhe Ebu Afaku i turpëronin Ansarët, poeti jehud, Kab bin Al-Ashraf, i inatosur nga fitorja e myslimanëve në luftën e Badrit, udhëtoi për në Mekke për t'i ngacmuar Kurejshët kundër Profetit të Shenjtë. Ai e shfrytëzonte dobësinë e arabëve për hakmarrje:

Kokërat e fushës së Badrit u lanë

Në gjak të popullit të vet.

Për ngjarjet si Badri ju duhet të qani e vajtoni

Njerëzit më të mirë u vranë

Rreth banimit të tyre

A nuk ju vjen çudi se princët mbetën të vranë

U vranë sa njerëz fisnikë, të bukur,

Strehim për ata të pashtëpi,

Të zemërgjerë kur yjet nuk lëshonin shi.

2. Hakmarrja, siç ne vërejtëm qysh herët, ishte njëra nga shtyllat e shoqërisë arabe të paraislamit. Pra, kurdo herë në konfliktin e armatosur vritej ndonjë pagan luftëtar nga një mysliman, trashëgimtarët e tij përbetoheshin për hakmarrje dhe tërë fisi e akuzonte Islamit për vrasjen e tij. Fakti që konfliktet së pari i fillonin vetë paganët harrohej.

3. Misioni i Profetit të Shenjtë *s.a.v.s.* ishte i kufizuar për një rajon të vogël të Arabisë për shkak të armiqësisë së përgjithshme ndaj tij. Misionarët nuk mund të përcillnin mesazhin e Islamit në tërë gadishullin.

4. Shumë arabë e përqaftuan Islamin, por frika e luftës ishte pengesë kryesore që ata të pohonin haptazi besimin e tyre të ri.

5. Konvercioni në një religjion të ri kërkon një angazhim dhe guxim, bile edhe atëherë kur nderi dhe jeta nuk është në rrezik. Këtu pranimi i Islamit kërkonte më shumë kurajë dhe qëndrim sesa për t'iu bashkuar ndonjë shoqërie tjetër religjioze. Kjo do të thotë të marrësh armë për mbrojtje. Meqë myslimanët në atë kohë ishin të paarmatosur dhe të dobët, të bashkuarit me ta ishte njësoj si të bësh vetëvrasje.

6. Vetëmbrojtja i bëri myslimanët aq të angazhuar sa që shumë pak kohë u mbetj për të përhapur fenë.

Nëse premisa jonë është e drejtë, atëherë, në këtë rast, përfundimi i armiqësisë do të shtonte menjëherë përhapjen e Islamit. Dhe siç do ta shohim ne, tamam ashtu ngjau. U fitua Mekka në janar të vitit 630. Kjo fitore, sipas orientalistëve dhe të armiqve të Islamit, ishte kthesë në historinë e Islamit. Nëse kjo ishte e vërtetë, dikush pa dyshim mund të thotë se shpata ka luajtur një rol në përhapjen e Islamit. Mirëpo, historia na tregon të kundërtën. Armiqësitë në mes të myslimanëve dhe të paganëve arabë morën fund me marrëveshjen e armëpushimit të *Al-Hudejbiaut* (mars të vitit 628). Kushtet e armëpushimit dukeshin aq të degraduara sa që Omeri nuk mundi të përmbahej dhe e pyeti Profetin s.a.v.s.: *Përse të dorëzohemi në një mënyrë aq të ulët kundër nderit të religjionit tonë?* Mekkasi ia jepnin atyre emrin e fitores. Mirëpo, ky ishte ai armëpushim nga konflikti i

armatosur që i dha Profetit të Shenjtë s.a.v.s. më shumë kohë për të përhapur fenë e tij. Madhësia dhe shtrirja e suksesit të tij mund të matet nga numri i njerëzve që marshuan bashkë me të për në Mekkë, në janar të vitit 630. Më parë, forca më e madhe e tij kishte vetëm 3000 vetë. Kjo ishte fuqia e ushtrisë së myslimanëve që e mbrojti Medinën, atëherë kur kjo ishte e rrethuar nga një ushtri e përbërë prej 10,000 paganëve arabë. Edhe 7000 njerëz e përqaftuan qartazi Islamin gjatë këtij armëpushimi dyvjeçar. Personalitetet si Amr b. As dhe Khalid b. Validi e përqaftuan Islamin në të njetën kohë. Suksesi i depërtimit paqësor të Islamit ishte aq i madhëruar sa që i hutuari Montgomri Vatt këtë e konsideron *ndër të pabesueshmit*, dhe shton: *I pari prej të gjitha shkaqeve të këtij sukse si të Muhammadit ishte tërheqja dhe atraksioni i Islamit dhe rëndësia e tij si një sistem religjioz dhe social të arabëve*. Vatti, , sikur i adresohet drejtpërsëdrejti Molana Modudiut, thotë:

*Po të mos ishte Muhammadi në gjendje të përmbante dhe të përforconte mbajtjen e tij ndaj myslimanëve, duke i qeverisur idetë religjioze të Islamit mbi imagjinatat e tyre, dhe po të mos ishte në gjendje të tërhiqte konvercionet e freskëta ndaj Islamit, marrëveshja e Al-Hudejbiat nuk do të shkonte në favorin e tij... çdo historian që nuk është i paragjykuar në favor të materializmit, patjetër duhet të pranojë besimin e Muhammadit dhe në mesazhin e Kuranit si faktor tepër të rëndësishëm, besimin e tij në strukturën e Islamit si një sistem politik dhe religjioz, dhe devotshmërinë e tij të vendosur ndaj detyrës për të cilën - siç besonte ai - Zoti e ka thirrur atë ... Kjo ekspeditë dhe marrëveshja shënojnë një iniciativë të re nga ana e Muhammadit.*

Është trishtim të shënohet se gjersa një orientalist sukseset e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. i konsideron *sundimi i ideve religjioze të Islamit*, një udhëheqës mysliman i pozitës së Molana Modudiut insiston se ai ishte tehu i shpatës, pas betejës së Hunenit, që i detyroi grupe me mijëra e mijëra arabë që ta përqafojnë Islamin.

Nëse këta ishin ata njerëz shpirtërat e të cilëve ishin pastruar me tehun e shpatës, atëherë këta do të ishin ata që do të ishin të parët për t'u revoltuar pas vdekjes së Profetit s.a.v.s. Kjo përgjigje e argumentit të Molanës, megjithatë, nuk e sqaron revoltën.

Në të kaluarën udhëtimi ishte i vështirë. S'kishin rrugë e andaj siguria nuk i garantohej askujt. Pra, ishte e pamundur për çdo arab të vinte te Profeti për të mësuar rreth Islamit, po në anën tjetër as Profeti nuk ishte në gjendje t'i bënte vizitë çdo rajoni të gadishullit.

Ishte zakoni i arabëve që ata dërgonin te Profeti s.a.v.s. ndonjë delegacion nga tërë fisi, ose ndonjë delegacion i myslimanëve u dërgohej fiseve për t'u përcjellë mesazhin e Islamit. Aty bëheshin diskutime dhe debate, dhe në fund i tërë fisi e pranonte vendimin e marrë nga anëtarët e delegacionit ose nga paria e fisit. Pra ka shumë njerëz që e përqaftuan fenë Islame, por që nuk patën rast të përfitonin dobi drejtpërsëdrejti nga mësimet e nga predikimet e Profetit s.a.v.s.; ata, bile, as nuk e kanë parë atë dhe s'patën rast të kalonin ndonjë çast me es-habët e Profetit s.a.v.s. Religjioni është një eksperiencë personale dhe mësohet veçanërisht nga shembulli e nga

inspiracioni (frymëzimi), gjë që nuk e kishin në dispozicion pranuesit e rinj. Dhe fill pas pranimi të tyre të Islamit, u vjen fatkeqësia e vdekjes së Profetit të Shenjtë s.a.v.s. Horizonti i Arabisë u errësua pak nga vdekja e Profetit të Islamit s.a.v.s. Ne mund të mësojmë shumë nga ajo periudhë e historisë, kur njerëzit e refuzuan dhe e përgënjeshtroan Profetin e kohës së tyre dhe dëshironin që ta shuanin dritën e tij me forcë, mirëpo ata u dënuan ashpër për këtë gjest. Duke e parë dënimin, shumë njerëz e shohin dritën e imanit (besimit) tamam në atë kohë kur burimi i asaj drite është gati të shuhet. Disa herë njerëzit e njohin ndonjë profet pas një kohe të gjatë të vdekjes së tij. Çfarë dënimi! Ta persekutosh Profetin kur ai është i gjallë, por ta pranosh atë vetëm pas vdekjes së tij.

Prejse Molana Modudiu iu bashkua armiqve më të këqinj të Islamit, duke argumentuar se shpata ka luajtur një rol në përhapjen e Islamit, ne duhet të rishqyrtojmë jetën e Profetit s.a.v.s. me qëllim që të shohim se a ka ndonjë rast ose ndonjë moment kur njerëzit u detyruan ta përqafojnë fenë Islame pa vullnetin e tyre.

Ndarja e jetës së Profetit të Shenjtë s.a.v.s. në dy faza - faza e Mekkes dhe ajo e Medinës, duket e logjikshme, por, në realitet, kjo është tejet e thjeshtë. Pas Hixhrës, Profeti s.a.v.s. dhe Emigrantët (Muhaxhirë) shpëtuan nga persekutimi, mirëpo përpjekja për të jetuarit ende nuk kishte marrë fund. Do të ishte më e logjikshme që jeta e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. të ndahet në tri faza: e para është jeta e tij gjer në emigrim për në Medinë; e dyta është jeta e tij nga emigrimi dhe gjer në marrëveshjen e

Hudejbiaut, që gjithashtu është një periudhë e persekutimit, ndërsa e treta është jeta e tij nga marrëveshja e gjer te nënshtrimi i Mekkes. (Ndonëse myslimanëve u ishte lejuar të luftonin, ata nuk kishin barazi me opozitën e paganëve. Medina ishte ai qytet i vetëm ku jetonin myslimanët, por ata s'kishin kontrollin e tij. Tri fiset e jehudëve dhe anëtarët jomyslimanë të fisit Aosit dhe të Khezraxhit sundonin në qytet. Po ashtu, madhësia e armiqve në betejën e Badrit e reprezentonte fuqinë e tyre aktuale. Andaj, kjo periudhë duhet të konsiderohet si një shtesë e përpjekjeve të idhëta të periudhës së Mekkes). Periudha e tretë fillon me nënshtrimin e Mekkes. Kjo ishte periudha e paqes. Paganët e Mekkes nuk i sulmuan myslimanët, sadoqë u bënë disa përleshje të vogla me jehuditë dhe me disa fise të Arabisë, të cilat i thyen marrëveshjet e nënshkruara me myslimanët.

Periudha e parë e persekutimit zgjati 13 vjet. Gjatë kësaj kohe nuk vinte në shprehje çështja e konvercionit me forcë. Edhe orientalistët pajtohen me këtë fakt. Në të vërtetë, njerëzit, me gjithë persekutimin, e përqafonin Islamin. Myslimanët që e përqafuan Islamin në atë kohë në Mekke, njihen si muhaxhirë (emigrantë) dhe kjo është një e vërtetë historike që asnjë emigrant nuk u detyrua të pranojë fenë Islame përkundër dëshirës së tij.

Myslimanët u lejuan të marrin armë për t'u rezistuar gjatë periudhës së dytë të persekutimit të tyre. Një kritik mund të mendojë se gjatë këtij konflikti të armatosur është e mundur që së paku disa njerëz do të dalin që u detyruan me forcë ta përqafojnë Islamin. Mirëpo,

historia e asaj periudhe është tërësisht e dokumentuar. Shumica e myslimanëve në Medinë u takonin dy fiseve arabe - fisit Aos dhe fisit Khezraxh. Këta ishin ata njerëz që e kishin ftuar Profetin e Shenjtë s.a.v.s. në Medinë. Kur ata u takuan me Profetin s.a.v.s. në Akabah, ai tha: Unë e lidh këtë pakt me ju me kusht që besnikëria, për të cilën ju më përbetoheni, do të ju detyrojë të më mbroni, ashtu siç i mbroni ju gratë dhe fëmijët tuaj.

Prijësi i Khezraxhve, Bars, i cili u ngrit të përgjigjet, e kapi dorën e Profetit s.a.v.s. dhe tha: Pasha atë Qenie që të dërgoi ty me vërtetësi, ne do të të ruajmë ty, ashtu siç do t'i ruajmë ata. Andaj, pranoje betimin tonë të besnikërisë, o i dërguari i Zotit, sepse ne jemi njerëz të luftës, posedues të armëve të trashëguara nga gjenerata në gjeneratë.

Këta ishin ata njerëz që udhëtuan tërë rrugës nga Jethrebi (Medina) për në Mekke që t'i ofronin Profetit s.a.v.s. shpatat e tyre dhe që njihen si Ansarë (ndihmtarë).

Po ashtu, disa jehudë në Medinë dhe një numër i vogël i arabëve nga fshatrat e largëta e pranuan Islamin, por asnjëri prej tyre nuk e pranoi fenë e tij të re nën shtrëngimin ose si rezultat i konfliktit të armatosur. Gjatë kësaj periudhe përhapja e Islamit në Mekke ishte e pazbatueshme dhe, përkundër persekutimit të madh, arabët e Mekkes vazhduan ta përqaфонin Islamin. Edhe një herë mund të themi se forca nuk ka luajtur ndonjë rol në këtë konvercion.

Konvercioni i robëve të luftës është i vetmi përjashtim i mundshëm i largët. Para se ta shohim këtë, ne duhet të shpjegojmë një keqkuptim. Fjalët *ghazvah* dhe *sarijah* nuk do të thonë luftë ose konflikt i armatosur. Këto përdoren për ndonjë ekspeditë. Gjurmuesit, patrullat, ambasadat, ekipet shpëtimtare, dëbimi i kusarëve - bile edhe udhëtimi i një sahabinu (kolegu i Profetit s.a.v.s.) për të përhapur fenë - grupohen nën këtë titull. Ekspeditat janë të njohura si sarijah; nëse Profeti s.a.v.s. e ka udhëhequr vetë, atëherë quhet *ghazvah*. P.sh. ekspedita e parë, të cilën e ka udhëhequr Profeti s.a.v.s., ajo ishte për në AI-Abva, ku nëna e tij është varrosur. Ai ishte i shoqëruar nga 60 muhaxhirë. Aty Profeti i Shenjtë s.a.v.s. qëndroi disa ditë dhe nënshkroi një marrëveshje miqësie me prijësin e Banu Damrahit. Menjëherë pas kësaj, Profeti s.a.v.s. u detyrua ta përcjellë Kurz al-Fihriun. Si Vatti shënon: Kjo ishte një tentativë për të dënuar një kusar të rajonit fqinj për shkak të vjedhjes së disa deveve që kullotnin në Medinë. Ekspedita, prapë sipas fjalëve të Vattit, i ilustron ato rreziqe kundër të cilave ai (Profeti i shenjtë) vazhdimisht duhej të jetë i kujdesshëm. Aty në mes të Hixhrës dhe të Marrëveshjes së Hudejbaut kanë pasur më së paku 50 ekspedita. Prej tyre, tri konflikte patën dimensionin e luftës së vërtetë: Badri, Ohudi dhe Ahzabi. Në konfliktin e armatosur me Benu Mustalikun u robëruan më shumë se 100 vetë, por të gjithë këta u liruan pa ndonjë kompensim. Në disa ekspedita të vogla u robëruan vetëm dy ose tre veta që gjithashtu u liruan pa ndonjë kusht. Ajo ishte vetëm beteja e Badrit ku u zunë 72 robë lufte. Dy prej tyre u dënuan me vdekje për shkak të krimeve të mëparshme, ndërsa të tjerët u liruan



pasi paguan kompensimin - që në disa raste ishte vetëm që t'u mësojnë lexim e shkrim fëmijëve të Ansarëve.

Periudha e tretë fillon me Marrëveshjen e Hudejbiaut dhe mbaron me nënshttrimin e Mekkës. Gjatë kësaj periudhe, u bënë 22 ekspedita, prej të cilave vetëm tri kanë pasur karakter konflikti ku nuk u zë ndonjë rob lufte. Profeti i Shenjtë s.a.v.s. e pat dërguar Dihja bin Khalifa al-Kalbin si një përfaqësues te Cezari. Gjatë kthimit të tij, Dihja, i cili ishte duke mbajtur dhuratat bizantine për Profetin e Shenjtë s.a.v.s., u plaçkit nga Al-Hunejdi dhe nga anëtarët e fisit Xhurham. Profeti i Shenjtë s.a.v.s. dërgoi një ekspeditë nën komandën e Zejd b. Harithit për t'i dënuar Al-Hunejdin dhe bashkëpuntorët e tij. Robërit, të cilët u zunë në përleshje të vogla, u liruan pasi shprehën pendimin. Bashir b. Sadi udhëhoqi me sukses një ekspeditë kundër Ghatfanit, i cili ishte në aleancë me jehuditë e Medinës dhe me paganët e Mekkës. Aty u zunë vetëm disa robë, por nuk dihet gjë mbi fatin e tyre. Po ashtu, u dërgua një ekspeditë për ta dënuar B. Bani Kalbin. Një grup nga fisi B. Urejnah, i cili jetonte në mesin e B. Kalbit, erdhi në Medinë me pikëllim të madh dhe e përqafoi Islamin. Pasi ata vuanin nga ethet, u dërguan në kullotat e Profetit s.a.v.s. që të kenë ushqim të mirë dhe qumësht. Por, kur u shëruan dhe u bënë shëndosh e mirë, e vranë mizorisht bariun dhe vodhën 15 deve. Këta u dënuan për shkak të këtij krimi makabër. Ata ishin një numër i vogël robërish, hollësitë nuk dihen.

Ky shqyrtim i hollësishëm tregon se nga Hixhra e deri te nënshtrimi i Mekkës, asnjë rob lufte nuk u detyrua me

dhunë që ta pranojë Islamin. S'ka asnjë të dhënë e evidencë që të verifikojë se ndytëria e shpirtërave të tyre u eliminua me anë të teheve të shpatës. Por, përkundrazi, këta robër u lejuan të kthehen lirisht në paganizmin e tyre. Periudha finale e jetës së Profetit të Shenjtë s.a.v.s. filloi me

nënshtrimin e Mekkes - ose të themi me ditën e ngadhënjimit të zemrave. Fitorja e Islamit mbi banorët e Mekkes përfundimisht vërteton se përhapja e Islamit nuk kishte ndonjë lidhje qoftë edhe të venitur me dhunën. S'ka njeri që e pranoi fenë islame me anë të dhunës.

Abu Sufjani, armiku i përbetuar i Islamit, i cili e përqafoi fenë islame, tamam në rastin e hyrjes triumfale të Profetit s.a.v.s. në Mekke, e shikonte ushtrinë myslimane nga një lartësi afër qytetit. Axha i Profetit të Shenjtë s.a.v.s., Abbasi, ishte me të. Ajo që pa Abu Sufjani, është përmendur në mënyrë të shkëlqyer nga Martin Lingsi:

*Trupat kalonin njëra pas tjetrës, dhe me kalimin e çdonjërës prej tyre, Abu Sufjani pyeste se kush janë këta, dhe çdo herë ai çuditej, ose për shkak se fisi në fjalë gjer më tani ishte shumë larg nga rrethi i influencës së Kurejshve, ose për shkak se ai tani ishte në armiqësi ndaj Profetit, siç ishte rasti i Ghatafanitëve, fisi i Ashxhës, njërin nga flamujt e të cilit ishte i bartur nga Nuejmi, ish shoku i tij dhe i Suhejlit. Prej të gjithë arabëve, tha Abu Sufjani, këta ishin armiqtë më të idhët të Muhammadit. Zoti bëri që Islami të hyjë në zemrat e tyre, tha Abbasi, gjithçka kjo është nga mëshira e Zotit.*

Athua, ajo ishte shpata që i bëri myslimanë? Dhe kur Profeti hyri në Mekke bashkë me 10,000 besimtarë, a u hakmor për persekutimin 13 vjeçar të bërë kundër tij? Idea e hakmarrjes ishte, në të vërtetë, në mendjen e disa personave. Kur Sad b. Ubejda e pa Abu Sufjanin, ai tha: O Abu Sufjan, kjo është dita e gjakderdhjes; dita kur i pacenuari do të jetë i poshtëruar: dita e poshtërimit të Zotit ndaj Kurejshve. Kur Abu Sufjani ia përsëriti Profetit të Shenjtë s.a.v.s. çka kishte thënë Sadi, Profeti s.a.v.s. iu përgjigj: Kjo është dita e mëshirës, dita ku Zoti i lartësoi Kurejshët. U shpall një amnesti e përgjithshme. Duke përdorur fjalët e Hazret Jusufit a.s., të përmendura në Kuran, Muhammedi s.a.v.s. tha:

Me të vërtetë, unë them ashtu siç tha vëllai im Jusufi: *Sot nuk ka qortim kundër jush. Allahu ju faltë! Ai është më i Mëshirshërn prej të gjithë atyre që bëjnë mëshirë.*(12:93)

Washington Irvingu që nuk është ndonjë observor simpatizues i Islamit, e përmend hyrjen e Profetit të shenjtë s.a.v.s. në Mekke me këto fjalë:

*Dielli sapo lindte kur ai hynte në portat e qytetit të tij të lindjes me madhëstinië e një ngadhënjimtari, por me rroba dhe me përulje të një haxhiu. Ai hyri duke i recituar në mënyrë përsëritëse ato ajete të Kuranit, të cilat iu zbritën në Medinë dhe që e mbanin profecinë e kësaj ngjarje. Ai triumfoi me shpirtin e një religjiozi të zellshëm, e jo të luftëtarit.*

Liderët e Mekkes, të cilët e kundërshtuan Profetin s.a.v.s. me të gjitha mjetet që kishin në dispozicion, jo vetëm që u falën me shpirtmadhësi, por ashtu siç Montgomri Vatt pranon: *Nuk u detyruan ta pranojnë Islamin; ata dhe*

*shumë të tjerë të dyshimtë mbetën pagan, më së paku deri te Al-Xhirahah.*

Maksim Rodinsoni pajtohet me Vattin: *Asnjë njeri nuk u shtrëngua që ta përqafojë Islamin.*

Sikur të gjendej në burimet tona primare të hadithit (të thënat e Profetit të Islamit) e të siretit (biografia e Profetit dhe e reformatorëve) ndonjë pikë a gjurmë më e venitur e konvercionit me forcë, kritikët e Islamit, me të vërtetë, do të kishin ditë ngadhënjimi. Tani krahasoni opinionet e Irvingut, të Vattit dhe të Rodinsonit me ato të Molana Modudiu rreth kësaj teme: *Kur çdo metodë e bindjes dështoi, Profeti mori shpatën. Ajo shpatë ia zhduki dhe e eliminoi të keqen, djallëzinë dhe ndyrësinë e shpirtit.*

Fitorja e Mekkës do të mbetet përgjithmonë e gdhendur në faqet e historisë. Ajo ditë vazhdimisht do ta lirojë Profetin s.a.v.s., mëshirë për tërë njerëzimin, nga akuzat e përdorimit të dhunës e të forcës, të cilët Molana Modudiu ia ngarkoi atij. Një orientalist jomusliman, Stanli Lane Pula, u detyrua të korrigjojë gabimin e Molan Modudiu dhe kjo është një tragjedi me rëndësi të madhe që i sjell pikëllim zemrës së çdo muslimani fisnik. Lane Puli thotë:

*Dita e triumfit më të madh të Muhammedit mbi armiqtë e tij ishte gjithashtu dita e fitores madhështore ndaj vetvetes. Ai zemërgjersisht i fali Kurejshët kundër të gjitha atyre brengave, vuajtjeve, përbuzjeve dhe mizorisë që ata ia shkaktuan atij vite me radhë, dhe e amnestoi tërë popullësinë e Mekkës.*

Faza e fundit e jetës së Profetit të Shenjtë s.a.v.s. fillon me fitoren e Mekkës dhe mbaron me vdekjen e tij. Aty patën shtatë ekspedita gjatë kësaj kohe. Në tri nga këto nuk u bë fare luftë dhe as nuk u zu ndonjë rob. Në katër ekspeditat e tjera u zunë më shumë se 6000 robë. E çfarë ngjau me këta robë? Logjika e Modudiut do t'na udhëzonte të besojmë se ky ishte rast perfekt për të eliminuar

ndyrësinë nga shpirtërat e të burgosurve dhe për t'i detyruar ta pranonin Islamin. Mirëpo, historia na tregon diçka ndryshe: Në betejën e Hunenit u zunë 6000 robë. Profeti i Shenjtë s.a.v.s. e pat kaluar fëmijërinë e tij bashkë me njerin nga bajrakët e këtij fisi, si bir në shpirt. Në mesin e të burgosurve ishte një plakë që bëri protestë kundër zënies së saj duke thënë: Pasha Zotin, unë jam motra e kryetarit tuaj. Ajo plakë u soll para Profetit të Shenjtë s.a.v.s., dhe ai e liroi atë se ajo me të vërtetë ishte njera ndër motrat e tij në shpirt, Shejma. Profeti ia shtroi qilimin dhe i tha të ulet. Me sy të përlotur ajo pyeti për Halimën, nëna e saj në shpirt. Aty s'kishte fjalë qortimi. Profeti s.a.v.s. nuk bëri pyetje se përse fisi nuk ka menduar për birin e tyre në shpirt, para se të shkonin në luftë. Në vend që të bënte këtë pyetje, ai tha: Për sa u përket atyre që më takojnë mua dhe që i takojnë Abdul Muttalibit janë të tuat, merrini dhe janë të liruar. Kur myslimanët e tjerë e dëgjuan këtë, ata thanë: Çfarë na takon neve, i takon Profetit të Shenjtë s.a.v.s., dhe aty për aty ia sollën robërit e tyre. Prandaj, të gjithë 6000 robërit u liruan. Shpata nuk ka luajtur ndonjë rol në konvercionin e tyre. Profeti i Shenjtë s.a.v.s. motrës së vet në shpirt i dha deve, dele dhe dhi si dhuratë. Harithi, vëllai i të atit të Profetit

të shenjtë s.a.v.s. në shpirt, insistonte që tërë fisi Havazin të konsiderohet si farefisi i tij në shpirt. Lideri i tyre, Malik, i cili kishte ikur në Taif, u thirr dhe iu dhanë 100 deve. Profeti i Shenjtë s.a.v.s. e emërtoi gjithashtu edhe komandën e shoqërisë myslimane në rritje në Havazin. Po ashtu, edhe shumë të tjerë morën dhurata.

Gjithashtu 62 robë u sollën në Medinë nga ekspedita e Ujanah b. Hisnit. Ata kërkuan mëshirë dhe u liruan.

Në ekspeditën për në Fuls, një qendër e adhurimit të idhujve, Adi - lideri i fisit kundërshtar Taj, iku, por njëra nga motrat e tij u zu. Kur ajo u soll në Medinë, ajo ra para gjunjeve të Profetit s.a.v.s. dhe e luti për mëshirë. Ajo tha: Babai im i lironte robët, u bënte mikpritje mysafirëve, i ushqente të uriturit dhe u ofronte rehati e qetësim të vuajturve. Ai kurrë nuk e ktheu askënd që vinte te dera e tij dhe kërkonte ndihmë. Unë jam bijë e Hatim Taiut.

Profeti i Shenjtë s.a.v.s. foli me të në mënyrë të njerëzishme dhe dha urdhër për lirimin e saj, duke thënë: Ati i saj i donte rrugët e bamirësisë, dhe po edhe Allahu i do ato. Profeti s.a.v.s. i dha një deve dhe rroba të bukura. Ndonëse, ajo nuk deshë të lirohej vetëm, andaj u liruan të gjithë robët e tjerë të zënë. Gjithçka kjo u bë vetëm se ajo ishte bija e një poeti të madh, mikëpritja dhe bujaria e të cilit i bëri arabët krenarë. Kur Adi dëgjoi për sjelljen ndaj motrës së vet, e përqafoi Islamin dhe Profeti i Shenjtë s.a.v.s. e verifikoi atë si kryetar të fisit Taj.

Duke vështruar opinionet e konfliktuara të orientalistëve rreth personalitetit të Profetit s.a.v.s., Maksim Rodinoni ka vërejtur: Çdokush e trajtoi sipas pasioneve, ideve ose fantazive të vet. Ky vështrim aplikohet më shumë për Molana Modudiun, një mysliman, se sa për orientalistët jomyslimanë. Pasioni i tij për të fituar autoritet politik ushqej nga impresionet e fëmijërisë së tij, të shuarjes së shkëlqimit të Hejdrabadit dhe u përforcua nga përpjekjet politike të ditëve të rinisë, kur së pari e admironte Gandixhiun e mandej e kundërshtoi komunalizmin hindus. Kjo mbizotëronte aq mbi mendimet e tij sa që për shkak të kësaj ai e paraqiti jetën e Profetit të Shenjtë s.a.v.s., mëshirë për tërë njerëzimin, në formë të një luftëtari - luftëtari që i përudh njerëzit me anë të tehut të shpatës.

## KAPITULLI IV

### PROFETËT DHE KALORËSIT

#### Një studim me kontrast

Pra, ti (o profet) vetëm këshillo se je vetëm një këshillues. Ti nuk je caktuar kujdestar për ta.

(Kurani 88:22)

Ky (xhemati islami) nuk është ndonjë organizatë misionare ose ndonjë organ i predikuesve apo i përgëzuesve, por është një organizatë e kalorësve të Zotit.

(Molana Abul Ala Modudiu)

Në kapitullin e mëparshëm u analizua piktura e Muhammadit s.a.v.s., Profeti i Islamit, e bërë nga orientalistët e shek. XIX. Kjo ishte një pikturë e një kalorësi luftarak fanatik që vrapon në shkretëtirën e Arabisë, duke e mbajtur shpatën të nxjerrë në njerën dorë dhe Kuranin në dorën tjetër, duke u ofruar viktimave të tij të pandihmuara zgjedhjen e njerës nga këta të dy. Tmerri i kësaj pikturë, e popullarizuar nga Edvard Giboni, është zbehur nga orientalistët bashkëkohor. Bile, edhe dijetari i mirënjohur jehud, Bernard Levisi, me humorin e tij të thatë britanik, u bind të pranojë se piktura jo vetëm se është false por, gjithashtu është e pamundur - veç në qoftë se ne jemi në gjendje të marrim



në mend garën e shpatarëve mëngjarashë. Në praktikën islamike, dora e majtë përdoret për sende të papastra, dhe asnjë mysliman i ndershëm nuk dëshiron ta përdorë për të mbajtur Kuranin. Mirëpo, ka një mysliman *i vetëndershëm* - Molana Modudiu - që shpatën e tij të nxjerrë e rroki në dorën e tij të djathtë, pavarësisht nga mungesa e tij përkatëse ndaj mësimëve të Kuranit të shenjtë dhe të praktikës së Profetit të Shenjtë s.a.v.s.

Molana pohon se ai është një ithtar besnik i Profetit s.a.v.s., dhe, si i tillë, njeriu pret prej tij të flasë me admirim për Mësuesin e tij. Kjo është natyra e njeriut që ai sheh vetëm bukurinë e të dashurit të vet. Syri i tij sheh në fytyrën e tij atë bukuri që nuk ekziston askund. Por, si Molana Modudiu mund t'i shohë të metat në qenien e zotriut të tij (Muhammadit s.a.v.s.) të dashur, të cilat i mohojnë bile edhe armiqtë më modernë të Islamit. Ka tri përgjigje lidhur me këtë pyetje:

1. Që pohimi i Molana Modudiu se është ithtar besnik i Islamit është fals. Sipas asaj që ka shkruar Molana Modudiu në *Al- Xhihad Fil Islam* dhe në punimet e tij të tjera, lexuesi me arsye mund të fitojë impresion se autori s'ka as ndonjë lidhje të largët me mësimet e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. dhe se pohimi i tij se është ithtar besnik është fals. Kjo është një akuzë mjaft serioze. Pasi unë i takoj një xhemati; që në mënyrë të rrejshme; akuzohet se gjoja e çnderon Profetin e Islamit s.a.v.s., unë do të jem i fundit ndër ata që dyshojnë në besnikërinë e Molana Modudiu ndaj Profetit dhe Mësuesit tonë, Muhammedit s.a.v.s.

2. Se të kuptuarit e Molanës ndaj vlerave është i ngatërruar, andaj ai ka aq shumë vështirësi në dallimin e

të mirës nga e keqja sa ka ai njeri që nuk dallon dot ngjyrat, në dallimin e së kuqes nga e gjelberta.

3. Se Molana Modudiut i ishte mbushur mendja në mënyrë të atillë që s'gjente qetësi mendore me dëshirën që të ketë fuqi politike dhe autoritet (është i sëmurë nga obsesioni - ankthi). Kjo sëmundje mund të përkufizohet si vijon: Një ide këmbëngulëse ose përsëritëse, zakonisht e ngjyrosur me emocion; shpeshherë një dëshirë e ngatërruar ndaj disa formave të aksionit; e tërë gjendja mendore është patologjike.

Piere Zhanet zbuloi se një person i tillë është i paskrupullt, gjithnjë i ndërgjegjshëm dhe i qëlluar nga një kuptim i pavlefshëm. Elton Majo e ka përmbledhur mendimin e Zhanetit dhe karakteristikën e tij të kësaj sëmundjeje me këto terma: Ata janë ekspertë në rimendimin e vështirë të së logjikshmes - ata e zëvendësojnë përpikërinë e tepruar në aktivitete të vogla, sepse ata lidhur me aktivitet në çështje të mëdha janë të paaftë ose e ndiejnë veten të paaftë.

Memoria fëmijënore e Molanës dhe përvojat rinore të Hejdrabadit, siç pamë më parë, e çoi atë nga një burim i kontrollit psikologjik - fuqia politike. Kurt Levini ka vërejtur se nëse dikush dëshiron të kuptojë sjelljen e një individi, duhet hedhur një shikim mbi tërë hapësirën e jetës së tij - dikush duhet ta lidhë individin me rrethin e tij gjatë kalimit të kohës dhe gjatë momentit të veçantë. Fusha e interesit të Levit është kështu: Hapësira e jetës, duke përfshirë personin dhe rrethin e tij psikologjik. Vudvorthi dhe Shihani e përpunuan teorinë e Levit dhe

thanë: *Rrethi psikologjik ose i sjelljes, me të vërtetë, është rrethi siç perceptohet e kuptohet nga personi, por më shumë se kjo është rrethi që ka të bëjë me nevojat e tij prezente dhe të dukshme. Shumë objekte që perceptohen, tani për tani, s'kanë lidhje me të, dhe që ekzistojnë vetëm në sfondin e rrethit të tij psikologjik. Objekte të tjera kanë valencë pozitive ose negative-pozitive nëse premtojnë t'i plotësojnë nevojat e pranishme të tij, dhe negative nëse kërcënojnë lëndim. Objektet e valencës pozitive e tërheqin atë, kurse objektet e valencës negative e neveritin atë.*

Psikologjia nuk është ndonjë shkencë absolute dhe kjo ende është në zhvillim e sipër, por *obsesioni* i Molana Modudiut duket se i përshtatet dhe i përputhet teorisë, të cilën ne e diskutuam. Kjo nuk do të thotë, me të vërtetë, se aty s'ka mundësi tjetër për shpjegimin e gjendjes së tij psikike. Çfarëdo që të jetë shpjegimi, vizioni i Molanës në mënyrë të padyshimtë është errësuar nga obsesioni. Ai udhëton dhe, nganjëherë, ndodhet në ato rrugë, të cilat para tij i kanë shkelur armiqtë e Zotit. Andej, ky është ai obsesion i tij që e frymëzoi atë të përkrahë dënimin me vdekje për ata që e ndërrojnë religjionin. Ky dënim gjithmonë është kërkuar për profetët dhe për ithtarët e tyre, të cilët e ndërrojnë religjionin e tyre tradicional. Është obsesioni i njëjtë që e shtyri atë që të vërë shpatën në dorën e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. dhe, duke vepruar në këtë mënyrë, u jep përkrahje atyre armiqtë të Islamit që e vizatuan një pikturë të përgjakshme të Muhammadit s.a.v.s. Prejse bindja dhe forca janë reciprokisht ekskluzive, Molana e adopton shpatën si një mjet të reformës dhe e hedh poshtë

arsyetimin si një metodë konvercioni. Bindja dhe arsyetimi janë çështje të vështira për të cilat ai është i paaftë ose e ndien veten të paaftë. Ato janë të lidhura me sakrificat dhe me mundime të gjata në formë të opozitës, siç na tregon jeta e Profetit s.a.v.s. në Mekke. Pra, Molana i hedh poshtë si objektet e valencës negative. Forca nëpërmes fuqisë politike duket se i plotëson nevojat e tij të tanishme, andej ai e adoptoi atë dhe e lidh jetën e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. me një proces të të menduarit rëndë.

Kur unë e përmend obsesionin e Molanës, unë muk kam ndërmend të tregoj ndonjë mosrespektim ndaj tij, migjithëse, duke vënë një shpatë në dorën e Mësuesit e të zotërisë tim Muhammedit s.a.v.s. ai tregoi mosrespektim ndaj Profetit s.a.v.s. Duke i bërë recension librit të Israel Shenkerit *Coat of Many Colors* (Pallto shumëngjyrash), një përmbledhje e eseve rreth jehudizmit, Hugh Nissendeni shkruan: *Zotëri Shenkeri obsesionin e tij e dramatizon në atë mënyrë që historinë e popullit të vet e bën të pranueshme dhe të ndriçueshme për secilin*. Unë vetëm dëshiroj që Molana obsesionin e tij ta përdorë për qëllime të mira. Në vend që të justifikonte forcën, jo vetëm si legjitim, por gjithashtu si një metodë esenciale për reformë, ai thotë: Eshtë e pamundur që ata (armiqtë e Islamit) t'i lajnë duart nga interesat e tyre vetëm me anë të këshillave e të bindjes. Po, gjithçka mund të bëhet kur do të arrish fuqinë politike dhe kur të mos lejosh që njerëzit të kryejnë vepra të këqija.

Kjo metodë e reformës duket efektive dhe më e lehtë se bindja, e cila kërkon durim dhe këmbëngulje ndaj prapsjes, talljeve dhe ndaj përbuzjeve. Është shumë lehtë

t'i kthesh njerëzit me dhunë në fe. S'ka asnjë krahasim në mes të këtyre dy metodave. Njëra është e lehtë dhe e shpejtë; tjetra është e vështirë dhe kërkon kohë e durimin e Jakubit a.s. Të gjithë reformatorët ballafaqohen me tallje, përbuzje dhe me përgënjeshttrim. Ja se si e përmend Kurani fatin e tyre:

Ata që janë fajtorë, i përqeshnin besimtarët. Dhe kur ata kalonin pranë tyre, ia bënin me sy njëri-tjetrit. Dhe kur ktheheshin te familjet e tyre ktheheshin, duke folur shumë (kundër besimtarëve). Dhe ata kur i shihnin besimtarët, thoshin se këta janë të humbur (83:30-34).

Ajetet e lartëcituarat shpjegojnë se përse Molana Modudiu nuk e ndjek rrugën e reformatorëve të dërguar prej Zotit. Njerëzit i përqeshin këta reformatorë dhe thonë: Shikoni këta njerëz - e vetmja armë e të cilëve është bindja! Këta janë aq të dobët sa që kur të dëshirojmë mund t'i shkatërrojmë; dhe prapë ata pohojnë se do të fitojnë zemrat e njerëzve me anë të arsyetimit dhe të predikimeve dhe të këshillave të tyre. Pra, Molana e hedh poshtë argumentin paqësor dhe në vend të tij thotë:

*Çdokush që dëshiron të çrrënjësojë veprat e këqija dhe çrregullimin nga toka e Zotit dhe dëshiron të reformojë njerëzimin, duhet të realizojë se një punë të tillë ai s'mund të kryejë vetëm me anë të predikimeve dhe të këshillave. Kjo është e padobishme. Ai duhet të ngrehet kundër qeverisë që ka principe false, ai duhet ta zabtojë pushtetin, t'i largojë keqbërësit nga autoriteti dhe të*

*formojë një qeveri të bazuar mbi Principe të shëndosha dhe menjë administratë të drejtë.*

Por, metoda modudiane e reformës që është e modeluar sipas Marksizmit, nuk është rrugë hyjnore për shpëtimin e njerëzimit. Në planin e Zotit, bindja është aq e rëndësishme sa që, edhe në një epokë të rrezimit të moralit të përgjithshëm, vetëm besimtarët e vërtetë e të devotshëm, të cilët e nxisin njëri-tjetrin me vërtetësi dhe me qëndrim (103:4), do të korrin sukses. Edhe një vështrim i sipërfaqësor i hedhur mbi historinë do të tregojë se për të bërë revolucione morale e shpirtërore, Zoti i këshillon shërbëtorët e vet që t'i fitojnë zemrat e njerëzve me vërtetësi e me durim. Durimi dhe lutja janë pjesë integrale e revolucionit religjioz dhe ata duhet të vazhdojnë të predikuarit deri sa të plotësohet premtimi i Zotit. Është paralajmëruar se përfundimi i këndshëm u takon bamirësve (7:129).

Të gjithë profetët e Zotit e kanë adoptuar këtë metodë të reformës religjioze, e cila tërësisht është kundër përdorimit marksist të forcës. Kurani e ruan historinë e shumë profetëve e të predikonjësve. Sipas kësaj historie hyjnore, mjeti i revolucionit të Nuhit a.s. ishte bindja dhe po ashtu edhe ai i Ibrahimit a.s. Ky ishte edhe mjeti i Shuejbit a.s. dhe i Salihut a.s. Edhe Luti a.s. u dërgua si këshilltar dhe ashtu edhe Musai a.s. Isai a.s. bëri revolucion me anë të predikimeve të veta. Dhe, mbi të gjithë, Vula e profetëve, reformatori më i madh i të gjitha kohërave, Mësuesi ynë Muhammedi s.a.v.s., u dërgua të bëjë një revolucion shpirtëror universal pa asgjë pos bindjes dhe arsytimit. Mirëpo, Molana jo

vetëm që nuk e mori në konsideratë traditën e profetëve të shenjtë të Zotit, ai gjithashtu e kontradiktoi me anë të fjalëve vijuese: *Çdo kush që dëshiron të çrrënjësojë veprat e këqija dhe çrregullimin nga toka e Zotit dhe dëshiron të reformojë njerëzimin, duhet ta dijë se një punë të tillë ai s'mund ta kryejë vetëm me anë të predikimeve dhe të këshillave. Kjo është e padobishme.*

Le të krahasojmë deklaratën e rëndësishme të Modudiut me traditën e pathyeshme të Profetit të Zotit. Kur populli i Nuhit a.s. e akuzoi atë për përhapjen e *gabimit të hapur*, ai iu përgjigj: *O populli im, s'jam në gabim, por, përkundrazi, unë jam një profet prej Zotit të botërave. Unë vetëm po ju përcjell mesazhin e Zotit tim dhe ju këshilloj singërisht dhe unë në bazë të dijes që Allallu më dhuroi mua, e di atë që ju nuk e dini (7:62-63).*

Kjo është sjellja e Zotit ndaj ministrit të Nuhit a.s. Sipas deklaratës së Modudiut, Nuhi do të duhej të thoshte: Unë jam profet i Zotit dhe unë do t'ju imponoj, doni ose nuk doni ju, një trup të një njeriu të devotshëm që do ta rrëmbejë fuqinë prej jush.

Kur populli i Adit i tha Hudit a.s. se është i humbur nga budallëku, ai nuk tha: Mos u mështroni t'më thoni budall për shkak të këshillave të mia të padëmshme; ju s'më shihni mua realisht. Faktikisht, unë jam një shtypës dhe një ditë do ta rrëmbej fuqinë nga duart e atyre, të cilët rebeluan kundër Zotit dhe do t'ia japë popullit tim të drejtë. Pa dyshim, ai nuk foli në këtë mënyrë, por në vend të kësaj ai ndoqi traditën e profetëve dhe tha:

O populli im, s'jam i marrë, por, përkundrazi, unë jam një profet prej Zotit të botërave. Unë vetëm po ju përcjell mesazhin e Zotit tim dhe unë jam një këshilltar i sinqertë për ju. (7:68-69) Populli i Thamudit, si ai i Adit, e përgënjeshtroi Salehun a.s. dhe e akuzoi për gjithçka. Por, duke ecur rrugës së Nuhit a.s. dhe të Hudit a.s., ai u tha:

*O populli im, unë jua kam përcjellë mesazhin e Zotit tim dhe ju këshillova sinqerisht, mirëpo ju s'i doni këshillat e sinqerta (7:80).*

Dhe mandej Zoti e dërgoi Lutin, ithtarët e të cilit nuk bënë ndonjë përpjekje për të rrëmbyer fuqinë nga të paudhët, dhe vazhduan të argumentoheshin me ta, gjersa atyre nuk u erdhi dënimi. Para se të vinte dënimi i caktuar, Luti dhe ithtarët e tij me lejen e Zotit i lanë shtëpitë e tyre. Mandej, u gdhi ai mëngjes rreth të cilit tiranët gjithmonë kanë qenë të paralajmëruar.

*E kur do të zbresë ai ndëshkim në oborret e tyre, sa i tmerrshërn do të jetë mëngjesi i atyre, të cilët kanë qenë të alarrnuar! (37:178)*

Sureja e shtatë e Kuranit vazhdon me tregimin e të paudhëve dhe të profetëve të Zotit, të cilët u munduan t'i reformojnë ata. Pas rrëfimit të tregimit të Lutit a.s., Kurani na tregon se si Shuejbi u argumentua me popullin e tij arrogant dhe zhvilloi debate kundër atyre njerëzve mizorë që e torturuan. Kur e tërë këshilla e tij u refuzua, ai u largua prej tyre, duke thënë: *O populli im, Pa dyshirn unë jua kam përcjellë mesazhin e Zotit tim dhe ju*



*kam predikuar sinqerisht. Si, pra, të vajtoj unë për popullin mosbesimtar (7:94).*

Kurani që për Molana Modudiu dhe për të gjithë myslimanët është Fjala e Zotit, na tregon se të gjithë profetët e Zotit dhanë predikime dhe këshilla dhe kur u refuzuan të gjitha këto, ata kanë qarë dhe kanë bërë lutje para Zotit të tyre. Ata kishin një besim të patundur ndaj mesazhit të tyre dhe, në vend që të rrëmbenin fuqinë nga armiqtë e tyre, ata vazhdimisht u ofruan dashuri dhe zemërmirësi. Ata argumentoheshin butësisht, jepnin këshilla me përlësi dhe rezultatin ia linin Zotit. Ai është i vetmi Zot dhe Ai ia fal pushtetin atij, të cilin e do ai. Dëshirat e të gjithë profetëve janë të përmbledhura në fjalët e Musait a.s.: *O Zoti ynë, përforco durimin tonë dhe na merr shpirtin vetëm kur jemi të bindur (7:127)* Musai a.s. e këshilloi popullin e vet me këto fjalë: *O populli im, kërkonti ndihmë prej Allahut dhe dilni durimtar! (7:129)*, dhe u tregoi se pushteti i takon vetëm Allahut; Ai ia trashëgon atij që e do Ai. Nuk është e hijshme për bamirësit të rrëmbejnë fuqinë me forcë. Krejt ajo që dimë ne është se përfundimi i mirë u takon atyre që i frikësohen Zotit. (7:129)

Pas Musit a.s., Isai a.s. po ashtu e kaloi jetën e tij, duke i bindur dhe duke i këshilluar njerëzit dhe nuk mori në konsideratë kurrë që të rrëmbejë fuqinë. Më në fund, kryetar i të gjithë profetëve, Hazret Muhammedi s.a.v.s., u dërgua si një këshilltar dhe predikues që t'i ftojë njerëzit në drejtim të bamirësisë, jo në formën e një polici ose të një ushtari. Zoti e pagëzoi me emrin *këshilltar*, siç i tha:

*Pra, ti vetëm këshillo se je vetëm një këshillues. Ti nuk je i caktuar kujdestar për ta (88:22-23).*

Mirëpo, Molana insiston se ai dhe ithtarët e tij s'janë një grup i predikuesve religjioz dhe i evangjelistëve, por janë një organizatë e kalorësve të Zotit që *ata mund të jenë dëshmitarë kundër njerëzimit*. (2:144). Detyra e këtyre *kalorësve* është që të përdorin forcën për të zhdukur padrejtësinë, veprat e këqija, çrregullimin, mosbindjen dhe shfrytëzimin nga kjo botë. Zoti <sup>xh.sh.</sup> i drejtohet Profetit të Vet më të madh me këto fjalë: Ne nuk të kemi bërë ty rojtar të tyre dhe as nuk je mbikqyrësi i tyre. (6:108) Por, Molana Modudiu për të dhe për ndjekësit e tij rezervon jo vetëm autoritetin e një polici, por edhe kompetencën e një gjyqtari. Është çudi se Zoti nuk i dha Profetit <sup>s.a.v.s.</sup>, reformator më i madh i Tij, autoritet politik ndaj zemrave të mosbesimtarëve, por përkundrazi i dha Molana Modudiu dhe ithtarëve të tij. Profeti i Shenjtë <sup>s.a.v.s.</sup>, burim mëshire dhe zemërmirësie, luste shumë që ai të bëhet instrument për t'i treguar rrugët e bamirësisë tërë njerëzimit. Por, Zoti iu përgjigj: Atëherë, pra, ti a do t'i detyrosh me dhunë të bëhen besimtarë? (10:100) Për sa u përket besimtarëve, Zoti Profetit të Shenjtë <sup>s.a.v.s.</sup> i tha: Dhe sikur të kishte dashur Allahu, ata nuk do të bënin shirk (nuk adhuronin përveç Allahut). Dhe Ne nuk të kemi bërë ty rojtar të tyre, as nuk je mbikqyrës i tyre (6:108).

Përkundrazi, sjelljes së stabilizuar të të gjithë profetëve të Zotit, të përmendur në Kuran me emra ose në përgjithësi, Molana Modudiu i jep vetës autoritet për t'i shtypur e t'i shtrënguar shërbëtorët e Zotit me qëllim që

Xhamati Islami (Partia e Molana Modudiut) mund të çrrënjësojë padrejtësinë, veprat e këqija, çrregullimin, mosbindjen dhe shfrytëzimin nga bota.

Ambicia i Molana Modudiut për rrëmbimin e fuqisë s'ka kufi. Ai do të shkonte më larg për të arritur qëllimin e vet. Ai është i dehur tërësisht për autoritet politik dhe e konsideron se adhurimi i Zotit është përmendur vetëm për t'i stërvitur myslimanët që të zaptojnë fuqinë dhe ta sundojnë botën. Sipas tij, adhurimi s'ka ndonjë qëllim shpirtëror. Kjo nuk është një eksperiencë religjioze, rast takimi në mes të njeriut dhe të Kreatorit të tij, por një ritual i të disiplinuarit të vetvetes. Zoti thotë: *Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit por vetëm që t'Më adhurojnë Mua.(51:57)* Bota është krijuar vetëm për adhurimin e Zotit. Adhurimi nuk është krijuar për ndonjë qëllim tjetër. Mirëpo, megjithëkëtë, Molana insiston: *Namazi, agjërimi, zakati dhe haxhillëku janë përmendur për t'na përgatitur dhe stërvitur për këtë qëllim (për xhihad). Të gjitha qeveritë në këtë botë u japin armatave të tyre stërvitje speciale e të veçantë, po ashtu edhe policisë dhe shërbimit civil. Në të njëjtën mënyrë, Islami u jep stërvitje atyre, të cilët e përqafojnë atë, mandej kërkon prej tyre që ata të shkojnë në xhihad dhe të stabilizojnë qeverinë e Zotit.*

Asnjë religjion në botë nuk predikon një koncept të tillë materialistik të adhurimit. Bile, edhe adhurimi i Zotit mund të jetë asgjë pos ushtrimit të armatës për një person të sëmurë nga obsesioni.

Ambicia, sipas përkufizimit, është i padurueshëm, por prej të gjitha ambicieve marrëzia e fuqisë duron pak vonesë. Pra, Molana nuk merr rrugë të drejtë, sepse ajo është shumë e ngushtë dhe shumë e gjatë për të. Dhe gjithashtu Marksizmi nuk do të kishte marrë rrugën e gjatë e të vështirë të demokracisë për t'i çliruar të shtypurit. Në vend të kësaj, ai e adopton dhunën për të bërë orvatje që të përmbysë qeverinë e zgjedhur të sotme. Metoda e reformës së Molanës nuk ndryshon nga ideologjia marksiste e përpjekjes së dhunës. Molana thotë: *Ngrihuni për reformën e njerëzve kudo që të mundeni. Përpiquni t'i ndërroni principet e gabuara me ato parime të drejta. Rrëmbejeni fuqitë ekzekutive e legislative nga ata, të cilët nuk i frikësohen Zotit.*

Është i çuditshëm fakti se si një gazetar, si Molana Modudiu, duke pasur një eksperiencë të gjatë politike nuk mundi ta kuptojë principin se qeveritë nuk përmbysen me forcë, pa marrë parasysh a ka ndonjë arësytim apo jo. Të shkelësh këtë princip themelor do të thotë të krijosh çrregullim e të prishësh rendin. Zjarri i luftës civile do të shkrumbojë tërësisht godinën e shoqërisë.

Së pari, asnjë parti nuk mund të jetë gjyqtare për vete dhe të vendosë se qëllimet e saj janë të mira. Së dyti, sado që të jenë të mira ato qëllime, partitë opozitare nuk mund të dënohen dot. Është i pakuptueshëm fakti se çdo anëtar i opozitës është mizor, i padrejtë ose shpirtkeq, kurse çdo anëtar i kalorësve të Zotit është i ndërgjegjshëm, i frikësohet Zotit dhe është larg epshit dhe lakmisë. E vërteta qëndron në faktin se partitë, të cilat fillojnë punën e reformës me deklarata shumë të

larta fluturonjëse, janë ato që së shpejti bëhen lakmitare për pushtet, qëllimet e tyre të mira shkrumben nga flakat e lakmisë. Molana Modudiu vetë shpjegon se sa e pafrenuehisme është dëshira për pushtet: *Si çdo kush e di, pushteti është një djallëzi aq e rrezikshme sa që me të lind dëshirë për pushtet, ngriten stuhitë e lakmisë nëqenien e njeriut. Dhe ai (njeriu) me një dëshirë të përflakët shikon përpara për të grumbulluar thesaret e tokës dhe për të pasur kontroll ndaj qenieve njerëzore që ai të mund të ushtrojë fuqinë absolute mbi ta.*

Një problem në shpjegimin e kësaj retorike të pakontrolluar është se si një gazetar me përvojë, si Molana Modudiu, i harron kontradiktat inherente në shkrimet e veta. Nëse mendimi për të pasur pushtetin mund të sjellë një ndryshim aq të rrezikshëm zemëror, atëherë çfarë garanci ka që këta anëtarë të drejtë të Xhamati Islamit nuk do të korruptohen me të marrë pushtetin në dorë dhe fuqinë absolute? Pa dyshim, këta njerëz të drejtë kanë marrë ushtrimin e shërbimit civil, të përmendur nga Zoti d.m.th. adhurimin islamik (Namazi, agjërimi; zakati etj), por ky ushtrim shërbimi nuk kufizohet me Xhamat Islamit. Sipas Molana Modudiu, adhurimi i Ahmedianëve pranohet si adhurimi islamik. Mirëpo, çka thotë ai lidhur me adhurimin e Brelvit dhe të Deobandit (sekte në Islam)? A mund të thotë dikush se Namazi i Ehle-Kuranit është joislamik? Nëse është ashtu, atëherë përse këto sekte të Islamit nuk mund të ngriten kundër qeverive të bazuara mbi principet false, dhe të rrëmbejnë fuqinë, të eliminojnë keqbarësit dhe të stabilizojnë një qeveri të bazuar mbi administratën e shëndoshë dhe të drejtë? *False, keqbarës, e shëndoshë*

dhe e drejtë të gjitha janë terma relative. Ç'është false, sipas Xhamati Islamit, mundet që të mos jetë false sipas Deobandëve. Ç'është e shëndoshë dhe e drejtë sipas Deobandëve, s'mund të jetë e shëndoshë dhe e drejtë sipas Brelvive. Mandej, ç'mendon për jomyslimanët? Sepse edhe ata kanë pikëpamjet e veta rreth asaj që është e drejtë dhe jo e drejtë. Nëse pikëpamjet e tyre nuk ndryshohen nga ato të myslimanëve, ata do të qëndronin në rreshta për ta përçafuar Islamin. A thua, edhe ata do të kenë të drejtë që ta përmbysin qeverinë e kohës?

Qëllimet e mira dhe projektet e reformës s'mund të bëhen justifikim për të përmbysur qeverinë. Ekzistojnë diferenca të mëdha në përkufizimin e *të qenët të drejt'* në mes të partive të ndryshme politike sa që nëse pranohen të gjitha këto diferenca, asnjë parti s'mund të konsiderohej e drejtë. P.sh. sipas Molana Modudiu, Lëvizja Ahmediane s'ka kurrfarë lidhje me Islamin, sepse qeveria Britanike e krijoi për të përçarë ummetin mysliman me qëllim që myslimanët të pengohen nga xhihadit dhe të dobësohet fuqia e tyre. Thuhet se gjoja Lëvizja Ahmediane është themeluar që ta shkatërrojë fshehurazi ummetin mysliman.

Mirëpo, vetëshembëlltyra e Xhamatit Ahmadija është shumë ndryshe nga ajo e Xhamatit Islami. Ahmadi të besojnë se Lëvizja e tyre është themeluar për të stabilizuar epërsinë e Islamit dhe për të sjellë rilindjen e një myslimani. Ajo nuk ishte Britania, por ishte vetë Zoti, i cili e mbolli farën e kësaj Lëvizjeje për ta plotësuar atë premtim që Ai i kishte dhënë popullit të Muhammedit s.a.v.s. Allahu pat premtuar se do të dërgojë

një Mahdi për ta reformuar ummetin dhe do të ngrerë një Masih, i cili me argumentet e veta të pathyeshme do ta çrrënjësojë Kryqin, Kryqin që i dha vuajtje Krishtit (Isai a.s.). Andaj, i tillë ishte ai Mahdi dhe Masih që e themeloi këtë Lëvizje që tani është e zënë në shërbim të tërë njerëzimit. Në një anë kjo Lëvizje me përulje dhe modesti u jep këshilla dhe predikime njerëzve që ata të ndryshojnë veten, kurse, në anën tjetër, kjo lufton kundër dogmave të gabuara të krishterizmit dhe e mposht atë në çdo front. Prandaj, si mund të besojë dikush se Lëvizja Ahmadiane është themeluar nga Britania, që vetë është e krishterë? A mund të imagjinojë dikush se Britania e përkrah një lëvizje që është e dedikuar për çrrënjësimin e Trinitetit (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë) dhe që vetë ajo mbolli pemën e shenjtë të unikatësisë së Zotit - le të gjejë ai vetë ndonjë lëvizje të tillë. Kudo në botë shkuan Ahmaditë, u tha bari i Trinitetit dhe pema për herë e bukur e unikatësisë së Zotit u zbukurua me lule aromatike dhe me frute të ëmbëla. Nëse e tillë është ajo pemë e mbjellë nga Britania, atëherë dikush dëshironte vetëm që ata të kishin mbjellë disa pemë të tilla që të shpejtohej Rilindja e Islamit dhe të çrrënjësohej dogmat false të krishterizmit.

Atë besojnë ahmaditë për veten është krejt e kundërt me pikëpamjet e Molanës për ta. Sipas besimit të ahmadianëve, themeluesi i Lëvizjes së tyre ishte i kredhur tërësisht në dashurinë e Profetit të Islamit, Muhammadit s.a.v.s. Rreshtat e poshtëshënuara të njërës prej poemave të tij tregojnë ekstazën e dashurisë së tij dhe thellësinë e devotshmërisë së tij ndaj Profetit të Shenjtë s.a.v.s.:

*Unë jam i dehur në dashurinë e Muhammadit, pas dashurisë së Allahut, nëse ky është mosbesim (kufr), atëherë unë, pasha Zotin, jam mosbesimtar i fuqishëm (Durre Thamin).*

Sipas ahmedianëve, besimi i tyre është i rrënjosur thellë në dashurinë e Vulës së profetëve, Muhammadit s.a.v.s., ndërsa Molana Modudiu pohon se rrënjet e tyre shkojnë thellë në tokën e imperializmit britanik. Këto dy pikëpamje e kundërshtojnë tërësisht njëra-tjetrën.

Ne duhet të shqyrtojmë pikëpamjen e kundërt. Molana pohon se Xhamati Islami (Partia politike e Molana Modudiu) është themeluar për të krijuar një grup njerëzish të drejtë përmes një discipline të gjatë të adhurimit islamik. Këta njerëz duhet të arrijnë atë nivel të gatshmërisë ku Islami mund t'u thotë: *Po, tani ju jeni shërbëtorë më të drejtë të Zotit nëpër tokë. Marshoni përpara, o ju ushtarë myslimanë, luftoni kundër rebelëve të Zotit, i dëboni nga autoriteti dhe i mbani në duart tuaja frerët e qeverisë.* Falënderim për përpjekjet e Molanës, se ai grup i njerëzve të drejtë tani është i gatshëm dhe pret të fitojë forcën që të përmbysë qeverinë eksiztuese.

Molana realisht beson se ky grup i njerëzve të drejtë është krijuar për të reformuar njerëzimin dhe për të ngritur flamurin e Islamit në botë. Ky grup do ta asgjësojë çdo gjë jofetare dhe me shpatë do të gdhendë emrin e Allahut në çdo zemër.



Pohimi i Molanës se anëtarët e Xhamati Islamit janë shërbëtorë më të drejtë të Zotit, konsiderohet si i pabazë nga ahmedianët. Po kështu për sa i përket principit, secili ka të drejtë që veten dhe anëtarët e vet t'i konsiderojë të drejtë. Të jesh i drejtë është një gjë, por të jesh më i drejtë është diçka fare ndryshe. Ne s'mund të pohojmë se ne jemi të përudhur dhe më të drejtë. Njeriu është i humbur në labirintin e vetëmashtrimit, të deziluzionit dhe të hipokrizisë të plotë, andaj ai është i paaftë ta përshkruajë veten me ndonjë saktësi. Kush i di fshehtësitë e zemrës, pasionin e mendjes dhe dëshirat e fshehura, përveç Zotit? Vetëm Ai e di se kush është i drejtë dhe kush është mëkatar. Aty, me të vërtetë, ka edhe përjashtime. Disa njerëz shfaqin shenja të pagabuara dhe konkluzive se ata janë të drejtë, kështu që dashuria e Zotit është evidente nga sjelljet e tyre. Zoti flet me ta ashtu siç fliste Ai në të kaluarën me njerëzit e drejtë. Drita e Tij ndriçon mbi ta ashtu siç ndriçonte mbi mistikët dhe mbi shenjëtarët e mëdhenj të ummetit, dhe ndihma dhe përkrahja e Zotit manifestohen në fjalë e në vepra.

Prandaj, ahmedianët tërësisht e hedhin poshtë pohimin e Molana Modudiut se Xhamati Islami është themeluar për to ngritur flamurin e Islamit. Kjo, në realitet, është degradimi dhe njollosja e religjionit, të cilin ai ndjek, siç pohon ai. Ithtarët e Molana Modudiut mund të pohojnë çka dëshirojnë ata në një shtet të sigurtë islamik siç është Pakistani ose Arabia Saudite, por le të përhapin doktrinën e tyre *Islami me forcë* në ndonjë vend tjetër dhe të shohin se çfarë pritje dhe përgjigje do marrë kjo parti politike. A mund t'i kthejnë të krishterët në Islam

me gjithë besimin e tyre se Krishti është i gjallë në qiell që nga dita e Kryqëzimit? A mund ta shkatërrojnë Kryqin? A mund të ngrerë dikush flamurin e Islamit me këto besime dhe dogma Modudiane?

S'ka asnjë dyshim në mendjen e një ahmediu se mësimi i Molana Modudiut e diskrediton Islamin dhe e bën cak të përqeshjeve. Xhamati Islami jo vetëm që nuk është një shok i Isalmit, por është një formë e komunizmit. Pa vlerat shpirtërore dhe i uritur për pushtet, Xhamati Islami është i frymëzuar nga Moska e jo nga Mekka.

Shkurt, ahmaditë e dënojnë Xhamati Islamin aq ashpër sa Molana e kritikon Lëvizjen Ahmadiane se gjoja është mospërfillëse dhe sharëse. Shumëzoni këto dy pikëpamje të kundërta në mesin e sekteve e të grupeve të ummetit dhe ju do të shihni secilin prej tyre duke e çarë pohimin e njëri-tjetrës, gjoja për të qenë të drejtë. Kush, pra, duhet të ngritet për t'i reformuar njerëzit dhe t'i rrëmbejë fuqitë legjislative dhe ekzekutive nga duart e tyre që nuk i frikësohen Zotit?

Obsesioni i pushtetit është pikëpërqendrimi dhe koncepti i reformës së Molana Modudiut. Ai jetën e Profetit të Islamit *s.a.v.s.* e sheh në pasqyrën e termave politike, dhe adhurimin islamik e shpjegon në zhargonin militarist dhe Kuranin e interpreton si fuqi të vërtetë politike. Molana e di se ai është i paaftë të bëjë reformë me bindje, me durim dhe me modesti, andaj e vë përpara një politikë të dhunës dhe të çrregullimit. Interpretimi më bujar i qëllimeve të tij është se nijeti (qëllimi) i tij është i mirë. Mirëpo, rruga për në xhehenem është e shtruar me nijetet e mira. Vendimi i Kuranit, megjithëse, është eksplicit:

*Dhe kur u thuhet atyre: Mos krijoni çrregullim nëpër tokë! Ata thonë, ne jemi vetëm paqedashës dhe përrnirësues. Dëgjoni! Ata, me të vërtetë, janë çrregullues, por nuk e kuptojnë. (2:12-13)*

## KAPITULLI V

### LIGJI MODUDIAN I APOSTACISË

*Vërtet, ky (Kuran) është një këshillë. Pra, kush dëshiron, le ta marrë për vete atë rrugë që e shpie atë te Zoti i tij.*  
(Kuran, 76:30)

*Nën sundimin tonë, ne nuk do të lejojmë që një mysliman të ndërrojë fenë e tij e as nuk do të lejojmë që ndonjë reliqjion tjetër të propagandojë besimin e tij.*  
(Molana Modudiu)

Dëshira e Molana Modudiu për fuqinë politike nuk njihet kufi. Ligji i apostacisë, të cilin ai e zhvillon, është shtrirje e diktaturës dhe e personalitetit të tij jotolerant – dhe kjo s'ka asgjë të bëjë me Islamin. Dr. Israr Ahmadi, i cili punoi bashkë me Modudiu, thotë se Modudiu principet e lëvizjes së tij i huazoi nga Molana Abul Kalam Azadi dhe nga vëllezërit Khair, kurse stilin e prezantimit të tij e mori nga Nijaz Fatehpuri. Mirëpo, ai ishte aq egocentrik sa që kurrë nuk e pranoi se idetë e tij buronin prej ndonjë dijetari, por nga ai vetë.

Gjithashtu idetë e Molanës mbi apostacinë, ndonëse rrjedhin nga interpretimi i gabuar i jurisprudencës islamike të hershme (Fikha), janë, me të vërtetë, të bazuara në Krishterizmin mesjetar. Shkolla Deobandiane

në një anë bashkëpunonte me një organizatë predominuese politike hinduse, Kongresi Nacional Indian, ndërsa në anën tjetër luftonte me një aksion praparojeje kundër fushatës së Shudit, duke u dhënë shkëlqim mendimeve të Modudiut rreth kësaj teme. Influenca e shkrimeve të Marksit, të cilat me sa duket Molana i pat lexuar kur ishte redaktor i ri dhe impresiv, shihet qartë në mendimin e tij. Tehrik-i-xhamat islami është përzirje e çuditshme e praktikave të krishterizmit mesjetar, të intolerancës deobandiano-vahabiste dhe të nxitjes së marksizmit për përçarje.

Siç e pamë në kapitullin e parë të këtij libri, koncepti i lirisë religjioze nuk është evolucionuar ose lineal (trashëgimtar), por është një fenomen ciklik. Kurdoherë që paraqitet ndonjë profet i Zotit ose ndonjë reformator religjioz, ai kundërshtohet. Ai akuzohet për ndarjen e komunitetit dhe për thyerjen e unitetit tradicional. Ai shpallet si apostat (renegat). Mirëpo, profeti gjithmonë korr sukses në stabilizimin e lirisë fetare, por religjioni i vërtetë, i përhapur në këtë liri religjioze, shndërrohet në dogma të ashpërta që në të vërtetë e fshin të drejtën e mospajtimeve dhe të deferencave.

Gjatë vizitës së tij të fundit që ai i bëri Tempullit, Krishti pat thënë: *Kthejani Cezarit gjërat që i takojnë Cezarit, dhe Zotit ato që i takojnë Zotit.*

(Marku, 12:17)

Kjo deklaratë shumë e qartë e ndan besimin religjioz nga autoriteti politik. Megjithëse, brenda një viti nga marrja e autoritetit politik (v.312), Kisha katolike u gris nga

përçarja. Për më shumë se 3 shekuj me radhë të krishterët u persekutuan dhe u shkatërruan ekonomikisht, dhe prapë, fill pas konvercionit të Konstantinit në Krishterizëm, Kisha u konfrontua me përçarje monastike, me ndarjen Donatiste dhe me herezinë Ariane. Gjatë tërë historisë së Kishës krishtere, herezia ose devijimi nga ortodoksia ka qenë një çështje me rëndësi të madhe. Kjo është e përzier në mënyrë të përhershme në konceptin e të qenët Zot e të hyjnisë së Krishtit.

Nëse Krishti ishte i shenjtë në një kuptim absolut, megjithëse i veçuar nga Zoti, do të ishin dy zota dhe krishterizmi do të kishte një formë të dualizmit e jo të moneteizmit. Në anën tjetër, nëse marrëdhëniet birërisë interpretohen letrarisht, atëherë Zoti At do të ishte pasardhës i Zotit bir. Mirëpo, logjika e kësaj marrëdhënije do të thotë se Krishti nuk është Zot i plotë, derisa aty ka qenë koha kur ai nuk ishte dhe aty ekzistonte vetëm Zoti At.

Të Krishterët ortodoksë e konsideronin Krishtin identik me të qenurit Zot At (homousinous), kurse Ariusi (256-336) e konsideronte vetëm të përgjashëm në të qenurit të Tij (homoiousios). Mandej, mbetet fjala rreth nënës së tij. Nesroriusi (vdiq më 451) deklaroi se Isai a.s. (Krishti) ishte në dy persona të veçuar, njeri ishte qenie njerëzore, tjetri qenie hyjnore; kurse Mejreme ishte vetëm nëna e qenies njerëzore e jo e Krishtit hyjnor. Andaj, është më mirë që ta quajmë nënë të Krishtit a.s. Doktrina ortodokse thotë se Merjemja është nëna e vërtetë, jo Perëndia në vete, por ai, për shkak të mishërimit të legosit, ose të

Fjalës së Zotit, mban të dyja natyrat, hyjnore dhe njerëzore të Krishtit.

Këshilli i parë ekumenik i Kishës u tubua në vitin 325, në Bithinian Neka dhe e nxori doktrinën mbi misterin e Trinitetit. Ariusi i papenduar u mallëkuua nga Këshilli, u çkishërua dhe u dëbua nga Perandoria Konstantini. Perandoria gjithashtu urdhëroi që të gjitha librat e Ariusit duhet të digjen dhe mbajtësi i këtyre librave duhet të dënohet me vdekje.

Cikli i lirisë religjioze që filloi me Krishtin nga Nazareti u shndërrua në një rreth të plotë kur Justiniani (483-565) përshkroi dënim me vdekje për apostacinë. Dënimi me vdekje u bë pjesë e kodifikimit të ligjit Romak në vitin 536 të e.s.

Ky është një rrotullim tragjik i fatit që liria e vetëdijes u shua nga të krishterët e hershëm romakë, stërgjyshët e të cilëve, që pak më parë e patën ndërruar fenë e tyre dhe digjeshin për t'i dhënë zjarr e argëtim Romës së Neroit (64 e.s). Derisa të krishterët persekutoheshin nga autoritetet politike jokrishtere, shkrimtarët e krishterë e mbronin lirinë fetare. Por, kur një herë froni perandorak e zgjodhi për vete Krishterizmin, Kisha filloi ta shikonte me të njëtin sy armiqësie individualizmin në besim, siç shikonte shteti ndarjen ose revoltën. Nga mesi i shek.V gjërat që i takonin dhe ende i takojnë Zotit, iu kthyen Cezarit. Autoriteti politik u bë armë kryesore e Kishës. Në rrjedhim të fushatës së tij kundër Donatistëve, Augustini i Shenjtë (354-430) arsyton: *Ekziston një persekutim fisnik që Kisha e Krishtit e zbaton kundër të*

*padrejtëve. Ajo persekuton në shpirtin e dashurisë... që ajo të përmirësohet dhe që të mund të largohet nga gabimi, duke marrë masa për të mirën e tyre, për të siguruar shpëtimin e tyre të amshueshëm.*

Në vitin 385 një peshkop spanjoll, Prisillian, u akuzua për predikim të Manikaizmit dhe të beqarisë universale. Megjithëse e mohoi aktakuzën, ai u gjykua, u dënua dhe u dogj për së gjalli bashkë me disa shokë.

Martin Lutheri (1483-1546), lideri gjerman i Reformës Protestante, pajtohet me paraardhësin e tij të Romës katolike, Augustinin, dhe thotë: *Kleri pat autoritet ndaj vetëdijes, por u ndie e nevojshme se ata duhet të përkrahen nga shteti me dënime absolute të jashtëligjshmërisë, me qëllim që gabimi mund të çrrënjësohet, sadoqë ishte e pamundur që të largohet mëkati.*

Por, ishte teologu francez protestant, Zhon Kalvin (1509-1564), që në realitet e inspiroi Molana Modudiu. Kalvini dëshironte ta zgjeronte religjionin me shpatë dhe përcaktonte dënim me vdekje për apostacinë . . . *katolikët duhet të pësojnë të njejtat dënime siç pësojnë ata që ishin fajtorë për mosbindje, përshkak se madhështia e Zotit duhet patjetër të hakmerret si froni i mbretit.*

Ndërsa inspiracioni erdhi te Molana Modudiu nga Kalvini, racionalizmin ia paraqiti mendimtari anglez, Thomas Hobsi (1588-1679), në librin e tij, *Leviathan*. Meqë fuqia për të shfaqur mrekullitë është një ndër



shenjat e një profeti të vërtetë, dhe, sipas Hobsit, ditët e shfaqjes së mrekullive paskan kaluar, s'ka më mundësi që njeriu të ketë udhëzim nga ndonjë profet ose nëpërmjet inspiracionit hyjnor. Vetëm sovrani kishte autoritet civil ose religjioz. Ai vetëm kishte fuqi të bënte ligj, sepse kush ka fuqi ligjore ndaj çdo shkrimi, për ta bërë atë ligj, ka edhe fuqi ta miratojë ose të mos e miratojë interpretimin e atij ligji.

Herezia, sipas pikëpamjes së Hobsit, ishte gjykim privat dhe aksion i kundërt me besimin e popullarizuar, siç është shtruar nga sovrani:

*Nuk është gabimi thelbësor i gjyimit që herezinë e bën të dënueshme, por rebelizmi privat kundër autoritetit. Për të qenë besnik ndaj urdhërave të vetëdijes duhet që principi sundonjës t'i sanksionojë të gjithë njerëzit privatë që të mos u binden principeve të atyre në mirëmbajtjen e religjionit të tyre të vërtetë apo jo të vërtetë.*

Sipas Hobsit, ky është subversion. Nuk ka apostaci pa herezi dhe nuk ka herezi pa dogma. Dogma Katolike e Romës u shpjegua hollësisht në doktrinën e Athanasianit, i cili thotë: *Ne e adhurojmë një Zot të Trinitetit, dhe Trinitetin si Njësi, duke mos i ngatërruar Personat dhe duke mos e ndarë substancën.*

Në këtë traditë të Krishterizmit mesjetar, e jo të Islamit, Molana Modudiu i zhvilloi idealet origjinale të Molana Abul Kalem Azadit, dhe të vëllezërve Khairi *Hukumat-i-Ilahija* (Mbretëria e Zotit). Augustini i shenjtë, Martin Lutheri, Zhon Kalvini dhe Thomas Hobsi ia ofruan

Modudiut konceptet jo-islamike të ortodoksisë, dogmën dhe herezinë, dhe gjithashtu e furnizuan me retorikën e intolerancës.

Bile, edhe orientalistët që kurrë nuk e kanë humbur ndonjë rast për ta kritikuar Islamin, pajtohen se s'ka asnjë dogmë dhe herezi në Islam. Goldziheri thotë: *Roli i dogmës në Islam nuk mund të krahasohet me atë që luan në jetën religjioze të ndonjë Kishë krishtere. Aty s'ka Këshilla dhe Synoda që, pas polimikës së fortë, shtrajnë formulën që sot e tutje do të konsiderohet se e përfaqson tërë fenë e vërtetë. S'ka asnjë institucion klerik që shërben si masë e ortodoksisë; asnjë interpretim i autorizuar i skriptave të shenjta, mbi të cilin mund të bazohen doktrina dhe interpretimet e Kishës. Konsensusi, autorizim suprem në të gjitha çështjet e praktikës religjioze, vepron në mënyrë elastike, në një kuptim të juridiksionit të përkufizuar, konceptin e të cilit është shpjeguar në mënyra të ndryshme, veçanërisht me unanimitetin që do të ketë efekt si Konsensusi i padiskutuar, por çfarë është e pranueshme si Konsensus nga një grup, mbetet i papranueshme nga grupi tjetër.*

Orientalisti bashkëkohor jehud, Bernard Lewis, i cili kurrë nuk u akuzua se gjoja është promysliman, vështron: *Ç'ishte e rëndësishme në realitet dhe ç'bënë njerëzit ortopraksinë se sa ortodoksinë, dhe myslimanët në tërësi janë të lejuar ta besojnë atë çfarë e zgjedhin për vete, me kusht që të pranojnë minimumin themelor - Zoti është Një dhe Muhammedi është profeti i tij, dhe t'i konfirmojnë normat sociale.*

Islami i vërtetë kishte pushuar së qeni forcë frymëzuese për Molana Modudiun. Pas njoftimit të koncepteve të herezisë e të apostacisë, ai nuk mund të largohet prej logjikës së Kalvinit që e përshkruan *dënim me vdekje për apostacinë*. Mirëpo, Molana, për t'u argumentuar mendimin e vet, kishte guximin fals që e lidhi me Profeti e Shenjtë s.a.v.s. autoritetin për dënim me vdekje. Molana shkroi një pamflet mbi këtë temë ku në mënyrë të sigurtë ai e përmendi aksionin ushtarak të Ebu Bakrit kundër fiseve të rebeluara si argument se ka pasur dënim me vdekje për apostacinë. Para diskutimit të kësaj, njeriu duhet t'i citojë shkrimet e Molanës për të treguar se sa fort u ndikua ai nga modelet krishtere.

Mirëpo, së pari, sipas prijësve krishterë të Evropës mesjetare, heqja dorë nga Krishterizmi dënohej me vdekje dhe definicioni i vetëm i pranueshëm i Krishterizmit ishte i tyre. Po ashtu, heqja dorë nga Islami dënohej me vdekje dhe i vetmi definicion i Islamit ishte ai që e shtron Molana dhe pasardhësit e tij. Është e qartë se nën qeverinë e Modudiut, qeveritari modudian do të gjykojë se kush është mysliman e kush jo. Çfarë gjykimi do të jetë ky? Shkrimet e Molanës janë shumë të qarta.

Sipas Modudiut, ahmeditë janë apostatët (renegatë) dhe një minoritet jo-mysliman. Mirëpo, vetëm ahmaditë s'janë heretikë - Ehle Kuran, ndjekësit e shkollës së mendimit të zotëri Pervezit, janë gjithashtu heretikë. Këta janë kafirë (mosbesimtarë) dhe apostatë. Faktikisht, herezia e tyre është shumë më serioze se sa ajo e ahmadive. Urdhëri i poshtëshënuar i dënimit të caktuar nga Molana Amin Ehsan Ilahi, i cili deri atëherë s'kishte

hequr dorë nga mësimi modudian dhe ende konsiderohej dorë e djathtë e Modudiut, u botua në *Tasnim* organ zyrtar i Xhamat-i-Islamit.

*Disa njerëz këshillojnë se pasi nuk ka mundësi të futet në praktikë Sheriati islamik, qeveria e këtij vendi (Pakistani) duhet të bazohet mbi principet e shtruarra nga Kurani. Nëse, me këtë, këta njerëz kuptojnë se Sheriati kufizohet vetëm deri te Kurani dhe se rregullat e tjera s'janë pjesë e Sheriatit, atëherë kjo është herezi e hapët. Kjo herezi është e ngjajshme me atë të kadianive (ahmadive), bile, me të vërtetë, më serioze se ajo.*

Ky vendim është qartazi kundër ahmadive dhe kundër Ehle-Kuranit. Për të zbuluar se *herezia* dhe si rrjedhim apostacia kufizohet vetëm me këta dy grupe, kërkon një vështrim të shkurtër.

Sipas shkrimeve të Molana Modudiut çdo gjë, pos asaj të Modudiut, është herezi. Mësimet e Modudiut janë si Doktrina e Athanasianit dhe çdo devijim nga ato është kufr (mosbesim). Molana shkruan:

*Nëntëdhjetë e nëntë për qind e popullsisë myslimane s'ka njohuri rreth Islamit e as aftësi të dallojnë të vërtetën nga e pavërteta. Ata nuk i kanë ndërruar vlerat e tyre morale as mendimet e tyre ndaj Islamit. Një mysliman është mysliman vetëm se babai i tij është mysliman dhe feja ka kaluar nga gjenerata në gjeneratë. Këta myslimanë nuk e kanë pranuar të vërtetën sepse e kuptojnë atë të vërtetë e as të pavërtetën nuk e hedhin poshtë sepse e kuptojnë që është e pavërtetë. Nëse çështjet e myslimanëve u dorëzohen këtyre myslimanëve*

*dhe dikush mendon prapë se këto çështje do të shkojnë mbarë, jeton në parajsën e marrëzisë.*

*Ai vazhdon: Procesi i zgjedhjeve demokratike është të tundet qumështi për të fituar gjalpë. Nëse tundet qumështi i helmuar, edhe gjalpi do të jetë e helmuar. Pra, ata që mendojnë se Mbretëria e Zotit (Hukumati Ilahija) do të rezultojë automatikisht kur zonat e banuara me myslimanë do të mbeten të çliruara nga mazhoranca hinduse janë më të vërtetë në një gabim të hapur. Ata do të kenë vetëm qeverinë heretike të myslimanëve (Kafirana hukumat).*

Molana në mënyrë eksplicite shkruan në këta rreshta të poshtëshënuar:

*Populli i quajtur mysliman është i përbërë prej mbeturinave të të gjitha llojeve. Të gjitha tipet e karaktereve që ekzistojnë te mosbesimtarët, gjenden edhe te ky popull. Numri i dëshmitarëve të qënjeshtër që paraqiten në gjyqet, nuk është më i vogël se numri që paraqitet në gjyqet e popujve të tjerë. Ryshveti, vjedhja, kurvëria, gënjeshtria, më shkurt, s'ka asnjë formë të korrupsionit moral ku myslirnanët janë mbrapa, në krahasim të mosbesimtarëve të tjerë.*

Këto dekrete dhe vendime modudiane janë shumë të qarta e të kuptueshme. Megjithëkëtë, disa njerëz akoma mund të kenë dyshim se këto dekrete u referohen 99.9 % të myslimanëve dhe dijetarëve (uluma) dhe intelektualëve myslimanë janë përjashtuar prej këtyre kufizimeve. Sepse Molana ka dhënë një deklaratë tjetër rreth liderëve myslimanë dhe rreth dijetarëve për të sqaruar se çdo mysliman që nuk e pranon doktrinën

modudiane është i humbur nga rruga e drejtë. Molana shkruan: *Liderët politikë të edukuar nga perëndimi, ulumatë dhe dijetarët e jurisprudencës islamike. të gjithë këta janë të humbur për nga idetë dhe për nga politika e tyre. Ata kanë humbur rrugën e vërtetësisë dhe janë duke bredhur verbërisht në errësi. Asnjëri prej tyre nuk ka pikëpamje islamike.*

Pra, sipas Molana Modudiu, as 99,9 % të myslimanëve e as liderët e tyre religjioz ose sekular s'janë në rrugë të drejtë. Ata kanë humbur rrugën; pikëpamja e tyre s'është islamike dhe të gjitha tipet e krimeve që ekzistojnë te kuffarët (mosbesimtarët), gjenden edhe te myslimanët. Nëse dikush ummetin e quan *një tufë apostatësh*, atëherë duke dëgjuar këtë përshkrim, Modudiu do të përgjigjej: Ju thoni e jo unë. Duke iu drejtuar atyre që largohen nga Xhamati Islami, ai thotë: Kjo nuk është ajo rrugë nga e cila mund të tërhiqesh. Tërheqja nga kjo rrugë do të thotë të bëhesh apostat (renegat). Nëse tërheqja nga Xhamati Islami dhe të bashkuarit në një grup tjetër mysliman është apostaci, atëherë ai grup ose organizatë automatikisht është kufr (mosbesimi).

Pra, janë myslimanë ata që falen pranë varreve të njerëzve të shenjtë dhe gjithashtu edhe shitë që tre kalifatët e parë i konsiderojnë uzurpues. Është njohur qartë se sipas Molanës, dhe të gjithë dijetarët Deobandian pajtohen me të, se Xhamati mbizotëronjës, Ehle Sunnet val xhamat, i Indisë dhe i Pakistanit, të njohur si Brelvi, janë kafir (mosbesimtarë).

Tani, pasi Molana në realitet i deklaroi të gjithë jomodudianët si apostatë, ai flet me hollësi rreth çështjes së atyre njerëzve që janë myslimanë përkah lindja. Kjo është një ndër pjesët më të vështira të argumentit të Modudiut. Duke diskutuar Islamin e vet, ai thotë:

Unë kam hedhur poshtë qaforën e Islamit të trashëguar . . . . Unë kam lexuar Kuranin dhe kam studiuar jetën e Muhammedit dhe tani jam bërë një mysliman i ri. Mbi të njëjtën bazë, ai ka sajuar një plan për rikonvercionin e myslimanëve të tjerë. Ai planin e vet e zbulon me këto fjalë:

*Kurdoherë kur dënimi me vdekje u zbatua me forcë në ndonjë shtet të ri islamik, myslimanët mbetën në vathën e Islamit. Por, aty ka një rrezik se një numër i madh hipokritësh do të jetojnë përbri tyre. Ata gjithmonë do të ballafaqohen me rrezikun e tradhtisë. Sipas meje, zgjedhja e këtij problemi qëndron në faktin se kurdoherë që do të bëhet një revolucion islamik, të gjithë myslimanët që nuk e praktikojnë Islamin, duhet që Brenda një viti të deklarojnë se s'janë myslimanë dhe të largohen nga shoqëria myslimane. Pas një viti të gjithë myslimanët e lindur do të konsiderohen myslimanë. Të gjitha ligjet islamike do të zbatohen ndaj tyre. Ata do të detyrohen t'i praktikojnë të gjitha farzet dhe vaxhibet (obligimet) e religjionit të tyre dhe, nëse dikush, pas kësaj, dëshiron ta braktisë Islamin, ai duhet të dënohet me vdekje. Do të bëhet çdo përpjekje për t'i shpëtuar sa më shumë myslirnanë që të mos biejnë në prehrin e kufrit (mosbesimit). Mirëpo, ata që s' do të shpëtojnë, padashje do të ndahen një herë e përgjithmonë nga shoqëria (ekzekutohen). Pas këtij pastrimi shoqëria islamike do të*

*ketë një fillim të freskët me myslimanët që kanë vendosur vullnetarisht të mbeten myslimanë.*

Molana nuk na tregon se në bazë të së cilës rregullsie të ixhtihadit një ligj cakton dënim me vdekje për apostacinë. Në çdo rast ky ligj do të lëshohet vetëm në atë kohë kur një shtet islamik është i stabilizuar - e jo të konsesionit. Pas kësaj periudhe të madhërishe, myslimanët që janë të lindur mosbesimtarë, do të zhduken. Molana shpjegon se përse ai s'ka mundësi të shënojë ndonjë përjashtim për këta fatkëqinj. Ai thotë:

*Ka një pyetje finale rreth dënimit me vdekje që mund ta shqetësojë shumicën prej nesh. Një jomysliman që e përqafoi vullnetarisht Islamin, i kthehet kufrit (mosbesimit), mund të themi se ka bërë një gabim me qëllim. Ai mund të jetë zimmi (jomysliman në një shtet islamik), pra përse hyn në një religjion të përgjegjësive kolektive që s'ka rrugë ikjeje? Mirëpo, si qëndron puna me njeriun që është i lindur nga prindërit mysliman, por që nuk e ka përqaftuar Islamin? Ai është mysliman për nga lindja. Nëse, me të arritur moshën e pjekurisë, ai dëshiron ta refuzojë fenë, jepini kërcënim me vdekje dhe kështu ai do të mbetet mysliman. Kjo është e padrejtë. Dhe një akt i tillë do të krijojë përherë një numër të madh hipokritësh, të lindur në shoqërinë islamike. Ka disa përgjigje të kësaj pyetjeje, njëra ka të bëjë me aspektin praktik, kurse tjetra me principin. Parimisht, s'mund të ketë dallim në mes të ndjekësve të lindur të një religjioni dhe të atyre që e pranojnë një fe (të konventuar). Dhe asnjë religjion nuk ka bërë kurrë një dallim të tillë. Ndjekësit e konventuar dhe ata të lindur që të dy qeverisen nga ligje të njëjta. Praktikisht është e*



*pamundur dhe është një absurditet logjik që me fëmijët e ndjekësve të një religjioni të sillesh dhe t'i konsiderosh si kuffar (mosbesimtarë) ose të huaj, derisa ata s'e arrijnë moshën e pjekurisë, atëherë do t'u jepet rast të zgjedhin ose ta refuzojnë religjionin (ose nënshpëtimin) e kohës së lindjes së tyre. Asnjë shoqëri në botë nuk mund t'i drejtojë çështjet e veta në këtë mënyrë.*

Edhe nëse e pranojmë ligjin modudian se Islami përshkruan dënim me vdekje për apostaci dhe se të gjithë myslimanët, pos atyre të Xhamati islamit, janë kafirë (mosbesimtarë), ne s'mund të sillemi ndaj myslimanëve jomodudian si apostatë - bile edhe vetë sipas logjikës së Modudiut. Ata janë *kafirë për nga lindja*. Molana dëshiron të ketë dardhën e vet dhe ta hajë vetë! Myslimanët që nuk pajtohen me konceptin modudian rreth Islamit, së pari janë të përshkruar si *myslimanët për kah lindja* dhe kafirë, sepse ata u rriten dhe u edukuan nga prindërit e tyre në një mjedis mosbesimi. Mandej ata u quajtën apostatë, sepse me të arritur moshën e pjekurisë ata nuk e mohuan Islamin e prindërve të tyre në preferencë të Islamit modudian. Një njeri jomysliman që e përqafton Islamin dhe më vonë heq dorë, duhet të dënohet me vdekje përshkak se ai u bë mysliman, duke ditur mirë faktin se nuk ka ikje nga ky religjion. Po ashtu, një mysliman i lindur jomodudian duhet të sillet si apostat, sepse me të arritur moshën e pjekurisë ai nuk e ka pranuar versionin e Islamit të Molana Modudiut. Ky është ai argument që tregon qartë personalitetin diktatorial, manipulues dhe intolerant të Modudiut. Asnjë mysliman, i konventuar ose i lindur,

nuk është larg shtrirjes së tij. Dekreti i Kuranit se *S'ka dhunë në çështjet e fesë* është shpjeguar me këto fjalë: *Kjo do të thotë se nuk e detyrojmë dikë të përqafojë religjionin tonë. Kjo është e vërtetë. Por, ne pa tjetër duhet t'i tërheqim vërejtje atij që dëshiron të largohet nga ky religjion, se kjo derë është e pakalueshme për trafik. Nëse dëshiron ti të hysh në këtë derë, atëherë eja me vendim të prerë, sepse s'ka rrugë kthimi.*

Një dijetar eminent i Ehli Kuranit, Ghulam Ahmad Parvezi, duke ju referuar këtë koment të Modudiut, rreth këtij ajeti të Kuranit, thotë: *Islami i Modudiut është një kurth minjsh; miu nund të hyjë brenda kurthit, por s'mund të dalë jashtë.*

Pika qendrore e argumentit të Molanës është se çdo religjion i konsideron pasardhësit e vet si ithtarët e vet. Prandaj, pasardhësit e prindërve myslimanë - bile edhe aty ku prindërit janë posaçërisht kafirë - do të jenë pronë e Islamit. Nëse ndaj këtyre fëmijëve stabilizohet e drejta e pronësisë, si mund të jenë të lirë të zgjedhin ndonjë religjion tjetër me të arritur moshën e pjekurisë? Në shpjegimin e kësaj pike, siç duket, Molanës nuk i kanë rënë ndërmend të thënat e Profetit të Shenjtë s.a.v.s.:

*Çdo foshnjë lind me prirje për Islamin, por prindërit e tij e bëjnë jehud ose të krishter ose zoratust.*

Nëse pika qendrore e argumentit të Molanës është korrekte, atëherë përse e kufizon vetëm me pasardhësit e myslimanëve? Përse nuk e aplikon edhe për fëmijët jomyslimanë, me që, sipas këtij hadithi, ata janë të lindur me predispozicion për të qenë mysliman? Kjo do t'i jepte kontroll të plotë qeverisë së Modudiut ndaj çdo fëmije.

Kjo nuk bën asnjë dallim, qoftë një fëmijë është në mbretërinë modudiane ose jo. Meqë Molana Modudiu nuk i ra ndërmend ky hadith i lartëpërmendur, forca e logjikës së tij e çoi atë deri te ky absurditet.

Molana Modudiu, më të vërtetë, e riprodhoi Krishterizmin mesjetar gati fjalë për fjalë në formë të lëvizjes së Xhamati Islamit. Duke komentuar politikën e tij të intolerancës, Elizabeth Labrouse, një historiane e Krishterizmit mesjetar, observon: *Në nivelin individual, kjo krijon vetëm martirë ose hipokritë.*

Tani krahasoeni observimin e Labrouses me rreshtat e poshtëshënuar nga libri i Molana Modudiu *The Punishment of Apostacy in Islam* (Dënimi i Apostacisë në Islam): *Nëse ai (renegati) është aq i ndershërë sa që nuk dëshiron të jetojë si një hipokrit dhe me të vërtetë dëshiron të mbetet i qëndrueshëm në fenë e vet, përse ai nuk e paraqet veten për vdekje?*

Prejse koncepti modudian i religjionit është e vetmja rrugë e shpëtimit, Molana nuk do t'u lejonte të drejtat e njëjta dhe privilegjet ithtarëve të asnjë religjioni tjetër. Veprimtaria misiorare e religjioneve të tjera do të jetë e ndaluar në një shtet modudian. Molana Modudiu thotë: *Dënimi me vdekje për apostacinë është çështja e vendosur. Mbasi ne nuk e lejojmë asnjë mysliman të përqafojë ndonjë religjion tjetër, çështja e lejimit të religjioneve të tjera, që t'i stabilizojnë misionet e tyre dhe të bëjnë propaqandë për religjionet e tyre brenda kufive tanë nuk vjen në konsideratë. Ne s'mund ta tolerojmë atë.*

Mirëpo, një kafir a mund të bëjë propagandë për religjionin e vet në mesin e kafirëve të tjerë? P.sh. një i krishter a mund t'i stabilizojë misionet për të punuar në mesin e jehudëve ose të hindusëve? A Arja Samaxhitë, të cilët nuk e besojnë adhurimin e idhujve dhe besojnë në një Zot, mund t'i predikojnë ithtarët e Sanatan Dharmas panteiste? Molana Modudiu thotë:

*Islami s'mund të tolerojë që religjionet false të përhapen në botë. Si mund t'u jepet leja misionarëve të religjioneve false që të shpërndajnë gënjeshtra dhe t'i tërheqin të tjerët në drejtim të atij zjarri ku marshojnë ata vetë?*

Molana Modudiu pranon vetë se jehuditë dhe të krishterët janë *Ehli Kitab* (Populli i Librit), por, nëse ata dëshirojnë t'i kthejnë (konvertojnë) idhujtarët, adhuruesit e zjarrit ose politeistët që të adhurojnë Zotin Një - Zotin e Musait dhe të Isait - kështu t'i sjellin ata afër Islamit, këta do të ndalohen.

Me një fjalë. Molana pranon vetëm se një kafir i lindur s'mund të vritet, nëse ai nuk e pranon Islamin. Por, nëse është ashtu, atëherë përse të vritet një kafir i ri, i cili heq dorë nga besimi? Nëse një kafir i ri duhet të dënohet në çdo rast, atëherë përse të dënohet me vdekje? Përse të mos dëbohet apo të dënohet me burgim të përjetshëm, që shoqëria myslimane të mos priset? Këtu Molana Modudiu, i dalë besnik logjikës së Augustinit të Shenjtë, shpjegon se apostati duhet ekzekutuar në interesat e veta. Ai thotë:

*Ekzistojnë vetëm dy metoda që kanë të bëjnë me apostatët. Ose të arratisen, duke u mohuar të drejtën për nënshtetësi të tyre dhe duke u dhënë leje vetëm të jetojnë,*

*ose t'u japim fund jetës së tyre. Metoda e parë definitivisht është më e ashpër se ajo e dyta, sepse ai jeton në një shtet ku ai as jeton e as vdes. Vrasja e tij është e preferueshme. Në këtë mënyrë të dyja-agonia e tij dhe agonja e shoqërisë njëkohësisht do të marrin fund.*

Mirëpo, dënimi që Molana u cakton apostatëve, nuk është me të vërtetë persekutimi i *shpirtit të dashurisë* i Augustinit të Shenjtë. Ekziston një jetë pas vdekjes dhe duke e vrarë një apostat, Molana drejtpërsëdrejti ia dorëzon zjarrit të xhehenemit. Duke e larguar një apostat nga agonitë e përkohshme të një jete të dëbuar, Molana e dërgon atë në agoni shumë më të mëdha të xhehenemit. Mbi të gjitha, Molana ia mohon të drejtën apostatit fatkeq për t'i dhënë rast të pendohet dhe të shpëtohet. Meqë një kafir ka rast të pendohet në çdo moment të jetës së tij, apostati s'mund të kthehet në Islam dhe të ketë pjesë nga mëshira e Zotit Mëkatfalës (Al-Ghaffar) dhe Tobepranues (At-Tavvab).

Duke e kufizuar liogjikën e Molana Modudiut në konkluzionin e tij absurd, dikush mund të pyesë: Prejse dënim me vdekje do të thotë t'i dekurajosh njerëzit, të cilët ndërrimin e fesë e marrin lehtë, duke hyrë në shoqërinë tonë, si propozoni ju për t'i ndaluar njerëzit e tillë të pavendosur sepse kanë lindur në shtëpitë myslimane?

Kjo politikë Drakoniane e forcës dhe e intolerancës brutale nuk kufizohet vetëm me shtetin Modudian. Jo vetëm kaq, por edhe politika e tij e jashtme është bazuar mbi forcën dhe mbi intolerancën. Molana thotë:

*Islami nuk dëshiron që një revolucion i tillë të bëhet në një shtet e në disa shtete. Por, ai dëshiron që ky revolution të përhapet në tërë botën. Ndonëse kjo është detyra e Partisë myslimane që së pari të sjellë këtë revolution në kombin e vet, qëllimi i tij i mëtejshëm është revolucionin botëror.*

Natyrisht, qëllimi final i Islamit është të bëjë një revolucion botëror. Mirëpo, Islami dëshiron revolucionin shpirtëror e jo revolucionin komunist, të cilin Molana e ka huazuar nga ideologjia komuniste. Kjo nuk është fatkeqësi që polemika modudiane përcjell së afërmi argumentin komunist. Zëvendësojini fjalët *Partia komuniste*, ju do të gjeni jehonën e Marksit dhe të Leninit në shkrimet e Molana Modudiu. Revolucionin modudian nuk është i bazuar në *Adl* (drejtësi), por në materializëm dhe përfundimisht në diktaturën personale. Politika modudiane ndaj shteteve fqinje dhe politika e jashtme komuniste nuk dallohen shumë. Molana shkruan:

*Marrëdhëniet njerëzore janë aq të integruara sa që asnjë shtet në bazë të principeve të veta s'mund të ketë liri të plotë të aksionit, përderisa principet e njëjta të mos jenë në fuqi në një shtet fqinj. Prandaj, një Parti myslimane nuk do të jetë e kënaqur me stabilizimin e Islamit vetëm në një rajon - për të dy (për sigurimin e tij dhe për reformën e përgjithshme. Ajo duhet të bëjë përpjekje për të përhapur në të gjitha drejtimet. Në një anë ajo do të përhapë ideologjinë e saj, kurse në anën tjetër ajo do t'i ftojë njerëzit e të gjitha kombeve ta pranojnë doktrinën e saj - se aty ekziston shpëtimi. Nëse ky shtet islamik do të ketë fuqi dhe mjete, do të luftojë kundër qeverisë*

*joislamike dhe do të shkatërrojë atë dhe në vend të saj do të stabilizojë shtetin islamik.*

Paragrafi i lartëpërmendur në realitet është një kopje mutatis mutandise (me pak ndryshime) e Manifestit komunist.

Molana nuk ngurron, duke ia ngarkuar Profetit të Shenjtë s.a.v.s. politikën e tij agresive. Ai thotë:

*Kjo ishte ajo politikë që e pat adoptuar Profeti i Shenjtë dhe kalifat e tij të përudhur mirë. Arabia, ku për herë të parë u formua Partia Myslirname, ishte vendi i parë që u pushtua. Pas kësaj, Profeti s.a.v.s. u dërgoi thirrje të gjitha shteteve fqinje, por nuk priti se a u pranuan ose jo, menjëherë sa arriti fuqinë, filloi konfliktin me Perandorinë Romake. Pas Profetit, Ebu Bakri u bë lider i Partisë dhe sulmoi Perandorinë Romake dhe Persiane, ndërsa Omeri përfundimisht fitoi betejën.*

Kjo është një deklaratë e përgjithshme e luftës kundër të gjitha shteteve fqinje jomyslimane - ato janë të sigurt vetëm derisa shteti modudian është i pafuqishëm. Porsa shteti modudian u ka dhënë një afat njëvjeçar myslimanëve të lindur të pranojnë Islamin modudian ose të largohen dhe të mbytin opozicionin e brendshëm, ai do të angazhohet në luftë pushtimi kundër fqinjeve të vet. Modudiu nuk pajtohet me pikëpamjen e përgjithshme të myslimanëve se Profeti s.a.v.s., Ebu Bakri dhe Omeri, me të vërtetë, u detyruan për luftë nga Perandoritë Krishtere dhe Zeratushte, që dëshironin të shaktërronin Islamin, dhe se myslimanët, përkundër mungesës së mjeteve luftarake, u detyruan të luftojnë për vetëmbrojtje.

## KAPITULLI VI

### TË HEQURIT DORË (KANTACIONI) NË ISLAM

*Shkruajeni për mua emrin e çdokujt që veten e quan mysliman.*

(Muhammadi s.a.v.s.)

Koncepti i apostacisë, siç ka ekzistuar në Krishterizmin mesjetar dhe siç është parashtruar nga Molana Modudiu, është i huaj në Islam. Për këtë bile nuk ekziston asnjë fjalë në gjuhën arabe. S'ka dyshim se disa dijetarë të hershëm myslimanë të jurisprudencës (Fikha) konsideronin se të hequrit dorë nga Islami është një cenim i madh, por në anën tjetër definicioni i tyre, i një myslimani, ishte aq i gjerë dhe i hapët sa që askush që e quante veten mysliman, nuk mund të quhej rikanter (njeri që heq dorë nga Islami). Profeti i Islamit s.a.v.s. na dha dy definicione të një myslimani. Me rastin e regjistrimit të parë të popullsisë së Medinës, Profeti s.a.v.s. tha: Shkruajeni për mua emrin e çdokujt që veten e quan mysliman. Kurse me një rast tjetër ai tha: Kushdo që falet siç falemi ne dhe i drejtohet Kiblës sonë dhe han atë që prehet ritualisht, është mysliman; ai është dhimatullah e dhimatur resul (në përgjegjësinë e Allahut e të



Profetit). Pra, mos e nxisni Allahun në kundërshtim të dhimatit (përgjegjësisë) të Tij.

Mirëpo, Molana Modudiu dhe ulematë (dijetarët) duke e përkrahur diktaturën dhe autokracinë në shtetet islamike ia shtuan cilësitë e ndryshme definicionit të thjeshtë të dhënë nga Profeti i Islamit s.a.v.s. Sipas fjalëve të Imam al-Ghazaliut (450-505 pas Hixhrës/1058-1113), ata e përkufizuan kështu: Mëshira e pakufishme e Zotit është të rezervojë parajsën për një klikë të vogël të teologëve. Rezultati i përpjekjeve të tyre është përmbledhur shkurtimisht nga ish-gjykatësi kryesor i Pakistanit, Muhammad Muniri, i cili kryesoi Gjykatësin hetues për trazirat e vitit 1953 në Penxhab (Pakistan). Ai shkruan:

*Duke pasur parasysh definicione të ndryshme të dhëna nga ulematë, a kemi nevojë të bëjmë ndonjë koment pos kësaj se as dy dijetarë shumë të admirueshëm nuk pajtohen për këtë çështje fundamentale (se kush është mysliman e kush jo)! Nëse ne zbatojmë definicionin tonë, siç e mban çdo dijetar i shkolluar, dhe ai definicion ndryshon nga të gjitha definicionet e të tjerëve, ne të gjithë do të përjashtohemi nga rrethi i Islamit. Nëse ne e adoptojmë definicionin e dhënë nga njeri prej ulemave, ne do të mbetemi myslimanë, sipas pikëpamjes së atij alemi (dijetari), por kafirë, sipas definicionit të çdokujt tjetër.*

Observimi i Gjykatësit Munir duhet të lexohet bashkë me referimin e qortimit të Profetit të shejntë s.a.v.s. që i bëri Usamës b. Zejdit. Në sulmin e Ghalib b. Abdullah al-Kalbit, sipas Ibn Is-hakut, u vra një njeri nga Usama

b. Zejdit dhe një tjetër. Duke shpjeguar këtë incident, Usama thotë:

*Kur unë dhe një njeri prej Ansarëve e zëmë atë dhe e sulmuam me armë tona, ai e shqiptoi Shahadah (Zoti është Një dhe Muhammedi është Profeti i tij), por ne nuk i frenuam duart tona dhe e vramë atë. Kur erdhëm te Profeti s.a.v.s. dhe i treguam çfarë kishte ngjarë, ai tha: Kush do të të falë ty, o Usama, për të mos marrë në konsideratë proklamatin e tij për fe? - unë i thashë se ai e shqiptoi Shahadetin vetëm për t'i shpëtuar vdekjes, mirëpo ai e përsëriti pyetjen dhe vazhdimisht e përsëriti atë sa që i thashë vetes që sikur të mos kisha pranuar Islamit para kësaj dite dhe sikur të mos kisha vrrarë atë njeri. Unë iu luta atij të më falë dhe i premtova se unë nuk do të vrasë kurrë ndonjë njeri që veten e deklaroi mysliman. Profeti s.a.v.s. tha: Këtë a do të thuash, o Usama, edhe pas vdekjes sime? - dhe unë i thashë po - do ta them.*

Profeti s.a.v.s. e dinte mirë se përkundër shqetësimit të tij ndaj jetës së myslimanëve që e recitojnë Shahadetin, ata do të vriten në emër të Islamit nga njerëzit e udhëhequr keq. Sipas raportit të Mesned Imam Ahmad Hanblit, Profeti s.a.v.s. gjithashtu e pyeti Usamën: A e pate hapur zemrën e viktimës sate për të provuar autenticitetin e besimit të tij? Dhe megjithëkëtë ulematë e uritur për pushtet dhe të orientuar politikisht vazhdimisht i nxisin myslimanët injorantë t'i vrasin vëllezërit e tyre myslimanë - ata myslimanë pikëpamja e të cilëve pak a shumë ndryshon nga pikëpamjet e tyre - sikur me hapjen e zemrave të tyre ata e zbuluan se besimi i tyre është besimi fals.

Për sa i përket rikantacionit, Kurani e përdor fjalën *irtadda* që do të thotë se askush s'ka të drejtë që ndonjë mysliman tjetër ta deklarojë *murtadd* (që heq dorë nga Islami). Siç Imam Ragib Isfahani shpjegon se fjala *irtidad* do të thotë t'i vërë njeriu hapat e tij prapë tamam në atë vend prej ku erdhi ai. Kjo fjalë është shoqëruar në mënyrë të veçantë me rikantacion (kthimi në drejtim të kufrit (mosbesimi) nga Islami: Ata që kthehen prapa (nga besimi në mosbesim) pasi u është sqaruar rruga e drejtë, djalli ua hijeshoi veprat e tyre të këqija dhe u dha shpresa të kota (Kurani 47:26) dhe kush prej jush largohet nga feja e vet (Kurani5:55).

*Ridda* është një fjalë intransitive dhe rrënja e saj *rdd* s'ka formë tranzitive; një njeri mund të heqë dorë, por dikush tjetër s'mund ta bëjë rikantor. Ky është një akt vullnetar dhe aty asnjë agjenci e jashtme nuk mund të luajë ndonjë rol. Ky është ai aspekt i dëshirës së lirë që e dallon *irtidadin* nga koncepti i apostacisë së Krishterizmit e të Modudiut, të cilin ne e diskutuam në kapitullin e kaluar. Apostacia dhe dënimi i saj kërkojnë një autoritet të jashtëm - Kishën ose shtetin. Kjo është si ekzekutimi ose më mirë të themi vrasja. Kurse irtidadi është si vetëvrasja. Njeriu mund të ekzekutojë dikë e të vrasë dikë, por s'mund t'i bëjë atij *vetëvrasje*.

Sureja Al-Kaferun, e zbritur në periudhën e hershme të ministrisë së Profetit të Shenjtë s.a.v.s., është një deklaratë e drejtpërdrejtë e vijës rreth temës së lirisë së vetëdijes. Profeti u urdhërua që t'u tregojë mosbesimtarëve se aty nuk ka absolutisht pikëtakimi në mes të mënyrës së jetës

së tij dhe të jetës së tyre. Meqë ata ishin në një mospajtim të plotë, jo vetëm nga pikëpamja themelore e koncepteve të religjionit, por ashtu edhe nga pikëpamja e hollësive të tij dhe e aspekteve të tjera, nuk ishte e mundur që të arrihej një kompromis midis tyre. Andaj, për ju është religjioni juaj e për mua religjioni im (Kurani 109:6).

Po ashtu Profetit s.a.v.s. i është thënë në mënyrë të pandërprerë që të mos shqetësohej nëse mosbesimtarët s'janë të gatshëm ta pranojnë mesazhin e Tij. Ai nuk ishte vakil (mbikëqyrës) i tyre. Zoti thotë:  
Dhe populli yt e ka përgënjeshtuar këtë (mesazhin e Profetit të shenjtë s.a.v.s., kurse ai është i vërtetë. Thuaj: Unë nuk jam mbikëqyrës ndaj jush (Kurani 6:67).

Kjo deklaratë është bërë në periudhën e Mekkes, kur Profeti s.a.v.s. dhe ithtarët e tij persekutoheshin. Prapë me ardhjen e tij në Medinë, deklarata e tij ishte pikërisht e njëjtë, sado që ai tani kishte fuqi. Kjo me të vërtetë është bërë edhe më eksplicite.

Sureja e parë (zbritur në Medinë) ku u diskutua tema e lirisë së vetëdijes, ishte Al-Bakara. Ajeti 257 i Surejes deklaron të qartë mbi këtë temë:

*Nuk ka dhunë në çështjen e fesë, sepse e vërteta është dalluar nga e pavërteta. Kush i mohon djajt (që e pengojnë nga rruga e drejtë) dhe e beson Allahun, ai e kap fuqimisht lidhjen e fortë që s'këputet kurrë. Dhe Allahu është i Gjithëdëgjueshëm dhe i Gjithëdijshëm. (2:257)*

Kjo është deklarata e sigurtë e një Profeti që organizoi një ummet në një qytet ku fuqia e tij ishte supreme. Të mos keqkuptohet tema e xihadit, myslimanëve u është treguar se virtyti i vërtetë qëndron në veprat e mira dhe në besimin e mirë dhe Madhështia e Zotit përkujtohet në ajetin e Fronit (2:255). Urdhëri *s'ka dhunë në religjion* vjen menjëherë pas ajetit të Fronit. Lexuesit e Kuranit mund të kenë menduar se Zoti kërkon prej myslimanëve që të përhapin Islamin me forcë, sepse ai thërret për të luftuar kundër armiqve të umetit dhe për t'ia ofruar Allahut sakrificat e veçanta. Pra, ajeti u tregon myslimanëve që në rrethana të pasigurta të mos drejtohen nga dhuna në emër të konvercionit. Rëndësia e këtij ajeti mund të matet me anë të një hadithi të përmendur në Xhame të Tirmidhiut (Përmbledhje e hadithëve). Ai thotë se kulminacioni i Kuranit është Al-Bakara, dhe se shejtani s'do të hyjë në shtëpinë e atij që reciton dhjetë ajete të kësaj Surejeje (4 ajetet e para, ajeti i Fronit, dy ajetet që vijnë pas tij -256-257- dhe tri ajetet e fundit).

Ky princip i mospërdorimit të dhunës ishte përsëritur edhe pas fitores së Badrit (3:21) dhe prapë në Sure Al-Maida që është sureja e fundit e diktuar. Tani, kur autoriteti i Muhammedit s.a.v.s. ishte i stabilizuar plotësisht, jo vetëm në Medinë por edhe në Mekke, dhe është vitale të theksohet se roli i Profetit s.a.v.s. ishte vetëm të përcjellë fjalën e Allahut. Dhe binduni para Allahut dhe para Profetit, dhe të keni kujdes. Por, nëse do të ktheheni mbrapa, atëherë ta dini se obligimi i Profetit Tonë është vetëm të përcjellë qartazi mesazhin (5:93). Dhe përfundimisht Profeti ka për detyrë vetëm të

përcjellë Mesazhin. Dhe Allahu e di çka zbuloni ju dhe çka fshihni ju. (5:100)

Besimi religjioz është një çështje personale e njeriut. Është vetëm Zoti - jo shteti ose autoritetet religjioz - që di çka njeriu ja zbulon Zotit ose çka i fsheh Atij.

Ky ajet na udhëheq drejt temës së munafikëve (hipokritëve). Termi *munafekun* i përshkruan ata banorë të Medinës, që në dukje e patën pranuar Islamin, por besimi i të cilëve dyshohej në bazë të arsyeve të ndryshme. Lidhur me këtë temë ka shumë referenca në Kuran, por në katër vende ata (hipokritë) janë cilësuar si murtad (rikanterë). Për herë të parë ata përmenden në surenë *Muhamed*. Kjo është një sure medenie (zbritur në Medinë) që shkurtimisht përshkruan qëllimet e luftës sipas Islamit. Kjo thotë se gjersa besimtarët e prisnin ngrohtësisht një diktim që i thërriste ata të luftojnë për hir të Allahut, hipokritët ndiheshin se gjoja janë duke u udhëhequr drejt therrjes së tyre. Në këtë mënyrë besimtarët e vërtetë janë të veçuar nga ata që mbajnë besim të përciptë ose fals. Sureja vazhdon të thotë: Vërtet, ata që kthehen prapa (nga besimi në mosbesim) pasi u është sqaruar rruga e drejtë, djalli ja hijeshoi veprat e tyre të këqija dhe u dha shpresa të kota. Kështu ngjau për shkak se atyre që e urrejnë mësimin e zbritur prej Allahut, u është thënë: Ne do t'ju bindemi në disa çështje! Dhe Allahu i di mirë fshehtësitë e tyre (47:26-27).

Ajetet e lartëpërmendura nuk përmenden asnjë dënim për këta njerëz.

Referanca e dytë lidhur me hipokritët është në surenë Al-Munafekun, që u diktua në fund të vitit 6 pas Hixhrës/628 e.s. Sureja ekspozon pabesnikërinë dhe pandersshmërinë e hipokritëve dhe hedh poshtë profesionin e tyre të hapët të besimit si fals e tradhtar. Ky është një qortim e vërejtje publike. Allahu dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë. Ata besimet e veta i kanë bërë mburojë (për t'u shpëtuar prej teje), dhe pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut. Vërtet, keq është që ata bëjnë. Kështu veprojnë sepse një herë e pranuan besimin e mandej e refuzuan. Prandaj, u është vënë vulë zemrave të tyre dhe ata s'kuptojnë.... Ata janë armiqtë e vërtetë, prandaj ruaju prej tyre ... është njësojë për ta qoftë të kërkosh falje për ta ose të mos kërkosh, Allahu nuk do t'i falë kurrë. Vërtet, Allahu nuk u tregon rrugë të drejtë njerëzve rebelë (63:2-7).

Dy referencat e fundit lidhur me hipokritët janë në njerën ndër suretë e fundit në zbritje - At-Tobe: Tani, pra, mos arsyetoni. Ju e keni pranuar mosbesimin pasi një herë e kishit pranuar besimin, andaj shijojeni dënimin! Dhe Ne do të falim një parti prej jush, kurse tjetrën do ta ndëshkojmë, sepse ishin fajtorë (kjo është puna Jonë 9:66). Ata që u falën, siç duket, ishin hipokritë që u penduan dhe u bënë mylیمانë të singertë. Për sa u përket atyre që e merituan dënimin, ajeti vijues thotë: Allahu u ka premtuar hipokritëve dhe hipokriteve dhe mosbesimtarëve zjarrin e xhehenemit ku do të jetojnë ata. Ai (xhehenemi) u mjafton atyre. Dhe pos kësaj, Allahu i ka mallkuar ata. Dhe ata do të kenë një ndëshkim të qëndrueshëm (9:68). Dhe përfundimisht: Ata (hipokritë) përbetohen në emër të Allahut se s'kanë

folur asgjë, kurse në realitet ata kanë folur fjalë mosbesimi dhe e pranuan mosbesimin pasi një herë e kishin përqaftuar Islamin.... Pra, nëse pendohen ata, do të jetë më mirë për ta, por nëse e kthejnë shpinën, Allahu do t'i dënojë me një ndëshkim të dhembshëm në këtë botë dhe në botën tjetër. Dhe ata nuk do të kenë as shok e as ndihmtar në tokë (9:74).

Profeti s.a.v.s. e dinte mirë se Abdullah b. Ubai b. Salulit është lider i hipokritëve, por megjithkëtë ai nuk mori asnjë aksion kundër tij. Përkundrazi, Profeti s.a.v.s. u lut për të, kur vdiq ai. Omer b. al-Khatabi thotë: Kur Profeti s.a.v.s. shkoi dhe qëndroi pranë kufomës së Abdullah b. Ubaiut dhe ishte gati të falte xhenazen, unë e pyeta: O Profet, a je duke falur xhenazen e armikut të Zotit? Profeti s.a.v.s. buzëqeshi dhe tha: Eja pas meje, o Omer. Mua më është dhënë një zgjedhje dhe unë e zgjodha këtë. Mua më është thënë: Nëse do të kërkosh shtatëdhjetë herë falje për ta, Allahu nuk do t'i falë ata. Po ta dija se me kërkimin e faljes më shumë se 70 herë ai do të falej unë do të bëja këtë. Mandej, ai e fali xhenazen e tij dhe shkoi bashkë me xhenazen deri në varrezë dhe qëndroi pranë varrit të tij derisa u varros.

Liria e konvercionit është provim i thartë i mësimit kuranik *S'ka dhunë në religjion*. Kjo s'mund të jetë liri e njëanëshme - liri për të hyrë në Islam, por jo për të dalë jashtë nga ai. Në Kuran ka dhjetë referenca të drejtëpërdrejta lidhur me rikantacionin: njera në sure Al-Nahl (zbritur në Mekke) dhe nëntë të tjera në sure të ndryshme të zbritura në Medinë. Në asnjërën prej tyre



nuk përmendet aspak dënim me vdekje për ata që heqin dorë nga Islami (rikantorë).

Njëra ndër deklaratat më ekspliciste lidhur me rikantacionin është ajeti 143 i Sures Al-Bakara. Kibla u ndërrua nga Jerusalemi në Mekke në vitin 2 të Hixhrës. Ibn Is-haku raporton: Dhe kur Kibla u ndërrua nga Siria në Kaba, Rifa b. Kejsi, Kardam b.Atnri, Kab b. al-Ashrafi, Rafib Abu Raji, al-Haxhaxh. Amri dhe një shok i Kabit, al-Rabi b. al-Rabi b. Abul Hukejk dhe Kinana b. al-Rabi b. Abul Hukejk erdhën te Profeti s.a.v.s. dhe e pyetën: Përse ia kthyet shpinën Kibles, së cilës i drejtoheshit me fytyrë kurse ju pohoni se po e ndiqni religjionin e Ibrahimit? Nëse do t'i ktheheni Kibles së Jerusalemit, ne do të të ndjekim ty dhe do të të deklarojmë ty të vërtetë. I vetmi qëllim i tyre ishte të mashtrojnë atë lidhur me religjionin e tij. Andej, Zoti tha: Dhe këtë Kible, të cilën e ndiqje ti, Ne e caktuam që të dallojmë atë, i cili e dëgjon Profetin, nga ai që s'dëgjon. Dhe kjo është shumë e rëndë për njerëzit - përveç atyre që i përudhi Allahu.

Kurani nuk përshkruan asnjë dënim për këta rikantorë (që heqin dorë nga parimet e Islamit). Edhe historia nuk mban ndonjë shënim të dënimit ndaj atij që hoqi dorë pas ndërrimit të Kibles.

Sureja Al-Imran që u diktua pas fitores së Badrit, në vitin 2 pas Hixhrës, përmban dy ajetet e poshtëshënuara ku përmendet rikantacioni i disa jehudëve të Medinës: O populli i Librit, përse duke ditur e përziени të vërtetën me të gënjeshtren dhe e fshihni të vërtetën? Dhe një grup prej popullit të Librit thotë: Çka është zbritur mbi

besimtarët, besojeni atë në pjesën e parë të ditës dhe e mohoni në pjesën e fundit të ditës, ndoshta (me këtë trik) ata (besimtarë) do të kthehen nga besimi i tyre (3:72-73).

Ibn Is-haku ka shënuar emrat e atyre që e patën përgatitur këtë komplot: Abdullah b. Sejf, Adi b. Zejd dhe Al-Harith b. Ofi u pajtuan që të pretendojnë se besojnë në mesazhin e Muhammedit s.a.v.s. dhe es-habët e tij në një kohë, kurse në një kohë tjetër e mohonin atë për t'i ngatërruar ata. Qëllimi i tyre ishte që besimtarët të ndjekin shembullin e tyre dhe të largohen nga religjioni i tyre. Asnjë prej këtyre tre jehudëve nuk u dënua.

Një referencë tjetër është në Sure An-Nisa ku thuhet: Ata që e pranojnë besimin dhe mandej bëhen mosbesimtarë dhe prapë bëhen besimtarë e pastaj prapë bëhen mosbesimtarë dhe mandej rriten e përforcohen në mosbesimin e tyre, Allahu kurrë nuk do t'i falë ata e as nuk do t'i udhëheqë nga rruga e drejtë (4:138).

Një rikantor (murtad) nuk mund të shijojë kënaqësinë luksoze të besimit e të mosbesimit, nëse dënimi për rikantantacion do të jetë vrasja. Njeriu i vdekur s'ka rast të besojë e të mohojë në mënyrë përsëritëse.

Syneti, sjellja e frymëzuar në mënyrë hyjnore e Profetit të Shenjtë s.a.v.s., është burimi i dytë i Sheriatit. Dhe edhe syneti tregon qartë se në Islam nuk ka dënim për konvercion. Emrat e atyre personave që u ekzekutuan nga Profeti i Shenjtë s.a.v.s., janë të ruajtur në Sira (Libra rreth biografisë së Profetit s.a.v.s.) dhe në hadith, dhe po ashtu ruhen edhe emrat e atyre që hoqën dorë nga Islami

në jetën e tij. Një bediun arab e kishte pranuar Islamin nga Profeti i Shenjtë s.a.v.s., mirëpo fill pas pranimi të Islamit ai u sëmurë nga ethet, kur ishte në Medinë, e luti Profetin ta lirojë nga betimi i tij. Ai tri herë bëri këtë lutje dhe çdoherë iu refuzua. Ai u largua, i patrazuar nga Medina. Profeti s.a.v.s. duke dëgjuar lajmin rreth largimit të tij, tha: Medina është si një furrë që e veçon mbeturinën nga ajo që është e pastër.

Ibn Is-haku raporton se Profeti s.a.v.s. u dha udhëzime komandantëve të tij që kur të hyjnë në Mekkë ata duhet të luftojnë vetëm kundër atyre që i kundërshtojnë. Ka pasur vetëm një përjashtim lidhur me këta kriminelët e poshtëshënuar që duhet patjetër të vriten, sadoqë gjenden të mbështjellë në perdet e Kabës.

1. Abdullah b. Sad b. Abi Sarah

2,3,4. Abdullah b. Khatal i Benu Tejmit b. Galib dhe dy valltaret e tij, të cilat këndonin këngë satirike rreth Islamit. Njëra pre tyre ishte Fartana, kurse emrin e vajzës së dytë nuk e përmendi Ibn Is-haku.

S. Al-Huvajrith b. Nukejdh b. Vabb b. Add b. Kusija.

6. Mikjas b. Subabah.

7. Sarah, skllave e liruar e Benu Abdul Mutalibit. 8. Ikrama b. Ebu Xhali.

Abdullah b. Sadi ishte njëri ndër shkruarit e Profetit s.a.v.s. në Medinë. Ai hoqi dorë nga besimi dhe filloi të flasë keq kundër Islamit. Ai shkruante diktimet e Muhammedit, andaj largimi i tij krijoi hutim në mes të Kurejshve të Mekkës. Pas stabilizimit të paqes në Mekkë, vëllai i tij në shpirt, Uthama b. Affani, bëri një ndërmjetësim te Profeti në emër të tij dhe ai u fal. Po të

ishte caktuar ndonjë dënim në Kuran për rikantacion, Profeti s.a.v.s. kurrsesi nuk do të mund të vepronte në këtë mënyrë. Qëndrimi i Profetit s.a.v.s. ndaj ndërmjetësisë lidhur me Haddin (dënim i caktuar nga Kurani) më mirë është ilustruar në incidentin e gruas së Makhzumit, e cila ishte fajtores për vjedhje. Kur Uthama b. Zejdi tentoi ta mbrojë atë. Profeti e qortoi dhe i tha: A ndërmjetëson ti lidhur me një dënim të caktuar nga Allahu? Ji dëshmitar: se nëse Fatima, bija e Muhammedit, do të ishte fajtores për vjedhje, unë me siguri do t'i prisja dorën.

Abdullah b. Khatal u dërgua nga Profeti s.a.v.s. për të tubuar zakat, i shoqëruar nga një Ansar, i cili e shërbente. Kur ata u ndalën, ai i urdhëroi kolegut që të therë një dhi për të e të përgatisë pak ushqim para se të flente. Mirëpo, kur u zgjua, pa se asgjë nuk është përgatitur, ai e vrau nga hidhërimi dhe mandej hoqi dorë nga Islami. Ai për shkak të kësaj vrasjeje u ekzekutua nga Sejd b. Hurejth al- Makhzomit dhe Abu Barzh al-Aslami.

Al-Huverith b. Nukejdhi ishte në partinë e Habbar b. al-Asvad b. al-Muttalib b. Asadit, i cili e zuri bijen e Profetit s.a.v.s., Zejnebën, kur ajo ishte duke udhëtuar nga Mekka në Medinë. Al-Huverthi e nxiti deven e Zejnebës me hosten. Zejneba ishte shtatëzëne dhe dështoi për shkak të sulmit dhe ajo u kthye në Mekkë. Profeti dërgoi disa njerëz me urdhër që nëse e gjejnë Habbar b. al-Asvadin ose Al- Huverthiu, duhet të vriten, por Al-Hurejthi iku. Në një raport tjetër, Hishami thotë se Al-Abbas b. Aud al-Muttalibi hypi Fatimën dhe Zejnebën, bijat e Muhammedit, mbi një deve që t'i sjellë nga

Mekka në Medinë. Al-Huvejrithi e nxiti deven dhe ato të dy gratë u rrëzuan. Më në fund Aliu e vrau në Mekke.

Makis b. Subaba erdhi në Medinë nga Mekka dhe tha: Unë erdha te ju si mysliman që të kërkoj kompensimin e vëllait tim, i cili u vra gabimisht. Profeti s.a.v.s. urdhëroi që t'i pagohet kompensim për vëllain e tij, Hishamin. Duke marrë kompensimin, Makisi u ndal te Profeti për një kohë. Por, sa gjeti një rast, e shfrytëzoi dhe e vrau vrasësin e vëllait të vet dhe hoqi dorë nga Islami. Makisi u ekzekutua nga Numejlah b. Abdullahut për shkak se vrau një Ansar, në emër të të cilit i kishin paguar kompensim për vrasjen e vëllait të tij.

Sarah, e cila ishte akuzuar për krijimin e çrregullimeve, nuk u vra gjatë jetës së Profetit të shenjtë s.a.v.s.

Ikrama b. Abu Xhahli iku në Jemen. Gruaja e tij Umm Hakim, e pranoi Islamin dhe kërkoi imunitet për të shoqin dhe Profeti s.a.v.s. ia fali.

Të gjitha këto ilustrime tregojnë qartë se nuk ka ndonjë evidencë që dëshmon se Profeti s.a.v.s. ka dënuar dikë për rikantacion (për largimin nga Islami).

Pas vdekjes së Profetit s.a.v.s. në vitin 11 pas Hixhrës/632 e.s. administrata e re myslimane u ballafaqua me një krizë të madhe. Shpërthyen çrregullime në disa pjesë të gadishullit dhe shumë fise u shkëputën nga Medina, duke refuzuar të paguajnë zakatin. Kjo lëvizje njihet me emrin *Ar-Riddah*. Detyra kryesore e pasardhësit të Profetit s.a.v.s., Ebu Bakrit, ishte që ta kontrollonte këtë çrregullim. Megjithëse, detyra e tij e parë ishte që të përcillte ekspeditën për përcjelljen e së cilës Profeti s.a.v.s.

pat urdhëruar para vdekjes së vet. Pra, pas dy ditëve të shpalljes së kilafetit të vet, Ebu Bakri dërgoi në kufirin e Sirisë një armatë nën komandën e Uthama b. Zejd b. Harithit.

Pasi u largua Uthama dhe ushtria e tij, shumë fise u larguan nga Medina. Vetëm Mekka dhe Medina dhe rrethinat e tyre i mbetën besnik administratës qendrore. Agjentët myslimanë, të caktuar nga vetë Profeti s.a.v.s. pak para vdekjes së tij në fiset rebele, u detyruan t'i braktisin pozitrat e tyre e të kthehen në Medinë. Kjo ishte një revoltë e plotë.

Duke vendosur të luftohet kundër rebelëve, Ebu Bakri dërgoi delegatët te disa fise besnike që të vijnë e të dalin në ndihmë të tij. Gjersa Ebu Bakri ishte duke pritur përforcimin, Kharxhah b. Hism, i udhëhequr nga Unejnah b. Hism b. al-Fazari dhe AI-Akra b. Habis al-Tamimi, organizoi një sulm të befasishëm kundër myslimanëve. Myslimanët u ngatërruan, por shpejt u ritubuan dhe bënë një kundërsulm ndaj njerëzve të Kharxhës, të cilët u mposhtën.

Para përleshjes në Dhul al-Kassa, një delegacion i fiseve arabe shkoi në Medinë që të bëjë negociacion me Ebu Bakrin, lidhur me çështjen e zakatit, mirëpo Ebu Bakri e refuzoi kërkesën e tyre. Disa muhaxhirë (emigrantë) të parë e të famshëm nuk u pajtuan me vendimin e Ebu Bakrit, që të luftohet kundër atyre që nuk japin zakat. Fakti se këto fise ishin kurreshtarë për negociacion tregon qartë se ata nuk kishin hequr dorë nga Islami dhe nuk dëshironin që të ashpërsohen marrëdhëniet e tyre me

Medinën, por prapë nuk ishin të gatshëm të pranonin kontrollin e Medinës ndaj vetes. Nuk ishte çështja e besimit në Allah dhe në Profetin e Tij, por ishte e zakatit (taksës). Një grup i shokëve të njohur i udhëhequr mirë nga Omeri kundërshtoi vendimin e Ebu Bakrit që të luftohet kundër rebelëve. Shkruhet se Omeri i tha Ebu Bakrit: Çfarë të drejte ke ti të luftosh kundër këtyre njerëzve? A nuk e di ti se çka pat thënë Profeti s.a.v.s.: Unë jam urdhëruar të luftojë kundër njerëzve derisa ata thonë se s'ka Zot tjetër përveç Allahut. Po nëse ata thonë kështu, ata janë të sigurtë dhe do të jenë të sigurta edhe pronësitë e tyre prej meje.

Pas largimit të delegacionit nga Medina, Ebu Bakri i tuboi myslimanët dhe u tha: Delegacioni ka observuar se sa pak jeni ju në Medinë. Ju nuk e dini se a do t'ju sulmojnë ata ditën ose natën. Pararoja e tyre është aq afër Medinës sa gjuhet guri. Ata dëshironin që ne t'i pranojmë propozimet e tyre dhe bëjmë një marrëveshje me ta, por ne e hodhëm poshtë kërkesën e tyre. Prandaj, bëhuni gati kundër sulmit të tyre. Brenda tri ditëve ata e sulmuan Medinën.

Lufta e Riddahut shkaktoi gjakderdhje të madhe. Ishte e pashpjegueshme për historianët e mëvonshëm të Arabisë se pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s. shumë luftëra u bënë të domosdoshme në tokën e Arabisë; ata konsiderojnë se janë bërë vetëm për shkak të Riddahut - një lëvizje religjioze kundër Islamit. Juristët, të cilët dështuan të gjejnë autoritetin kuranik apo të synetit lidhur me ekzekutimin e myslimanëve të akuzuar për kufër (mosbesim), ose lidhur me luftën kundër fuqive

politike të myslimanëve, e kanë pranuar këtë mendim pa e bërë më të gjatë.

Duke diskutuar legalitetin e luftës së Ebu Bakrit kundër rebelëve myslimanë, Imam al-shaft thotë: *Riddah* mbështetet mbi një religjion të mëparshëm, të adoptuar në mosbesim dhe në refuzimin e plotësisht të përgjegjësisë së pranuar më parë. Rikantacioni nuk mjafton, por ky patjetër duhet të jetë i ashpërsuar nga justifikimet e thyrjes së një marrëveshjeje. Ibn Abi al-Hadid, dijetar i një shkolle tërësisht ndryshe, në komentin e tij Naxh al-Balagah, e sqaroi çështjen kur shkroi: Fiset që refuzuan të paguajnë zakatin, nuk ishin rikantet. Ata ashtu u quajtën metaforikisht nga es-habët e Profetit s.a.v.s..

Sipas Velhausenit, *Riddah* ishte një shkëputje nga udhëheqja e Medinës e jo nga Islami. Shumica prej fiseve dëshironin ta adhuronin Allahun, por pa paguar zakatin. Kaetani pajtohet me Velhasenin dhe thotë se *Riddah* nuk ishte ndonjë lëvizje e rikantacionit dhe se këto luftëra kanë pasur karakter politik. Beckeri duke e ndjekur Velhausenin dhe Kaetenin, nxjerr këtë konkludim:

Vdekja e papritur e Muhammedit u dha përkrahje të reja tendencave centrifugale. Karakteri i tërë lëvizjes, siç është shënuar me forcë nga historianët, ishte, me të vërtetë, e fshehur nga bashkëkohësit. Arabia do të fundosej në partikularizëm nëse nevoja e shkaktuar nga shkëputja e AI-Riddahut nuk do të ishte zhvilluar në shtetin e Medinës si një energji që shkon mbarë. Lufta kundër Riddahut nuk ishte kundër apostatëve dhe nuk



ishte çështje e besimit ose e mosbesimit, por e haraçit që duhej t'i paguhej Medinës; lufta u zhvillua për supermaci politike ndaj Arabisë.

Bernard Levisi e bën shumë të qartë se Riddah reprezenton një shtrembërim të rëndësisë reale të ngjarjeve teologjiksht të ngjyrosura nga historianët e mëvonshëm. Ai vazhdon të thotë:

*Refuzimi i fiseve për të pranuar kilafetin e Ebu Bakrit nuk ishte në realitet ndonjë kthim nga ana e myslimanëve të konventuar kah paganizmi i tyre i mëparshëm, por mbarim i thjeshtë dhe automatik i një kontrakti politik nga vdekja e njerës ndër partitë. Fiset që banonin afër Medinës, faktikisht u konvertuan dhe interesat e tyre u ngjanin atë shumë interesave të ummtetit sa që nuk është shënuar veçmas historia e tyre. Nga ana tjetër edhe vdekja e Muhammedit automatikisht u shërbeu marrëdhënieve të tyre me Medinën dhe partitë vazhduan lirinë e tyre të aksionit. Ata nuk u ndienë të kufizuar në asnjë mënyrë nga zgjedhja e Ebu Bakrit në të cilën ata nuk morën pjesë, dhe menjëherë pezulluan të dy haraçin dhe marrëdhëniet e kontratës. Me qëllim që të ristabilizohet hegjemonia e Medinës, Ebu Bakri u detyrua të bëjë kontrata të reja.*

Aliu u vra në vitin 661. Me vdekjen e tij mbaroi edhe koncepti i një sunduesi mysliman, i cili i kombinoi funksionet e kryetarit të shtetit dhe të religjionit. Mbretëria dinastike e Ummejdve (661-750) - sundues politikë të Islamit, filloi me Muaviaun. Ata s'kishin kurrfarë afërie me kalifatët e devotshëm dhe u konsideruan pak a shumë si mbretër sekularë. Ulematë, si rojtarë

të Sheriatit, filluan të okuponin një pozitë të ngjashme në shumë vija me atë të klerit pas konvercionit të Konstantinës. Si kleri në Evropën mesjetare, ata u nderuan për shkak të dijës dhe të dëlirësisë dhe përkrahja e tyre ishte kërkuar për të legalizuar fuqinë politike të një sundimtari tiran ose jopopullor. Ata gjithashtu vepruan si liderë të opozitës dhe u përpoqën të ushtrojnë fuqinë politike se sa të pranojnë për vete.

Revolta politike dhe sociale tani justifikoheshin në terma religjioze dhe përpjekja dinastike ndaj fuqisë politike së shpejti u përforcuan në përçarje të thella në doktrinën religjioze. Kharxhizëm dhe Shitizëm, dy lëvizje kryesore që u ndanë nga trupi kryesor pas vrasjes së kalifit të tretë, Osmanit (644), burojnë gjatë një përpjekjeje për pasardhësin. Kharxhitët ishin myslimanë të parë, të cilët sugjeruan se një mëkatar i madh nuk ka të drejtë të jetë mysliman. Ata gjithashtu ishin të parë, të cilët proklamuan *xihadin* kundër atyre myslimanëve, të cilët, sipas tyre, nuk janë besimtarë të vërtetë, dhe origjinalisht i takonin partisë së Aliut; ata e lanë atë, megjithëse, lidhur me mospajtimin rreth arbitrimin në mes tij e Muaviaut, vendosën të zgjedhin diferencat e tyre të ngritura lidhur me vrasjen e Osmanit. Ata thanë: Gjykimi i takon vetëm Allahut dhe jo trupave gjykuese. Kharxhitë ishin figurë kryesore në zhvillimin e dogmatizmit. Ata ishin të veçantë rreth kualifikimeve të një myslimani dhe rreth sjelljeve të tij ndaj qenies tjetër njerëzore - myslimane ose jomyslimane. Ky është i pari grup, i cili krijoi sektizëm në Islam, dhe gjithashtu i pari në refuzimin e principeve të justifikimit nga feja. Ata ishin të mendimit se një mëkatar i madh s'mbetet

musliman as s'mund të rikthehet në Islam, përkundrazi ai duhet të vritet bashkë me familjen e tij. Ata jokharxhitë i kosiderojnë kriminelë dhe jomuslimanë. Siç pamë më herët, Profeti s.a.v.s. i njihte mirë hipokritët e Medinës dhe liderin e tyre, Abdullah b. Ubei, dhe prapë ai nuk ndërmori ndonjë aksion kundër tij. Ai nuk gjykonte cilësinë e besimit të një muslimani.

Kharxhitë drejtpërdrejtë ranë në konflikt me mësimet e Kuranit e të synetit të Profetit s.a.v.s. Deklarata e tyre se *Gjykimi i takon vetëm Allahut* ishte tërësisht në kontradiktë me synetin. Profeti s.a.v.s. e ernërtoi Sad b. Muadhin si hakam (gjykatës) që të vendosë fatin e fisit jehud B. Kurejzaut dhe ku u zbatua vendimi i tij.

Duke komentuar mbi raportin e Sahih Muslimit (përmbledhja e të thënave të Profetit) rreth gjykimit të Sadit, AI-Navavi (676 pas Hixhrës) tha: Myslimanët në grindjet e tyre janë të lejuar ta ndjekin *tahkimin*. Faktikisht, nëse dy grupe të muslimanëve luftojnë a grinden mes veti, është detyra e muslimanëve të tjerë të krijojnë paqe në mes të tyre. Kurani thotë: Vërtet, të gjithë besimtarët janë vëllezër. Pra, krijoni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj, dhe frikësohuni nga Allahu që të mëshiroheni ju (49:11).

T'i deklarosh muslimanët *jomuslimanë* dhe mandej t'i dënosh vetëm se standardet e tyre janë të ndryshme nga ato të një autoriteti të veçantë religjioz - *takfir* - është i huaj në Islam. Profeti s.a.v.s. vetë e bëri definicionin e një muslimani. Sipas këtij definicioni ai që deklaronte se beson në Allah dhe në Profetin Muhammed, është

musliman. Ky është i vetmi definicion në bazë të të cilit mund të gjykohet një musliman. Duke diskutuar temën e *takfir* Bernard Levisi thotë:

Bile edhe rebelimi i hapët nuk e shkakton automatikisht *takfirin*. Në vitin 1923 prijësi Kadi ibn Buhali refuzoi t'i padisë rebelët Garmathian si mosbesimtarë meqë ata filluan të shkruanin letra lutjeje në emër të Allahut dhe të Profetit s.a.v.s., prandaj në bazë të kësaj ata mbetën muslimanë. Ligji i Shafive insiston

se sektarizmi, edhe në revoltë, cilësohen që të sillen si një musliman; kjo do të thotë se familja dhe pasuria e tij janë të respektuara, dhe se ai s'mund të vritet ose të shitet në robëri edhe kur burgoset një herë.

*Takfiri*, megjithatë, ishte themeluar nga juristët. Siç e pamë edhe më herët, ai ishte justifikimi i Kharxhitëve për ta denoncuar Aliun. Por, duke adoptuar këtë inovacion të Kharxhitëve, juristët nuk mundën të pajtoheshin me definicionin e një muslimani.

Shfletimi i historisë islamike i 1300 viteve për të gjetur numrin e muslimanëve të ekzekutuar për shkak të konvercionit të tyre nga Islami do të jetë i padobishëm. Ka tentativa të pasukseshme për ekzekutimin e Maimonidesve në Kairo, për Maronite Amir Junusin në Liban, dhe për ekzekutimin e Rashid-ud-Dinit në Tebriz, por shembuj të tillë janë të rrallë. Në Indinë mongoliane është shënuar vetëm një rast. Një Frat portugez e pranoi Islamit e më vonë u kthye në fenë e tij të mëparshme. Ai u ekzekutua në Aurangabad. Shkaqet e ekzekutimit të tij

ishin politike e jo religjioze. Frati ishte i dyshuar se, nën mbulesën e Islamit, bënte spiunazhe për Portugalinë.

Xhad b. Dirharni u dënua me vdekje me urdhërin e Hisham b. Abdul Malikut në Kufa ose në Vasit në vitin 124 ose 125 pas Hixhrës. Ai ishte akuzuar për përparimin e doktrinave të Muttazilit rreth Kuranit të krijuar ose të vullnetit të lirë. Në vitin 167 ose 168 pas Hixhrës poeti irakian Bashir b. Burda u akuzua për zandakah, u rrah dhe u hodh në një moçal në Batiha. AI-Husen b. Mansur al-Hallaxhi u ekzekutua në vitin 309 pas Hixhrës për blasfemi, sepse ai pat deklaruar se ka lidhje substancionale me Zotin (hulul). Shihab ud-Din Jahjah al-Suhravardi u dënua me vdekje me urdhërin e AI-Malik al-Zahirit (578 p.h.). Krimi i tij ishte se ai i konsideronte të vërteta të gjitha gjallesat dhe krijesat dhe se ai gjithashtu argumentin e vet rreth Zotit e bazonte mbi simbolin e dritës.

Martiri i Shek.XVII ishte Muhammed Said Sarmadi. I lindur nga prindërit jehud në Kashan, Sarmadi ishte rabin (prift izraelit) para se të përfaqonte Islamin. Një poet i madh persian, i cili ishte një monist dhe e mohonte ekzistencën e materies, u ekzekutua në mbretërinë e Orengezebit (1658-1707). Varrri i tij që gjendet përballë xhamisë kryesore të Nju Dehilit. Ky varr tërheq çdo ditë qindra myslimanë, të cilët hedhin lule mbi varrin e tij dhe recitojnë AI-Fatiha.

Në Afganistan, dy Ahmadi u ekzekutuan për shkak se e pranuan pohimin e Mirza Ghulam Ahmadit të Kadjanit se është Masihu i Premtuar, Sahibzadah Abdul Latifi që

e pat kryer ceremoninë e kurorëzimit të Amir Habibullah Khanit (mbret i Afganistanit të asaj kohe), u gurëzua me vdekje në vitin 1903 dhe Molvi Nimatullah në 1924. Të dyve u dha rasti që të mohojnë pohimin e Mirza Ghulam Ahmadit, por ata e refuzuan kërkesën e tyre.

Muhammed Mahmud Taha u ekzekutua në Sudan në vitin 1985. Ai besonte se ligjet e Kuranit të zbritura në Medinë nuk janë më të përdorueshme.

Është me rëndësi të përmendet se sulltani Otoman, megjithëse ishte kryetar i perandorisë religjioze dhe ishte kalif i të gjithë myslimanëve, nuk dha urdhër që Baha Ullahu të dënohet me vdekje për krimin e irtidadit. Baha Ullahu e deklaroi veten se është ai i Premtuar - për ardhjen e të cilit paralajmëroi Babi, dhe e themeloi Bahaizmin si një fe. Bahaizmi tërësisht është i ndarë nga Islami. Ai pohon se me ardhjen e Baha Ullahut anulohet Kurani dhe mësimet e Muhammedit. Baha Ullahu u arrestua në Akka afër Hejfës, atëherë në Palestinë, tani në Israel. Por kur Sabbati Zevi (1627-76), një mistik jehud, e deklaroi veten Masih në vitin 1648, atëherë shejkhul-Islami i Perandorisë Otomane urdhëroi ekzekutimin e tij. Ai u arrestua, hoqi dorë nga deklarata e tij vetëm për t'i ikur vdekjes, dhe e përqafoi Islamin. Baha Ullah pat deklaruar se është manifestim i ri i Zotit dhe hoqi dorë nga Islami, por me gjithë apostacinë e tij nuk u ekzekutua për shkak se ai nuk ishte rrezik për rendin publik në Perandorinë Otomane.

Siç e pamë më parë, koncepti i apostacisë është i huaj në Islam dhe se sipas Islamit nuk ka dënim në këtë botë për rikantacion. Mirëpo, ulematë (dijetarë), të cilët e

paraqitën para Gjykatës Hetuese - të përbërë nën Aktin II të Penxhabit në vitin 1954, për të hetuar shkaqet e trazirave të vitit 1953, vërtetuan se apostacia në një shtet islamik dënohet me vdekje. Ata ishin:

Molana Abul Hasanat Sajed Muhammed Ahmed Kadri, kryetar i xhamiatul Ulamave të Pakistanit, në Panxhab; Molana Ahmed Ali, kyetar i xhamiatul Ulamave të Islamit, i Pakistanit Perëndimor; Molana Abul Ala Modudiu, themeluesi dhe ish Amir (kryetar) i xhamat-e-Islamit, Pakistan; Mufti Muhamed Idris, Xhamia Ashrafia Lahor, dhe anëtarë të Xhamiatul Ulamave të Pakistanit; Molana Daud Ghaznavi, kryetar i xhamatit të Ehle Hadithit; Molana Abdul Halim Kasmi, Xhamiatul Ulamave të Islamit, Penxhab; dhe zotëri Ibrahim Ali Çishti.

Duke komentuar këtë pohim, Gjykata Hetuese observoi: Sipas kësaj doktrine, Çohdri Zafrullah Khani duhet të ekzekutohet, nëse ai nuk i ka trashëguar besimet e religjionit tij të tanishëm, por e zgjodhi me dëshirën e vet dhe i pëlqeu të jetë Ahmadi, anëtar i xhentatit Ahmadia. Dhe të njëjtën fat duhet të kenë edhe deobanditë dhe vahabitë bashkë me Molana Muhammed Shafi Deobandi, anëtar i Këshillit të Talimat-i-Islami (mësimet islamike) të lidhur me Asamblen e Kushtetuese të Pakistanit, dhe Molana Daud Ghaznavi), nëse njeri prej këtyre Ulamave (të paraqitur si të ulur mbi çdo gjethë të një lisi të bukur të fetvës (Ex.D.E.14)) do të ishte kryetar i një shteti të tillë islamik. Dhe nëse Molana Shafi Deobandi do të ishte kryetar i shtetit, ai do t'i ekzekutonte ata, të cilët patën deklaruar se deobanditët

s'janë myslimanë por janë kafirë. Ai mandej do t'i ekzekutonte, në qoftë se ata vinin nën definicionin e murtaddit d.m.th. ata i kanë ndërruar pikëpamjet e tyre religjioze e jo që i kanë trashëguar.

Realiteti i fetvës (Ex.D.E.I3) nga deobanditë që thotë se ithnaashri shitë janë kafirë dhe murtadë, u muar në pyetje në rrjedhim të hetimit tonë. Por, Molana Muhammed Shafi e shpjegoi këtë çështje nga ana e deobandëve dhe e mori nga Arkivi i Institucionit një kopje të fetvës të nënshkruar nga të gjithë mësuesit e Darul Ulumit, bashkë me Molana Muhammed Shafin. Shënimet thonë se ata, që nuk besojnë se Ebu Bakri ishte sahabi dhe që janë kazif (shpifës) të Hazretit Ajesha Sidika dhe janë fajtorë për *tehrif* (ndërrimit) të Kuranit, janë kafirë. Edhe zotëri Ibrahim Ali Çishti, i cili e di mirë dhe e ka studiuar këtë çështje, i bashkohet këtij mendimi. Ai mendon se shitë janë kafirë sepse ata besojnë se Hazrat Ali ka pjesë në Profetiztrtin e Profetit tonë të Shenjtë s.a.v.s. Ai refuzoi të japë përgjigje lidhur me pyetjen se një Sunni që i ka ndërruar pikëpamjet e veta dhe pajtohet me sektin e shitëve, a është fajtor për irtidad, dhe a meriton dënim me vdekje? Sipas shitëve, të gjithë Sunnitë janë kafirë dhe Ehle Kuranitë, të cilët konsiderojnë se të thënat e Profetit s.a.v.s. janë të pabesueshme dhe andnj nuk zbatohen - janë gjithashtu kafirë. Pra, të gjithë mendimtarët e pavarur janë të tillë. Si rezultat i kësaj del qartë se as shitë e as sunnitë, as deobanditë e as Ehle Hadithët e as brelvitë nuk janë myslirnanë. Dhe nëse qeverinë e shtetit e udhëheq një parti, e cila partinë tjetër e konsideron kafire, atëhere çdo



ndërrim nga njëra pikëpamje në tjetrën rezulton dënim me vdekje.

Njeriut nuk i nevojitet të imagjinojë shumë për të gjykuar konsekuencat e kësaj doktrine kur është përmendur se as dy ulema (dijetarë) nuk u pajtuan kurrë para nesh mbi definicionin korrekt të një myslimani. Pa dyshim, nëse të gjitha definicionet e tyre merren në tërësi, bazat mbi të cilat dikush mund të akuzohet për apostaci do të dalin aq shumë saqë, bile, as nuk do të mund të numërohen.

## KAPITULLI VII

### DËNIM PËR APOSTACINË

Në kapitullin e mëparshëm ne kemi parashtruar të dhëna të shumta nga Kurani i Shenjtë dhe nga historia e Islamit për të paraqitur mendimin e gabuar se gjoja Islami përshkruan ndonjë dënim fizik e trupor për ata që e mohojnë Islamin si fe të tyre. Ne kemi shqyrtuar gjerësisht argumente më të përgjithshme të paraqitura nga avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë d.m.th. raportin e Ikramës dhe incidentin e zakatit në kohën e Ebu Bakrit. Disa argumente të tjera do të shqyrtohen në këtë kapitull.

Është vështirë të vlerësohet se koncepti i shtrëngimit në Islam ka lindur në tokën islamike ose është pjellë e imagjinatës së orientalistëve dhe më vonë u transferua në prehërin e Islamit. Duke shqyrtuar këtë nën dritën e historisë islamike, unë sinqerisht besoj se kjo ide së pari u rrënjos vetë në botën islamike dhe është gabimi ynë që të akuzojmë orientalistët, se gjoja janë ata që kanë filluar përdorimin e saj. Ata e morën prej vetë myslimanëve para se të lindnin bile orientalistët. Ideja, siç duket, ka qenë e pranishme në mendimin islamik mesjetar. Kjo buron nga dinastia e fundit e Umejdve. Gjatë tërë periudhës së Abasidëve, kjo ide vazhdimisht u lulëzua dhe u fuqizua më shumë, sepse sovranët Abasidë dëshironin të përdornin forcën jo vetëm kundër armiqve të Islamit, por gjithashtu edhe kundër popullit të vet.

Liçencë për këtë nuk ishte kërkuar rrallë nga dijetarët myslimanë që ishin nën ndikimin e tyre. Prandaj, ky koncept u ngrit nga sjellja dhe nga planet e qeverisë myslimane në nivel të kilafetit Rashida të Bagdadit.

Duke shikuar nga jashtë, dijetarët e Perëndimit besuan se ky është një mësim islamik, por e vërteta qëndron në faktin se ky nuk është ndonjë mësim islamik. Ky ishte vetëm parim i sjelljeve të disa qeverive myslimane. Ne duhet të sjellim ndërmend se kjo ide lindi në atë kohë kur në tërë botën përdorimi i forcës për të përhapur influencën dhe ideologjinë ishte një veçori e përgjithme dhe s'ka pasur ndonjë përjashtim.

Është e qartë se pohimi se Islami e përkrah përdorimin e forcës për të përhapur ideologjinë e vet, nuk buron nga studimi i burimeve të mësimave të Islamit por nga studimi i sjelljeve të disa shteteve myslimane. Tani, kur një epokë e re ka gdhirë, ku për ne gjenden të gjitha literaturat islamike dhe traditat dhe është përkthyer Kurani i Shenjtë në shumë gjuhë - kur dijetarët e Perëndimit kanë hyrje drejtëpërsëdrejti në burimet e mësimave të Islamit - këmbëngulja e tyre rreth kësaj deklarate është e pajustificuar. Ata duhet të thellohen në burimet dhe të studiojnë mësimet e Kuranit të Shenjtë, të thënat dhe sjelljet e Profetit të Islamit, Muhammedit s.a.v.s.

Ky punim është një përpjekje për të shqyrtuar tërë çështjen, jo në dritën se si myslimanët e një epoke të veçantë sillleshin, por në dritën e mësimave fundamentale të Kuranit të Shenjtë dhe të ekspozitës së këtyre

mësimeve nga fjalët e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. e nga sjelljet e tij.

Prirja për të gjykuar mësimet nga sjelljet e ndjekësve të tyre shpesh i ka udhëhequr gabimisht njerëzit rreth mësimeve origjinale. Është vërejtur botërisht se pas pak kohe të gjitha religjionet e humbasin influencën e tyre ndaj sjelljeve të ndjekësve të tyre. Për ilustrimet e kësaj, studiojeni sjelljen e budistëve të sotëm ose të epokave të mëparshme, studiojeni sjelljen e qeverive Hinduse etj; kjo shpeshherë s'ka lidhje me mësimet origjinale. Veçanërisht, politika nuk duhet të ngatërrohet me religjion, sjelljet politike të një populli nuk duhet të trajtohen si një pasqyrë që reflekton mësimet e atij religjioni, të cilën e ndjekin njerëzit e atij populli.

Është kundër kësaj sfonde se ne kemi shqyrtuar argumentet e prezantuara nga avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë.

### **Definicioni i një apostati**

Kurani i Shenjtë shkruan:

Ata nuk do të ndërpresin luftën kundër jush, derisa të mos ju kthejnë nga besimi i juaj -nëse munden. Dhe cili prej jush kthehet prej besimit të tij dhe vdes në atë gjendje mosbesimi, të tillë janë ata, veprat e të cilëve do të shkojnë kot në këtë botë e në botën e paskëtajme. Ata janë banorët e Zjarrit dhe aty do të rrijnë për një kohë të gjatë (2:218).

Kjo do të thotë se kushdo, pa frikë nga shpata (ose nga dhembja e dënimit), vendos të heqë dorë nga Islami ka të drejtë fundamentale të veprojë në këtë mënyrë, por askush tjetër s'ka të drejtë ta deklarojë atë apostat. E drejta për të deklaruar veten apostat i takon vetëm atij personi. Kjo do të thotë se njeriu është i lirë të heqë dorë nga religjioni i tij, por s'ka të drejtë t'u imponojë mohimin e religjionit të tjerëve. Sipas mësimëve të Islamit, një apostat, prandaj, s'mund të fabrikohet nga dijetarët religjiozë ose nga kleri ose nga ndonjë individ ose ndonjë qeveri intolerante. Kurani po ashtu shkruan: Vërtet, ata që kthehen prapa (nga besimi në mosbesim) mbasi u është sqaruar rruga e drejtë, djalli ua hijeshoi veprat e tyre të këqija dhe u dha shpresa të kota (47:26).

### **Ajete të tjera të Kuranit të Shenjtë rreth apostacisë:**

O ju besimtarë, kush prej jush largohet nga feja e vet, le ta dijë ai se Allahu së shpejti do të sjellë një popull tjetër, të cilin Allahu e do, e ata e duan Allahun. Ata do të jenë të butë ndaj besimtarëve, por të ashpër ndaj mosbesimtarëve. Ata do të bëjnë xhihad në rrugën e Allahut dhe ata nuk do të frikësohen prej mallkimit të ndonjë mallkuesi. Kjo është dhurata e Allahut dhe Ai i jep atij kënd e do Ai. Allahu është Bekimdhënës i madh dhe i Ditur ( 5: 5 5).

Ata që pasi e pranuan një herë besimin, do ta mohojnë Allahun, përveç atyre që detyrohen me dhunë ta mohojnë Allahun, por zemrat e tyre janë të bindura plotësisht ndaj besimit (nuk do të dënohen). Mirëpo, ata që ia hapin gjoksin e tyre mosbesimit, do të pësojnë

zemërimin e Allahut, dhe për ta ka një ndëshkim të ashpër (16:107).

Ata që e pranojnë besimin e mandej bëhen mosbesimtarë dhe prapë bëhen besimtarë e pastaj prapë bëhen mosbesimtarë dhe mandej rriten e përforcohen në mosbesimin e tyre, Allahu kurrë nuk do t'i falë e as auk do t'i udhëheqë në rrugë të drejtë (4:138).

Dhe Muhammadi është vetëm një profet. Vërtet, të gjithë profetët kanë vdekur para tij. Pra, nëse vdes ai ose vritet, a do të ktheheni pas gjurmëve tuaja? Dhe ai që kthehet mbrapa (largohet nga Islami) s'mund t'i bëjë dëm Allahut. Allahu do t'i shpërblejë mirënjohësit. (3:145)

Asnjë dënim trupor s'mund të kuptohet sepse nuk është përmendur në asnjë shtrirje të imagjinatës te ajete të lartëpërmendura të Kuranit.

Në një hulumtim të dëshpëruar ekziston më së paku vetëm një ajet i Kuranit që mund t'i japë përkrahje dënimit me vdekje për apostacinë. Fjala është për ajetin 12-13 të Surjes At-Tobe. këtu poshtë ne po shkruajmë ajetet 3-14 të kësaj Sureje. Këto flasin vetë dhe i kundërshtojnë të gjitha përpjekjet e dikujt që i kupton ndryshe:

3. Dhe kjo është proklamata prej Allahut dhe prej Profetit të Tij për njerëzit në ditën e Haxhillëkut të madh se Allahu dhe Profeti i Tij u liruan nga të gjitha akuzat e idhujtarëve. Pra, nëse (duke shikuar fitoren e Mekkës) pendoheni, do të jetë më mirë për ju; por nëse e ktheni

shpinën, atëherë ta dini se ju nuk mund ta mposhtni Allahun. Dhe jepu lajm rreth një ndëshkimi të dhembshëm atyre, të cilët janë mosbesimtarë.

4. Pos atyre idhujtarëve me të cilët keni nënshkruar ndonjë marrëveshje dhe të cilët nuk ju tradhtuan aspak e as nuk i dhanë ndihmë askujt kundër jush. Pra, plotësojeni marrëveshjen deri në fund. Vërtet, Allahu i do ata që janë të drejtë.

5. Dhe le të kalojnë ata katër muaj (gjatë të cilëve u është ndaluar lufta, por ata nuk e respektuan marrëveshjen), atëherë i vrisni ata idhujtarë kudo që t'i gjeni dhe zijini robër, i rrethoni dhe uluni për ta në çdo pritë. Por, nëse pendohen dhe falin Namazin dhe paguajnë Zakatin, atëherë hapuni udhën. Vërtet, Allahu fal shumë dhe është i Mëshirëshëm.

6. Dhe nëse njeri prej idhujtarëve kërkon strehim prej teje, jepi mbrojtje derisa ai të dëgjojë Fjalën e Zotit, dhe mandej përcille atë në vendin e tij të sigurtë. Sepse ata janë popull që s'e kuptojnë (realitetin).

7. Si mund të nënshkruajë Allahu dhe Profeti i Tij marrëveshjen me idhujtarët? - pos me ata idhujtarë me të cilët e keni nënshkruar marrëveshjen pranë Xhamisë së shenjtë. Pra, derisa ata qëndrojnë besnik ndaj jush, edhe ju duhet të qëndroni besnik ndaj marrëveshjes së bërë me ta. Vërtet, Allahu i do ata që nuk i prishin zotimet e tyre.

8. Si mund të ndodhë kështu, Nëse ju mundin ata, nuk do të përfillin as farefisninë e as marrëveshjen tuaj. Ata ju

kënaqin vetëm me fjalë, kurse zemrat e tyre e mohojnë atë që thonë ata, dhe shumica prej tyre janë të pabesë.

9. Ata i kanë shkëmbyer ajetet e Allahut me diçka të pavlefshme dhe i ndaluan njerëzit nga rruga e Tij. Pa dyshim, veprat e tyre janë shumë të shëmtuara.

10. Ata nuk e përfillin as farefisninë e as marrëveshjen lidhur me ndonjë besimtar. Ata me të vërtetë i tejkalojnë kufijtë.

11. Por, nëse ata pendohen dhe falin Namazin dhe paguajnë Zakatin, atëherë ata janë vëllezërit tuaj në fe. Dhe Ne ua kemi shpjeguar Shenjat njerëzve të ditur.

12. Dhe nëse ata thyejnë betimet e tyre pasi e kanë lidhur marrëveshjen dhe fyejnë fenë tuaj, atëherë luftoni kundër prijësëve mosbesimtarë që të largohen prej djallëzive të tyre, sepse ata nuk kanë besë.

13. O besimtarë! A nuk do të luftoni kundër atij populli që i ka thyer betimet e veta dhe që ka bërë komplotin për të dëbuar Profetin dhe ata të parët, të cilët filluan luftën kundër jush? A frikësoheni prej tyre? Kurse Allahu meriton më së shumti që të frikësoheni prej Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë.

14. Luftoni me ta. Allahu do t'i ndëshkojë me duart tuaja, dhe do t'ju ndihmojë kundër tyre dhe kështu do t'i çlirojë zemrat e besimtarëve (nga brenga e nga frika).



Ata që arrijnë te përfundimi se në ajetet 12 e 13 dënimi për apostacinë është vdekja, nuk ofrojnë ndonjë shpjegim lidhur me kontradiktat e krijuara nga ajetet e tjera të shumta. Këto ajete kanë lidhje me periudhën pas emigrimit nga Mekka në Medinë (shifni ajetin 3) kur Kurejshët e Mekkës vendosën armiqtësisht ta zhdukën Islamin me forcë.

Avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë, duhet të kenë ndërmend se këto ajete u referohen idhujtarëve që i patën thyer zotimet e tyre dhe e përqeshnin Islamin. Këtu nuk janë përmendur ata që e mohojnë fenë e tyre. Ata i patën thyer zotimet e tyre pasi i kishin marrë fuqimisht. Ata që u bënë armiq të religjionit janë të parët që filluan armiqtësitë ndaj jush. Leja që ju është dhënë për të luftuar kundër tyre, është kufizuar me liderët e tyre - marrëveshjet e të cilëve janë të pavlefshme dhe false. Leja është dhënë me qëllim që të ndalen ata të bëjnë vepra armiqtësore kundër jush.

Ky është kuptimi i vërtetë i këtyre ajeteve, të cilat keqkuptohen nga avokatët e dënimit me vdekje. Këto s'kanë asnjë lidhje të largët me ata njerëz, të cilët mohojnë fenë e tyre, duke u detyruar të përqafojnë Islamin. Njerëzit e tillë janë diskutuar në një pjesë tjetër të Kuranit të Shenjtë. Mund të ndodhë që Allahu të krijojë dashuri ndërmjet jush e atyre që janë armiqtë tuaj, se Allahu është i Fuqishëm dhe Allahu është shumë Mëkatfalës dhe i Mëshirëshëm. Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë e me drejtësi ndaj atyre, të cilët nuk luftuan kundër jush për shkak të fesë, dhe të cilët nuk ju dëbuan nga shtëpitë tuaja. Vërtet, Allahu i do ata që janë të

drejtë. Allahu ju ndalon vetëm që të lidhni miqësi me ata, të cilët luftuan kundër jush për shkak të fesë dhe ju dëbuan nga shtëpitë tuaja ose u dhanë ndihmë armiqve tuaj për t'ju dëbuar, dhe kush miqësohet me ta, këta janë mizorë (60:8-10).

## Mosbesimi i përkohshëm

Një ajet tjetër i Kuranit të Shenjtë thotë:

Dhe një grup prej popullit të Librit thotë: Çka është zbritur mbi besimtarët, besojeni atë në pjesën e parë të ditës dhe e mohoni në pjesën e fundit të ditës, ndoshta me anë të kësaj metode ata (besimtarë) do të kthehen nga besimi i tyre (3:73).

Populli i Librit, i përmendur në këtë ajet janë jehuditë e Medinës. Ishte taktika e jehudëve që krijonin dyshim në mesin e myslimanëve me shpresë se disa prej tyre do të mashtrohen e do të largohen nga Islami. Si ishte e mundur për jehudët të bënin këtë plan nëse apostacia dënohej me vdekje? Sikur të jetë ekzekutuar njeri për këtë krim, kjo do të ishte një pengesë për të tjerët që nuk do t'i ndiqnin gjurmët e tyre.

Avokatët e dënimit me vdekje argumentojnë se ky ajet flet vetëm rreth një filozofie jehude që nuk u praktikua kurrë nga ana e tyre. Bile, nëse kjo do të ishte vetëm një filozofi, ky ajet është provë përfundimtare se s'ka dënim në këtë botë për apostacinë, sepse jehuditë kurrë nuk kanë pasur koncept se ka ekzistuar dikur një dënim i tillë. Pos kësaj, është gabim që të thuhet se ideja ishte një çështje hipotetike; librat e hadithve tregojnë se kjo ishte

futur në praktikë nga 12 shenjtësit jehudë të Khejberit dhe të Urenahut.

Të gjitha komentet pohojnë se kjo Sure e Kuranit të Shenjtë është zbritur në mes të fitores së Mekkës dhe të vdekjes së Profetit të Islamit. Kjo përfundimisht provon se jehuditë e futën këtë ide në praktikë pasi Islami u stabilizua fuqimisht në Arabi. Si ishte e mundur që jehuditë të mendonin për një strategji vetëvrasëse e të çmendur, nëse vdekja ishte dënim i apostacisë? Si ishte e mundur që ata t'i inkurajonin myslimanët që ta ndjekin fenë e tyre, duke e vërtetuar në pjesën e parë të ditës dhe duke e mohuar atë në pjesën e fundit të ditës, nëse ata dinin se myslimanët do të ekzekutoheshin për ndërrimin e fesë së tyre?

## Traditat - të thënat e Profetit të Islamit

Avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë keqkuptojnë tërë proporcionin e të thënave të Profetit të Islamit. Traditat nuk i japin përkrahje tezës së tyre. Përkundrazi, ka shumë tradita që tregojnë qartazi se s'ka dënim për apostacinë në këtë jetë.

Megjithëse, për hir të plotësimit, ne këtu po përmendim ato të thëna të Profetit të shenjtë *s.a.v.s.* që shpesh citohen nga avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë:

a) Ebu Kalabah raporton në emër të Anasit se Profeti i Shenjtë *s.a.v.s.* popullit të Akalit ose të Urenahut i tha të shkojnë dhe të qëndrojnë me devet, femëra të tij, jashtë Medinës. Këta njerëz e vranë kujdestarin e deveve dhe ikën bashkë me kopenë. Megjithëse ishte fakt se ata e

ndërruan fenë dhe u fajsuar për apostacinë, ata nuk u dënuan për shkak të apostacisë, por për shkak se e patën vrarë kujdestarin e kopesë.

b) Ndonëse Ibn Khatali që, pa dyshim, ishte njeri ndër ata katër të ekzekutuar, në kohën e rrënimit të Mekkës ishte një apostat. Ai gjithashtu kishte bërë krimin e vrasjes së bashkudhëtarëve të vet. Prandaj, ai u ekzekutua vetëm se ishte vrasës.

c) Një incident tjetër është ai i Makis b. Sabahut që e vrau një Ansar në hakmarrje të Hishamit, vëllai i tij që u vra aksidentalisht gjatë fushatës së Zikardit. Pastaj, Makisi u bë apostat. Ai u ekzekutua në bazë të vrasjes së një Ansari. Në secilin ndër incidentet e lartpërmendura çdo person i ekzekutuar kishte bërë vrasje. Këta tre njerëz gjithashtu e patën mohuar fenë e tyre, por si mund të mbyllë dikush sytë e tij ndaj vrasjeve të tyre, kurse ekzekutimet e tyre i cilësoni si akt të apostacisë!

d) Avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë pohimin e tyre e bazojnë mbi një hadith që përmend ekzekutimin e një gruaje për apostacinë. Ky hadith (siç duket) është i pabesueshëm dhe jo i sigurtë. E vërteta qëndron në faktin se Profeti i Shenjtë s.a.v.s. kurrë nuk dha urdhër që ajo grua të ekzekutohej për hir të apostacisë. Traktati i mirënjohur i jurisprudencës, Hedajah, shpjegon sa vijon:

Profeti i Shenjtë s.a.v.s. ndaloi vrasjen e grave për apostacinë, sepse principi i rregullave ndëshkimore është që në raste të tilla dënimi lihet për Ahiretin (botën e paskësajme), si dënim i imponuar në këtë jetë e kundërshton qëllimin e apostacisë, duke qenë një provë që kërkon llogaritje e që i takon vetëm Zotit. Ky princip mund të largohet vetëm atëherë kur personi në fjalë

shpreh armiqësinë me këmbëngulje (gjatë kohës së luftës). Si gratë, për nga natyra e tyre, nuk janë të afta për luftë, një grua apostate s'mund të dënohet në asnjë rast.

Çudi se dijetarët si Molana Modudiu, i cili mund të supozohet se është tërësisht i kujdesshëm ndaj të metave serioze të këtyre të thënave, prapë gjurmon të thëna të dobëta që janë të hedhur poshtë nga shumë dijetarë eminentë myslimanë.

dh) Incidenti i Abdullah b. Sadit është përmendur pak më parë. Po të ishte caktuar në Kuran dënim me vdekje për apostacinë, atëherë si do të mund të kishin efekt fjalët e Profetit s.a.v.s. se askush nuk është jashtë ligjit - ky është një përkufizim i qartë i vërejtur prej tij me përpikëmeri ndaj ligjeve të Zotit. Nëse vdekja ishte dënim për apostacinë, atëherë si ishte e mundur që ai të mos i respektonte urdhërat e Zotit?

### Es-habët e Profetit të Shenjtë s.a.v.s.

Ne kemi vërejtur se as Kurani i Shenjtë e as të thënat e Profetit Islamit nuk u japin përkrahje avokatëve të dënimit me vdekje për apostacinë. Por, këta avokatë kanë disa dredhi të tjera. Është e domosdoshme që të shqyrtohen në një masë të madhe argumentet e tyre të mbetura. Ato argumente janë të bazuara mbi opinionet e es-habëve të Profetit të Shenjtë s.a.v.s. e jo mbi gjykimin e tij personal të drejtëpërsëdrejtë. Le të jetë e qartë në fillim se observimet dhe opinionet e es-habëve mund të jenë vetëm një komentim; ato s'kanë të drejtë të trajtohen me aq respekt si urdhërat e Kuranit të Shenjtë. Më me

vend është të trajtohen e të konsiderohen vetëm si një opinion.

a) Incidenti i apostacisë së përgjithshme që ka të bëjë me të paguarit e zakatit është diskutuar (shifni fq.85-87). Absi dhe Zubjani ishin ato fise që filluan armiqësinë duke sulmuar Medinën. Hazrat Ebu Bakri luftoi kundër tyre para kthimit të Osamës nga ekspedita. Apostatët ishin agresorë. Ata jo vetëm që refuzuan të paguanin Zakatin, por gjithashtu ngritën shpatën kundër myslimanëve. Kështu ata u rebeluan kundër shtetit islamik, i therrën myslimanët që jetonin në mesin e tyre, duke i djegur disa për së gjalli dhe i copëtuan ata të cilët i kishin vrarë. Ata që e përkrahin dënimin e apostacisë, në bazë të autoritetit të këtij incidenti, janë ose injorantë ndaj fakteve ose qëllimisht në mënyrë të gabuar i udhëheqin njerëzit, duke e fshehur vrasjen e myslimanëve të pafajshëm nga duart e rebelëve.

b) Avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë shtrojnë pyetjen se nëse s'ka pasur dënim me vdekje për apostat, atëherë përse Muselemah gënjeshtari u ekzekutua? E vërteta qëndron në faktin se ai dëshironte fuqinë politike. Ai u shoqërua me Ebu Hanifën dhe ia ofroi Profetit të Shenjtë s.a.v.s. bindjen e tij me kusht që ai të emëronte atë pasardhës të tij. Profeti i Shenjtë s.a.v.s. i tha atij se ai nuk do t'ia japë pushtetin, bile nuk do t'i japë as edhe një degë të palmës. Muselemah u kthye dhe deklaroi se gjysma e Arabisë i takon atij. Ai i dërgoi një letër Profetit të Shenjtë s.a.v.s. ku ai deklaroi: Unë jam i caktuar partner i juaj në autoritet. Profeti i Shenjtë iu përgjigj, duke i cituar atij ajetin 129 të Sures 7 të Kuranit të shenjtë. Pas deklarimit të Muselemahut se është një profet, ai e zuri Habib b. Zejdin, një sahabi i Profetit të

shenjtë, dhe e sakatoi dhe pjesët e mbetura i dogji. Avokatët e dënimit me vdekje e injorojnë këtë vrasje rrëqethëse dhe pohojnë se apostacia ishte i vetmi krim i Muselemahut. A nuk bëri ai vrasje? A u ekzekutua vetëm për shkak të apostacisë? A nuk u soll para drejtësisë për vrasje e për ngatërrim e çrregullimin që krijoi në vend? Nuk ekziston asnjë fije e evidencës se me të dëgjuar refuzimin e Muselemahut për të bindur para profetësisë së Muhammedit, Profeti i Shenjtë s.a.v.s. e dënoi atë me vdekje ose e nxiti ndonjë sahabi të vet për vrasjen e tij. Meqë dështoi gjetja e ndonjë evidence të ndonjë dënimi specifik nga ana e Profetit të Shenjtë s.a.v.s., Molana Modudiu i është dashur të kërkojë strehim në një dëshirë, të cilën Profeti i Shenjtë s.a.v.s., siç thuhet, e shprehu në momentet e tij të fundit që Muselemah duhet të vritet. Sikur të ishte shprehur një dëshirë e tillë, është e pamundur për ne të besojmë se kalifi i parë i Profetit të Shenjtë s.a.v.s., Ebu Bakri, ta kishte injoruar atë dhe të mos kishte dërguar ndonjë ekspeditë për të plotësuar dëshirën e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. Përse Abu Bakri priti derisa erdhi koha kur Muselemahu vetë bëri ofencivën dhe haptazi u rebelua kundër myslimanëve? Ne e dimë se Muselemah e mblodhi një ushtri të përbërë prej 40,000 luftatarësh të Banu Hanifës kur luftoi me Khalid b. Validin. Muselemahu filloi armiqësinë dhe u vërsul kundër Medinës. Ajo ishte koha kur Ebu Bakri pat urdhëruar të marshohet kundër tij - vetëm për shkak të rebelimit të tij dhe të vrasjes së tmerrshme të Habib b. Zejdit.

c) Një incident tjetër që përmendet është ai i Talaihaut, një pretendues i profetësisë. Prapë themi se ai nuk ishte vetëm një pretendues por i pat vrarë Ukash b. Mohsinin

dhe Thabit b. Akrama Ansarin. Khalid b. Validi, para se të fillonte betejën kundër tij, i dërgoi një emisar Tulaihaut që të pajtohet me termat e paqes dhe t'i shmanget gjakderdhjes. Avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë nuk vërejnë faktin se nëse ekzistonte dënim me vdekje për apostacinë, s'kishte nevojë t'i dërgohej ndonjë emisar që t'i ofrojë falje atij.

d) Një rast i ngjashëm është ai i Esvad Anasit që ngriti standardin e rebelimit bashkë me apostacinë e tij. Ai e vrau guvernatorin mysliman të Jemenit, Shahr b. Bazanin, me forcë u martua me vejushkën e tij dhe e bëri veten guvernator të Jemenit. Kur u informua Profeti i Shenjtë s.a.v.s. rreth rebelimit të tij, ai i dërgoi një letër Muaz b. Xhabalit dhe myslimanëve që të kundërshtojnë Esvad Ansarin që më vonë u vra në një përleshje me myslimanët. Lajmi i vrasjes së tij arriti një ditë pas vdekjes së Profetit të Shenjtë s.a.v.s.

e) Po ashtu, Lakib b. Malik Azdiu u bë një apostat dhe deklaroi se është një profet. Ai i dëboi Xhaferin dhe Abadin, të cilët ishin caktuar funksionarë në Oman. Ai si deklaruesit e tjerë të profetësisë, s'kishte lidhje me religjionin, por ka pasur interesat e veta politike. Përpjekja e tij për sundimin politik ishte nëpërmjet rebelimit të hapët kundër shtetit islamik ku jetonte ai vetë. Pra, pyetja e apostacisë këtu është irrelevante. T'ë supozojmë për një çast se të gjithë këta njerëz nuk patën hequr dorë nga religjioni i tyre, por kishin bërë vetëm rebelim kundër shtetit islamik. Shteti patjetër do të duhej të ndërmernte masa për të shtypur rebelimin; për këtë krim Kurani i Shenjtë përshkruan dënim me vdekje. Ky dënim nuk është për apostacinë.



f) Avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë citojnë gjithashtu rastin e Umme Karfahut, grua që u bë apostate gjatë kohës së Ebu Bakrit. Ajo kishte 30 djem, të cilët i nxiti në mënyrë të pandërprerë të luftojnë kundër myslimanëve. Ajo u dënua për shkak të tradhtisë së saj dhe për shkak të vrasjes e jo për shkak të apostacisë së saj.

g) Rasti i Hazrat Aliut kur luftoi kundër Khavarexhve është përmendur disa herë. Khavarixhët krijuan çrregullim në vend, i vranë meshkujt e gratë myslimane, governorin e caktuar nga Hazrat Aliu, robëreshën e tij dhe gjithashtu edhe emisarin e Aliut.

h) Është e nevojshme të përmendet emërimi i Muaz b. Xhabalit dhe Abu Musa Asharit, secili si governor i një rajoni të Jemenit. Kur ata ishin gati për t'u nisur, Profeti i Shenjtë s.a.v.s. i këshilloi: *Lehtësojini gjërat për njerëzit dhe mos i shtyni në vështirësi. Me ta bisedoni buzëqeshur dhe jo në mënyrë që i neverit ata.* Një ditë Muazi erdhi tek Ebu Musa Ashari dhe aty pa një person të ulur, i cili ishte i lidhur me një konop. Kur Muazi pyeti lidhur me këtë, atij iu tha se ky ishte jehud dhe e pat pranuar fenë islame e mandej u bë apostat. Rrëfyesi i shtoi se gjatë dy e tre muajve myslimanët argumentuan me të me qëllim që ta bindin atë që të mbetet mysliman, por më kot. Muazi deklaroi se ai nuk do të zbrisë nga kali derisa të mos ekzekutohet ky dhe të vërtetohet se ky ishte gjykimi i Zotit dhe i Profetit të Tij. Ky komentim i fundit tregon jo më tepër se opinionin e tij personal që ai e ka kuptuar se është dëshira e Zotit dhe e Profetit të tij. Opinionet e tilla nuk çojnë peshë në ligj (Sheriat) derisa nuk janë të vërtetuara plotësisht nga referencat që e verifikojnë pohimin.

Tani, ne duhet të shqyrtojmë besnikërinë e këtij hadithi. Komentimi i Muazit i kundërvihet udhëzimit të Profetit të Shenjtë s.a.v.s. që të lehtësoni gjërat për njerëzit e jo t'i bëni të neveritur. Të kesh besim në një hadith pa e hulumtuar kuptimin e Muazit rreth Islamit mbi një çështje të rëndësishme, ku marrin pjesë të drejtat njerëzore është krejtësisht një absurditet.

Dyshimi i konsiderueshëm mbizotëron lidhur me këtë hadith, me zinxhirin e rrëfyesëve dhe me autenticitetin e tyre. Kudo që paraqiten grindje të tilla, hadithi refuzohet tërësisht. Duhet mbajtur mend se këto hadithe u tubuan nja tre e katër shekuj pas ardhjes së Islamit dhe se pas kalimit të një kohe kujtesat u anuan nga gabimet. Sipas një hadithi, jehudiut iu pre koka në bazë të urdhërit të Muazit. Ndërsa sipas një hadithi tjetër Muazi e preu vetë kokën e atij jehudiu. Pra, si mund të pranohet autenticiteti i këtyre hadithve, kur shfaqen diferenca fundamentale në një incident aq të rëndësishëm? Njerëzit mund të harrojnë çka tha dikush, por nëse ata janë dëshmitarë, ata së paku do të mund të mbajnë mend se çka ngjau më në fund me *apostatin* në fjalë.

Mandej, ne i kthehemi një hadithi, për të cilit duhet të kihet kujdes i madh sepse është theksuar fuqishëm dhe besohet nga avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë. Ky është shtyrë qëllimisht për në fund të kaptinës, që të bëhet drejtësi ndaj tij, pa ndërhyrje në rrjedhëm e përgjithshme të kësaj teme.

Para se të bëjmë analizën e hollësishme të këtij hadithi, nuk do të jenë të pavenda disa fjalë lidhur me aplikimin

e disa principeve të veçanta të pranuar nga dijetarët e Islamit të të gjitha epokave. Këto principe japin ndihmë në zgjidhjen e kontradiktave lidhur me kontradiktën e paraqitur në mes të Kuranit e të hadithit në një anë dhe të vetë hadithve në anën tjetër.

1. Fjala e Zotit është supreme.
2. Kjo është përcjellë nga praktikat aktuale të Profetit të Islamit. Kjo njihet si Syneti i Profetit.
3. Kjo është përcjellë nga hadithi - të thënat e Profetit të Islamit.

a) Nëse autenticiteti i fjalëve të Profetit të Shenjtë s.a.v.s. është stabilizuar në mënyrë të pakundërshtueshme, atëherë fjalët në diskutim janë ato fjalë që janë vënë në gojën e Profetit nga Zoti i Plotëfuqishëm. Aty ku nuk paraqitet ndonjë kontradiktë në mes të fjalëve të Profetit dhe të Kuranit, hadithi mund të pranohet si autentik.

b) Nuk ekzistojnë dy opinione lidhur me faktin se nëse ndonjë hadith që i drejtohet Profetit të Islamit, i kundërvihet ndonjë mësimi të qartë të Kuranit, atëherë një hadith i tillë duhet hedhur poshtë si fals dhe nuk është i pranueshëm si fjala e Profetit të Islamit.

c) Nëse një hadith nuk cenon qartazi ndonjë mësim të Kuranit dhe ka vend për kompromis, atëherë është ideale të bëhet një përpjekje për të gjetur një kompromis të përshtatshëm para se ta refuzojmë përfundimisht atë hadith.

d) Duhet mbajtur mend kur të bëjmë përpjekje për të pajtuar një hadith me Kuranin e Shenjtë se mësimet e qarta të Kuranit nuk duhet të interpretohen në mënyrë që t'u përputhen hadithve, por duhet bërë një përpjekje për të gjetur një shpjegim të hadithit. Prandaj, në të gjitha

rastet e dyshimit, hadithi duhet vënë në kuadër të Kuranit të Shenjtë dhe duhet gjykuar sipas tij.

e) Nëse nuk ekziston ndonjë kontradiktë në mes të Kuranit të Shenjtë dhe të hadithit, atëherë merita e tyre reciproke e besimit duhet të vendoset sipas besueshmërisë së burimeve e sipas vargut të rrëfyesve.

f) Po ashtu një hadith i tillë duhet të krahasohet me hadithe të tjera autentike dhe shumë të pranueshme me qëllim që të vërtetohet se hadithi në fjalë nuk u kundërvihet haditheve të tjera.

g) Më në fund, një metodë tjetër e besueshme për të hulumtuar besueshmërinë e një hadithi është studimi kritik i evidencës së tij të brendshme. Nëse përmbajtja e hadithit i kundërvihet personalitetit të Profetit të Islamit që është shfaqur nga studimi i sjelljes së tij dhe i qëndrimit të tij gjatë tërë jetës së tij, atëherë një hadith i tillë duhet të refuzohet se është atributi fals i Profetit të Islamit ose është kundër principeve të logjikës e të arsyes.

Në dritën e principeve të lartpërmendura, ne duhet të shqyrtojmë hadithin në fjalë.

## Hadithi

Eshtë shkruar se:

Ikramah rrëfen se ai ka dëgjuar se disa *zindikë* u sollën para Hazrat Aliut dhe ai urdhëroi që ata të digjen për së gjalli. Ibn Abasi rrëfen se nëse ai ka vepruar në këtë mënyrë, është gabim sepse Profeti i shenjtë ka thënë se vetëm Zoti ka të drejtë të dënojë dikë në zjarr. Ai vetëm pat thënë: Vritni secilin që e ndërron religionin e tij.

Ky hadith, me disa variante, gjendet edhe në përmbledhje të tjera të hadithve, siç janë Abu Daud, An-Nisai dhe Ibn Maxha.

## Kontradiktë me Kuranin e Shenjtë

Nuk është e mundur për një person me mendje të shëndoshë që të vëjë një pajtim në mes të këtyre ajeteve të Kuranit të poshtëshënuar dhe të këtij hadithi në fjalë:

	22:40
2:57, 100, 109, 218, 257, 273	24:55
3:21, 73, 86-92, 145	25:42-4,
4:83, 138, 139, 146	26:117,
5:55, 62, 91-93, 99-100	28:57,
6:67, 105-108, 126	29:19,
7:124-129	39:30-42,
9:11-14	40:26,27.
10:100-9	42:7. 8, 48, 49.
13:41	47:26.
15:10	50:46,
16:83, 105-7, 126	51:57,
17:55	64:9-13,
18:30	66:7,
19:47	88:22-3
20:72-4	

Disa prej këtyre ajeteve të lartëshënuara janë cituar edhe më parë. Për hir të sqarimit të mëtejshëm po shënohen këto ajete: Dhe kush dëshiron të pranojë fenë tjetër pos Islamit, le ta dijë se nuk do të pranohet prej tij dhe ai në botën e paskësajme do të jetë ndër ata që do të pësojnë

humbje. Si do t'u tregojë Allahu rrugën e drejtë atyre, të cilët e përqaftuan mosbesimin, pasi e kishin pranuar njëherë besimin dhe kishin dëshmi se ky profet është i vërtetë, po edhe kanë pasur argumente të qarta. Dhe Allahu nuk e përdh popullin mizor. Të tillët janë ata që do të kenë për shpërblim mallkimin e Allahut e të engjëjve dhe të gjithë njerëzve. Ata do të rrinë nën atë mallkim. Nuk do t'u lehtësohet ndëshkimi e as nuk do t'u jepet afat, pos atyre, të cilët, pas kësaj, pendohen dhe bëjnë metani dhe e përmirësojnë veten. Vërtet, Allahu është ai që fal shumë dhe është i Mëshirëshëm. Vërtet, nuk do të pranohet metania (pendimi) e atyre, të cilët e mohojnë besimin, pasi e kishin pranuar njëherë, dhe mandej rriten e përforcohen në mosbesimin e tyre. Të tillët janë ata që janë të humbur. Për sa u përket atyre që shfaqin mosbesimin dhe vdesin si mosbesimtarë, nuk do të pranohet prej asnjërit si kompensim ari i gjithë botës. Për njerëzit e tillë do të jetë ndëshkimi i pikëllueshëm dhe ata s'do të kenë ndihmtarë. (3:86-92)

Del qartë nga këto ajete se Islami nuk i jep askujt të drejtë të dënojë dikë për shkak të apostacisë. Fjalët *nën të do të jetojnë* tregojnë qartë se fjala është për dënimin e ahiretit. Me asnjë shtrirje të imagjinatës asnjë person i arsyeshëm nuk duhet t'i interpretojë fjalët *mallkimi i Allahut* si leje për të vvarë këdo që quan apostat. Këtu nuk është përmendur dënim me vdekje. Po të ishte përmendur, sipas kërkesave të përpikta të ligjit, dënimi do të ishte i përmendur qartazi, siç është rasti i të gjitha *hodudeve* (dënime të caktuara nga Kurani). Përkundrazi, Kurani i Shenjtë e përmend mundësinë e pendimit (tobes) nga ana e personave të tillë dhe mandej

mundësinë e të falurit nga ana e Zotit. Si mund të bëjë metani (tobe) dikush e të kërkojë falje prej Zotit për mëkatet e tij në këtë botë nëse dënohet ai me vdekje?

Avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë duhet të kenë në konsideratë, nëse hadithi i tyre merret si i përpikët, se duhet të zgjidhet kontradikta e hapët në mes të Kuranit e të këtij hadithi. Veçanërisht, ata duhet të rikonsiderojnë qëndrimin e tyre, duke paraparë këto ajete të lartëcitura dhe t'i rishqyrtojnë me mendje të paanshme. Si mund t'ia akreditojë dikush peshën më të madhe hadithit se sa këtyre ajeteve të qarta të Kuranit të Shenjtë:

Dhe sikur të kishte zbatuar Zoti yt dëshirën e Tij, vërtet të gjithë njerëzit që ekzistojnë nëpër tokë, do të kishin pranuar besimin. Atëherë, pra, a do t'i detyrosh ti me dhunë të bëhen besimtarë? Dhe asnjë njeri s'mund të pranojë besimin pa vullnetin e Allahut dhe Ai zbret zemërimin e Vet për ata, të cilët duke pasur mendjen nuk punojnë me mend (10:100-1).

Kur Zoti vetë nuk i detyron njerëzit të pranojnë besimin, në çfarë pozite jemi ne që të marrim shpatën në dorë dhe t'i detyrojmë njerëzit të pranojnë besimin ose të vendosim kurthin modudian të minjve? Problemi me avokatët e dënimit me vdekje për apostacinë qëndron në faktin se ata i pranojnë letrarisht hadithet e përmbledhura qindra vite pas vdekjes së Profetit të Shenjtë s.a.v.s., të cilat qartazi u kundërvihen mësimëve të qarta e të përmendura në Kuran.

**Konfliktet me praktikën e Profetit të Islamit** s.a.v.s.

Burimi ynë i dytë i ligjit është sjellja dhe shembulli personal i Profetit të Islamit s.a.v.s. Ne kemi demonstruar boshllëkun e pohimit se dikush është ekzekutuar kurrë për krim të apostacisë.

Fundi i fundit, çfarë ishte qëndrimi i Profetit të Islamit s.a.v.s. kundër Mekkasëve? Ai ishte vetëm se Profeti duhej të lejohej të ushtrojë e të përhapë paqësisht mesazhin e Zotit. Mekkasit nuk iu falën këtë liri dhe i dënonin ashpër ata që e përqaftonin besimin. Për sa u përket Mekkasëve, të cilët e përqaftuan Islamit, ata konsideroheshin apostatë, sepse hoqën dorë nga religjioni i tyre i mëparshëm - adhurimi i idhujve.

Profeti i Islamit s.a.v.s. tërë jetën e vet e kaloi duke luftuar për hir të të drejtave fundamentale njerëzore se secili njeri duhet të jetë i pavarur dhe i lirë të zgjedhë religjionin e tij, askush s'ka të drejtë të ndërrojë me dhunë religjionin e ndonjë personi tjetër, dhe secili ka të drejtë të ndërrojë religjionin e tij - çfarëdo qoftë të jetë ai religjion.

Faktikisht, ky është kuptimi i vërtetë i *luftës së shenjtë (xhahadi)*, zhvilluar nga të gjithë profetët e Zotit kundër opozitarëve të vet gjatë tërë historisë religjioze. Kurani shpesh herë e ka përmendur këtë fakt, duke paraqitur shënimet e profetëve të mëparshëm (shifni 2:5; 6:113; 21:42; 25:32; 36:8,31; 43:8). Duke përmendur emrat e disave, siç janë Ibrahim (6:75-9; 19:47; 21:53,59,61,69-70; 37:89-91,98); Iljasi (37:126-7); Luti (26:166-8; 27:57; 15:71); Nuhi (7:60; 10:72; 11:26-7; 26:117; 71:2-21); Musai (7:105-6,124-7; 10:76-9; 17:102-3;20:44-5;



50-3: 26:19-34) dhe Isai (3:52-6: 5:118; 19:37; 43:65). Për çka u munduan ata? Ajo ishte vetëm një përgjigje e thjeshtë dhënë pohimit të kundërshtarëve të profetëve se ata s'kanë të drejtë të ndërrojnë fenë e bashkëkohësve të tyre. Me të vërtetë, çdo njeri ka të drejtë të zgjedhë për vete fenë e tij dhe derisa të përhapet mesazhi i paqes e i dashurisë me anë të mjeteve paqësore, askush s'ka të drejtë ta ndalojë atë me forcë. Reagimi kokëfortë i kundërshtarëve, ndaj këtij qëndrimi shumë të logjikshëm dhe humanitar, ishte se ata pozitivisht e refuzuan pozitën e profetëve dhe dolën këmbëngulës ndaj pohimit të tyre se profetët s'kanë të drejtë të ndërrojnë fenë e popullit të tyre. Nëse ata nuk do të heqin dorë nga ky drejtim i tyre, profetët duhet të pranojnë dënimin e apostacisë që (sipas opinionit të opozitarëve) nuk është tjetër pos vdekjes ose dëbimit.

Përpjekja e Profetit të Shenjtë *s.a.v.s.* me kundërshtarët e tij ishte rrjedhim i praktikave të të gjithë profetëve të së kaluarës. Qysh një person i arsyeshëm mund të mohojë misionin e Profetit të Shenjtë *s.a.v.s.*, të cilin ai e zhvilloi gjatë tërë jetës së tij, dhe të sfidojë qëndrimin e tij të fuqishëm lidhur me këtë princip fundamental? Kurani, praktika e Profetit të Shenjtë *s.a.v.s.* dhe hadithe të tjera paraqesin kontradikta të hapura me hadithin në fjalë. Njeriu s'mund t'i japë theksim të tepërt pabesueshmërisë së plotë të këtij hadithi.

## Besueshmëria e burimeve dhe e rrëfyesve

Në vështrim të parë, hadithi i kundërshtuar këtu është autentik nga përmbledhësit me reputacion Bukhari,

Tirmidhi, Abu Daud, An-Nisai dhe Ibn Maxha; ky gjendet në pesë prej gjashtë përmbledhjeve të pranuar të hadithve në përgjithësi. Mirëpo, pohimi i autenticitetit të tij përfundon këtu. Autenticiteti i një hadithi nuk qëndron se gjendet në një përmbledhje autentike. Ka masa të tjera të stabilizuara që aplikohen për çdo hadith. Masa më e rëndësishme prej këtyre është studimi i thellë dhe i hollësishëm i reputacionit dhe i karakterit të rrëfyesve që formojnë lidhjet e vargut të rrëfyesve.

Ka dijetarë, të cilët sakrifikuan tërë jetën e tyre për hir të këtyre studimeve dhe, falënderim për hulumtimin e tyre shumë të kujdesshëm dhe të përsosur, se ne sot jemi në gjendje të studiojmë çdo lidhje të vargut të rrëfyesve të ndonjë përmbledhjeje. Le t'i drejtohem pak hadithit që po marrim në konsideratë. Ky hadith hyn në kategorinë e *ahad garib-it* (një hadith ku ka vetëm një varg të rrëfyesve të lidhur me një burim të njëjtë), sepse të gjitha këto pesë përmbledhje të haditheve e kanë prejardhjen e vargut të rrëfyesve nga Ikramahu, si burim i tyre i fundit.

I ndjeri Molana Abdul Hai nga Laknau (Indi) në mënyrë specifike referon Ikramahun, duke theksuar se vetëm Bukhari e ka shënuar atë në përmbledhjen e vet, ndërsa përmbledhësit e tjerë e shënuan pa bërë ndonjë hulumtim të veçantë.

Një hadith mund të jetë autentik dhe i besueshëm nëse ai citohet, bile vetëm nga një varg i rrëfyesve. Megjithëse, ai nuk duhet merret si i besueshëm aq sa hadithet, të cilat kanë më shumë se një varg të rrëfyesve të besueshëm. Hadithe të tilla nuk duhet të lejohen të aplikohen në

çështjet e të drejtave, përgjegjësi dhe të dënimeve; veçanërisht kujdes i posaçëm kërkohet lidhur me *hududet*. *Hududi* është një term që fuqimisht është i aplikueshëm ndaj atyre dënimeve që në mënyrë specifike janë të përmendura në Kuran. Përfaqësuesit e dënimit me vdekje për apostacinë e konsiderojnë pikëpamjen e tyre të bazuar mbi mësimet dhe urdhërat e Kuranit, duke e futur në kategorinë e hududit. Me të vërtetë, ne më parë e hodhëm poshtë këtë pohim.

Është me rëndësi të mbahet në mend se hadithi në diskutim është një hadith i cituar nga një varg i rrëfyesve dhe se s'ka asnjë jurisprudencë, sadoqë disa e konsiderojnë të saktë. Në këtë kontekst, është esenciale të mësohet më shumë rreth Ikramahut dhe rreth reputacionit të tij.

## **IKRAMAH**

Ikramahu ishte një rob i Ibn Abasit dhe nxënësi i tij – një nxënës shumë indiferent dhe që ulej në bankat e fundit. Ai e vërtetoi vetë duke thënë se Ibn Abasi ishte aq i egërsuar nga mungesa e interesit të tij në mësim dhe nga mungesa e tij nga oret e mësimit sa që ia lidhte duart dhe këmbët për ta detyruar të rrijë i pranishëm gjatë predikimeve të tij.

Ai ishte një oponent i Hazrat Aliut - Kalifi i katërt i Islamit, dhe anonte kah khavarxhitë, tamam në atë kohë kur filluan të dilnin diferencat në mes të Hazrat Aliut dhe të Ibn Abasit. Më vonë, gjatë periudhës Abaside (Abasidë, duhet mbajtur mend, ishin shumë antagonistë

ndaj atyre, të cilët në ndonjë mënyrë kanë pasur lidhje me pasardhësit e Hazrat Aliut, për shkak të parandjenave politike). Ikramahu gëzonte famë të madhe dhe respekt si një dijetar me aftësi të gjithanshme, dhe për shkak të armiqësisë së tij që kishte ndaj Hazrat Aliut dhe të lidhjes së tij me khvarxhitë.

Dhahbi rrëfen se me që Ikramah ishte kharxhi, hadithet e përmendura prej tij janë të pabesueshme dhe të dyshimta. Një ekspert i dënimit për apostacinë, Imam Ali b. Al-Medaini, është i njëjtë mendim. Jahja b. Bekiri thotë se kharxhitë e Egjiptit, të Algjerisë dhe të Marokut ishin të lidhur fuqimisht me Ikramahun.

Në përgjithësi është vërejtur se hadithet, ku është bërë fjalë për dënim me vdekje për apostacinë, burojnë kryesisht nga ngjarjet e Basres, të Kufës dhe të Jemenit. Njerëzit e Hixhazit (Mekka e Medina) ishin tërësisht të panjohur me këto. Njeriu s'mund të mbyllë sytë ndaj faktit se hadithi i rrëfyer në diskutim nga Ikramahu është i njohur si një hadith iraken. Le të përkujtojmë Imamin e famshëm të Mekkës, Taus b. Kaisanin, i cili thotë se hadithet irakiane zakonisht janë të dyshimta.

Nuk mjafton vetëm kaq. Një dijetar i madh Jahja b. Said Al-Ansari, e vuri ashpër Ikramahun nën censurë të ashpër për shkak të pabesueshmërisë së tij në përgjithësi dhe shkon më tutje duke e quajtur *kezzab* (gënjeshtar i madh).

Abdullah b. Al-Harithi rrëfen një ndodhi shumë interesante, të cilin ai e kishte parë vetë, kur i bëri një vizitë Ali b. Abdullah b. Abasit. Ai u prek thellë dhe u

çudit shumë kur e pa Ikramahun të lidhur jashtë derës së Ali b. Abdullah b. Abasit. Ai për këtë mizori shprehu keqardhjen e tij, duke e pyetur Ali b. Abdullah b. Abasit se a nuk i frikësohesh Zotit lidhur me të. Kjo do të thotë se Ikramah, me gjithë famën e vet të pastërtisë, nuk meritonte një sjellje aq poshëtruese e mizore nga dora e të birit të mësuesit të tij. Lidhur me këtë Ali b. Abdullah b. Abasi e justifikon aktin e tij duke treguar se Ikramah pati guxim të përmendë gjëra të gënjeshtërt në emër të babait tim të ndjerë, Ibn Abasit. Si mund të jetë më mirë gjykimi i karakterit të Ikramahut se sa gjykimi i Ali b. Abdullah b. Abasit? S'është çudi, prandaj, se Imam Malik b. Anasi (95-179 P.H), përmbledhës pioner i hadithit dhe një Imam i jurisprudencës që gëzonte një reputacion të lartë në tërë botën islame, ishte i mendimit se hadithet e rrëfyera nga Ikramahu janë të pabesueshme.

Dijetarët e poshtëshënuar me reputacion të lartë pohuan se Ikramahu kishte prirje të fuqishme për të shtuar dhe për të zmadhuar diçka: Imam Jahja b. Said Al-Ansari, Ali b. Abdullah b. Abasi dhe Ata b. Abi Rabei.

Pra, ky është ai njeri, për të cilin ne jemi duke diskutuar dhe vetëm në bazë të autoritetit të tij varet, gjer më sot, jeta e atyre njerëzve, të cilët e ndërrojnë fenë e tyre.

## Ibn Abasi

Kurdoherë që përmendet emri i Ibn Abasit në krye të një vargu të rrëfyesëve, një shumicë e madhe e dijetarëve myslimanë kanë frikë. Ata harrojnë faktin se për shkak të emrit e të reputacionit të Ibn Abasit, shpikësit e haditheve false fabrikonin hadithe false në emër të tij,

sepse ata e dinin se në këtë mënyrë njerëzit do t'i besojnë lehtë këto hadithe. Prandaj, të gjitha hadithet që fillojnë me emrin e Ibn Abasit duhet të gjykohen dhe të analizohen në mënyrë të përshtatshme.

Pos kësaj, bile nëse Ibn Abasi është raportuar besnikërisht nga rrëfyesi, mundësia e gabimit njerëzor nga ana e Ikramahut, lidhur me atë që është thënë nga Ibn Abasi, nuk mund të përjashtohet.

Hadithi i poshtëshënuar do të jetë një ilustrim i mirë lidhur me këtë temë në fjalë:

Ibn Abasi thotë se Omeri thoshte se Profeti i Shenjtë s.a.v.s. tha se të qarit mbi të vdekurin i sjell dënim të vdekurit. Ibn Abasi mandej thotë se pas vdekjes së Omerit, ai ja tregoi këtë hadith Ajshës, e cila tha: Zoti faltë Omerin! Pasha Zotin, Profeti i Shenjtë s.a.v.s. nuk pat thënë gjë të tillë. Ai vetëm pat thënë se nëse pasardhësit e një mosbesimtari qajnë mbi të vdekurin, ky akt i tyre ia shton dënimin e tij, dhe duke arsytuar Ajesha tha: Na mjafton vetëm çka thotë Kurani: Pa dyshim, asnjë shpirt nuk do të bartë barrën e dikujt tjetër.

Nëse një njeri i statusit e i integritetit të Hazrat Omerit mundi të kuptojë gabimisht Profetin e Shenjtë s.a.v.s., megjithëse shumë rrallë ka ngjarë kështu, sa i madh është rreziku për rrëfyesit e tjerë për të keqkuptuar raportet e Ibn Abasit! Duke pasur mundësi të tilla, aq të gjera për të përcjellë mesazhin e Profetit të Islamit s.a.v.s., si një person i arsyeshëm mund të mbështetet tërësisht me evidencën e këtij hadithi dhe të nxjerrë konkludim për çështje shumë të rëndësishme d.m.th. për jetën,

vdekjen dhe për të drejtat fundamentale njerëzore? Pra është puna se Ikramahu e ka përpiluar këtë hadith duke ia cilësuar Ibn Abasit, siç është zakoni i tij, sipas Ali b. Ibn Abasit.

## Kriteret e tjera të brendshme

Kur ne i bëjmë analizë me përgjegjësi çështjes së hadithit në konsideratë, ne gjejmë se përmbajtjet janë të gabueshme në disa aspekte:

a) Të besohet se njeriu i statusit të Hazrat Aliut të jetë i paditur ndaj faktit se Islami e ndalon kategorikisht faktin që ndonjë person të dënohet me zjarr.

b) Fjalët *vriski këdo që e ndërron fenë e vet* janë aq të përgjithshme sa që mund të interpretohen në shumë mënyra. Këto mund të aplikohen për meshkujt, gratë dhe për fëmijët, ndërsa sipas Imam Abu Hanifës dhe sipas disa shkollave të jurisprudencës, një grua apostate (renegate) nuk duhet të vritet kurrë.

c) Fjala arabe din (fe) e përdorur në këtë hadith është një fjalë e përgjithshme që do të thotë ndonjë religjion, jo vetëm Islami në veçanti. Bile, edhe feja e idhujtarëve quhet din në Kuran (sure Al-Kaferun).

Në dritën e natyrës së përgjithme të gjuhës së përdorur, si mund të kufizojë dikush aplikimin e këtij hadithi me një mysliman që e mohon fenë e tij? Në termat e kufizuara legale, sipas këtij hadithi çdokush që e ndërron fenë e tij, çfarëdo qoftë ai religjion, duhet të dënohet me vdekje. Kjo do të thotë që të vritet jehudiu që bëhet i krishter; të vritet i krishteri që pranon fenë islame: dhe të vritet pagani që e adopton ndonjë fe të re. Po ashtu edhe fjala *çdokush* i tejkalon kufijtë gjeografikë të shtetve

islamike, duke u përdorur kudo në botë, çdokush që e ndërron fenë e tij - qoftë të jetë ai një banor primitiv i Australisë, ose të jetë shkurtabiq i Afrikës ose një indian i Amerikës Jugore - duhet të vritet përnjëherë në atë moment kur e mohon fenë e tij të mëparshme dhe pranon fenë e re.

Islami thekson në mënyrë të veçantë prozelitizmit (të ndërruarit rishtas të fesë), kështu që është detyra e çdo myslimani të bëhet predikues në rrugën e Allahut. Prandaj, sa ironike është faktise shumë dijetarë të famshëm myslimanë sot e mohojnë shpirtin e xhihadit islamik, duke u mbështetur në mënyrë të gabuar pikëpamjen jolargpamëse se Islami urdhëron që kushdo që e ndërron fenë e tij, që në këtë kontekst do të thotë Islamit, duhet patjetër që aty për aty të dënohet me vdekje. Mirëpo, ç'thoni rreth feve të tjera? Islami këtë deklaron si një obligim të çdo myslimani që ai të angazhohet për të kryer qëllimin fisnik, duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të ndërruar besimin e të gjithë jomyslimanëve përreth tyre me metoda paqësore. Ky obligim është aq i rëndësishëm dhe i nevojshëm sa që çdo mysliman këshillohet të bëjë përpjekje deri në frymën e fundit të jetës së tij. Kurani i Shenjtë thotë: Fto njerëzit kah rruga e Allahut tënd me urtësi e me predikim të mirë dhe argumentohu me ta në mënyrë më të mirë. Vërtet, Zoti yt i njeh më mirë ata që devijuan nga rruga e drejtë dhe Ai i njeh mirë edhe ata që janë të përudhur. (16:12 6)

Avokatët e doktrinës fanatike jonjerëzore, të dënimit me vdekje për apostacinë, nuk e përfytyrojnë kurrë efektin e



tij mbi marrëdhëniet njerëzore ndërkombëtare dhe ndërfaqetare. Përse s'mund të shohin ata se sipas pikëpamjes së tyre të Islamit, ndjekësit e të gjitha religjioneve kanë të drejtë fundamentale të ndërrojnë religjionin e tyre, por, jo myslimanët; dhe se Islami ka të drejtë t'i kthejë të tjerët, por të gjithë ndjekësit e religjioneve të ndryshme s'kanë të drejtë t'i kthejnë myslimanët në fenë e tyre? Çfarë pikturë të shëmtuar të drejtësisë islamike paraqet kjo!

Ta përfundojmë, apostacia është mospranimi i qartë i besimit nga një person, i cili e mbante fuqimisht. Diferencat e doktrinaeve, sadoqë të mëdha e serioze të jenë, s'mund të konsiderohen apostaci. Dënimi për apostacinë është në dorën e Zotit të Plotëfuqishëm, kundër të cilit është bërë cenimi. Apostacia që nuk është bërë me ndonjë krim tjetër, nuk është e dënueshme në këtë botë. Ky është mësimi i Zotit. Ky është mësimi i Profetit të Islamit s.a.v.s. Kjo është pikëpamja e juristëve hanafi, Fateh al-Kadrit, Çalipit, Hafiz ibn Kejemit. Ibrahim Nakhait, Sufjan Thorit dhe shumë të tjerëve. Pohimi modudian i ixhmaut (mendim i përgjithshëm i dijetarëve myslimanë), lidhur me atë hadith, të cilin e konsiderojnë të vërtetë, është vetëm një fiksjon.

## KAPITULLI VIII

### MËSHIRË PËR TËRË UNIVERSIN

Ata (Ehrraritë) ishin shumë mendjemprehtë dhe realizuan se ndjenjat e myslimanëve s'mund të preken më shumë se sa kur realisht ose në mënyrë endërrimtare të fyehet personaliteti i Profetit të Shenjtë s.a.v.s. Prandaj, ata filluan të pohonin se veprimtaritë e tyre janë për ta ruajtur nabuvatin (profetësinë) e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. dhe për të zrapur sulmet ndaj namusit (nderit) të tij... Taktika e tyre pati sukses dhe ata filluan të tërheqnin dëgjues në masë të gjerë në mbledhjet e tyre. Meqë disa oratorë ehrarë janë ekspertë në zgjedhjen e fjalëve dhe në të folur dhe në përdorimin e shëmbujve dhe të metaforave dhe mund t'i bëjnë më të laramishme ligjëratat e tyre me humor e me një gjuhë të ndytë, shpejt filluan të fitonin popullaritet.

(Gjykatës, Zotëri Munir)

Nënçmimi ndaj një profeti të Zotit është aq i vjetër sa është vetë profetësia (Pejgemberllëku). Bile, edhe Muhammedi s.a.v.s. nuk mundi t'i ikë kësaj dukurie. Ai u përqesh jo vetëm gjatë periudhës mekki të jetës së tij, por ashtu edhe në Medinë ku ai kishte autoritet për të dhënë dënim. Jehuditë e Medinës kishin një gjuhë të mprehtë dhe një ndjenjë të sëmurë të humorit dhe nuk e humbasin asnjë rast pa e përqeshur Profetin e Shenjtë s.a.v.s.

Pas Hixhrës. Kurejshët e Mekkës i bashkuan forcat me jehuditë që të ndalnin progresin e Islamit. Po ashtu edhe

hipokritët ishin *kolonë e pestë*. Krahas intrigës dhe luftës, ata gjithashtu futën në punë rrjetin e komunikimit për të bërë propaganda antiislamike. Poetët propagandues, të cilët Maksime Rodinson i ka përshkruar si *ndezës të betejës* i akuzuan myslimanët e Mekkës se e çnderuan veten duke pranuar një të huaj. Ebu Afak tallej me fëmijët e Kajlës (Avsët dhe khazraxhët):

Kam jetuar për një kohë të gjatë,  
por nuk kam pare kurrë  
As ndonjë shtëpi a tubim të njerëzve  
Më besnik e fisnik ndaj Aleatëve,  
kur i thërrasin ata,  
se ata fëmijët e Kajlës në tërësi  
Malet do të copëtohen para se ata nënshtrohen  
Megjithatë këtu është një kalorës  
që vjen në Mesin e tyre që  
i ndan  
(Ai thotë) Kjo është e lejuar,  
kurse kjo është e ndaluar  
Për të gjitha llojet e gjërave  
Por nëse ju keni besuar në fuqi  
Dhe në forcë, përse pra  
Nuk e ndjekni Tubën?'

Ebu Afaku thoshte: Tubba, fundi i fundit, ishte një mbret i Arabisë Jugore me reputacion të madh e ju prapë i rezistoni atij. Tani, çka ndodhi me ju që i keni pranuar pohimet e një refugjati nga Mekka? Në këtë kohë, Kabi u zgjodh prijës i jehudëve, duke e zëvendësuar Malik b. AI-Sejfin, i cili gjithashtu vajtonte humbjen e Kurejshve

në Badr. Në një elegji ai thotë: Përzini të marrët tuaj që të jeni të sigurt

Nga biseda që s'ka kuptim  
A më përqeshni se derdh lot  
Për ata që më donin singerisht?  
Derisa jam i gjallë do të qaj  
e do t'i përkujtoj Meritat e popullit  
lavdia e të cilëve janë shtëpitë e Mekkës.

Është e qartë se qëllimi kryesor i kësaj fushate të panjerëzishme dhe abuzonjëse ishte të mbillet fara e mosmarrëveshjes në mes të Ansarëve dhe të Muhaxhirëve në një anë dhe në mes të Avsve dhe të Khazraxhve në anën tjetër. Fushata pushoi së vepruari kur një jehud nga Beni Kajnuka, Shas b. Kejsi, urdhëroi rininë jehude të recitojë disa poezi të përpiluara në rastin e betejës së Buathit. Ato e recituan në një tubim të përzierë të myslimanëve, duke përfshirë Avsët dhe Khazraxhët. Eventualisht, të dy palët u ngritën dhe thirrën njëra-tjetrës duke thënë: Nëse ju dëshironi të njëjtën gjë ne do ta bëjmë përsëri. Ata të dy u përgjigjen: Ne do ta bëjmë! Vend takimi juaj është jashtë - ky ishte një vullkan. Armë! Armë! Sa dëgjoi profeti i shenjtë këtë lajm, ai u ngut të arrijë në atë vend bashkë me Ansarët dhe ju drejtua njerëzve të Avsit e të Khazraxhit: O myslimanë! Përkujtojeni Zotin. A do të veproni ashtu siç kanë vepruar paganët kurse unë jam me ju? Pasi Zoti ju udhëzoi drejtë Islamit, ju dha respekt dhe ju shpëtoi nga paganizmi? Pasi Ai ju shpëtoi nga mosbesimi dhe duke u sjellë në këtë mënyrë Ai ju bëri shokë? Në atë moment u diktuan këto ajete të Kuranit:

O ju besimtarë! Frikësohuni prej Allahut me të gjitha kushtet e saj dhe vdisni vetëm kur jeni tërësisht të bindur. Dhe ju të gjithë së bashku kapeni fuqimisht litarin e Allahut dhe mos u përçaheni. Dhe kujtojeni favorin që Allahu bëri ndaj jush - kur keni qenë armiq të njëri-tjetrit dhe Ai krijoi dashuri në zemrat tuaja kështu që me anë të mëshirës së Tij u bëtë vëllezër. Dhe ju keni qenë në buzë të një grope zjarri dhe Allahu ju shpëtoi prej asaj. Pra, ashtu Allahu i shpreh urdhërat e Tij, që të gjeni rrugë të mbarë! (3:103-104)

Kjo ishte atmosfera e pasigurisë në Medinë kur Profeti i Shenjtë s.a.v.s. vendosi të ndalë fushatën e propagandës së poetëve dhe kërkoi vullnetarë t'i ekzekutojnë. Ishte e qartë se ata ishin bërë rrezik i madh për paqe. Të thuash se ata u vranë sepse ata e përbuznin dhe e çnderonin Profetin e Shenjtë s.a.v.s. është të shtrembërosh faktin historik. T'i përdorësh këto ekzekutime si precedent për ekzekutimin e atyre që e shpifnin Profetin e Shenjtë s.a.v.s., është pandershmëria me qëllim ose është thjeshtë injorancë historike. Çnderimi i Profetit të Shenjtë teknikisht njihet si sabb, nuk është as ndonjë cenim (që hyn në përkufizimin e haddit) sipas Kuranit e as nuk është krim që dënohet me vdekje sipas synetit. Faktikisht, ky krim nuk është i dënueshëm kurrsesi, veçse nëse ekzistojnë rrethana të tjera ndihmëse. Dënimi i këtij krimi, si ai i apostacisë, është vetëm në duart e Allahut. Kurani përdor vullnetin e mirë për të mbajtur nderin e Allahut e të Profetëve të Tij, e jo shpatën. Kurani thotë:

Dhe mos i shani ata (idhuj), të cilët i thërrasin ata në vend të Allahut, sepse edhe ata duke u bërë armiq, do ta

shajnë Allahun nga mosdija e tyre. Pra, kështu ia kemi zbukuruar çdo populli veprat e tyre. Mandej, te Zoti i vet do të kthehen, dhe Ai do t'i informojë ata rreth asaj që bënëin ata. (6:109)

Respekti, nderi, dashuria dhe vlerësimi për dikë burojnë nga zemra. Forca mund të mbyllë gojën, mund të krijojë tmerr dhe mund të rezultojë si mosrespektimin. Për këtë arsye Kurani ka pikëpamje pozitive lidhur me çështjet e zemrës. Për sa i përket respektit të Profetit të Shenjtë s.a.v.s., Kurani thotë:

Allahu dhe engjëjt e Tij e bekojnë Profetin. Pra, o besimtarë, bekojeni edhe ju dhe kërkoni paqe për të. Vërtet, Allahu do t'i mallkojë në këtë botë e në Ahiret ata që e trazojnë Allahun dhe Profetin e Tij, dhe Allahu ka përgatitur për të një ndëshkim poshtërues. Dhe ata, të cilët i shqetësojnë besimtarët dhe besimtarët pa ndonjë faj, e ngarkojnë barrën e shpifjes dhe të mëkatit të madh. (33:57-59)

Kurani është shumë i qartë rreth sabbit (sharjes). Ai i këshillon myslimanët që të mos i përbuzin edhe zotat falsë të mosbesimtarëve dhe ai nuk cakton ndonjë dënim për ata që shajnë ose çnderojnë Profetin e Islamit s.a.v.s. - sepse për ta Zoti ka përgatitur një ndëshkim poshtërues.

Dhe si u soll Shembulli i Shkëlqyeshëm (Hazret Muhammadi s.a.v.s.) ndaj atyre që e përbuznin? Të kthehemi te lideri i hipokritëve, Abdullah b. Ubai. Pas betejës së Al-Mustalikut (6 P.H/737 e.s), kur Profeti i Shenjtë s.a.v.s. ishte duke qëndruar afër vendit të ujitjeje të Al-Murejsit, ngjau një grindje e pakëndshme në mes të Muhaxhirëve dhe të Ansarëve. Një shërbëtor i paguar i

Omerit, Jahja b. Masudi, dhe Sinan b. Vabar al-Xhuhani, një aleat i Ansarëve, filluan grindjen. Sipas Ibn Is-hakut: Xhuhani bërtiti - O njerëz të Ansarëve! Dhe Jahjah bërtiti - O njerëz të Muhaxhirëve! Abdullah bin Ubai b. Saluli u zemërua. Bashkë me të ishin disa njerëz të tij dhe ku ishte edhe Zejd b. Arkamit, një djalosh i ri. Ai tha: A kanë bërë kështu në realitet? Ata na kundërshtuan epërsinë tonë, ata na kaluan për nga numri në vendin tonë. Asgjë s'është më e përshtatshme për ne dhe për vagabandët e Kurejshit se sa thënia e vjetër *Ushqe qenin dhe ai do të të përpirë*. Pasha Zotin, kur ne do të kthehemi në Medinë, njeriu më i respektuar do të dëbohet nga mesi ynë. Mandej, ai shkoi te njerëzit e vet dhe tha: Kjo është ajo që keni bërë kundër vetvetes suaj. Ju i keni lënë të pushtojnë vendin tuaj dhe ju i keni ndarë me ta pasuritë tuaja. Sikur të kishit ruajtur pasuritë tuaja prej tyre, ata do të kishin shkuar diku tjetër. Zejd b. Arkami e dëgjoi këtë dhe, kur ai i caktoi armiqtë e tij, shkoi dhe e informoi Profetin. Omeri, i cili ishte me të, tha: Thuaji Abbad b. Bashirit të shkojë dhe ta vrasë atë. Profeti iu përgjigj: Çka do të flasin njerëzit se Muhammedi i vret vetë besimtarët e tij? Jo, por urdhëroi të vazhdojnë udhëtimin.

Profeti i Shenjtë s.a.v.s. me të vërtetë ishte shumë i shqetësuar. Apeli fisnor i Xhuhanit drejtuar Ansarëve dhe thirrja e Jahjahut: O njerëz të Muhaxhirëve, ia përkujtoi Ditën e Buathit dhe luftën e Basusit që zgjati 40 vjet. Po të korrte sukses Abdullah b. Ubai, Ansarët dhe Muhaxhirët do të ktheheshin te luftërat e tyre fisnore. Mesazhi i Islamit i unitetit që i shndërroi këto fise të përçara në kombin e fuqishëm arab do të zhdukej

përgjithmonë. Profeti i Shenjtë s.a.v.s. ishte aq i shqetësuar sa që urdhëroi të largohej, megjithëse, sipas raportit të Ibn Is-hakut, ajo ishte koha kur Profeti i shenjtë nuk udhëtonte. Lidhur me këtë incident Kurani thotë: Ata (hipokritë) thonë: Nëse kthehemi në Medinë, ai më i nderuari do të dëbojë atë më të poshtërin. Ndërsa nderi i vërtetë i takon Allahut e Profetit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët s'e kuptojnë (63:9).

Kur Abdullahu, biri i Abdullah b. Ubait, dëgjoji këtë, ai shkoi te Profeti i Shenjtë s.a.v.s. dhe tha: Unë kam dëgjuar se ju dëshironi të vrisni Abdullah b. Ubain për atë që keni dëgjuar për të. Nëse keni vendosur, më urdhëroni që të kryej këtë punë dhe unë do të ta sjell kokën e tij, sepse Al-khazraxhët e dinë se ata s'kanë njeri më të bindshëm se unë ndaj babait të vet. Unë kam frikë se nëse ju ngarkoni dikë tjetër për ta vrarë atë, unë s'mund të duroj të shoh ekzekutuesin duke u sjellë rreth tij dhe të vrasë atë. Në këtë rast unë do të jem vrasës i një besimtari për hir të një mosbesimtari dhe sigurisht do të jem i mallëkuar. Profeti s.a.v.s. tha: Jo, por ne duhet të sillemi ndaj tij në mënyrë njerëzore dhe të shoqërohemi me të gjersa ai është me ne.

Sunduesit myslimanë, të cilët kuptuan se përse Profeti i Shenjtë s.a.v.s. u soll kështu ndaj Abdullah b. Ubait dhe hipokritëve të tjerë dhe ndaj jehudëve, janë tepër të pavendosur për të krijuar martirët fals në procesin e mbrojtjes së nderit të Profetit të Shenjtë s.a.v.s. (Namus-i-Resul). Në Kortoba (Spanjë), në mes të vitit 850-859, u formua një grup fanatikësh të krishterë nën udhëheqësinë e Eulogiusit. Anëtarët e këtij grupi ishin të vendosur ta mohonin publikisht Profetin e Shenjtë s.a.v.s. dhe të



pranonin martirizmin. Kaditë e Kortobës, megjithëse, refuzuan kërkesën e tyre dhe i burgosën. Lidhur me këtë incident Vill Duranti shkruan: Is-haku, një murg i Kortobës, shkoi te kadiu dhe shprehu dëshirë për konvercion: por kur kadiu, i gëzuar shumë, filloi të shpjegojë për Muhamedanizmin, ai ndërhyri dhe tha: Profeti juaj ju ka gënjyer dhe ju ka mashtruar. Qoftë i mallëkuar ai, i cili i tërhoqi zvarrë shumë të gjorë bashkë me vete në ferr! Kadiu e riprovoi atë dhe e pyeti se mos është i dehur? Murgu iu përgjigj: Unë jam në vete. Dënomë me vdekje! Kadiu e burgosi atë, por kërkoi leje nga Abdur Rahmani II ta shkarkojë nga puna, si njeri të paarsyeshëm.

Shejkul Islam Ebussad Efendiu, kryemufti i Perandorisë Otomane, gjatë mbretërisë së Sultan Sulejmanit të Madhërishtëm, lejoi dënim me vdekje, por vetëm për ata që kanë habi e adet ta fyejnë publikisht Profetin e Shenjtë s.a.v.s. Ai shkoi më tutje dhe insistoi që të mos ekzekutohet askush për gjëra jo serioze. Ai haptazi shprehu dëshirë që të largohet nga paditje jo serioze dhe të ngritura me smir, dhe shpjegoi se një ofendues nuk duhet të trajtohet si trajtohen ata që kanë zakon të shpifin, vetëm në bazë të fjalës së një e dy personave. Karakteri i zakonshëm i ofenduesit duhet të provohet tek autoritetet nga myslimanët e paanëshëm, të cilët s'kanë ndonjë motiv të keq të fshehtë. Por, ka qenë një kalorës i rëndësishëm që tregon se sadoqë Shejkul Islam Ebussad Efendiu e lëshoi një fatve (vendim i prerë i lëshuar nga muftiu) pa ndonjë autoritet të Kuranit e të hadithit, ai e dinte se e drejta për të dhënë dënim për *sabb* i takon vetëm Allahut. Fatva u lëshua, siç duket nën presionin

politik, sepse ai e asgjësoi tërë efektin e saj duke pohuar se mosbesimtarët nuk mbajnë faj për pohimin (që është pjesë përbërëse e besimit të tyre) se e mohojnë misionin e Profetit të Muhammedit.

Cilësia e besimit të një myslimani dhe matja e respektit që e mban ndaj Profetit të Shenjtë s.a.v.s., s'mund të përkufizohet legalisht. Përkundrazi, një mosbesimtar s'mund të detyrohet të përqafojë Islamin e as të nderojë Profetin e tij. Për këtë arsye Zoti s'ka përshtuar asnjë dënim për *irtidad* ose për *sabb* në këtë botë. Përkundër fjalëve përbuzëse që dolën nga goja e Abdullah b. Ubait afër vendit të ujitjeje të Al-Murejsit, Profeti i Shenjtë s.a.v.s. nuk e dënoi fare.

Dënimi për këto dy krime është eksploatuar në mënyrë shumë të lehtë nga ulematë politikisht të orientuar që i poshtërojnë çështjet religjioze duke i përdorur për qëllimet materialiste dhe eksploatojnë besimet religjioze për qëllimet e veta.

Tani për tani, ulematë deobandianë (Ehle Hadith) i akuzojnë Ahmaditë se e nënçmojnë Profetin e Shenjtë s.a.v.s. Ata duhet të kuptojnë pak se duke vepruar kështu, ata vetë kanë krijuar mjetet e shkatërrimit të tyre. Në krahasim me sektin kryesor, Sunni, që ka shumicën e myslimanëve në nënkontinent, në Turqi, dhe në shumë vende të tjera myslimane, Deobanditë (Ehle Hadithët) dhe ndjekësit e reformatorit të Naxhdit, Abdul Vahabit, janë pakicë në tërë botën myslimane (pos Naxhdit). Ata akuzohen për nënçmimin e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. Ulematë deobandianë (vahabitë) i konsiderojnë sunnitë si kafir për arsye se i japin Profetit disa cilësi që, thuhet

më së paku, janë politeiste. P.sh. ata thonë se trupi i tij nuk bënte hije sepse ai ishte plotë dritë. Kur Mevludi Sharif, i popullarizuar nga poeti turk Sulejman Çelebi i Busrës (1410), përfundon me *ja nabi salam alejka* (qoftë paqe mbi ty), shpirti i Profetit s.a.v.s. prezantohet tamam në atë moment, dhe, prandaj, secili pjesëmarrës duhet të ngrihet në shenjë nderimi. Në të njetën mënyrë, të bërit lutje mbi varrin e tij, puthja e parmakëve rreth varrit dhe shumë besime të tjera të tilla dhe praktika të sunnive (brelvive) janë shirk, sipas deobanditëve. Vahabitë, duke e shembur varrezën historike të Xhenatul Bakiut, dëshironin që të shkatërronin edhe minaren e xhamisë së Profetit s.a.v.s., por u penguan të veprojnë kështu vetëm për shkak të reaksionit të fuqishëm në botën myslimane. Për këto gjeste të shkatërrimit të varreve e të kubeve, sunnitë në tërë botën i akuzojnë vahabitë për nënçmimin dhe çnderimin e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. Brelvitë janë të mendimit se ata ishin dijetarë deobandianë, Molana Muhamed Kasim Nantvi dhe Molana Ashraf Ali Tanvi, që nuk e besonin Khatm-i-Nubuvatin. Në një pomflet *Deobandi Molvijon ka Imam* (Imami i hoxhallarëve deobandian) Molana Abdul Mustafa Abu Jahja Muhamed Muinudin Shafi Kadri Rizvi Thanvi shkruan: O myslimanë! Shihni se si ky pohim i mallkuar, jo i Shenjtë dhe djallëzor e pret rrënjen e Khatm-i-Nubuvatit . . . . shihni si Molvi Kasim Nantvi nuk beson në Khatm-i-Nubuvatin, kurse Molvi Rashid Ahmad, Molvi Khalil Ahmad dhe ulematë vahabian i kanë shpallur kafirë ata që e mohojnë Khatm-i-Nubuvatin. Polemikrat Brelvio-Deobandiane - të gjitha në emër të mbrojtjes së Profetit të Shenjtë s.a.v.s., shembëlltyrën shumë të lartë të modestisë kanë arritur aq me vullgaritet

sa që shembujt më të butë janë ofencivë. Shoresh Kashmiri, një përkrahës i shkollës deobandiane, në pamfletin e tij *Kafir saz Mulla* (Hoxhallarët që njerëzit i bëjnë kafir), shkruan se secili që liderin e madh të Deobandit e deklaroi kafir, është gënjeshtar. Në të njëjtin pamflet ai shkruan se brelvitë e shesin religjionin dhe Sheriatin e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. për të siguruar jetesën, kështu që ata janë të lindur robë të familjes së Lord Klivit, armiqtë e Lidhjes Myslimane dhe të Kaid-i-Azem Muhamed Ali Xhinahut (themeluesi i Pakistanit). Në një pamflet tjetër ai thotë se këta njerëz janë më të ulët se një tullë e nevojtorës së Molana Husen Ahmadit dhe të Sejed Ataullah Shah Bukarit. Përgjigja e brelvive ndaj këtyre akuzave poshtëruese ishte pahijshme. Ata thonë se njeriu që i shpif ata dhe Profetin e Shenjtë s.a.v.s., e kalon jetën e tij duke bredhur rreth shtëpive publike. Njeriu, i cili Nehrun e quati një Profet, tani neve na akuzon për shitjen e Sheriatit të Profetit të Shenjtë, thonë ata. Përse Muhamed Kasim Nantvi quhet kafir dhe si të pranojmë ne Ashraf Ali Tanvin mysliman? A nuk janë këta, të cilët thanë se dera e vazhdimsisë së profetizmit është e hapur? A nuk janë ata që ua zbuluan rrugën Ahmedianëve? Kush ju ka mësuar se si të denigrohet Mustafa? Kush ju ka mësuar rreth mosbesimit? Ju i keni hequr rrobat tuaja nga trupi, a nuk e mbani ndjenjën e sedrës ose të modestisë? Ju keni krijuar çrregullim në emër të Khatm-i-Nubuvatit dhe krijoni ngatërresa në emër të paqes. Ju jeni duke mbledhur paratë nën emrin e Nubuvatit dhe jeni duke lypur në emër të Profetit. Një poet tjetër, Sejed M. Taha, thotë:

Si mund të çmoni statusin e lartë të Ahmed Razaut

Shkoni e merrni erë të keqe të brekëve të hindusëve.  
Ari është Profeti juaj, ari është Zoti juaj.  
1 takoni partisë së atyre që ju tregojnë arin  
Tërë jetën e keni kaluar me kufr  
Si mund të pranoni Islamin - hindu khatri të ulët!  
O Nemrud, si mund të glorifikoni Allahun?  
Vendi juaj është me hindusët, shkoni atje dhe  
Lavdro në emër të Hari-Hari-it.  
Krahasoni gjuhën, stilin dhe përmbajtjen e sulmit të  
brelvive kundër dijetarëve deobandianë me atë sulm të  
ashpër të dijetarëve deobandianë kundër Ahmadiëve:

1. Ahmadiët e mohojnë Khatm-i-Nubuvatin.
2. Ahmadiët e nënçmojnë Profetin e Shenjtë s.a.v.s.
3. Ahmadiët vunë bazën e imperializmit britanik në Indi.
4. Ahmadiët kundërshtuan krijimin e Pakistanit.
5. Ahmadiët kundërshtojnë xhihadin.
6. Ahmadiët asocionohen me jomyslimanët.
7. Ahmadiati është një poterë në emër të religjionit.

Dijetarët e Ehli Sunna Val Xhamatit (Brelvi) dhe ata deobandianë që të dy e akuzojnë njëri-tjetrin për nënçmim të Profetit të Shenjtë s.a.v.s.. Siç e pamë më parë, Xhamati Islami përshkruan Ehli-kuranin më të këqinj se Ahmadiët. Por, as shitët nuk janë të shpëtuar - edhe ata janë të akuzuar se e degradojnë statusin e Profetit të Shenjtë s.a.v.s., duke pohuar se edhe Aliu ka pasur pjesë në profetësinë e tij.

Dijetari kanadez, Vilfred Kantvel Smithi, i cili i bëri vizitë nënkontinentit dhe vëzhgoi prej së afërmi shoqërinë myslimane të Indisë e të Pakistanit, i akuzon

myslimanët për një fanatizëm me vrull të përflakët. Në librin e vet *Islam in Modern India* (Islami në Indinë Moderne) shkruan:

*Myslimanëve u lejohet ta sulmojnë Allahun: aty ka ateistë dhe publikime ateiste dhe shoqëri racionaliste, por të nënçmohsh Muhammedin kjo do të provokojë fanatizërn me vrull të përflakët, bile edhe nga sektoret më liberale të shoqërisë.*

Ky është një vlerësim jo i saktë i temperamentit mysliman. Prof. Smithi ka të drejtë në përgjithësi. Vërtet, këta janë mulla (hoxhallarë) dhe udhëheqja politikisht e orientuar që rekomandon: se ndjenjat e një myslimani s'mund të preken e as zemërimi i tij s'mund të ndizet më kollaj se ta nënçmohsh realisht ose në mënyrë false personalitetin e Profetit të Shenjtë.

Pa dyshim, i pasuri dhe i varfëri, intelektualët e të pashkolluar, të dëlirët dhe të padëlirët, të gjithë ishin të bashkuar në lidhje me dashurinë e Profetit të Shenjtë dhe konsideroheshin *fana fir rasul* (të kredhur në dashurinë e Profetit) dhe si kulminacioni i eksperiencës religjioze. Por, asnjë mysliman nuk është i pavetëdijsëm se eksperiencia më e lartë e Profetit të Shenjtë s.a.v.s. ishte miraxhi, kur ai, i rrethuar me re engjëjsh, fluturoi drejt Prezancës Hyjnore, ku edhe Xhibraili s'mundi të hyjë. Udhëheqja myslimane e uritur për fuqinë politike harron faktin se predikimi *Muhammedi është profeti i Zotit* është vetëm pjesa e dytë e pohimit të besimit mysliman. Pjesa e parë është: *S'ka Zot tjetër përveç Allahut.*

Nuk ekziston asnjë metodë për matjen e dashurisë e të respektit. Dashnorët dhe mistikët kanë shkruar divan (përmbledlije poezish) pas divaneve dhe kanë sakrifikuar jetën e tyre, duke bërë përpjekje për t'i shprehur ndjenjat e veta, në mënyrë që asnjë gjuhë s'mund t'i përcjellë realisht. Mullat mund të lexojnë poezinë e dashurisë, por s'mund ta kuptojnë atë. Kjo nuk është vetëm një ngjarje e rastësishme se themeluesi i Lëvizjes Ahmadian në Islam është pagëzuar me emrin Mirza Ghulam Ahmedi (shërbëtori i Ahmadit). Çfarë nderi! Çfarë statusi! Çfarë glorifikimi! Në tri vargjet e poshtëshënuara ai u jep përgjigje atyre që e akuzojnë për nënçmim të Profetit të Shenjtë s.a.v.s., si edhe kritikëve, si Kantvell Smithi, që i akuzojnë myslimanët se janë të pakujdesshëm ndaj nderit të Zotit:

Pas dashurisë së Allahut është dashuria e Muhammadit  
Me të cilën është dehur e tërë qenia ime  
Nëse kjo është kufër, pasha Zotin Unë jam kafiri më i madh.  
I dashuri im! O mirënjohësi im! Le të flijohet jeta ime Në rrugën tënde, sepse ke dalë indiferent  
Në të bërë mirësi ndaj meje.  
O i dashuri! Nëse është zakon që  
Në rrugën tënd të prehen kokat e dashnorëve  
Atëherë të dish se jam i pari për këtë.

Themeluesi i Lëvizjes Ahmadiane në Islam qartazi dhe me ndeshmëri ka pohuar besimin e tij në autoritetin suprem të Profetit të Shenjtë s.a.v.s. si Khatamun Nabijin. Ai thotë:

*Baza e religjionit tonë dhe esenca e besimit tonë është se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është Profeti i Tij. Besimi që mbajmë ne në këtë botë materiale dhe besimi me të cilin, nga mirësia e Zotit, do të largohemi nga ky vendbanim kalimtar, është se Prijësi dhe Mësuesi ynë i madh është Muhamedi s.a.v.s. Dhe se ai është Khataman Nabijin që e përsosi religjionin dhe me ardhjen e tij u përsos ai bekim me anën e të cilit njeriu, duke e zgjedhur rrugën e bamirësisë, arrin drejt oborrit të Zotit.*

Ai në një vend tjetër shkruan:

*Prijësit e Mësuesit tonë - Vulë e Pejgembërllëkut, Muhammedit s.a.v.s., i takon statusi më suprem dhe pozita më e lartë. Ai është unik në këtë status e në këtë pozitë dhe askush s'mund ta realizojë e as ta arrijë atë.*

Shkruesi i këtyre katër citimeve të lartëshkruara, Mirza Ghulam Ahmadi, dhe ndjekësit e tij janë deklaruar *kafirë* nga myslimanët e përshkruar nga Sër Muhamed Ikbali (poet kombëtar Pakistanez dhe një ndër poetët më të famshëm në Indo-Pakistan, 1875-1938) në këto strofa të poshtëshënuara të një poeme të gjuhës urdu.

Duart janë të pafuqishme dhe të plogëta

Zemrat jo besnike e pafe (skeptike)

Umeti është bërë zemërthyerëse

Ndaj Profetit dhe turp

U zhdukën idhuj-thyesit dhe në vend të tyre

Mbetën vetëm idhuj-bërësit,

Ibrahimi qe babai i tyre

Fëmijët meritojnë emrin e Azarit

E re dhe e çuditshme shoqëria e pianecve

E re është edhe vera e tyre dhe e çuditshme



E re është edhe Shenjtësia e Kabës  
Të rinj janë edhe idhujt  
Sa i rëndë është për ju Namazi i sabahut  
Mbi shpirtërat tuaj  
Sa herë më shumë e doni gjumin  
Se sa të zgjoheni e t'Më adhuroni  
Ramazani është shumë i mundimshëm  
Për ju të lirë,  
Tani, më tregoni se a kjo është Besnikëri ndaj Sheriatit  
Kombi formohet me fenë  
Ku s'ka fe s'ka as komb,  
Pra, kur pushon gravitacioni  
Yjetë e grumbulluar doemos perëndojnë;  
Përse jeni ai popull që  
S'e di asnjë zanat  
Asnjë komb në botë nuk përbuz  
Aq vendin e vet sa ju;  
Ju jeni si hambar ku struken Vetëtimat, dhe nuk  
largohen;  
Ju jeni ata që shesin varrezat e të parëve  
Dhe thoni se një punë e tillë është e drejtë;  
Duke nxjerrë fitim nga gurët e varreve  
Mendonin se keni siguruar nam  
Përse nuk do të hapni dyqanin e idhujve  
Nëse keni rast;  
Dëgjohen zhurma se myslimanët  
U zhduken dhe nuk shihen!  
Jehon zëri, A ekzistonin dikund Myslimanë të vërtetë  
Të Krishterët jeni ju në dukje  
Në kultur u ngjani jehudëve;  
Përse, pra këtyre myslimanëve të tillë  
Të turprohen jehuditë!

Mjafton që keni në mesin tuaj Sejedët, Mirzat, Afganët e të tjerë;

Por, a mund të pohoni se jeni

Myslimanë, paraqiteni nëse është e vërtetë

Duke pohuar se myslimanët e sotëm janë ata para të cilëve turpërohen jehuditë, dhe se ata bile edhe shesin gurrëvarrin e të parëve të tyre, poeti, filozofi, mendimtari politik dhe figura më eminente në Islamin e Indisë të shek.XX, vendosi të krijojë dallimin në mes të myslimanëve dhe Ahmadianëve. Pra, në vitin 1936 ai i dërgoi një letër të hapur Pandit Xhavahirlal Nehrut - Lideri i Lidhjes Nacionale Indiane Hinduse dhe, më vonë Kryeminister i parë i Indisë, duke kërkuar që Ahmadianët duhet të deklarohen një pakicë jomyslimane. Në Kushtetutën e Indisë sekulare kjo kërkesë nuk u pranua. Mirëpo, për ulematë deobandian kjo ishte një çështje e jetës dhe e vdekjes. Hindusët e kanë pushtuar Xhaminë Babri në Ajudha dhe nën mbrojtjen e policisë e shndërruan atë në tempull - Ram Xhanma Bhumi. Një grup tjetër i hindusve kërkoi që xhamitë e Benarës dhe të Kashit të shndërrohen në tempuj. Shumica e hindusëve bënin agjitacion për anulimin e ligjit personal të myslimanëve.

Kjo u ndodhi njerëzve që i refuzojnë profetët e Zotit dhe njerëzit e paqes. Ata qëndrojnë të përçarë dhe të shkretuar nga bekimet e paqes. Ata e rrisin dhunën dhe terrorizmin.

## KAPITULLI IX

# TERRORIZMI ISLAMIK

Ç'është terrorizmi *islamik*? - Çuditë! Islami është aq i afërt me terrorizmin sa drita me errësirën ose jeta me vdekjen ose paqja me luftën. Këto, natyrisht, mund të vijnë në kontakt me njëra-tjetrën, por nga drejtimet diametralisht të kundërta. Ato rroken me njëra-tjetrën, por kurrë nuk ecin dorë për dorë, të gëzuar me njëra-tjetrën.

Megjithëse, njeriu s'mund ta mohojë faktin se në shumë raste disa myslimanë kanë dorë në aktivitete terroriste, qoftë në emër të një grupi apo në emër të një shteti me popullësi mbisunduese myslimane.

A nuk janë njësoj ato grupe të tjera që kanë dorë në aktivitete terroriste dhe në veprimtari antishtet anemabnë botës? A do të jetë e përshtatshme t'u ngjitet të gjitha llojeve të terrorizmit etiketa *terrorizmi islamik*, duke përdorur principe të njejta që e krijuan termin *terrorizmi islamik*, duke krijuar një listë të terrorizmit sik, të terrorizmit hindus, të terrorizmit krishter, të terrorizmit jehud, të terrorizmit ateist, të terrorizmit budist, të terrorizmit animist dhe të terrorizmit pagan?

Nuk është e lehtë që të mbyllen sytë e dikujt nga llojet e ndryshme të terrorizmit, që fatkeqësisht janë të

përhapura anembanë botës; me të vërtetë, është e pamundur për një vërejtës që të jetë i paditur ndaj persekutimit, gjakderdhjes dhe vrasjes që shpesh herë bëhen në emër të disa qëllimeve ideale, ose për hir të ndonjë arsyeje fisnike. Terrorizmi është një problem global dhe kërkon që të studiohet në perspektivën e tij të gjerë. Derisa ne nuk do t'i kuptojmë ato forca që janë të fshehura prapa dhunës, ne nuk do të jemi në gjendje të kuptojmë se përse disa grupe a shtete myslimane i orientojnë terrorizmit për të arritur qëllimet e veçanta.

Jam plotësisht i bindur se gati çdo formë e dhunës komunale që shihet sot në botë - kudo qoftë të jetë dhe në çfarë forme, është esencialisht e natyrës politike. Religjioni nuk është eksploatues, por ai vetë është eksploatuar nga interesat politike të brendshme e të jashtme.

P.sh. ne gjejmë terrorizëm të pjellë nga racizmi - por ky, në analizat përfundimtare, është esencialisht i natyrës politike. Ekzistojnë edhe disa shprehje të tjera të terrorizmit, të lindura për shkaqe të rebelimit dhe të urrejtjes kundër sistemit mbizotëronjës socialo-kulturor. Këto përgjithësisht konsiderohen si akte të të çmendurve dhe të anarkistëve. Ekziston një lloj specifik i terrorizmit që ka lidhje me përpjekjen e Mafias për epërsi; ky terrorizëm udhëzohet nga fraksionet e veçanta kundër fraksioneve të tjera brenda Mafias. Siç duket, ky terrorizëm, me të vërtetë, është një përpjekje për pushtet dhe prandaj është politik.

Kur ne analizojmë të ashtuquajturin *terrorizëm islamik*, ne zbulojmë forcat politike që veprojnë prapa fasadës së Islamit. Më shpesh se kurrë, drejtuesit dhe shfrytëzuesit e vërtetë s'janë as vetë myslimanët. Të drejtohemi kah disa ilustrime të veçanta të terrorizmit me qëllim që t'u bëjmë diagnozë sëmundjeve të brendshme. Të marrim së pari Iranin e të shohim se si u shfaq Khomeinizmi.

Eshtë një fakt i vërtetë se në kohën e Shahut (mbret i Iranit – Raza Shah Pehlavi) dominonte një prosperitet i madh. Planet tepër ambicioze të zhvillimit industrial e ekonomik parashikonin një ardhmëri të shkëlqyer të vendit. Mirëpo, a mund të jetojë njeriu vetëm me bukë? Për sa u përket iranianëve nën sundimin despotik të Shahut, përgjigja ishte *jo*. Ata dëshironin të kenë një pjesë të besueshme në çështjet kyçe të vendit të tyre. Ata nuk mund të rrinin më, të kënaqur me barkun plot. Uria e tyre për vetërespekt e për dinjitet dhe dëshira e tyre e jashtëzakonshme për liri e për çlirim nga sistemi i lartë i regjimentit të shtypjes i bëri ata më shumë të padurueshëm dhe të avullueshëm.

Kjo situatë u shndërrua në një revolucion të përgjakshëm dhe të dhunës.

Nëse natyra e këtij revolucioni të shfaqur pak më parë të mos ishte esencialisht islamike, atëherë ky do të ishte një revolucion komunist dhe do të ishte më i përgjakshëm dhe më radikal. Trazira që e tundi Iranin nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim ishte një rezultat natyror dhe i pashmangshëm i një shtypjeje të gjatë politike dhe i mohimit të të drejtave fundamentale njerëzore për çlirimin, dhe gjithashtu rezultat i përmbysjes dhe i

shfrytëzimit nga fuqitë e mëdha të jashtme Perëndimore. Irani ishte i vetëdijshëm ndaj faktit se regjimi despotik i Shahut ishte plotësisht i përkrahur, i ndihmuar dhe i sanksionuar nga qeveria e SHBA-ës. Urrejtja e popullit dhe dëshira e tyre për hakmarrje nuk u ndal me përmbysjen e regjimit të Shahut dhe me shkatërrimin e të gjitha forcave të brendshme që në një mënyrë ose në ndonjë tjetër ishin përgjegjëse për mirëmbajtjen e monarkisë.

Konsekuencat e përkrahjes Amerikane ia zbulun Shahut tendencat më të ulëta e të këqija despotike të tij. Ai filloi të frikësohej, por gradualisht kjo frikë u shndërrua në terror. Frika e revoltës e bëri të ngurtë sjelljen e tij, bile më të ashpër me kalimin e kohës. Gradualisht, në Iran u formua një shtet policor i tipit më të keq. Me kalimin e kohës iranianët filluan të kuptonin se shteti policor, pa dyshim, është i përkrahur plotësisht nga qeveria e SHBA-ës. Shahu luante vetëm rolin e një kuklle, fijet e së cilës ishin të lidhura me gishtat dinake e drejtuese të SHBA-ës. Kjo, siç është përmendur edhe më lartë, çoi drejt një situatë të përgatitur për një revolucion të motivuar dhe që shaktohej nga një zjarr i urrejtjes.

Këtë situatë e shfrytëzoi plotësisht Ajetullah Khomeini. Idealogjia, të cilën ai e parashtroi për t'i dhënë ngjyrë dhe pamje këtij revolucioni ishte Shiaizmi në Islam. Por, a ishte në realitet kjo dashuri ndaj Shiaizmit në Islam që polli urrejtjen kundër SHBA-ës, apo vetëm emri i Islamit ishte një fasadë për t'i fshehur motivet e brendshme? Po të mos e kishte përdorur Khomeini flamurin e Islamit, a nuk do të ishte një revolucion me ndonjë emër tjetër? A

nuk është e vërtetë se nëse Khomeini nuk do ta kishte shfrytëzuar situatën dhe nuk do t'i kishte dhënë ngjyrën dhe pamjen e Islamit, të njëjtën situatë të urretjes do të ishte shfrytëzuar mirë nga një filozofi joreligjioze, siç është nacionalizmi apo socializmi shkencor?

Me të vërtetë, Khomeini i shpejtoi forcat, të cilat vinin pas tij dhe që, po t'u ishte dhënë kohë, do ta kishin zënë atë dhe do t'i shkatërronin të gjitha planet e tij. Për këtë arsye situata në Iran u bë shumë e ndërlikuar dhe konfuze. Dëshira themelore e revolucionit nuk ishte kundër komunizmit ose të ndonjë filozofie majtiste por vetëm kundër Shahut dhe kundër këshilltarëve të tij. Mirëpo, me që ekzistonte një udhëheqje reale pak a shumë e majtistëve, duke i marrë frerët e revolucionit nga Khomeini, atij i duhej të luftonte njëkohësisht në tri fronte. Pas përmbyesjes së Shahut, ai jo vetëm që ndërmoi masa për çrrënjosjen dhe për çfarosjen e të gjithë përkrahësve të ish-Shahut, por gjithashtu për çrrënjosjen e influencës amerikane, kudo që dyshohej për këtë ndikim. Kjo do të thotë se kjo ishte përkrahje e ideologjisë majtiste që, nëse lejohej të lulëzonte pa u kontrolluar, do të mund të korrite sukses për të rrëmbyer fuqinë nga duart e Khomeinit, duke e zëvendësuar me ideologjinë islamike së bashku me Marksizëm-Leninizmin.

Për fat të mirë, Ajatullah Khomeini doli mjaft mendjemprehtë dhe i fuqishëm për të përdorur shpatën dytehe të ideologjisë islamike, jo vetëm kundër djathtizmit amerikan, por edhe në mënyrë efektive kundër majtizmit rus.

Por, kur gjithçka që u tha dhe u bë, është e qartë se, çfarëdo që të ishte, nuk ishte Islami, i cili e udhëhoqi dhe e drejtoi revolucionin e Iranit. Më së miri, nëse dëshironi, ju mund ta quani Khomeinizëm atë çka ngjau dhe çka po ndodh në Iran. Forcat reale në aksion esencialisht nuk kanë karakter religjioz. Fuqitë politike e kanë shfrytëzuar reaksionin e iranianëve kundër Shahut për të arritur vetëm qëllimet politike.

Eshtë një histori e gjatë e zhvillimit të vetëdijes iraniane ndaj shfrytëzimit dhe të robërisë së tyre nga fuqitë e huaja të njërit ose tipit tjetër. Përkundër faktit se një shumicë e madhe e iranianëve janë myslimanë, askush s'mund të injorojë faktin se iranianët kurrë nuk ishin në gjendje të harronin e të falnin pushtimin e vendit të tyre nga arabët. Ndonëse duket se plagët u shëruan kaherë dhe shumë faktorë të fuqishëm, siç janë njerëzit e religjionit dhe armiqësia e përgjithshme kundër shteteve të tjera, kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në bashkimin e iranianëve me arabët, nuk mund të mohohet fakti se ende ekziston një mossatisfakcion i fshehur për shkak të sundimit të arabëve në Iran gjatë disa shekujve të kaluar. Duhet ta kesh të qartë se në epokën preislamike, Irani mburrej si njëri ndër civilizmet më të fuqishme e të shndëritshme, që gjithnjë kishte influencuar te njerëzimi kudo në botë. Në fillim të Islamit, arabët i njihnin vetëm dy botëra - atë në Perëndim, e dominuar nga Perandoria Romake, dhe atë të Lindjes, e udhëhequr dhe e qeverisur nga Khosrosi i Iranit. Kujtimet e kësaj periudhe të largët e të lavdrueshme të së kaluarës, ndonëse ishte pushtuar deri diku nga influenca e fuqishme e vëllazërimit islamik, s'mund të shlyheshin tërësisht. Aty gjithmonë, në zemrat



e intelektualëve, iranian, ka ekzistuar një hije e gjatë dhe e qëndrueshme e civilizimit të madh Iranian.

Historia e gjatë e hakmarrjes Irano-Arabe dhe ekspeditat *ndëshkimore* iraniane në Arabi gjithashtu kanë lënë në mendjet arabe vërragë të shëmtuara e të pezmatuara, të cilat bile edhe shëronjësi më i madh, koha, s'mundi t'i zhdukte. Kjo është vetëm njerëzore. Njerëzit në tërë botën disa herë mund ta kenë të vështirë të ndajnë veten nga e kaluara ose t'i harrojnë plagët dhe fyerjet ndaj nderit të tyre. Kaptina të tilla të historisë nuk janë mbyllur përgjithmonë, por hapen kohë pas kohe.

Mjafton ajo që e thamë për hakmarrjen Irano-Arabe të së kaluarës. T'i drejtohemi tani kohës më moderne. Nuk janë vetëm arabët kundër të cilëve iranianët kanë rritur zemërimin e tyre. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, iranianët ishin të nënshtruar ndaj një lloji më të keq të dominimit nga forcat predominuese Britanike. Ndërsa, në rastin e arabëve ekziston një faktor kompenzues i lidhjes së përgjithshme kulturo-religjioze, në rastin e britanikëve humnera në mes të sunduesit e të sunduarve, në vend që të ngushtohet, u zgjerua shumë. As nuk mund të lidhet me ndonjë urë të barabarësisë sociale, kulturore e religjioze.

Pas rrënies së ndikimit britanik erdhi epoka e kontrollit dhe e nënshtrimit drejtpërdrejtë të vendeve të Botës së Tretë nga ana e fuqive të mëdha nëpërmjet regjimeve të kukëllave e të lodrave. Mbrojtja e iranianëve në periudhën e neoimperializmit u transferua nga prehëri

britanik në prehërin amerikan. Shahu i Iranit kështu u bë një simbol i imperializmit amerikan që i dha përkrahje ideologjisë së konfliktuara siç po ndodh sot, p.sh, në Poloni, Nikaragua. Israel dhe në Afrikën Jugore.

Zjarri i urrejtjes që më në fund u ndez nga revolucioni khomenian, nuk ishte vetëm një produkt amerikan i shtypjes por ishte akumuluar shekuj me radhë si rezervat nëntokësor të naftës e të gazit. Pika më me rëndësi që duhet shënuar, është se kjo urrejtje nuk ishte me esencialisht e origjinës religjioze. Po të mos e shfrytëzonte Khomeini urrejtjen në emër të Islamit, disa liderë komunistë me siguri do ta kishin eksploatuar në emër të drejtësisë sociale. Çfarëdo emër - religjioz ose joreligjioz- t'i jepet revolucionit, forcat dhe faktoret e nënkuptueshme do të mbeteshin të njëjta.

Unë shumë herë kam folur duke theksuar se padrejtësitë e bëra nga Khomeini kundër disa njerëzve të popullit të vet, dhe aktet e hakmarrjes të kryera në shtete të tjera, i konsiderojnë të karakterit islamik, se Islami si një religjion s'ka të bëjë aspak me shprehjen e pakënaqësisë iraniane. Ta themi qartë se Perëndimi duhet ta trajtojë Ajatullah Khomeinin më shumë si mirënjohës ndaj tyre se sa armik të tyre. Unë them kështu sepse unë jam i mendimit pozitiv se po të mos eksploatonte Khomeini situatën dhe nuk do t'i jepte një pamje islamike për t'i dhënë përkrahje një junte të myslimanëve *klerëve* e për ta përjetësuar atë, situata me siguri do të ishte eksploatuar nga liderët iranianë të tendencave majtiste. I njëjti Iran, të cilin ne sot e shohim të gjelbertë të stërpikur me të kuq n, do të dukej para mesh tërësisht i

kuq. Do të ishte naiviteti të thuhet se udhëheqja komuniste e krijuar dhe e ushtruar nga Dr. Musadeku ka qenë e dobësuar dhe e ligështuar aq shumë në kohën e rrënimt të Shahut sa që nuk ishte në gjendje të luante një rol efektiv e revolucionar në këtë udhëkryq epokëkrijonjës të historisë iraniane. Me të vërtetë, udhëheqja komuniste përkrahej dhe e ushtronte mirë rolin e saj. Ajo ishte tërësisht e gatshme për të shfrytëzuar një rast. Mirëpo, për Ajatullah Khomeinin, Irani do të mund të përfundonte si një regjim radikal Marksist. Një ngjarje e tillë do të kishte konsekuenca shkatërronjëse për pasanikët e naftës, por ushtarakisht të dobët në Lindjen e Mesme. Pra, edhe Islami khomeinian - sado që të paraqitet i përgjakshëm dhe i urryer në Perëndim - mund të shihet si një bekim i maskuar.

Roli i Ajatullah Khomeinit duhet shikuar në këtë perspektivë. Lufta Irako-Iraniane nuk duhet t'i jetë relevante temës nën diskutim, por kjo hedh pak dritë mbi natyrën e ngjarjeve shpërthyse në një pjesë të botës Islame. Të dy shtetet pohojnë se janë myslimanë dhe dëshirojnë që të kenë frymëzimin e tyre për urrejtje, shkatërrim dhe për asgjësim të njëri-tjetrit në emrin e Shenjtë të Islamit.

Të gjithë ata ushtarë irakenë, të cilët u vranë në betejë, u duartrokitën si martirët e mëdhenj nga media irakene. Të gjithë ushtarët Iranian, të cilët u vranë nga duart e ushtarëve irakenë, u shpallën tradhtarë dhe jobesnikë dhe u dërguan drejt në xhehenem nga media irakiane. Në të njëjetën mënyrë për ditë është përsëritur i njëjti tregim në kthim përtej kufirit në Iran. Kurdoherë që vritej me

bajonetë ndonjë ushtar iraken, fushbeteja jehonte me britmën *Allaho Akber* (Zoti është i madh). Në cilën anë ishte Islami? Njeriu çuditet! Gjithçka që ndodh demonstroi boshllëkun e këtyre parullave. E vetmja pikë që mund të vërtetohet pa fije dyshmi është se ushtarët irakenë dhe ata iranianë që sakrifikuan jetën e tyre për hir të një qëllimi fisnik të dukshëm, u mashtruan nga paria e tyre. Islami nuk ishte as në këtë anë e as në atë anë. Kurani thotë:

Vërtet, Allahu i mbron ata që e pranojnë besimin. Vërtet, Allahu nuk e do njeriun tradhtar dhe mosbesimtar. U lejohet atyre, kundër të cilëve bëhet lufta, që të marrin armë (për mbrojtje], sepse u bëhet mizori. Dhe Allahu ka fuqi t'i ndihmojë ata që u dëbuan padrejtësisht nga shtëpitë e tyre vetëm se ata thanë: Zoti ynë është Allahu! Dhe nëse Allahu nuk i ndalonte disa (mosbesimtarë) me anë të disave të tjerë, atëherë do të ishin shembur deri në themel manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë ku përkujtohet shumë emri i Allahut. Dhe Allahu, sigurisht, do t'i ndihmojë atij që e ndihmon Atë. Pa dyshim, Allahu është i Plotëfuqishëm dhe i Fortë. (22:39-41)

Kurdoherë që kanë ndezur zjarrin për luftë, Allahu e shoi atë. Dhe ata u orvatën të krijojnë çrregullim nëpër tokë, dhe Allahu nuk i do ata, të cilët krijojnë çrregullim (5:65).

Dhe nëse dy grupe besimtarësh grinden ndërmjet veti, ju duhet t'i pajtoni, por nëse pas pajtimit ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë ju të gjithë duhet të luftoni kundër atij që e teproi, derisa të kthehet kah urdhëri i Allahut.

Dhe nëse ai kthehet, krijoni pajtim me drejtësi, se vërtet Allahu i do ata që ndajnë drejtësinë. Vërtet, të gjithë besimtarët janë vëllezër. Pra, krijoni pajtim ndërmjet vëllezëve tuaj, dhe i frikësoheni Allahut që të mëshiroheni ju (49:10-11).

Gjatë luftës u hodhën poshtë mësimet e lartëpërmendura nga kombet e alarmuara. Në Mekke, gjatë kohës së Haxhillëkut vjetor, janë bërë disa tentime nga Irani për t'ia përcjellë mesazhin e revolucionit khomenian botës myslimane që erdhën aty për Haxhillëk. Fatkeqësisht, këto tentime në disa raste u shndërruan në situata mjaft të vështira, duke i futur myslimanët në një pozitë të keqe. P.sh. çka ngjau në Mekke gjatë Haxhillëkut të vitit 1987 dhe kundërmasat që ndërmori Arabia Saudite janë diskutuar mjaft nga media Perëndimore. Kurani i Shenjtë, megjithëse, u jep myslimanëve këtë predikim: Dhe mos luftoni kundër tyre në Xhaminë e Shenjtë e as afër saj, vetëm nëse ju sulmojnë ata. Po nëse ata fillojnë luftën, atëherë edhe ju duhet të luftoni kundër tyre. Ashtu është shpërblimi i mosbesimtarëve (2:192).

Një dobi të cilën të gjitha fuqitë (që haptazi ose fshehurazi e ndihmojnë Izraelin), prijësi i të cilave është SHBA, e kanë nxjerrë nga Khomeini dhe nga Khomeinizmi, është se Khomeinit nuk i mbeti zgjedhje tjetër pos të zgjasë luftën Irako-Iraniane. Kjo e largoi vëmendjen e botës myslimane nga gjëmbi shumë ngacmues, Izraeli, prej tyre, dhe i ktheu nga një çështje kryesisht e ndryshme. Vetëdija ndaj kërcënimit të një armiku të jashtëm e hapi rrugën e mosbesimit në mes të myslimanëve.

Bota e Lindjes së Mesme u përça. Frika nga Izraeli u la mënjanë si një rrezik i vogël dhe latent, të cilit mund t'i drejtohet më vonë. Frika e një seksioni të myslimanëve për seksionin tjetër ishte një faktor kërkues dhe i ngutshëm, i cili i hodhi në harresë frikën reale ose imagjinare rreth armikut të jashtëm. Natyrisht, për të mashtruar ushtarin e thjeshtë, parulla se Islami ishte në rrezik përdorej shpesh nga të dy palët. Në realitet, çka ishte duke ngjarë, ishte rilindja e rivaliteteve dhe e xhelozive në mes të arabëve e të iranianëve axhami (aleancave jo arabe). Kjo nuk ishte çështja e forcave islamike kundër forcave joislamike ose e Shiaizmit kundër Sunizmit, por ishte riaprovim i thjeshtë dhe i drejtë i ligjit të ekzistencës së hakmarrjeve mijëravjeçare. Për këtë arsye edhe ata arabë, të cilët më parë e kritikonin Irakun dhe Arabinë Saudite, ishin orientuar në mënyrë të pashmangshme të flasin në favor të Irakut. Kjo ishte një çështje e thjeshtë e ekzistencës së arabëve kundër thirrjes së rritur dhe kërcënimit nga Irani.

Arabët para ardhjes së Islamit ishin të kënaqur në gjatimin e veprimtarive hakmarrëse ndërfisnore për gjëra shumë të parëndësishme. Islami u dha fund këtyre aksioneve të hakmarrjes. Ai i bashkoi myslimanët në një bashkim e vëllazrim të pastër nga çdo lloj rivaliteti e diskriminacioni. Mirëpo, kur myslimanët i nxorën në harresa mësimet e Islamit, atëherë vëllazërit u bënë armiq dhe u anuan nga rivaliteti fisnor. Pra, çka vërejmë ne në botën islame nuk është realisht e karakterit islamik. Kjo është një rast tjetër i ringjalljes së tendencave armiqësore.

Fuqitë e mëdha haptazi e dënuan luftën dhe në mënyrë të pandërprerë kërkuan që të pushojë armiqësia, por ato vetë janë përgjegjëse për furnizimin konstant të armëve të Irakut e të Iranit. Fundi i fundit, aeroplanet luftarak, raketat, predhat, topat, tankat, automjetet e tjera artilerie dhe armët destruktive, të cilat u përdorën lirisht nga të dy palët në luftë, nuk ishin të prodhuara në tokat e tyre. Haptazi dhe fshehurazi, nafta e Lindjes së Mesme dhe armët e Perëndimit këmbyen duart. Sipas analizave përfundimtare, zjarrin e luftës e ndezi nafta që ishte prodhim i Irakut e i Iranit dhe u shndërrua në armë nga fuqitë Perëndimore dhe Lindore jomyslimane. Për sa i përket Perëndimit, kjo kurrsesi nuk ishte një shkëmbim i keq - nafta e Lindjes së Mesme blehej me armë të vjetëruara. Çfarë shkëmbimi më të përfitueshëm mund të ketë se ky?

Siç e pamë ne, edhe Izraeli, armiku më i madh, u harrua tërësisht. Myslimanët i vritnin myslimanët. Nafta e botës myslimane u përdor e përdoret për të djegur e për të shkatërruar ekonominë e botës myslimane. U shkatërruan të mirat e mundimshme ekonomike të dekadës së kaluar. Për sa i përket progresit dhe prosperitetit, në vend që të dy - Iraku dhe Irani të përparojnë, filluan të udhëtojnë mbrapa.

Natyrisht, të gjitha luftërat kanë efekte shkatërronjëse në zhvillimin ekonomik, në burimet materiale dhe njerëzore dhe në arritjet kulturele dhe industriale. Por, në rastin e shteteve të zhvilluara, industria e luftës mund të përkraket nga vetë burimet e tyre ose të aleatëve të tyre. Kërkesa dhe presioni i luftës dhe përpjekja për

ekzistencë nuk i shterrin burimet e tyre; kjo e pasuroi diturinë e tyre shkencore dhe njohurinë e tyre teknike në një shkallë të jashtëzakonshme brenda një kohe të shkurtër. Dituria dhe opinionet teknike të fituara gjatë kohërave të luftës mund të inkuadrohen mandej menjëherë jo vetëm për të rihabilituar ekonominë, por për t'i dhënë një ngritje të jashtëzakonshme. Luftërat destruktive lindin ide të reja konstruktive dhe depërtime në arritjet shkencore e industriale. Prandaj , edhe pse materialisht të varfëruar si rezultat i një lufte të gjatë, ata mund të jenë shumë të pasur me qëllim që të ndërtojnë një ardhmëri më të bukur.

Vallë nuk është i tillë rasti i shteteve shkencërisht e ekonomikisht të prapambetura që janë të kënaqura në luksin e luftës. E vetmja zgjedhje e tyre është të shesin çdo gjë që kanë dhe bile edhe të lënë pengë ardhmërinë e tyre, duke bërë marrëveshje me shtete shkencërisht e industrialisht të pasura e të zhvilluara që të furnizohen me mjetet e luftës. Pa bërë këtë, është e pamundur për ndonjë luftë në Botën e Tretë që të zgjatet për një kohë të gjatë dhe me efekte të atilla shkatërronjëse siç ndodhi në luftën Irako-Iraniane. Përgjegjësinë për çfarëdo barbarizëm që bëjnë këto shtete kundër njëri-tjetrit dhe ngandonjëherë kundër shteteve të tjera, deri në një masë, duhet të ndajnë edhe ato shtete, të cilat janë përgjegjëse për furnizimin e armëve dhe të municionit të tyre.

Kur do të kryhet gjithçka, të gjitha borxhet do të rregullohen, dhe kur do të shqyrtohet llogaria e shkëmbimeve të të gjitha mallrave, ndoshta tamam



atëherë do të ishte përkatëse të konsiderohet pyetja se kush fitoi nga armiqësitë?

Ne kemi parë se Islami dënohet si një religjion i fabrikuar që e përkrah terrorizmin, predikon urrejtjen dhe intolerancën dhe ndjekësit e vet i ndan në kampe opozitare të armiqve të etshëm për gjak. Kjo nuk është e çuditshme. Ekzistojnë dobi të tjera anësore që fitohen nga ata, të cilët vizatojnë planin, bëjnë komplot, zbatojnë dhe furnizojnë me mjetet e shkatërrimit fraksionet fatkeqe të umetit mysliman.

Incidentalisht, termi *terrorizmi islamik* çon te një term interesant që është shpikur nga media Perëndimore në dekadën e fundit - *bomba nukleare islamike*. Pohohet se Pakistani ka këtë. Natyrisht, duhet të ekzistojë bomba nukleare islamike nëse ekziston një gjë e tillë siç është terrorizmi islamik. Mund të ndodhë që disa terma të tjera të përshtatshme të modave të ndryshme të luftës të kenë prefiks *islamik*. Përse ne nuk dëgjojmë për bombën nukleare krishtere, bombën nukleare jehude, bombën nukleare hinduse, bombën nukleare indiferente ose për bombën shintose? Është çudi se përkundër mundësisë së të përmendurit të mijëra bombave *religjioze*, media Perëndimore ka zgjedhur vetëm një, identifikon dhe vë në censurë vetëm bombën islamike - ekzistenca e së cilës është shumë e dyshimtë.

Siç u tha më parë, forcat reale në akcion nuk janë realisht e esencialisht të karakterit religjioz. Përse veçohet *islamik* kurdoherë që forcat terroriste sot janë në akcion në grupet e në shtetet myslimane? Ato fuqi që janë

përgjegjëse për zgjatjen e luftës Irako-Iraniane që sigurojnë furnizim konstant të armëve, s'mund t'i ikin përgjegjësisë së tyre për humbjen e pamatur të jetës e të pasurisë dhe të vuajtjeve të papërshkrueshme njerëzore që janë rezultat i kësaj lufte. Pa marrë parasysh motivet e tyre të mëtejshme, ata vetëm do të ndihmojnë Khomeinizmin që të ekzistojë më gjatë. Sikur shtetet që janë në luftë të liheshin të mbështetur vetëm me burimet e tyre jo të begatshme, Khomeinizmi do të fillonte të rrënohej.

Në mes të tjerash, kjo luftë e ringjalli dhe e përforcoi shpirtin nationalist që e ktheu vëmendjen e iranianëve nga problemet e brendshme të kërcënimi i armikut të jashtëm.

Brenda Iranit, ekzistonte një prirje e fortë ndaj vlerësimit të vlerave të revolucionit dhe për të gjykuar anët negative e pozitive të tij. Sado që një pjesë dërmuese e njerëzve të zgjedhur ishte zhdukur, intelektualët, të cilët mbetën të gjallë, u detyruan t'i vlerësojnë dëmet dhe fitimet e tyre gjatë revolucionit Khomeinian. Aty ishte e pashmangshme lëvizja që i jepte Iranit një rend të ri.

Gjatë luftës, nevoja për të mbajtur lart moralin e masave të Iranit u ballafaqua mjaft me nxitjen e konfliktit. Kur Iranit do t'i zhduket morali, ajo do të jetë dita e pasigurisë së madhe. Sido qoftë të zëvendësohet regjimi i sotëm nga forcat majtiste ose ato djathtiste ose nga ndonjë parti tjetër, aty do të jetë me siguri një betejë për të fituar epërsinë e për të marrë në dorë qeverinë. Çdo gjë do të kthehet në enën shkrirëse e askush s'mund të

thotë me siguri se çka ruan fati për Iranin. Allahu e di më së miri. Unë vetëm mund t'i lutem Allahut për popullin e Iranit që kohërat e tyre të vështira të shndërrohen në konkludim paqësor e të gëzuar. Ata, pa dyshim, janë një popull trim dhe i talentuar. Ata kanë vuajtur shumë në të kaluarën dhe ende po vuajnë nga duart e iranianëve dhe joiranianëve - dhe në shkëmbim ata, ironikisht, kanë fituar një emër të keq. Allahu pastë mëshirë ndaj tyre dhe i çliroftë nga gjendja e tyre e vështirë!

Tani, të kthehemi nga një aspekt tjetër i revolucionit Khomeinian të Iranit. Fill pas arritjes së pushtetit, Ajatullah Khomeini bëri planin që jo vetëm të ndërrojë stilin e jetës së myslimanëve iranian nga dominimi i huaj i hapur ose i fshehur, por ai i parashtrroi vetes detyrë që të krijojë revolucione të tilla në shtete myslimane fqinje. Ai gjithashtu e bindi botën myslimane se ai do të luajë një rol të rëndësishëm e të fortë për t'i dhënë ndihmë Palestinës dhe për t'i mposhtur forcat cioniste. Me të vërtetë, as shtete të tjera myslimane e as Izraeli nuk donin t'i pranonin krahëhapur korierët e revolucionit Iranian, prandaj eksporti s'mundi të jetë efektiv me anë të mjeteve legale e paqësore. Irani dështoi për t'i përcjellë të mirat e revolucionit shteteve myslimane fqinje. Ky arriti një masë suksesi, pa dyshim, në Palestinë, sektorin Izraelian. Siç kam shpjeguar më parë, aktivitete terroriste të zbatuara në këtë rajon, qoftë janë drejtpërsëdrejti kundër Izraelit ose kundër përfaqësuesve të fuqive të Perëndimit, nuk marrin leje nga Islami por nga filozofia e revolucionit Iranian.

Zhvillimi i bisedës militante dhe përdorimi i forcës që ne dëgjojmë, kërkon që të analizohet me kujdes para se të

mund to kuptojmë këtë fenomen të çuditshëm. Qëndrimi shumë i ngushtë dhe jo tolerant filloi të bëhej më i popullarizuar me *klerin* mysliman në të gjitha shtetet islamike. Përgjegjësia për këtë bie mbi supet e Arabisë Saudite që përpiqet të kontrollojë imagjinatën e tërë botës myslimane dhe duket e vendosur të përhapë influencën e saj politike nën maskën religjioze. Me që ajo gëzon fitim unik për shkak se është kujdestare e dy qyteteve të shenjta të Islamit - Mekkes dhe Medinës - është me siguri në një pozitë të eksploatojë këtë situatë për dobitë më të mira të saj.

Filozofia religjioze e Arabisë Saudite rrjedh nga Vahabizmi, i cili e thith inspiracionin e vet më shumë nga bota jo-tolerante e Islamit mesjetar se sa nga botëkuptimi e nga butësia e Islamit të kohës së Profetit të Shenjtë s.a.v.s. Përhapja e influencës saudite është e përkrahur nga dollarët e naftës Saudite dhe nga bankbalanca saudite me masë kolosale në të gjitha bankat e mëdha në tërë botën. Kjo është merita e Arabisë Saudite që një pjesë e interesit e fituar nga këto investime kolosale e përdor për të krijuar kanalet e ndihmës nga arkat e Arabisë Saudite për në kombet e varfëra myslimane me popullësi të gjerë myslimane. Në të shumtën e rasteve, kjo ndihmë nuk jepet për t'u dhënë mbështetje problemeve të tyre ekonomike të sëmura, por për të ndërtuar xhamitë, shkollat edukuese dhe institucionet për prodhimin e dijetarëve të markës saudite.

Prandaj, kudo që të vështroni rrjedhën e ndihmës Saudite, ju gjithashtu do ta vëreni një rritje të shpejtë në

qëndrimin e ngushtë e jotolerant të *klerit* mysliman. Pa dyshim, kur bota krishtere i dëgjon këto zëra që për afërsisht i dënojnë të gjitha vlerat joislamike dhe predikojnë *xihadin* kundër qeverive joislamike, ato udhëheqen të besojnë se biseda rreth kësaj lufte të Shenjtë gati përkthehet me ndërluftuesin aktual. Çka po ndodh në realitet është krejtësisht ndryshe.

*Kleri* mysliman flet me zë të lartë rreth luftës së Shenjtë dhe shpreh shkatërrimin e forcave jo-islamike. Ata kur flasin për forcat jo-islamike, nuk kanë parasysh në realitet forcat krishtere, jehude, budiste ose ateiste. Sipas pikëpamjes së tyre, të gjitha sektet myslimane, pos sektit të tyre, për nga karakteri s'janë myslimane ose i ndjekin ato doktrina që i bëjnë ata pre të zemërimit të Allahut e të shërbëtorëve të Tij të vërtetë. Armiqtë e vërtetë të Islamit, siç i dallojnë ata, nuk janë jomuslimanë, por disa sekte të Islamit brenda botës islame. Tendencat militante të zgjuara janë më shumë të drejtura nga myslimanët e një sekti kundër myslimanëve të sekteve të tjera se sa kundër jo-muslimanëve. Ja, për këtë arsye i jepet një theksim i jashtëzakonshëm dënimit me vdekje për apostacinë. Kjo është arma e tyre kundër atyre myslimanëve, të cilët për shkak se diferencohen në disa çështje doktrinare nga shumica e sekteve të një vendi. Këto sekte, në realitet, e trajtuan çështjen e dënimit me vdekje në dy hapa - së pari, doktrinën e tyre të shpallen si jo-islamike që quhen renegat (apostati); e së dyti, sipas doktrinës së tyre se apostati duhet të dënohet me vdekje, ata konsiderohen se meritojnë të ekzekutohen.

Një vëzhgues neutral do të pajtohet me idenë se kjo tendencë militante është duke krijuar çrregullim vetë ndër myslimanët dhe se është përgjegjëse për ngjalljen e urrejtjes së tepërt në zemrat e ndjekësve të një sektit kundër ndjekësve të sektit tjetër.

Përsa u përket fuqive jomyslimane, ato mund ta ndiejnë veten të sigurtë dhe duhet të jenë të sigurtë për shkak se ato nuk kanë kurrfarë rreziku nga të ashtuquajturat tendencat militante të botës myslimane. Për ta demonstruar këtë dikush duhet vetëm ta konsiderojë marrëdhënien e Arabisë Saudite me Perëndimin, veçanërisht me SHBA. Është e pakuptueshme se Arabia Saudite ose shtetet nën influencën e saj s'mund, as bile, të ëndërrojnë të ngrenë shpatën kundër SHBA-ës ose kundër aleatëve të saj. Regjimi i Arabisë Saudite qind për qind varet, për ekzistencën e saj, praj SHBA-ës. Gati tërë pasuria e familjes sundimtare është depozituar në Bankat Amerikane dhe në ato të Perëndimit. Në vend të parë, varësia mbi Perëndim për sigurim të jashtëm e të brendshëm është aq e qartë sa që s'ka nevojë të diskutohet këtu. Vetëm këta dy faktorë mund të garantojnë se as Arabia Saudite e as ndonjë shtet mysliman nën influencën e saj s'mund t'i paraqesin kurrë ndonjë kërcënim Perëndimit jomysliaman. Pos kësaj, fakti se asnjë shtet prej shtetve myslimane sot nuk është i pavarur në prodhimin e materialeve të luftës, dhe se varet prej Perëndimit apo prej Lindjes për të gjitha nevojat e veta defencive ose ofencive, paraqet një siguri të mjaftueshme për marrëdhëniet e tyre paqësore e të sigurta me fuqitë jomyslimane. I njëjti princip mund të aplikohet për ato shtete si Libia e Siria, të cilat kanë më

shumë marrëdhënie të përzemërta me fuqitë e Lindjes se sa me ato të Perëndimit. Askush që ka një njohuri të zbehtë ndaj luftës moderne, s'mund të imagjinojë një kërcënim real nga i ashtuquajtimi militarizmi *islamik*. Natyrisht, ka rrezik në këto rritje të tendencave dhe dikush mund të shqetësohet prej tyre. Rreziku nga militarizmi *islamik* është një kërcënim ndaj vetë botës islame. Ky është një kërcënim i brendshëm që e shkatërron kudo paqen e myslimanëve. Të gjitha intoleranca, mendjengushtësia dhe fanatizmi që ne i vërejmë sot në botën myslimane po bëjnë kërdi me paqen e botës islame. Vaj medet!

Jam i vetëdijshëm ndaj faktit se, me pak fjalë, fjala *terrorizëm* aplikohet për aksionet e terrorit, për tentativat e bëra për shpërthimet e bombave etj. Por, unë nuk besoj se vetëm nga ky tip i terrorizmit po vuan bota. Unë besoj se kurdoherë që të mirren masa shtypëse nga qeveritë kundër qytetarëve të vet për të mbytur zërin e mospajtimit, edhe këto masa duhet të jenë të përfshira në termin *terrorizëm* dhe janë të dënuara ashpër si çdo formë tjetër e terrorizmit. Unë të gjitha masat e ndërmarra nga qeveritë kundër majtistve ose kundër djathtistëve brenda kufive të tyre, i konsideroj si akt terrorizmi të tipit më të keq. Kur aksionet e terrorizmit drejtohen kundër qeverive të huaja dhe këtu e aty përdoren forma të ndryshme të eksplozimeve ose rrëmbim aeroplanësh, rasteve të tilla duhet t'u kushtohet një vëmendje të posaçme. Opinioni botëror ushqen një simpati ndaj viktimave të aksioneve të pandërprera terroriste, e pa dyshim ashtu duhet. Simpati të tilla nuk shprehen vetëm me zë, por përgjithësisht ndiqen me

masa konstruktive për t'i ndalur tentime të tilla në të ardhmën. Megjithëse, çka thoni rreth atyre qindra e mijëra njerëzve, të cilët vuajnë nën duart e pamëshirshme e të ashpra të vetë qeverive të tyre? Rënkimet e tyre rrallë dëgjoen jashtë. Rënkimet e tyre të protestës shpesh herë janë të mbështjella nga aplikimi i masave të rrepta të cenzurës. Bile, edhe agjencitë filantropike si Amnestia Ndërkombëtare ia tërhoqi vëmendjen botës për aksionet e tilla mizore të persekutimit, të torturës dhe për mohimin e të drejtave njerëzore, aksione të tilla dënohen lehtë nga qeveritë e botës. Në të shumtën e rasteve, këto konsiderohen si probleme të brendshme të shteteve përkatëse. Në vend që të përshkruhen si aksionet e terrorizmit, ato më gjerësisht përshkruhen si përpjekjet e qeverisë për të shtypur terrorizmin në këto shtete, dhe për të stabilizuar paqen dhe rendin publik.

Unë jam tërësisht i bindur se në esencë të gjitha masat pengonjëse dhe ndëshkimore që ndërmerren nga një qeveri kundër popullit të vet për ta shtypur ndonjë lëvizje të popullarizuar ose opozicionin e dyshimtë, në shumtën e heras, i tejkalojnë kufijtë e masave origjinale legale dhe përfundojnë si aktet brutale të dhunës me qëllim që të krijohet terrori në zemrat e një seksioni të pakënaqur të vetë popullit të tyre. Njerëzimi më shumë ka vuajtur nga akte të tilla të terrorizmit shtetëror se sa nga të gjitha aktet e sabotazhit ose të kidnapimit, së bashku. Përsa i përket Islamit, ai kategorikisht e hedh poshtë dhe dënon çdo formë të terrorizmit. Ai nuk i ofron ndonjë mbulesë ose justifikim ndonjë akti të



dhunës, qoftë të bërë nga një individ ose nga një grup dhe nga një qeveri.

Natyrisht, ka rajone të shqetësuara e të trazuara në botën Islame ku grupe dhe organizata, dhe disa herë bile edhe vetë qeveri, duket se bëjnë akte të terrorizmit, të dhunës dhe të sabotimit. Palestina, Libani, Libia dhe Siria shpesh herë paraqiten dhe përmenden në lajme. Në të shumtën e rasteve, shtete në fjalë janë myslimane për nga besimi, por ka edhe përjashtime. Në mesin e palestinezve, p.sh. ka edhe shumë që janë të përbetur për të bërë akte terroriste kundër Izraelit, por përsa i përket besimit ata janë të krishterë. Për leverdi ose për shkak të mungesës së dijes ata të gjithë janë emërtuar si terroristët islamikë nga media Perëndimore. Në Liban, kanë qenë terroristët myslimanë dhe ata të krishterë, dhe gjithashtu agjentët dhe ushtarët izraelian janë përzierë kohë pas kohe në aktivitetet terroriste që i trembin sensitivitetet njerëzore. Mirëpo, ju s'do të dëgjoni kurrë për terrorizmin jehud a të krishter në lidhje me atë çka po ndodh në Liban. Të gjitha aktet e dhunës janë tubuar bashkë dhe janë mbështjellë në patron e *terrorizmit islamik*.

Për sa i përketë Selman Rushdiut, asnjë njeri i arsyeshëm me dijen e vërtetë të Kuranit të Shenjtë s'mund të pajtohet me Imam Khomeinin se dënimi me vdekje që shqiptoi për Selman Rushdiun, është bazuar mbi mësimet islamike. S'ka ndonjë dënim të tillë për blasfami (sharje) në Kuran ose në hadithet e Profetit të Islamit s.a.v.s. Blasfamia kundër Zotit është përmendur në Kuran me këto fjalë:

Dhe mos i shani ata (idhuj), të cilët i thërrasin ata në vend të Allahut, sepse edhe ata duke u bërë armiq, do ta shajnë Allahun nga mosdija e tyre (6:109).

Asnjë njeriu nuk i është dhënë autoritet të caktojë ndonjë dënim për blasfemi kundër Zotit. Blasfamia ishte bërë nga jehuditë kundër Merjemes, nënës së Krishtit a.s. Kjo është përmendur në Kuran:

Dhe për shkak të mosbesimit të tyre dhe për shkak të deklaratave të rënda shpifëse kundër Merjemes. (4:157)

Edhe një herë them se s'ka dënim përveç atij të cilin Zoti e ka përmendur. Është tragjik dhe i vajtueshëm fakti se Imam Khomeini papandehur e dëmtoi Islamit në vend që ta mbronte atë, dhe i shkaktoi një dëm të pakufishëm shembëlltës së Islamit në botën e lirë.

Imami i xhamisë së madhe të al-Az-herit në Kajro, po ashtu e diskreditoi vendimin e Imam Khomeinit, dhe jam i sigurtë se ka edhe disa myslimanë shitë që nuk do të pajtohen me Imam Khomeinin lidhur me këtë kërkesë.

Përkundër të gjithë kësaj, do të ishte e padrejtë nëse dikush e injoron çështjen reale. Unë e ndiej të padrejtë, siç kanë bërë disa politikanë dhe dijetarë, që të dënohet vetëm Khomeini në vend të S. Rushdiut që përpiloi një libër, gjuha e të cilit qëllimisht është tepër ofenduese ndaj miliona myslimanëve të mbarë botës. Kjo nuk është e tëra. Libri ka ndihmuar për të minuar nga brenda paqen në mes të myslimanëve dhe të të krishterëve dhe dikush mund të gjykojë nga komentet e disa letrave të gazetave nacionale, për të lëshuar forcat e intolerancës raciale.

Le të jetë shumë e qartë se unë nuk justifikoj asnjë lloj të terrorizmit, çfarëdo ngjyre, religjioni, sentimentit ose objektivit që përfaqëson terroristin.

Islami është besimi dhe religjioni im; dhe Islami nuk lejon të krijohet çrregullim në asnjë formë. Islami është shumë larg mësimeve të terrorizmit. Cili është religjioni i terrorizmit të organizuar dhe të përkrahur nga dollarët e naftës së Kolonel Gadafit - dikush mund të pyesë? Pra, cili është religjioni i aktiviteteve terroriste që Siria ka qenë toleruar në të kaluarën? A është Islami? Nëse është ashtu, atëherë çfarë dallimi ekziston në mes të Islamit e të socializmit shkencor? A nuk është një fakt se Libri i Gjelbertë i Kolonel Gadafit ka vetëm kopertinën të gjelbertë? Përmbajtjet e librit janë të kuqe gjerë në palcë.

Nëse aktivitete terroriste të fundamentalistëve myslimanë të Iranit ose të Libisë janë emëruar si *terrorizmi islamik*, atëherë ngjyra e Islamit të tyre do të dukej e gjelberte e errët. Si është e mundur që koncepti i Islamit të jetë diametrikisht i kundërt me vetveten dhe si mund të jetë Islami në të njëjtën kohë *i gjelbertë* dhe *i kuq* - çuditet njeriu! Nëse ka diçka, terrorizmi i Libisë mund të shihet vetëm si terrorizëm nacionalist në maskim. Incidentalisht, kjo na përkujton njërin ndër atë të Fidel Kastros të Kubës. Ai marshon shumë përpara Gadafit në shijen e tij për dhunë e për terrorizëm. Mirëpo, askush nuk dëgjon se aksionet e tij cilësohen si *terrorizmi krishter*.

Një gjë të çon tek tjetra: diskutimi rreth terrorizmit i nxjerr para visionit të gjithkujt faza të ndryshme të

historisë. Krishterizmi qëllimisht ka qenë i përzierë në aktet e shëmtuara të persekutimit dhe të torturës, dhe disa monarkë krishterë kanë toleruar aktet brutale të dhunës dhe të persekutimit nën nocione të gabuara se gjoja ata janë duke e shërbyer fenë e Krishtit. Gjatë viteve të Vdekjes së Zezë, 1348-9, a nuk u dogjën për së gjalli qindra mijëra jehudë në shtëpitë e tyre? Në kohën e inkuizionit spanjoll, një mbretëri e gjatë e terrorit ka mbizotëruar nën udhëheqjen dhe udhëzimin e disa priftërinjve të krishterë. Një numër i madh grash të pandihmuara në kohë të ndryshme u dënuan me vdekje sepse ato konsideroheshin shtriga dhe ekzistonte një nocion i shtrembëruar se kjo ishte mënyra krishtere për t'u sjellë me magjinë.

Megjithëse, këto akte më shumë janë të lidhura drejtpërsëdrejti me krishterizmin, krimet kundër njerëzimit ishin një produkt i një epoke shumë të errët kur sundonte injoranca. Kur do të fillojë njeriu të kuptojë diferencën në mes të sjelljeve të një personi dhe të mësimëve të religjionit të tij? Nëse njeriu ngatërrohet me këto të dy dhe përpiqet të kuptojë religjionin, duke studiuar sjelljet e ndjekësve të tij, ngrehen shumë pyetje.

Sjelljet e ndjekësve të çdo religjioni ndryshohen nga vendi në vend, nga sekt i sekt, nga epoka në epokë dhe nga personi në person.

Sa shumë ndryshojnë sjelljet e dishepujve të Krishtit nga ato të Çiles së Pioketit, ose në Afrikën Jugore, që pohon se i mbron vlerat krishtere. Çka e përfaqëson Krishterizmin? A kemi të drejtë që të përshkruajmë Luftën e Parë Botërore dhe atë të Dytën, ku miljona

njerëz e humbën jetën e tyre, si luftërat krishtere kundër njerëzimit? Në Luftën e Dytë Botërore humbjet e Bashkimit Sovjetik llogariten më shumë se 6.1 milion. Tre të katërtat e popullësisë së Bosnjes u zhduk. Humbjet materiale dhe të pasurive janë aq të mëdha sa që është e pamundur të llogariten. A do të përshkruhet ky krim i madh si Krishterizmi në aksion ose po ta kuptojmë ndryshe Krishterizmin nga ata të krishterë të hershëm, të cilët duke e pranuar shupllakën mbi një faqe ia kthenin faqen tjetër shuplakdhënësit, dhe nga ata, të cilët iu gjuajtën bishave të egra dhe të cilët preferuan të digjen për së gjalli në shtëpitë e tyre se sa t'i jepnin përgjigje dhunës me dhunë. Unë më shumë doja të zgjidhja të fundit.

Çdo akt i luftës në një shtet mysliman kuptohet në Perëndim si zgjerim i *terrorizmit islamik*, por në ndonjë shtet tjetër një akt i tillë mirret si një grindje politike. Përse mbizotërojnë sot në këtë epokë dy standarde të drejtësisë? Njeriu, me të vërtetë, fillon të habitet nëse ekziston një urrejtje nënsipërfaqësore ndaj Islamit nën sipërfaqen e qetë, në dukje, të civilizimit krishter. Kjo ndoshta është një mbeturinë që ka rrjedhur shekuj me radhë në kohën e kryqëzatave kundër fuqive myslimane ose a është kjo vera e vjetër e shpirtëligësisë së orientalistëve e shërbyer në kupa të reja kundër Islamit? Ideja se Islami është përhapur me anë të shpatës është e dyshimtë. Luftërat e shteteve myslimane duhet të gjykohen sipas principeve ekzistuese të marrëdhënieve politike dhe internacionale e jo në bazë të religjionit.

Shprehja e dhunës është simptomë e shumë sëmundjeve të shoqërisë. Sot bota myslimane nuk e di se në cilën rrugë

duhet të shkojë. Njerëzit e gjejnë veten të pakënaqur nga shumë gjëra për të cilat nuk ka ndonjë kontroll. Ata janë lodër për eksploatim nga vetë liderët e tyre të korrptuar ose nga agjentët dhe që janë bërë vegël e fuqive të huaja. Faktikisht, shumë liderë në shtetet myslimane kërkojnë vetësanksion nga Islami për aktet e tyre të dhunës e të shtypjes siç ka ngjarë në kohën e të ndjerit Gjeneral Zia-ul-Hakut të Pakistanit. Revolucionet e përgjakshme janë tërësisht të huaja ndaj filozofisë së Islamit dhe s'kanë vend në shtetet islamike.

Unë si një njeri fetar dhe si kryetar i ndjekësve të një xhamati shpirtëror, të cilët u ballafaquan me një shekull persekutimi, terrori dhe tiranie, duhet t'i dënoj ashpër të gjitha aksionet dhe format e terrorizmit, sepse ky është besimi im i thellë dhe i rrënjosur se jo vetëm Islami por edhe asnjë religjion i vërtetë, çfarëdo qoftë emri i tij, s'mund të sanksionojë dhunën dhe gjakderdhjen e njerëzve, grave dhe fëmijëve të pafajshëm në emër të Zotit.

Zoti është dashuri, Zoti është paqe! Dashuria kurrë nuk pjell urrejtje, dhe paqja nuk çon te lufta.

## SHËNIME

### Parathënia e botuesit

1. Raport of the Court of inquiry Constituted Under Punjab Act II of 1954 për të hulumtuar Trazirat e Penxhabit të vitit 1953 (Lahor; Governamant Printing House, Punjab, 1954]. Gjykatësi zotëri Muhamed Munir (kryetar) dhe gjykatësi zotëri M.R. Kijani përbënin këtë këshill. Shënimet e mëtejshme të këtij raporti do të jipen si Raporti i Këshillit të Munirit.

### Kapitulli I

1. Shiko P.Schaff, Select Library of Nicene and Post-Nicene Fathers, Ist series, voLIV (Buffalo, 1887)
2. Proklamimi i Njëjtësisë së Zotit dhe propagandimi i Islamit dhe i profetit Muhammed s.a.v.s.

### Kapitulli 11

1. Molana Abul Ala Modudi, amir (prijës) i Xhamati islamit gjerë në vdekje, jetën e tij të hershme e kaloi në ish-principatën Indiane të shtetit të Hajdrabadit. Modudi i ri e braktisi shkollimin para se të përfundonte shkollimin e mesëm për shkak të vdekjes së babait të tij. Një kohë punoi si redaktor i AI-Xhamiat të Delhit, gazetë e Xhemiet ulamai Hindit. Më 1927 dha dorëheqje si redaktor dhe, duke punuar për një kohë të gjatë me

ulematë e Deobandëve, dedikoi jetën e tij për të studiuar teologjinë. Ishte autodidakt në teologji, në arabisht dhe në anglisht. Përkundër njohjes së të tij të thellë, diturisë së thellë dhe stilit të lartë të urdishtes që përbënin të gjitha pjesëpërbërëse të diturisë, kritikët veçanërisht ulematë e Deobandëve dhe ata të shkollës Laknao, thonë se mungesa e tij në edukimin e diciplinës teologjike ishte dobësi e madhe e tij. Më 1941 Molana themeloi Xhamatin islami dhe erdhi në krye të tij. Ai filloi të kritikojë Xhemiet Ulemae Hindin për shkak se mbanin teorinë nacionaliste që i ballafaqoi myslimanët e Indisë me rreziqe serioze të përvetësimit kulturo-religjioz të tyre në Hinduizëm, dhe në të njëjtën kohë sulmoi ashpër nacionalizmin mysliman të Kaide-Azemit (themeluesi i Pakistanit) se nuk është më pak i rrezikshëm se sa nacionalizmi i Kongresit. Për të nuk ishte me rëndësi që mund të jetojnë myslimanët jofetar të Indisë në formën e Pakistanit apo jo. (Myslman our Moxhudah Sijasi Kashmakash, Pathankot, 1946, 6-7).

2. AI-Xhihad Fil Islam, 137-8.

3. Revd Dr. C. G. Pfander, Mizanul Haq, 648, 499. 4. Revd Dr. C. G. Pfander, Tatimma Mizanul Haq.

5. Washington Irving, Mahomet and His Successors, 2 vols.(New York: G. P. Putmans's Sons, 1868).

6. Haqiqat-i-Jihad (Lahore: Taj Company Ltd, 1964), 64; i është dhënë shtojca.

7. Mbi detalet a fushatës së Dr. Pfanderit kundër Islamit, shiko: The Mohomedan controversy, The Calcutta, July -December 1845), vol. IV, 420.

8. Sir William Muir, The Life of Mohomet (London: Smith Elder &Co, 1859), vol.1 III



9. Përkthyer nga një fjalim, nga urdishtja, të Pandit Shastrit në mitingun e Gorakhpurit (Indi) më 1928, për të përkujtuar ditëlindjen a Profetit s.a, shiko: Dunja ka Hadi Ghairon ki Nazar Main, 57-61.
10. Sat Updaish, Lahore, 7 korrik 1915; shiko: Bargazida Rasul Ghairon ki Nazar Main Maqbul, 12-13.
11. Prof. Ram Dev, The Prakash, Bargazida Rasul Ghairon ki Nazar Main Maqbul, 24.
12. Dr. D. W. Leitz, Asiatic Quarterly Review, October 1886. Ai citon ajetet 40 dhe 41 të sures AI-Haxhit të Kuranit të Shenjtë.
13. Haqiqat-i-Jihad, op. cit, 65.
14. Mas'ala a Qomijat (Pathankot: Maktaba Jamaati Istami, 1947)
15. Ne kërkohet mbrojtjen a Allahut që të përdorim një gjuhë aq bangle që a përdor vetëm Molana Modudiu.
16. W. Tomas Arnold, The preaching of Islam, 2nd ed. (London, Constable and Co. Ltd, 1913).
17. Navan Hindustan, Delhi, 17 Nov. 1947. 18. Njohës i mentalitetit të Profetit të sjenjtë.

### Kapitulli III

1. William Haily, qeverisë së Indisë, 25 korrik dhe 12 gusht 1927, Govt.of India Home Political Proceedings 1927.
2. AI-Jihad Fil Islam, 93. Fjalët arabe janë: an Jadin vahum sagerun. 3. Ibid, 138.
4. Ibid.
5. W. Montgomery Watt, Muhammed at Medina (Karachi, Oxford University Press, 1981), 15.

6. Will Durant, *The story of Civilisation*, II vols. (New York: Simon & Schuster, 1950; vol. IV, *The Age of Faith*, 168.
7. Ibid. 157 8. Ibid.
9. Ata do t'i shndërrojnë shpatat a tyre në plorat dhe shigjetat do t'i shndërrojnë në çengela. Kombi nuk do të ngrisë shpatën kundër kombit tjetër a as që do të mësojnë më për luftë. (Libri i profetit Isaja, 2:4)
10. Fjala origjinale a Modudiut është 'Kalbarani', që bukvalisht do të thotë 'lëvrim'.
11. Maharaxha Kishen Perhad Shad ishte poet i urdishtes dhe persishtes dhe ishte i njohur për Nate Resulin [Hymnet për profetin a Islamit].
12. Harriet Rouken Lynton dhe Mohini Ragjan, *The days of the Beloved* (Berkeley: University of California Press, 1947), ix. Libri përshkruan jetën dhe kohën a Mahbub Pashës (1869-1911), Nizami gjashtë i Hajdrabadit.
13. U lind më 25 shtator të vitit 1903 në Aurangabad; Arif Batalvi, *Aik Modudi Das Islam* (Lahor).
14. Muinudin Akil, *Tahrike Pakistan our Molana Modudi* (Karachi: Khajale Nau, 1971), 27. Shumica a detaleve biografike janë marrë nga 'Molana Modudi Apni our Dusron ki Nazar Main' nga Muhamed Jusufi (Lahor: Maktaba AI-Habib, n.d.).
15. Muhamed Jusuf, op.cit; 363-4, n.d.
16. Molana Modudi më parë kish shkruar një libër mbi biografinë e Ganixhiut por qe ndaluar para se të botohej.
17. Muinudin Akil, op. cit.26; shiko Muhamed Jusuf, op.cit, 362-3.
18. Deccan ki Sijasi Tahrik dhe Dolate Asifijah our Hukumate Bartania.
19. FazlurRahman,

- Islam and Modernity - Transformation of an intellectual Tradition ( Chicago: University of Chicago Press, 1982).
20. Maktube a Hidajat (Deoband: Kutub Khana Izazijah), 21; shiko Molana Muhamed Akhtar, Modudi sahib Akabir-i-Ummat ki Nazar Main.
21. Molana Muhamed Akhtar, Modudi sahib Akabir-i-Ummat ki Nazar Main, op. cit,9.
22. Ibid, 15 23. Ibid, 48
24. Will Durant, The Age of Faith, op. cit, 159.
25. Joel Carmichael, The Shaping of the Arabs, a study in ethnic Identity (New York, 1967)
26. Maxime Rodinson, Mohamed, trans. Anne Carter (New York, 1971) 27. Fjala a përdorur nga Esma është shumë më poshtëruese.
28. Dy fise Jemene.
29. Ibn Hisham, Kitab Sirat Resul Allah, ed. F. Wusyenfeld, 2 vols. (Gottingen, 1856-60), 99-6.
30. Dy fise të Ansarëve, Ausët dhe Khazraxhët. 31. Ibn Hisham, op. cit, 995.
32. Nëna a kabit i takonte fisit jevrej an-Nadir. Edhe pse babai i tij ishte arab, ai merrej si anëtar i Banu an-Nadirit.
33. Ibn Hasham, op, cit, 548-9.
34. Si rezultat i një ëndërre, Profeti i Shenjtë~4 vendosi të shkojë në umra [haxhllëku i vogël] në Mekke me 1400-1600 njerëz. U vendos në skaj të territorit të Shenjtë të Mekkes, në AI-Hudejbijah, ku shkonin a vinin rreshtat a gjatë të myslimanëve dhe mekkasëve. Aty a nënshkrua një marrveshje sipas së cilës myslimanëve a lejohej të bëjnë Haxhllëkun në vitin a ardhshëm.

35. Beteja a Ahzabit apo ajo a Hendekut më 30 mars të vitit 627. 36. W. Montgomery Watt, Muhamed at Medina. op. cit, 69.
37. Ibid, 51-2. 38. Shiko faqen .  
152
39. W. Montgomery Watt, Muhamed at Medina, op. cit, 4. 40. Ibid.
- 41, Martin Lings, Muhamed, his Life Based on the Earliest Sources (London: George Allen & Unwin, 1983), 297.
- 42, Washington Irving, Mahomet and his Successors, 2 vols ( New York: G. P. Putman's Sons, 1868), vol. I, 253.
43. W. Montgomery Watt, Muhamed at Medina, op. cit. 68. 44. Maxime odinson, Mohammed, op. cit. 262.
45. Stanley Lane-Poole, Selection from the Kuran and Hadith, (Lahor: Sind Sagar Academy, n.d.), 28.
46. Maxime Rodinson, Mohammed, op. cit.312

## Kapitulli IV

1. Molana Modudi, Hakikati Xhihad (Lahor: Taxh Company Ltd.1964), 58 2. Edward Gibbon, Decline and Fall of the Roman Empire, vol. 5, ed. J. B. Buey (London:1909-14), 332
3. Bernard Lewis, The Jews of Islam (Princeton: Princeton University Press, 1983), 3.
4. James Drever, A Dictionary of Psychology (1964), 191.
5. Pierre Jannet, Les Observation et la psychasthenie (Paris: Alcan,1903); shiko Robert S. Woodsworth dhe Mary Sheehan, Contemporary School of Psychology

- (New York: The Ronald Press Company, 3rd ed, 1964), 253.
6. Elton Mayo, Some notes on Psychology of Janet (Cambridge, Massachusetts: Harvard University Press, 1984)
  7. Kurt Lewin, The Conceptual representation and the measurement of psychological forces, Contributions to Psychological Theory, I.
  8. Robert S. Woodsworth and Mary Sheehan, op. cit. 241.
  9. Konvercioni i fesë quhet irtidat dhe trajtohet si apostaci nga Molana Modudiu.
  10. Hugh Nissenden, Scripture and Survival, The New York Times Review, 17 mars 1985, 12.
  11. Fjala origjinale a Modudiut për 'fuqi politike' është 'iktida~ . 12. Hakikati Xhihad, op. cit, 10.
  13. Ibid, 11. 14. Ibid, 58. 15. Ibid.
  16. Ibid, 16-17. 17. Ibid.
  18. Ibid.15.

## Kapitulli V

1. Molana Abul Ala Modudi, 'Murtad ki saza islami kanun main'(Lahor: Islamic Publications Ltd. 1981 8th ed.)
2. Dr. AsrarAhmed,'Islam our Pakistan, Tarikhi siyasi ilmi aurthakafati pase manzar (Lahor: Anjuman Khudam-ul-Kuran, 1983). Dr. Asrar Ahmadi është ish shef i organizatës studentore të Xhamati islamit dhe më vonë u bë amir [prijës] i Xhamati islamit të Montgomrit. Ai pasiqë 10 vjet me radhë mori pjesë aktivisht në

aktivitete të ndryshme, dha dorëheqje nga anëtarësia a Xhamatit.

3. Seminari Deoband (Darul ulum) qe themeluar më 1867. Deobandi është i një qytet i vogël afër Delhit.

4. S. G. F. Brandon, Dictionary of the history of Ideas (New York, 1973), vol.II, 342.

5. C. J. Hefele, History of the Christian Counsils (Edinburgh, 1984), vol. III, 12. Shiko gjithashtu Durant Will, The History of Civilisation (New York, 1950), vol.1,48.

6. Will Durant, The story of Civilisation, 48.

7. P. Schaff, Select Library of Nicene and post-Nicene Fathers, Ist series (Buffalo, 1887), vol.IV, 640.

8. J. E. E. Dalberg-Action (Ist Baron Acton), The History of Freedom and Other Essays (London: Macmillan, 1907), 163.

9. Ibid. 178-9.

10. Thomas Hobbes, Leviathan, or Matter, From and power of a Commonwealth Ecclesiastical and Civil (Chicago: Great Books of the Western World, Encyclopaedia Britannica Inc. 1952).

11. Ibid. 210.

12. Dr. Asrar Ahmed, Islam our Pakistan, op. cit, 72.

13. Goldziher, Vorlesungen uber den Islam, 2nd ed. (Heidelberg, 1925). 14. Bernard Lewis, The Jews of Islam (Princeton University Press, 1983), 53.

15. The Daily Tasnim, 15 gusht 1952, 12. Shiko gjithashtu Mizaxh Shanase Resul, 372.

16. Molana Modudi, Musalman our maugjuda sijasi kashmakash (Pathankot: Maktaba Xhamati islami, 1941-2), vol.III, 130.

17. Ibid. 132. 18. Ibid. 166.

19. Musalman our magjuda sijasi kashmakash, op. cit. vol.III, 95.
  20. Ruidad -i- Xhamati islami (Ikra: Lahor: Shuba Nashr va Ishat, Xhamati islami, 1970), pjesa I, 16.
  21. Murtađ ki saza Islami kanun main, 1950.
  22. Murtađ ki saza Islami kanun main (8th ed.), op. cit., 72-3.
  23. AI-Buhari, Kitab al-Xhanaiz.
  24. Dictionary of the History of Ideas (New York), voLIV, 116.
  - ' 25. Murtađ ki saza Islami kanun main, 51.
  26. ibid., 32.
  27. Murtađ ki saza Islami kanun main, 35.
  28. Kurani, 87:14.
  29. Murtađ ki saza Islami kanun main, 51.
  30. Modudi, hakikati Xhihad (Lahor: Taxh Company Ltd, 1964), 64 31. I bid.,shtojcë.
- ### Kapitulli VI
1. Sahih al-Buhari, Bab Kitabul Imam al-Nas. 2. Ibid., Kitab al-Salat.
  3. AI-Ghazali, Faysal al-tafrika bejnal Islam va'I Zandakah (Kairo, 1901), 68.
  4. Munir Commission Report (Lahor, 1954), 28.
  5. Abdul Malik Ibn Hisham, Sirat Resulullah' ed. F. Wustenfeld, 2 vols. (Gotingen, 1856-60), 984: përkthyer nga A. Guillaume, The life of Muhammed (London Oxford University Press, 1970), fq. 667.
  6. Masnad Imam Ahmad Hanbal, voLV, 260.
  7. Mufredat al- Kuran.
  8. Kurani 6:67. Shiko gjithashtu 6:108, 17:55, 39:42 dhe 42:7.Fjala vakil është shpjeguar nga Imam Fahrudin Razi në Tefsir Kabir (Kairo,1308).
  9. Shënimi i shtuar.
  10. Abdul Malik ibn Hisham, Kitab Sirat resulullah, op. cit.,927.
  11. ibid., 381.

12. Ibid., 384.
13. Sahih al-Buhari (Kairo), vol. I libri 3,28. 14. Ibn Hisham, op. cit., 818.
15. Ibid., 819. 16. Ibid., 818-9. 17. Ibid., 819. 18. Ibid.
19. Ibid., 820. 20. Ibid., 469-9. 21. Ibid., 819.
22. Ibid. Ai-Zurkani, Sharah al-Mahavib al-Ladunjah (Kairo 1325), vol. II, 315
23. Ibn Hisham, op. cit., 728. 24. I bid., 819.
25. Ibid.
26. Muhamed Idriz al-Shafi, Kitab al-Um, botues Muhamed Zahri al-Nagjar (Kairo), vol. VIII, 256.
27. Ebu Xhafer Muhamed ibn Xharir al-Tabari, Tarikh al-Resul val Muluk, botues M.J. de Goeje (Leiden, 1964), vol.IV, 1874.
28. C.H. Becker, The Axpansion of the Saracans, The Cambridge Medieval ' History (New York: Macmillan, 1913), vol. II, 3335.
29. Muhamed Idriz al-Shafi, op. cit., 225-6.
30. Abdul Hamid Hibatultah ibn AI-Hadid, Sharah Nahxhul Balaghah, botues Muhamed Abu Fadl Ibrahim (Kairo, 1956-64), vol. VIII, 187. ' 31. C.H. Becker, op. cit., 335.
32. Bernard Lewis, The Arabs in History (London, 1958), 51-2. 33. Ashari, Makalat, vol. I, 191.
34. Ibn Hisham, op. cit., 688-9.
35. Sahih Muslim With Sharh al-Nawawi (Lahor: 1958,62), vol. II, 112-3. "" 36. Për tregime të ndryshme me dallime të vogla të fjalëve shiko Sahih al-Buhari dhe Sahih Muslim, Kitabul Iman. 37. Bernard Lewis, Islam in History, op. cit., 233.
38. Shiko detalet a Bernard Lewisit mbi analizën a gjenezës dhe evolucionin e këtij institucioni në historinë



islame në Isalm in history, op. cit., 217-36 dhe gjithashtu The jews of Islam (Princeton: Princeton University Press, 1984), 53-

39. Bernard Lewis, The Jews of Islam, op. cit., 100.

40. Ignaz Golziher, Muhammed and Islam, përktheu Kate Chambers Seeley (New Haven: Yale University Press, 1917), 74.

41. Bernard Lewis, The Jews of Islam, op. cit., 101.

42. Sir Judanah Sarkar, Short History of Aurangzeb (Kalkuta, 1954), 105-6.

43. But Bab [Door of thr Spirit]. Mirza Ali Muhamed, i cili deklaroi profetësinë a tij, a ekzekutua në Tabriz në korrik të vitit 1850.

44. Munir Commission Raport, 218, 219. 45. Ibid., 219.

18. Mizan al-Aitadal, vol. 2, 208. 19. Abu Daud, vol. II, 35.

20. Abu Xhafar Muhammed b. Amr b. Musa b. Hamad AI-akbli AI-Mulki, Kitab al Soafa AI-kabir (Liban: Darul Kutub AI-Almija). AI- Safr III, 1983, 373.

21. Abu Xhafar Muhammed b. Amr b. Musa b. Hamad AI-Akbli AI- Mulki, op. cit.

22. Mizan al-Aitadal, vol.2, 209. 23. Fathul Bari.

24. I biri i Abu Abbasit, axha i Profetit të Shenjtë°. Ibn Abbasi ishte vetëm një fëmijë në kohën a Profetit°.

25. Buhari, Kitab AI-Xhanaiz, kapitulli: 'Vajtım mbi të vdekurin.' 26. Hidajah.

27. Fathul Kadir, vol. IV, 389; vol.II, 580.

28. Chalpi, Commentary on Fathul Kadir, 388; Inayah, 390.

## **Kapitulli VII**

1. Termi i përdorur për katër kalifët a parë pas vdekjes së Profetit Muhamed°. Ata janë Hazret Ebu Bakri, Hazret

- Omeri, Hazret Osmani dhe Hazret Aliu. 2. Komentim: BahruIMuhit, vol. II, 237.
3. Tabari, vol. IV, 1873; Ibn Haldun, vol. II, 65. 4. Tabari, vol. IV, 1849.
5. Khamis, vol. II, 641.
6. Ibn Hixhr al-Askalani, AI-Isaba fi Tamiz-is- Suhaba (Bejrut: Darul Kitab AI-Arabi), vol.2. 448; Imam Allama IBn ul-thin Asadul Ghaba fi Marifate sahaba, vol.1.4,3.
7. Ibn al-Athir AI-Xhazri, Alkamil fil Tarikh (Bejrut: Darul Kutub al-Almija), vol.2, 201-5.
8. Tabari, vol.4, 1977. 9. Masbut, vol.x, 110
10. Fat-hul Bari, volLXII, 267; Imam Razi, Tefsir kabir, vol III, 614.
11. Buhari, Kitab al- Mustadin val Muanedin val Kitalihin, Bab Hukumul Murtad val Murtadda.
12. Abu Daud.
13. Kurani i Shenjtë thotë: Përse kur a kanë dëgjuar këtë (shpifje), nuk kanë menduar mirë besimtarët dhe besimtare për popullin a vet dhe përse nuk kanë thënë: Kjo është vetëm një shpifje a hapët? (24:13). Profeti i Shenjtë° ka thënë: Eshtë provë a mjaftueshme a mosbesimit të një personi se rrëfen diçka pa a vërtetuar atë.'
14. Buhari ( Botim arabisht-anglisht), volLIX, Libri 84, kapitulli 2 (Dar al-Arabia, Bejrut 1985).
15. Abdul Hai, AI-Raf val Takmil.
16. Të mos përzihet me Ikrama bin Abu Xhahlin. 17. Ibn Sad, AI Tabaka AI-Kabir, vol.2, 386.

## **Kapitulli VII 1**

1. Munir Commission Raport, 258.
2. Maxime Rodinson, Mohammad, përktheu Anne Carter (New York, 1971), 194. Një poet fisnor në mesin a

Beduinve, siç a paraqet Joel Carmichael, nuk ishte vetëm rreshtshkrues, por edhe ndezës i betejës; poemat a tij ishin 'mendime serioze mbi të filluarit a luftës.' (The Shaping of the Arabs, A study in Ethnic Identity, New York, 1967, 38). 3. Ibn Hisham, Kitab Sirat Resulullah, 995.

4. Ali b. Burhan ud Din ud Halabi, Insanul Ujun, vol. II, 116; cituar nga Kister, The Journal of the Economic and Social History of the Orient, vol. VIII. 267.

5. Ibn Hisham, op. cit., 459.

8. Ibn Hisham, op. cit., 550, përkthyer nga A. Guillaume.

7. Ibid., 386.

8. Ibid.

9. Ibid., 387. 10. Ibid., 726. 11. Ibid.

12. Ibid.

13. Will Durant, The Story of Civilisation, II vols. (New York: Simon & Shuster, 1950), vol. IV, The Age of Faith, 301.

14. Munir Commission Raport, 259.

15. Në Subkontinent (Indi dhe Pakistan) janë të njohur si Brelvi. 16. Deobandi Molvijon ka Imam.

17. Razakhani Fitna Pardazon ka sijasi xhut.

18. Shah Muhammed Asi dhe Sejed Muhamed Tanha, Shorish urf Bhare ka Tatu, 7-8.

19. Wilfred Kantwell Smith, Modern Islam in India (Lahor, bot. IL, 1947). 20. Munir Commission Raport, 257.

156 157

21. Mirza Ghulam Ahmadi, Izala-i-Uham (Amratsar, 1891), pjesa I, 176. 22. Mirza Ghulam Ahmadi, Aina-i-Kamalat Islam (Kadijan, 1893), fq. e fundit.

23. Ibid.

24. Mirza Ghulam Ahmadi, op. cit., Izala-i-Uham, 138.
25. Mirza Ghulam Ahmadi, Todihe Maram (Amratsar, 1308 p.h)
26. Sipas Kuranit, emri i babait të Ibrahimit a.s ishte Azar, ndërsa emri që iu dha nga një historian i Kishës, është Euzebius a jo Terah siç është dhënë në Genesis 11:26; Kuran, 6:75.
27. Sir Muhammed Iqbal, Bange Dara, Xhebab-i-shikvah, Vii, IX, X dhe XVII, përkthim i A. J. Arberry.
28. Aziz Ahmad dhe G.E. Grunenburg (Muslim Self-Statement in India and Pakistan, 1857-1968).

## **Kapitulli IX**

1. Në Luftën e Parë Botërore, forcat a mobilizuar të Aleatëve numronin 42,6 milion, kurse Forcat Qendrore 22,85 milion. Numri i viktimave të të dy palëve ishte 57,6 %. Në Luftën a Dytë Botërore kulmi i forcës ushtarake arrinte 72,581,566, nga të cilët a vranë 16, 829,758 vetë apo u zhduken dhe a plagosën 26,698,339 vetë. (Burimet: Arthur Guy Enoch, This War Business, London: Bodley Head, 1951, and Us Department of Defence). Këshilli për page Ndërkobëtare ka Ilogaritur se Lufta a Parë Botërore ka kushtuar \$400,000,000,000, duke përjashtuar pasuritë civile dhe jetërat a humbura. Sipas një Ilogarie, çmimi i Luftës së Dytë Botërore për kombet pjesëmarrëse arrin më shumë se \$1,098,938,000,000.
2. William J. Roehrenbeck, Collins Encyclopaedia, vol.1.23, article headed 'War Costs and Casualtie.

## FJALORTHI

Ahad gharib: Traditë për të cilën ekziston vetëm një zinxhir i treguesve të të vetmit burim.

Ahli Hadith: Njerëz të traditave - sekt i myslimanëve që të thënat e Profetit".a. i konsiderojnë burim kryesor ndaj burimeve tjera juridike.

Ahli Kuran: Njerëz të Kuranit - Ndjekësit a Ghulam Ahmed Pervezit a që a hedhin poshtë synetin dhe hadithet.

' Ahmedi: Anëtar i xhamatit Ahmedija të themeluar nga Hazret ' Mirza Ghulam Ahmadi nga Kadijani, India.

Ahrari Islam: Formë militante dhe a përpiktë a Vahabizmit. Axhami: Njeri jo-arab; i huaj.

AI-xhihad fil Islam Xhiahdi në Islam.

AI-Az-har: Universitet i myslimanëve ortodoks [Kairo]

Alim: Dijetar religjioz mysliman; shumësi: Ulema. An-Nabio bis sejf: Profeti i shpatës.

Ansar: Ndhimtarë - banorët mysliman të Medinës.

Arija Samaxhi: Lëvizje hinduse a shek. XIX a themeluar nga Svami Dajanandi.

As-habe kahf: Njerëzit a shpellës - titull i krishterëve të katakombeve.

Brelvi: Emri i Ahli synet val xhamatit [përcjellësit a synetit]. Dastar: Turban; lloj kapele.

Din: Fe, religjion, besim.

' Deobandi: Njerëz të njohur për nxjerjen a vendimeve të kodifi' kura religjioze.

Dhimmat: Përgjegjësi, obligim, mbrojtje.

Dhimmi: Jo mysliman në shtetin islamik, i cili paguan xhizjen. Divan: Përmbledhje poezish, odë, gjykatë mbretërore.

Fana fir Rasul: Person i kredhur në dashurinë a Profetitw~. ' Fakih: Teolog i specializuar në jurisprudencë.

Faraid dhe vaxhibat: Obligimet dhe detyrat religjioze.

Fatiha: Sureja a parë a Kuranit të Shenjtë~°.

Fetva: Vendim a dekret në çështjen a mësimëve të Islamit.

i Ghazve: Ekspeditë në të cilën Profeti i Shenjtë° vetë mori pjesë.

Hadd: Dënim i caktuar nga Kurani për kundërvajtje (sh. Hudud). Hadith: Të thënat a Profetit të Shnejtë~.~.

Haxhillëk: Pilgrimi në vende të shenjta- në Mekke a përreth. Hakam: Arbitër, ndërmjetues.

Hizbullah: Parti a Zotit.

Hixhra: Migrimi i ProfetitX~ nga Mekka në Medinë.

Ixhtihad: Arsyetim i pavarur në jurisprudencë islamike.

Imam: Hoxh, udhëheqës i namazit në xhami.

Irtidad: Tërheqje nga parimet religjioze. Imaili: Sekt shit.

Jathreb: Emri i vjetër i Medinës.

Kaba: Shtëpia a Zotit, shtëpia a parë a ndërtuar për adhurimin e Allahut. Gjendet në Mekke, ku shkojnë myslimanët për HaxhiJlëk.

Kadi: Gjykatës.

Kafir: Mosbesimtar, femohues (sh. kuffar). Kafirana:

Mendime a gjeste jo besimtare. Kalif: Trashëgimtar i profetit, zëvendës. Kazif: Akuzues i rrejshëm.

Khatamun-Nabijin: Vu1a a profetëve, titulli i Hazret Muhamedit nabijin s.a.s.

Khatme nabuvat: Finaliteti apo kulmi i profetëtsisë shariatprurëse që është marrë fund me ardhjen a Muhamedit~.°.. Khavarixh: Ata që a mohojnë kilafetin a Hazret Aliut.

Kufr: Mosbesimi.

Muharaxha: Sundues provincial indas, monark.

Mahdi: I udhëhequr drejt; Imami ardhja a të cilit është paraparë nga të gjitha religjionet.

Molana Shoku ynë; titull nderi për dijetarët a fesë.

Molvi: Hoxh, teokrat mysliman, mull; tiler mendjengusht. Mazar: Varr.

Miraxh: Udhëtimi vizionar i Profetit të Islamit<sup>^</sup>.~. në qiell. Mizaxh shenasi Titull nderi dhënë nga Arabia Saudite; personi, i cili është në harmoni komplet me zemrën a me mendjen a Profetit~~ aq sa që nga ai kërkohen mass të autoritetit.

Mufti: Person autoritativ që lëshon fetus.

Muhaxhir: Emigrant, ata që emigruan nga Mekka në Medinë. Muxhadid: Reformator që pritet në krye të çdo shekuJli. Munafik: Hipokrit (sh. munafekun).

Murtad: Ai që heq dorë nga besimi i mëparshëm.

Nabuvat: Profetësi; periods a një nabi (profeti). Namus: Nderi.

Nauzo billah: Kërkoj mbrojtjen a AJlahut nga ... Raxha: Sundues mbretëror indas.

Resul: Profet, nabi. Sabb: Sharje.

Sabi: Ai që heq dorë nga religjioni i tij i mëparshëm.

Sahabi: Besimtari që ka pranuar fenë Islame dhe që a ka parë dhe Muhamedin s.a.s.

Sahih: TituJl i përmbledhjeve të të thënave të Profetit,,~..

Salat: Namaz apo lutje para zotit.

Sarija: Ekspeditë në të cilën Profeti i Shenjtë<sup>o</sup>~. nuk mori pjesë. Sufi: Përcjellës i sufizmit.

Sunni: Sekt i myslimanëve që i bindet Kuranit dhe Syнетit dhe që i pranojnë katër kalifat a parë.

Sunnah: Syneti - burimi i dytë juridik i Islamit, pas Kuranit. Shahadeti: Deklarimi i besimit mysliman: Dëshmoj se s'ka Zot tjetër pos Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe profeti i Tij.

Sheriati: Libri i shenjtë i një religjioni, si Kurani. Tevrati dhe Bibla.

Shia (shit): Njeri nga dy sekte themelore të Islamit. Përcjellësit e Hazret Aliut.

Shirk: Besimi ndaj shumë zotave, paganizëm, idhujtari. Shuddi: Lëvizje hinduse që ka për qëllim t'i rikthejë në Hinduizëm ata, të cilët a përqafuan fenë Islame.

Tefsir: Komentim i Kuranit të Shenjtë.

Tahrif: Ndërrimi i fjalëve apo shkronjave me qëllim që të ndërrohet kuptimi esencial.

Umma: Komunitet religjioz, përcjellësit a Profetit të Islamit°. Vahabizmi: Lëvizje a emëruar sipas Abdul Vahabit (1703-87) në Arabinë Saudite që refuzon përsosmërinë a Profetit°. Xhemat: Komunitet, shoqatë. Xhemati islami: Partia politike a themeluar më 1941 nga Molana Abul Ala Modudiu.

Xhame Masxhid: Xhamia kryesore në ndonjë qytet.

Xhennatul Baki: Varreza a Medinës ku janë varrosur shumë sahaba të njohur të Profetit Muhamed°.

160 161

Xhihad: Përpjekje për të mbrojtur a për të shpërndarë Islamin. Xhizja: Taksë a përgjithshme a obliguar për jo myslimanë për mbrojtjen a tyre në një shtet islamik.

Zandakah: Herezi, ateizëm.